Mal Berisha

Jeta e jashtëzakonshme e amerikanit

CHARLES TELFORD ERICKSON

kushtuar Shqipërisë



Biografi

BOTIME
EDUALBA
2012

Drejtor i botimit Bardhyl Musai, prof.dr.
Redaktor letrar Tomorr Plangarica, prof.dr.
Korrektor letrar Teuta Toska
Korrektor teknik Emroda Zylfi
Ballina Ina Musai
Arti grafik Edualba studio

Për botimin e librit kontribuan kompania INSIG, Shtëpia Botuese e Librit shkollor Prishtinë, kompania American Global Consulting Retail Ltd., si dhe z. Saimir Zemblaku

SHTËPIA BOTUESE
LIBRI SHKOLLOR
Prishtinë

INSIG

INSIG
KOSOVË

AGC

Botuar nga Edualba
Rruga Mustafa Matohiti,
Pallati nr. 7, shkalla 1, nr. 2/1,
Tiranë
Tel: +355 4 2247884
www.edualba.com
Botimi i parë, 2012
ISBN: 978-99-28-121-578

© 2012 Mal Berisha & Edualba
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem kërkimi ose të transmetohet në çdo formë ose me çdo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistrues ose tjetër pa lejen me shkrim të botuesit.

Emër i harruar i një njeriu me përkushtim të pazakontë, që e deshi pafundësisht Shqipërinë, që sakrifikoi si askush tjetër në këtë botë për të mirën e popullit shqiptar. Nderim përjetë, emrit, veprës dhe kujtimit të tij.

PËRMBAJTJA

Mirënjohje..... 6
Parathënie..... 7
Tu-ngjat-jeta Shqipëri!..... 13
Charles Telford Erickson-i para se të arrinte në Shqipëri..... 16
Misionet amerikane në Perandorinë Osmane. Si lindën dhe u zhvilluan ato?..... 20
Erickson-ët në Shqipëri, 1908..... 26
Korçë – Sarandë - Korfuz - Durrës – Tiranë..... 36
Jeta e familjes Erickson midis tiranasve..... 43
Mëdyshjet Tiranë – Elbasan..... 48
Një fillim i ri - në Elbasan..... 54
Jeta e Erickson-ëve midis elbasanasve..... 56
Mbretërimi i terrorit..... 61
Dasma e Kristo Dakos në Manastir; hapja e shkollës "Erickson" në Elbasan..... 64
Arrati në malet e Elbasanit..... 68
Në internim – Manastir, 10 shtator 1910..... 73
Çështja "Erickson" në Shqipëri, midis DASH dhe qeverisë osmane..... 77
Luftë, uri dhe murtajë në Manastir..... 82
Kristo Dako, pishtar i arsimit..... 85
…Përsëri në Elbasan..... 88
Dhe malet rreth tij..... 90
Aksidenti i Earlit në Elbasan dhe vdekja e tij në Zvicër..... 92
Meditime në udhëtimin e kthimit në Shqipëri,..... 98
Shqipëria e pavarur – Erickson-i nën arrest nga pushtuesit serbë, dhjetor 1912..... 99
Kthim në mort në Elbasan - dëbimi nga serbët pushtues..... 103
Ecejaket e Erickson-it në Shqipërinë e pavarur 108
Vuajtjet dhe nevojat e Shqipërisë, shkrime në "The Economist", Londër..... 114
Flaka e Luftës ballkanike..... 130
Vlora dhe pushtimi italian..... 133
Me kryqin e kuq amerikan në Itali – mendjen te Shqipëria..... 148

Delegat nderi i Vatrës në Konferencën e Paqes në Paris, 1919..... 151
Presidenti Wilson 155
Katërmbëdhjetë pikat e presidentit Wilson..... 159
Kontributi i C.T. Erickson-it në Konferencën e Paqes në Paris, 1919..... 162
Ditët e Konferencës së Paqes në Paris, 1919..... 178
Një mandat amerikan për Shqipërinë..... 184
Erickson-i dhe parimet e ndërtimit të një shteti të ri demokratik shqiptar..... 189
Komisioner shqiptar në Uashington DC..... 197
Diplomat në Ambasadën amerikane në Tiranë, 1922..... 217
Emisar për gjetjen e një mbreti për kurorën shqiptare – anglezi Aubrey Herbert..... 223
Shqipëria, vendi i zhgënjimeve politike të pafund..... 229
Eksplorator i vajgurit shqiptar..... 234
Themelues i shkollës shqiptaro-amerikane të bujqësisë dhe shkollës së vajzave në Kavajë, 1923 – 1939 242
Organizimi i shkollës shqiptaro – amerikane të bujqësisë në Kavajë..... 255
Erickson-i dhe shkolla e vajzave në Kavajë..... 259
Mbajtës i medaljes "Urdhri i Skënderbeut" dhe vitet e fundit në Shqipëri..... 263
Mik nderi i mbretit Zog në festimet e 25-vjetorit të pavarësisë në Tiranë..... 269
Nderim tek varri i Nënës Mbretëreshë..... 274
Pushtimi fashist italian dhe fati i shkollës së Erickson-it në Kavajë 277
Delegati zyrtar i Vatrës në Konferencën e Kombeve të Bashkuara në San Francisko, 1945..... 281
Letra të parreshtura për Shqipërinë..... 319
Në Amerikë përsëri në shërbim të Shqipërisë, deri në fund të jetës..... 323
Radiotransmetimet për Shqipërinë, Boston, 1 shkurt 1942..... 330
Nderim nga Federata Panshqiptare Vatra fill pas vdekjes 370
Takimi im me Ericksonët "pas 100 vjetësh"..... 373
Epilog me kujtime nga nipërit dhe mbesat e dr. Charles Telford Erickson, SHBA… 375
Mbyllje..... 382
Foto album..... 385

MIRËNJOHJE

Dua të falënderoj për përgatitjen e këtij libri, më së pari, familjen time, prindërit e mi, Bajram e Sibe Berisha për sakrificat e mëdha që kanë bërë për shkollimin tim.Veçanërisht babai im i ndjerë ka qenë burimi kryesor i frymëzimit tim si shembull dhe model i njeriut që edhe në ditët e fundit të jetës së tij, edhe pse e dinte fundin e pashmangshëm, vazhdonte të lexonte libra për njerëzit e mëdhenj. Dua të falënderoj zonjën time Donika, për mbështetjen e pakursyer dhe ndihmën direkte që më ka dhëne gjatë tërë periudhës që jam marrë me këtë vepër, mbledhje, fotografime, sistemim materiali etj. Falënderoj djemtë e mi Erionin me të shoqen Kreuzën dhe Kreshnikun për mbështetjen e gjithanshme, edhe financiare, dhe inkurajimin gjatë tërë viteve të punës kërkuese dhe studimore për arritjen e botimit. Një mirënjohje të thellë dua t'i kushtoj Yale Divinity School Library në New Haven, Connecticut dhe posaçërisht arkivistëve Martha Smalley dhe Paul Stuehrenberg. Po ashtu falënderoj zonjën Nevila Nika dhe Emona Metalia nga Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar. Një falënderim dua t'i kushtoj zonjës Pranvera Dibra nga arkivi i MPJ në Tiranë, z. Nicholas C. Pano, Profesor Emeritus i historisë në Western Illinois University në ShBA; At Artur Liolinit nga Kisha Ortodokse Shqiptare në Boston dhe Federatës Panshqiptare Vatra, në New York. Dua të falënderoj gazetarin dhe historianin Ilir Ikonomi në Uashington D.C. për ndihmën e dhënë me një numër dokumentesh. Një falënderim shkon edhe për z. Vezir Muharremi, i cili më ka ofruar shumë dokumente të rëndësishme për Erickson-in si dhe z. Endrit Reka për ndihmesën e tij. Ndihmesa e z. Bejtullah Destani, drejtori i Qendrës për Studime Shqiptare në Londër ka qenë e jashtëzakonshme. Po ashtu, dua të falënderoj ish-gaztarin e BBC – së, z. Gëzim Guri në Londër, studiuesen e gjuhës shqipe dhe hartuesen e fjalorit të parë japonisht – shqip, znj Reko Dida në Tokio për ndihmën në redaktimin e materialeve. Falënderoj me zemër sponsorin e librit, z. Saimir Zemblaku, i cili me fondet e veta dhe të kompanisë "INSIG" që ai drejtonte kur po përgatitej libri mundësoi botimin e tij dhe kompaninë e djemve të mi, American Global Cunsulting Ltd., në Tiranë. Dhe pa dyshim falënderimi më i madh është për Zotin që krijoi rrethanat e lirisë për mua, si për tërë shqiptarët, që të udhëtoj, hulumtoj, mbledh dhe shkruaj i lirë në vendin tim për një njeri si C.T.Erickson-i, që mbi çdo gjë adhuronte lirinë dhe dinjitetin e shqiptarëve.

PARATHËNIE

Çdo rrugë e gjatë fillon me hapin e parë. Përgatitja e biografisë dhe vetë veprës së Charles Telford Erickson-it, për mua ka qenë një rrugë e gjatë dhe jo pak e mundimshme, por edhe shumë e bukur dhe intriguese në vetvete. Hapi i parë i kësaj rruge të gjatë nisi sapo lexova vlerësimet që këtij burri të madh ia bënte një politikan i shquar i Ballkanit, ish-Presidenti i Bosnje – Hercegovinës, dr. Harry Silajxhiç. Ai për habinë time ishte bërë doktor i shkencave historike me një punim shkencor me titull: *"Çështja shqiptare në arkivat amerikane"*. Në një mori dokumentesh dhe emrash të përmendur aty gjendej edhe ai i Charles Telford Erickson-it. Si një vetëtimë që të shkrep në mendje nganjëherë, u vura në kërkim të veprës së këtij njeriu dhe gjeta pikërisht atë që po i paraqes lexuesit.

Më duhet t'u them lexuesve të mi që në fillim se njeriu që flet në këtë libër për Charles Telford Erickson-in është vetë ai, Erickson-i, sa me veprën e tij të madhe në dobi të Shqipërisë, aq edhe me shkrimet e lëna trashëgim. Ky libër është shkruar në prag të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Në fakt periudha gjatë së cilës jam marrë me të, për mbledhjen dhe përpunimin e tërë materialit deri në hedhjen përfundimtare në letër është pikërisht periudha kur u mbushën 100 vjet që kur ai shkeli për herë të parë në Shqipëri. Është e tepërt ndoshta të them se tanimë asgjë nuk i ngjan kohës kur Erickson-ët erdhën në

Shqipëri, në vitin 1908, madje as kur ikën prej saj, tridhjetë vjet më vonë. Gjithçka ka ndryshuar që nga peizazhi, infrastruktura, mënyra e jetesës, edukimi, vetë jeta. E vetmja gjë e njëjtë, e pandryshuar dhe që ne na pëlqen të jetë ashtu siç është, është shpirti i shqiptarit: ashtu siç e gjeti, e pa, e zbuloi, e përshkroi, e nderoi, e himnizoi dhe e la, Erickson-i.

Brenga e atij njeriu që e deshi aq shumë Shqipërinë do të ishte kthyer në gëzim për të nëse ai do të shihte se sa shumë ka ndryshuar Shqipëria. Përkundër prapambetjes së patregueshme që lanë prapa osmanët, shkatërrimit që shkaktuan luftërat ballkanike dhe copëtimi i trojeve shqiptare, intrigave europiane për zhdukjen nga harta të Shqipërisë, pushtimit fashist, vendosjes së një regjimi diktatorial komunist, prapë Shqipëria arriti të mbijetonte dhe t'i bashkohej familjes së kombeve të qytetëruara. Kombi më i vjetër i Europës i është rikthyer qasjes së vet perëndimore me shpejtësi të pabesueshme, në një rrugë zhvillimi të cilën edhe njeriu më optimist dhe më i dashur për të, Erickson-i, zor se do ta kishte besuar. Dhe të mendojë njeriu se ora e shqiptarëve kishte ngecur shumë herë në historinë e saj. Në fakt kur ai shkeli në Shqipëri, tik-taku i orës së shqiptarëve sapo kishte filluar të trokiste përsëri, pas 430 vjetësh.

★★★★★

Puna për zbulimin, përzgjedhjen, digjitalizimin, sistemimin, përkthimin dhe jetëshkrimin e veprës së Erickson-it, sado e vështirë të më jetë dukur, ka qenë më e lehtë sesa gjetja e përgjigjes për pyetjen: "Çfarë e shtyu këtë njeri t'i kushtonte jetën Shqipërisë?"

Kjo pyetje më ka shoqëruar edhe kur kërkoja në bibliotekën e presidentit Herbert Hoover, edhe në bibliotekën e Universitetit Minosota, në Arkivin e Departamentit të Shtetit apo bibliotekën "Yale University Divinity School Library" në New Haven në shtetin Connecticut, në Arkivin Qendror të Shtetit shqiptar apo në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, në arkivin e Kantonit Somerset apo në atë të British Museum, aq sa edhe në faqet e pafund të internetit.

Janë me qindra mijëra faqe dokumente të lëna trashëgim prej tij, të shkruara, të ruajtura, të pabotuara, të botuara ose edhe të ribotuara.

Pra, çfarë e bëri amerikanin Charles Telford Erickson të merrte udhën drejt Shqipërisë në moshën dyzetedyvjeçare, bashkë me familjen dhe fëmijët, atëherë kur njeriu kujdeset më shumë se asnjëherë për të konsoliduar rehatinë dhe të ardhmen e vet dhe të familjes? Dhe nëse ai e mori këtë udhëtim për një mision që bazohej në bindjet e tij fetare, çfarë e lidhi atë kaq shumë me Shqipërinë dhe shqiptarët? Përgjigjen do ta gjejmë në tërë ato çfarë ai ka shkruar dhe në mënyrë të veçantë në materialet e përzgjedhura dhe të botuara në këtë libër.

Ai erdhi në Shqipëri si misionar, si një pastor i përgatitur në mënyrën më të shkëlqyer nga institucionet e shërbimeve fetare protestante, nga njëra anë, por edhe me dijenitë e marra nga një prej universiteteve më në zë në botë, Universiteti Yale. Por në Shqipëri ai vuri re menjëherë se:

"Gjëja më e fundit për të cilën kishte nevojë Shqipëria e vitit 1908 ishte evangjelizmi". [1]

Për këtë, pasi preku me dorë realitetin, studioi, hulumtoi, perceptoi, kuptoi thellë virtytet e mrekullueshme të popullit shqiptar, u kthye nga një pastor i thjeshtë kishe, nga një misionar fetar, në një korife përhapjeje arsimi, kulture, shkence, kulture bujqësore, dije, diplomacie, politike…

Erickson-i u kthye në një figurë që e lidhi emrin e tij me disa nga momentet më të rëndësishme të zhvillimit të Shqipërisë në disa fusha. Ai shumë shpejt kuptoi se në Vendin e Shqiponjave jetonin vërtet "bijtë e shqipes", siç i quan ai në çdo libër të tij, njerëz të cilët, edhe pse të zhytur në prapambetje për shkak të natës së gjatë e të errët osmane, ruanin brenda vetes virtytet më të larta njerëzore. Ai kuptoi se ky popull nuk meritonte këtë fat. Andaj luftoi tërë jetën e tij, që kur u njoh me shqiptarët, për ta ndryshuar atë. Ai luftoi për ta nxjerrë popullin tonë nga kjo skëterrë, herë i vetëm, herë i ndihmuar nga shqiptarët, herë nga miq të tij të huaj.

[1] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26.

Ai asnjëherë nuk e pat të lehtë, për shkak të armiqve të popullit shqiptar, të cilët u kthyen pa dyshim edhe në armiq të tij të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Unë besoj se ky libër mbi jetën e Erickson-it në Shqipëri dhe për Shqipërinë do të bëjë që çdo shqiptar të ndiejë një detyrim shpirtëror që i kemi këtij burri të madh, njeriu të shquar, kolosi të mendimit politik në dobi të Shqipërisë, misionari diplomatik amerikan në Shqipëri dhe atij shqiptar në Amerikë, njeriut që e deshi Shqipërinë deri në çastin e tij të fundit të jetës. Le të jetë ky libër një haraç i paguar, ndonëse shumë vonë, ndaj veprës së pashoqe të këtij amerikani, i cili që prej kohës kur erdhi në Shqipëri deri në vitin 1966 kur i mbylli sytë, ishte personi të cilit, në mënyrë të besueshme, mund t'i referohej qeveria amerikane për opinione që kishin të bënin me kombin tonë. Le të jetë ky libër një kontribut për ta nxjerrë atë nga harresa.

Nxjerrja në dritë e veprës së Erickson-it dhe nderimi i figurës së tij nga shteti shqiptar në fakt është një nderim për atë çfarë burra të mëdhenj si Erickson-i kanë bërë për vendosjen dhe çimentimin e themeleve të shtetit shqiptar dhe të së ardhmes së tij. Erickson-i, në përkushtimin e tij idealist ndaj kombit shqiptar, luftoi shumë që Shqipëria të vihej nën një mandat amerikan. Sado pak realiste të duket kjo sot, në kohën kur u hodh ajo ide prej tij shihej si një mënyrë shpëtimi nga lakmitë grabitqare të fqinjëve. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, në një farë mënyre, plotëson ëndrrën e Erickson-it për ta bërë Shqipërinë një aleate të vërtetë të ShBA-së dhe një shtet të sigurt nga çdo sulm. Por edhe ëndrra e tij për ruajtjen e trojeve shqiptare nga copëtimi do të ishte plotësuar, deri diku, kur të shihte Kosovën e pavarur.

Hartimi i kësaj monografie ose përshkrimi i veprimtarisë së Erickson-it është mbështetur në disa shtylla kryesore. Së pari, në Koleksionin Erickson[2], të cilin, me shumë dashamirësi e vuri në dispozicion Yale University Divinity School Library në New Haven, ShBA. Një pjesë e këtij libri është mbështetur, dhe cituar

[2] Po aty.

shpesh, në disertacionin doktoral për shkenca historike të Alan Fusinesë, "Shkolla bujqësore e Kavajës"[3], i cili përbën edhe studimin e parë dhe të vetëm për jetën e Erickson-it. Po ashtu, një material dyzet faqesh i shkruar në vitin 1968 nga Alice Lee Welsh - Erickson, gruaja e dytë e C.T. Erickson-it, i quajtur *"T'huajtja ime nga qytetërimi"*[4], bazuar në kujtimet e Erickson-it, dhuruar Universitetit Minosota, më ka ndihmuar shumë. Letrat e Erickson-it, të ruajtura në "Koleksionin Erickson" po ashtu përbëjnë bazën e librit, koleksion nga janë marrë shumica e dokumenteve të korrespondencës së tij. Edhe libri "Nënkresa e gurit"[5] e shkrimtares amerikane Phyllis Cole Braunlich më ka dhënë një mundësi tjetër për t'u njohur me jetën e Erickson-it në Shqipëri. Një koleksion i vogël dokumentesh i ruajtur në Arkivin Qendror të Shtetit shqiptar[6] dhe në atë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë□ përbëjnë një bazë të mirë dokumentare. Ndërsa dokumente të caktuara në British Museum, artikuj gazetash të "The Economist"[7] në Londër dhe disa tjera në Arkivin e Somerset County Records[8] në Britaninë e Madhe, e plotësojnë këtë mozaik shumëngjyrësh dokumentesh. Të gjitha këto materiale përbëjnë shtyllat për ndërtimin e këtij libri, i cili në të vërtetë është një përmbledhje, harmonizim, përpilim dhe botim kujtimesh të shkruara nga vetë ai dhe njerëz që e kanë njohur, dashur, vlerësuar, respektuar dhe përjetësuar. Duke pretenduar se, bazuar në tërë këtë material të shfrytëzuar, edhe unë jam një prej njerëzve që e njoh jo personalisht, por në distancë kohore, shpreh po ashtu atë vlerësim të lartë që më ka frymëzuar, nxitur, madje edhe shtrënguar që t'i jap lexuesit një përshkrim real të jetës dhe veprimtarisë së një njeriu që e ka dashur vendin tonë me gjithë zemër. Më duhet të them se si shpërblim dhe duke njohur thellë veprën e tij, edhe unë vetë ia kam kthyer dashurinë për shqiptarët po me të njëjtën mënyrë me dashuri e respekt pa fund për atë që ai ka bërë për ne.

---

[3] Po aty.

[4] Minosota University Library.

[5] Stone Pillow, written by Phyllis Cole Braublich. Amazon.com

[6] Arkivi Qendror i Shtetit shqiptar – Dosja Erickson.

[7] "The Economist" Collection, London.

[8] Somerset County Records.

Duke besuar se asgjë nuk humbet dhe se e mira vonon, por nuk harron, dua që me këtë rast të citoj letrën që Timothy L. Smith,[9] profesor i historisë, drejtor i Bibliotekës së Emigrantëve, në Universitetin Minosota, i dërgonte më 15 nëntor 1965 zonjës Alice Erickson:

> *"… E mora iniciativën dhe i shkrova Bordit Amerikan (të Misionarëve të Huaj) për të parë nëse dosjet e korrespondencës (së Erickson-it) apo raporte të tij të ruajtura, përmbanin punën e tij, në atë mënyrë që të mos i humbasë emri kur të vij dita që historianët e Shqipërisë të merren me figurën e tij. Në ndërkohë, mund t'ju siguroj se dorëshkrimi mbi Historinë e Shqipërisë, të cilin e ka përgatitur z. Erickson, edhe nëse nuk ka aq shumë interes për t'u botuar, në të ardhmen do të jetë i një interesi të konsiderueshëm për studiuesit të cilët do të kërkojnë të kuptojnë më mirë historinë e atij vendi…"*[10]

Unë mendoj se mbledhja dhe botimi i veprës së Erickson-it ka përmbushur pikërisht këtë parashikim të profesorit të nderuar amerikan, Timothy L. Smith pasi si shqiptar kam përmbushur deri në një farë mase atë parashikim të këtij profesori largpamës. Megjithatë, bashkë me botimin e librit, do t'i dorëzoj Arkivit Qendror të Shtetit Shqiptar tërë dokumentacionin që zotëroj, si dhe materiale të papërdorura të mbledhura në biblioteka të ndryshme. Ndoshta në të ardhmen do të ketë historianë që do të shkruajnë një histori edhe më të bukur për këtë figurë kaq emblematike amerikane. Le të jetë ky libër një nderim i madh për Erickson-in dhe një dhuratë për jubileun njëqindvjeçar të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Mal Berisha

Londër, shtator 2012

[9] Timothy Lawrence Smith (1924-1997) ishte një historian i shquar dhe edukator, i njohur si historiani i parë amerikan i botës ungjillore dhe hulumtues i njohur në fushën e arsimit. Ai ishte diplomuar në Universitetin e Virxhinias dhe mori gradën e lartë të studiuesit Tomas Xheferson dhe Phi Kappa. Më vonë ai mori gradën "Doktor i shkencave historike" nga Universiteti Harvard.

[10] Letër e profesor Timothy Lawrence Smith nga departamenti i historisë, Minneapolus – Minossota, 15 nëntor 1965, Biblioteka e Universitetit Minosota.

TU-NGJAT-JETA SHQIPËRI!

Është kjo fjala e parë shqipe që do ta shkruante dhe shqiptonte Ç. Telford Erickson në mbrëmjen e datës 8 shtator 1908, nga Korça, dhe do t'ia dërgonte mikut të tij Ted në Boston. Ishte kjo ajo fjalë e parë të cilën ai e përsëriti me qindra mijëra herë në biseda, në shkrime, në letra, të cilat i shkruante në anglisht, por edhe në shqip deri në fund të jetës së tij. Ishte fjala e parë që mësoi dhe e lidhi me Shqipërinë në mënyrë të pazgjidhshme. Ishte një fjalë për të cilën ai thoshte se është e rrallë, e bukur, shprehëse, më shprehëse se çdo fjalë që mbart të njëjtin kuptim në çfarëdo gjuhe tjetër të botës[11].

Ishte ajo mbrëmje në Korçë kur ai filloi të fliste me simpati për atë vend të cilin e shkelte për herë të parë dhe që do t'i kushtohej me mish e me shpirt, me punë e me pasion, me fëmijë e me grua, me gjithçka të tij, deri edhe me jetë.

I dashur Ted, "Tu-ngjat-jeta"!

Po e filloj kështu me fjalën përshëndetëse në gjuhën shqipe. Siç e sheh, unë tashmë e flas gjuhën e këtushme si ai i vogli që fillon të studiojë dhe, kur i pyetur në fund të javës se a i kishte pëlqyer mësimi ai përgjigjet: "Edhe nëse nuk më pëlqeu,

[11] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 6.

prapëseprapë e mësova". Mua nuk është se nuk më pëlqeu, përkundrazi e mësova këtë që ju shkrova menjëherë dhe me dëshirën më të madhe. Sepse në tetëmbëdhjetë orët e udhëtimit me karrocë nga Manastiri deri këtu, ne takuam tërë ata njerëz dhe secili prej tyre na përshëndeti me të njëjtat fjalë: "Tungjatjeta!" Pastaj na përcollën me fjalët: "Udhë të mbarë"! Me të gjitha ato që në fakt mund t'i ndodhin njeriut në këtë vend gjatë udhëtimit, kjo përshëndetje vjen e të duket përherë e më e ngrohtë, më e ëmbël. Kur një shqiptar merr përsipër të udhëtojë me ty për të të ruajtur (duke mos e bërë kurrë për para), atëherë në mendjen tuaj mbetet diçka që nuk hiqet lehtë. Për shembull, ne kaluam një vend në rrugë të cilën na e tregoi shoqëruesi ynë, z. Qiriazi, themeluesi i Misionit Amerikan në Korçë dhe që më habiti fare.

…Vetëm se për një gjë jam i sigurt: Çfarëdo të më mungojë në këtë vend, aventura nuk do të më mungojë asnjëherë, madje deri me rrezik për jetën. Këtu thithet ajër i pastër dhe i freskët. Këtu ka një egërsi dhe një liri që na rrethon, e cila e bën këtë vend të ndryshëm nga krejt bota tjetër, e veçanërisht nga jeta konvencionale në atdheun tonë."

Pas një përshkrimi të hollësishëm të udhëtimit, formën e karrocës, sjelljen e karrocierit, ai vazhdon me letrën, duke dhënë një variant shqiptar të krijimit të botës dhe të vetë Shqipërisë:

"Pamja e këtij vendi qenka madhështore dhe pothuajse krejt ashtu siç e paska bërë Krijuesi. Shqiptarët kanë shpjegimin e vet se si është krijuar vendi i tyre. Ata thonë se kur Krijuesi e kishte formësuar tërë gjithësinë, pa se i kishin mbetur edhe disa thasë të mëdhenj të mbushur me gurë. Në mungesën e Tij momentale ndodhi një tërmet i tmerrshëm. Kur u kthye, Ai pa se tërë thasët e gurëve që kishte lënë ishin ndarë e shpërndarë. Ai vendosi t'i linte ashtu siç ishin përhapur dhe kështu u formua vendi që më vonë mori emrin Shqipëri."[12]

Erickson-i, sapo futet në tokën shqiptare, ndalet, mëson dhe më vonë përshkruan masakrën që qeveria e sulltanit ndërmori ndaj tërë parisë shqiptare në

[12] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5. Letters from Ch. T. Erickson to Barton American Board of Commissioners of Foreign Missions – European Turkey Missions 1900-1912.

një fshat në të dalë të Manastirit. Në vitin 1830, tërë paria shqiptare prej pesëqind burrash u thirr nga sulltani për të diskutuar për kërkesat që shqiptarët herë pas here i parashtronin atij. Për tri ditë ata u dëgjuan me vëmendjen më të madhe, u mor shënim çdo kërkesë e tyre dhe u premtua se secila prej tyre do të përmbushej më së miri. Pas kësaj turqit i ftuan shqiptarët për një darkë të madhe në një anë rruge, në dalje të Manastirit. Shqiptarët, të mashtruar, shkuan në "gosti" në një vend tërësisht të rrethuar nga një mur natyror prej shkëmbi, në një livadh të izoluar. Sapo arritën aty, ata u sulmuan nga mijëra forca ushtarake turke, të cilët i ekzekutuan nga i pari tek i fundit. Në këtë mënyrë u sharrua e tërë burrëria shqiptare e aftë e asaj kohe. I vetmi që shpëtoi, për shkak të një vonese të rastësishme, ishte Mustafa Pashë Bushatlliu.[13]

Erickson-i vazhdon të na përshkruajë dhe të na japë pamje mahnitëse të Liqenit të Prespës, të fshatrave dhe fushës së Korçës. Pastaj vetë Korçën, e cila do t'i ofronte atij një pamje krejt tjetër dhe shumë të habitshme, ku jeta *alla frënga* kishte depërtuar, përveç të tjerash, edhe për faktin që shumë korçarë të asaj kohe shkonin e vinin në Shtetet e Bashkuara. Dhe kështu fillon jetën në Shqipëri bashkë me të shoqen Carrien[14] dhe fëmijët Earli[15], Paul dhe Lois.

Një familje e tërë, e ardhur nga Amerika, atëherë kur nga Korça mijëra shqiptarë merrnin udhën e kurbetit drejt Tokës së Re që kur njëri prej tyre, njëfarë Kolë Kristofori, zbriti në Boston në vitin 1880. Dhe, ja, Erickson-ët po bënin krejt të kundërtën. Po çfarë i sillte ata në këtë vend të harruar edhe nga Zoti? Si ndodhi? Kush ishin ata? Kush ishte ky burrë simpatik, me mustaqe, me syze, me një familje relativisht të madhe? Mbi çfarë marrëveshjeje dhe me çfarë statusi do të punonte, jetonte, predikonte dhe vepronte Erickson-i në Shqipëri? Në fund të fundit kush ishte ai?

---

[13] Po aty.

[14] Carrie Louise Earl, prej Akronit të New York-ut, ishte gruaja e parë e C.T. Ericksonit, e cila jetoi me të shoqin deri në fund të jetës nëpër Shqipëri. Jeta e saj në vendin tonë paraqitet të ketë qenë tejet e vështirë për shkak të kushteve të jetesës, sëmundjeve, fëmijëve të vegjël, persekutimit dhe mbi të gjitha vdekjes së djalit të madh, Earl.

[15] Earl Telford Erickson, djali i madh i C.T.Ericksonit i cili pas një dëmtimi në shtëpinë ku banonin në Elbasan, në tetor 1912, udhëtoi me të atin në Zvicër ku edhe vdiq në dhjetor 1912.

CHARLES TELFORD ERICKSON-I PARA SE TË ARRINTE NË SHQIPËRI

Charles Telford Erickson-i u lind në Gailesburg, Illinois, nga prindër suedezë, Mathias dhe Marie-Holmberg Erickson. Babai i tij, Mathiasi, kishte shkuar në Amerikë si një djalë i ri dhe ishte vendosur në Mamuth të Illinoisit, ku ishte formuar një koloni e emigrantëve suedezë. Kur shpërtheu Lufta Civile, në vitin 1861, Mathiasi iu bashkua kalorësisë suedeze të Illinoisit, ku shërbeu si burizan. Me të mbaruar Lufta Civile, Mathiasit iu dha e drejta për të kultivuar një copë toke të papërcaktuar mirë nga pronësia, në kantonin Nodauay, në veriperëndim të Misurit. Ishte pikërisht ky vend ku u rrit i riu Telford Erickson, duke ndihmuar të atin në detyrën e vështirë të bujkut, duke pastruar dhe kultivuar njëqind hektarë tokë. Gjatë këtyre viteve përpjekjesh, Erickson-i mësoi shumë prej mjeshtërive bujqësore, të cilat do t'i duheshin vite më vonë në Shqipëri. Kur i kishte mbushur të gjashtëmbëdhjetat, ai jo vetëm që kishte vendosur mbi karrierën e tij, por gjithashtu kishte filluar të bënte plane për një të ardhme në një kolegj katërvjeçar. Pasi i diskutoi këto plane me prindërit, Telfordi e la shtëpinë e tij në Misuri, me bekimin e babait dhe të mamasë. Do të ishte një udhë jo e lehtë për Telfordin e ri, që do të ballafaqohej me sigurimin e thuajse tërë gjërave që i duheshin për vete në kolegj.

Erickson-i u regjistrua si student parapërgatitor në Universitetin De Pauw në Greencastle në Indiana. Me qëllim që të financonte edukimin në De Pauw, muajve të verës Erickson-i punoi me orar të shkurtuar si pastrues, berber, kamerier dhe

mirëmbajtës objektesh. Më pas punoi si agjent i një kompanie sigurimesh, duke shpërndarë dhe mbledhur fatura. Pasi diplomohet në De Pauw me nderimet më të mëdha, në vitin 1891, kompania me të cilin Erickson-i kishte punuar gjatë viteve të kolegjit e bindi atë që të drejtonte agjencinë e tyre të patundshmërisë në Teksas dhe të investonte kursimet e tij të pakta në atë kompani. Kjo ishte një sipërmarrje e këshilluar keq, pasi ai humbi gjithçka që kishte në krizën e vitit 1892. Megjithatë, dështimi i këtij biznesi të vogël i doli për mirë, pasi ai shumë shpejt hyri në Seminarin Teologjik të Universitetit të Bostonit, prej të cilit u diplomua në vitin 1895. Më datën 18 shtator 1895, Erickson-i u martua me gruan e parë, Carry, Luis Earl, prej Akronit të New Yorkut.

Midis viteve 1897 dhe 1898 Erickson-i, bashkë me familjen, shkuan në Rangun, Burma, ku iu dha mundësia të drejtonte një mision të metodistëve. Detyrat e tij përfshinin punët e misionarit midis tetëmbëdhjetë ose njëzet grupe racash të ndryshme që jetonin në Rangun. Ai po ashtu bënte edhe shërbimet e çaplinit[16] për banorët britanikë. Meqë u pa se Erickson-i tregonte aftësi që i vlenin Kishës Kongregacionale në Uethersfileds Avenue dhe kishte ndërtuar një raport të mrekullueshëm me banorët vendas, ai u zgjodh zëvendëspresident i një klubi me influencë, të përbërë prej të diplomuarve të Universitetit brahmas, hindu, budistë dhe konfucianë. Ai u detyrua të kthehej në ShBA për shkak të një sëmundje e rëndë që i preku familjen. Me t'u kthyer, në vitin 1899, ai pranoi pastoratin në Ohaio, megjithëse koha e tij më e madhe kalonte në kishën Ashbury në Dollavere. Fill pas kësaj, ai hyri në shkollën "Yale Divinity", ku mori gradën "Master" në vitin 1902, ndërkohë që edhe predikonte, edhe kujdesej për gruan e tij dhe dy fëmijët e vegjël.

Pas kthimit, ai u bë pastor i Kishës Kongregacionale të Uethersfield Avenue në Hartford, Konektikat. Aty ai u bë një mik i vërtetë i të gjithë njerëzve me dëshirë të mirë – protestantë, katolikë dhe hebrenj. Qëndrimi i tij ekumenik, i cili në të vërtetë mund të ketë filluar në Rangun, përqasej me veprimet për të emëruar një katolik si kreun e klubit të njerëzve të bashkësisë së tij. Por edhe këtu Erickson-i nuk u ndje tërësisht i kënaqur, sepse besonte se mëshira e tij mund t'i shërbente

[16] Chaplin – një shërbëtor në kishë, i cili merret me organizimin e punëve të meshës dhe shërbimeve fetare.

një qëllimi më të lartë në qoftë se do t'i jepej mundësia që të shërbente edhe një herë në një mision të huaj. Si rrjedhojë, ai filloi të kërkonte brenda mundësive të misionit për ndonjë vend pune jashtë vendit.

Gjatë kësaj periudhe të përkohshme, Erickson-i u bë pastori i Kishës Kongregacionale në Ualla-Ualla, në Uashington. Prej aty shkroi shumë letra me kërkesa. Shumica e letrave të tij dërgoheshin drejtpërsëdrejti tek qendra e Bordit Amerikan të Komisionerëve të Misioneve të Huaja në Boston. Në fillim situata dukej e pashpresë. Edhe pse Erickson-i mbante korrespondencë me Kornelius Paton, një zyrtar i Bordit Amerikan të Komisionerëve, prapë kishte pak shpresa që ai të siguronte një post jashtë shtetit si misionar. Por ai përsëri aplikoi për një vend bosh të njoftuar në një mision në Natal, Indi. Më 6 prill 1908 Kornelous Paton e njoftoi Erickson-in se Bordi e kishte hedhur poshtë kërkesën e tij, pasi e kishin konsideruar atë si shumë të rritur (41 vjeç), përveç faktit që kishte edhe familje. Bordi gjithashtu pat ndjesinë se Erickson-i nuk do të mund ta zotëronte gjuhën e vendit me shpejtësinë e duhur.

Kjo me siguri duhet ta ketë mërzitur shumë atë, pasi në atë kohë as që i shkonte në mendje se mosha mund t'i bëhej pengesë në sipërmarrje të tilla. Megjithatë doli se Bordi Amerikan kishte hapur asokohe një mision në Shqipëri. Erickson-it iu tha se, nëse ishte i interesuar të shkonte në Shqipëri, kishte shumë të ngjarë të mos i merrej parasysh mosha, familja dhe pengesa e mundshme gjuhësore. Pa dyshim Erickson-i e kuptoi se kjo ishte i vetmja mundësi. Sigurisht, ky post matanë Adriatikut bëri që të provonte para Bordit se ai mund t'u bënte ballë vështirësive të jetës së misionit.

Por edhe një gjë tjetër duhej t'i bëhej e qartë Erickson-it gjithsesi dhe se një faktor mbetej për t'u vlerësuar në veçanti: pikëpamjet e tij teologjike, një faktor të cilin bordi duhej ta shihte me shumë kujdes. Përderisa një pjesë e madhe e parave të dhëna për projektin pesëvjeçar në Shqipëri vinin nga një burim tejet konservator, Erickson-i ndoshta duhej ta bindte dhuruesen, një farë zonja Borden, që teologjia e tij mbetej koherente me kriteret e saj teologjike për zgjedhjen e misionarëve të duhur. Cilido që të ishte mendimi i tij teologjik, atij do t'i duhej t'u përmbahej kërkesave të atij që e priste në Shqipëri, Phineas Kennedy-t[17] – një person i diplomuar

[17] Phineas dhe Violeta Kennedi ishin protestantët e parë amerikanë që shërbyen në Korçë, Shqipëri. Ata kishin mbërritur pikërisht në kohën kur shqiptarët i ishin futur luftës për pavarësi nga zgjedha turke dhe luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e jetës fetare dhe kulturore në këtë qytet. (Shënimi im – MB)

në Seminarin Teologjik të Princtonit dhe një mbrojtës i pikëpamjeve konservatore të atij seminari. Ky problem i veçantë provoi gjithashtu se ishte me interes të madh për Bordin Amerikan, i cili dëshironte një shkallë të caktuar harmonie të mendimit teologjik midis personelit në secilin prej stacioneve jashtë vendit.

Duke marrë parasysh këta faktorë, Shqipëria përsëri mbeti në mendjen e Erickson-it si vendi më i mundshëm për mision si një sfidë vetjake dhe një mundësi për të zhvilluar kapacitetet e tij të plota. Bordi Amerikan kishte plane për të hapur dy shkolla në Shqipëri dhe, po të kihet parasysh urrejtja shqiptare ndaj autoriteteve osmane, edhe pse në shumicë shqiptarët ishin me fe islame, shumë nga ata ndoshta do t'i pranonin misionarët.

Si fillim, Erickson-i u njoftua prej Bordit Amerikan që të kontaktonte z.Frost, i cili vepronte në emër të znj. Borden ndërkohë që ajo ishte në Europë. Z.Patern, zyrtar i Bordit Amerikan, e njoftoi Erickson-in se, nëse ai merrte miratimin e Z.Frost, pa dyshim do të emërohej në Misionin Euro-turk në Shqipëri. Intervista e Erickson-it me z.Frost duhet të ketë shkuar mirë, sepse Më 25 korrik 1908 ai e përgatiti psalmin e tij të lamtumirës për shërbesën e orës 10:30 të së dielës në Kishën Kongregacionale të Wethersfild Avenue.[18] Mesha e asaj të diele ishte një ngjarje e shënuar, pasi treqind pjesëmarrësit aty i dhanë lamtumirën Erickson-it përpara se të nisej për udhëtimin e gjatë drejt Shqipërisë.

Më datë 28 korrik 1908, Erickson-i u emërua zyrtarisht misionar i rregullt në Misionin Euro-turk në Shqipëri. Në mëngjesin e datës 1 gusht 1908, Erickson-i me familjen e tij hipën në avulloren "Republika" dhe u nisën nga Gjiri i Bostonit me destinacion fundor Stambollin, nëpërmjet Londrës dhe Marsejës. Pas disa orësh në Stamboll, Erickson-i dhe familja e tij e rifilluan udhëtimin, këtë herë për Selanik, nga ku do t'i hipnin një treni për në Manastir. Më datën 5 shtator 1908 Erickson-ët u nisën nga Manastiri në një karrocë kuajsh për Korçë, Shqipëri dhe arritën aty më datë 8 shtator 1908.[19] Por ku po shkonte, në çfarë vendi, me çfarë do të ballafaqohej, mbi çfarë baze vepronin këto misione në Perandorinë Osmane, pjesë e së cilës prej afro pesë shekujsh ishte edhe Shqipëri

[18] Erickson's farewell "The Hartford Daily Courant", July 25, 1908 p 18. See also "Farewell Service for Rev. Charles Telford Erickson "The Hartford Daily Courant", July 27 1908, p 8.

[19] Biografi e Charles Telford Erickson, botuar në faqen e internetit nga Yale Divinity School Library, New Haven.

MISIONET AMERIKANE NË PERANDORINË OSMANE. SI LINDËN DHE U ZHVILLUAN ATO?[20]

Erickson-i iu bashkua misionit të Bordit Amerikan të Misionarëve në Boston më datën 28 korrik 1908. Ai u bë pjesë e Misionit Euro-turk në Shqipëri, në një kohë kur Shqipëria ishte nën sundimin e Perandorisë Osmane. Në atë kohë anë e mbanë Perandorisë ishin shpërndarë misionarë amerikanë, që nga Stambolli deri në Van, nga Bullgaria në Eufrat, nga Bejruti në Aleksandri. Edhe Erickson-i kishte vendosur të bëhej pjesë e kësaj historie plot të papritura, mundime, dhimbje, mungesa, në cepin më perëndimor të perandorisë, në Shqipëri.

Kjo histori shkon shumë thellë në histori dhe pikërisht në vitin 1790, atëherë kur marinarët amerikanë u takuan për herë të parë me ata turq në Veriun e Afrikës (*Barbary Coast*). Gjatë periudhës nga viti 1800 deri 1830 udhëtarët dhe tregtarët amerikanë e vizitonin shpesh Turqinë nëpër porte të tilla si Izmiri (Smyrna), Aleksandria dhe Bejruti. Megjithatë, këto dy vende nuk vendosën marrëdhënie diplomatike deri në vitin 1830, kohë kur nënshkruan një traktat tregtie dhe lundrimi. Me fillimin e këtyre marrëdhënieve, filluan edhe misionet fetare, të cilat gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, bashkë me marrëdhëniet tregtare, përbënin edhe burimin kryesor të konflikteve diplomatike midis dy vendeve, pasi

[20] Dr. Cagri Erhan, asistent profesor në Universitetin e Ankarasë. Ky kapitull bazohet në librin e tij "Ottoman Official Attitudes Towards American Missionaries".

edhe puna e këtyre misioneve u zgjerua pak nga pak në tërë territorin e perandorisë.

Në vitin 1810 u krijua Bordi Amerikan i Komisionerëve për Misionet e Huaja (ABCFM) në Boston prej anëtarëve të kishës presbiteriane dhe asaj të reformuar. Ky bord kishte si mision ungjillëzimin e indianëve dhe të katolikëve të kontinentit amerikan. Por fill pas kësaj ata i vunë vetes edhe një qëllim tjetër: ungjillëzimin e tërë botës. Në vitin 1818 dy amerikanë, të quajtur Pliny Fisk dhe Levi Parsons, u caktuan të fillonin paraprakisht punën me Perandorinë Osmane.

Në fakt, veprimtaria e tyre në tokat e osmanëve nuk kishte objektiv thjesht dhe vetëm myslimanët dhe as kishat orientale, por, më shumë se këta, iu drejtohej hebrenjve. Sapo arritën në tokën e perandorisë në vitin 1821, Levi Parsons vdiq, ndërsa Pliny Fisk e vazhdoi misionin e tij. Puna e misionarëve, e cila filloi në fund të viteve 1820, u kthye në një punë sistematike dhe arriti shkallën më të lartë në vitin 1840.

Numri i misionarëve që shkuan në Perandorinë Osmane u rrit qoftë nga që predikonin fenë, qoftë nga ata që merreshin me probleme të arsimimit. Në vitin 1850 amerikanët kishin vetëm shtatë kisha nën kontrollin e tyre. Në vitin 1860 ishin hapur prej misionarëve 49 kisha dhe 114 shkolla, në vitin 1880, 97 kisha dhe 331 shkolla, ndërsa në vitin 1913, 163 kisha dhe 450 shkolla, me gjithsej 25 992 nxënës. Kjo tregon më së miri qëllimin kryesor të këtyre misioneve, të cilat shpërndanë dije, arsim e kulturë në botën e errët obskurantiste otomane.

Në fillim marrëdhëniet midis misionarëve dhe Portës së Lartë ishin paqësore. Edhe pse deri në vitin 1830 Perandoria Osmane nuk e njihte SHBA-në zyrtarisht si shtet, shtetasit amerikanë lejoheshin të kryenin veprimtarinë e tyre nën imunitetin diplomatik britanik. Objekt i punës së misionarëve u bënë të krishterët joprotestantë, ku natyrisht vendin kryesor e zinin grekët dhe arabët ortodoksë, armenët gregorianë dhe ata katolikë, druzët, nestorianët dhe maronitët, të cilët ishin katolikë arabë.

Në rrjedhë të viteve filluan të dilnin në pah dy probleme, njëri për shkollat dhe tjetri për kishat. Misionet ishin shpërndarë në tërë perandorinë, diku si stacione misionarësh, diku si shkolla misionarësh. I pari mision i tillë u vendos në Stamboll

si qendër e tërë veprimtarive misionare dhe arsimore. Misionet u porositën që të mos ndërtonin stacione në zona malore, për të shmangur çfarëdo ngatërrese me banorët dhe autoriteteve e tyre vendore.

Në fakt shkollat e misionarëve amerikanë u bënë mollë sherri e përhershme mes tyre dhe autoriteteve osmane. Në fillim të vitit 1860 misionarët ngritën ndërtesa shkollash thuajse në të gjitha qendrat e mëdha qytetare osmane. Me hapjen e kolegjeve, më shumë studentë osmanë, të shumtët jomyslimanë, filluan të ndiqnin këto vende shkollimi. Shumë prona të patundshme të osmanëve u vunë nën kontrollin e misionarëve amerikanë. Këta dy faktorë nxitën Portën e Lartë të merrte masa kundër misionarëve.

Kolegji i parë prej amerikanëve u hap në Bejrut në vitin 1866 me emrin "Kolegji protestant sirian", i cili më vonë, në shekullin XX u bë Universiteti Amerikan i Bejrutit. Fill pas misionari amerikan Cyrus Hamlin, mori një kontribut bujar financiar nga Kristofor R. Roberti, me të cilin ndërtoi Kolegjin Amerikan, që mbajti emrin e këtij dhuruesi. Kolegji u ndërtua në Bebek, Stamboll. Edhe pse sot mban emrin *Bogazi Universitesi*, prapë ai njihet me emrin *Kolegji Robert (Robert College)*. Atë e njohin shumë mirë shqiptarët, pasi një numër syresh kanë studiuar pikërisht aty. Charles Telford Erickson-i ka kontribuuar që studentë nga Elbasani të shkonin e të studionin në atë kolegj.

Fillimisht, Porta e Lartë refuzoi ta lejonte hapjen e kolegjit pasi kishte frikë se mos, duke lejuar amerikanët në këtë sipërmarrje, do të hapte udhën edhe për francezët dhe rusët. Në fakt ndërtimi i kolegjeve për jomyslimanët do të krijonte një epokë të re midis qeverisë otomane dhe Fuqive të Mëdha. Po ashtu Porta kishte shqetësime serioze për programin shkollor të këtyre shkollave. Disa prej vlerave perëndimore, siç është liberalizmi dhe nacionalizmi, duhet të kenë pasur reflektime shkatërrimtare mbi një perandori të përbërë prej aq shumë kombesh.

Po të kemi parasysh rolin i atyre që mbaronin kolegjet amerikane në rritjen e nacionalizmit shqiptar, bullgar apo armen, në çerekun e fundit të shekullit XIX, atëherë është e kuptueshme ndjesia e Portës së Lartë. Gjatë ndërtimit të kolegjeve shfaqeshin veprime nga më të çuditshmet dhe agresivet. Banorët rreth këtyre

kolegjeve nxiteshin të sabotonin dhe të pengonin punimet. Shembull për këtë ishte ndërtimi i Kolegjit Robert. Për ndërtimin e tij, në verën e vitit 1868, pranë Rumeli Hisarit në Bosfor, u dislokua një fregatë amerikane, e cila u bë garant për punën e një misionari të quajtur Farragut. Ndërtimi i këtij kolegji hapi udhën e shumë e shumë kolegjeve të tjera anë e mbanë perandorisë, deri në Tigër e në Eufrat.

Në vitet 1880 dhe 1890, ndodhën dy ngjarje të rëndësishme. Njëri kishte të bënte me ndërhyrjen e reformës së centralizuar të Sulltan Abdylhamidit dhe tjetra kishte të bënte me nacionalizmin armen. Sulltan Abdylhamidi u ngjit në fron në vitin 1875, dhe e përqendroi tërë pushtetin në dorën e vet.

Misionarët amerikanë kërkonin të drejtën për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në këto kategori: shkollat, që ishin në pronësi dhe ato të drejtuara nga amerikanët. Kishte shkolla që ishin pronësi e amerikanëve, por ku mësonin shtetasit otomanë dhe shkolla që ishin në pronësi të osmanëve dhe ku mësonin otomanët me mbikëqyrje dhe subvencionim amerikan. Gjatë kësaj kohe u regjistruan incidente të ndryshme, ku ndërhyrja e ashpër turke u shoqërua me shpagime të mëdha të qeverisë turke ndaj misionarëve. Në vitet 1895 ndodhi një ndër ngjarjet më të rëndësishme midis Perandorisë dhe misionarëve: shkatërrimi prej ushtrisë osmane i Kolegjit të Eufratit në Harput dhe Kolegjit të Marashit në Turqinë Qendrore. Me ndërhyrjen e legatës amerikane, qeveria osmane u ngarkua t'u paguante misioneve njëqind mijë dollarë, gjë të cilën ajo nuk pranoi ta bënte.

Më datën 4 dhjetor 1895 ShBA-ja vendosi që ta zgjidhte çështjen nëpërmjet një raporti që Presidenti Cleveland do ta paraqiste para Kongresit Amerikan. Sipas këtij raporti, qeveria osmane ngarkohej të paguante njëqind mijë dollarë si shpagim për dëmin e shkaktuar. Presidenti njoftoi Kongresin se ai kishte ngarkuar tri anijet luftarake: "San Francisko", "Marblehead" dhe "Mineapolis", të vizitonin portet osmane, me qëllim që të parandalonin çfarëdo incidenti tjetër ndaj misionarëve. Pas raportit të presidentit qëndronte Senati, i cili më 27 janar 1896 kaloi një rezolutë të paraqitur nga senatori Shelby M. Cullom, kryetar i Komitetit të Marrëdhënieve me Jashtë, i cili i kërkonte presidentit të ndërmerrte hapat e duhur për të tërhequr shumën e sipërthënë. Ky problem mbeti i pazgjidhur deri

në vitin 1901, kur kruizeri amerikan "Kentucky" u dërgua në Gjirin e Izmirit, që të bënte presion ndaj qeverisë osmane derisa të bëhej pagesa. Ky kërcënim ushtarak funksionoi në favor të ShBA-së dhe qeveria osmane i pagoi 100 000 dollarët Shteteve të Bashkuara, në qershorin e vitit 1901. I njëjti skenar u përsërit kur otomanët mbyllën shkollat dhe arrestuan disa armenë, të cilët kishin marrë shtetësinë amerikane. Presidenti Ruzvelt dërgoi një flotë të fuqishme në Gjirin e Izmirit dhe ShBA-ja, nëpërmjet kanaleve të veta diplomatike bëri të qartë se do ta bombardonte Izmirin. Si rezultat i këtij presioni, armeno-amerikanët u liruan nga burgu dhe shkollat u hapën. Gjithsesi, deri me rrëzimin e Sulltan Abdylhamidit nuk pati paqe dhe as u normalizuan marrëdhëniet ndonjëherë. Me formimin e qeverisë kushtetuese të vitit 1909, qëndrimi osman ndaj misionarëve amerikan u zbut në një farë mase.

Xhon G. Leishman, ambasadori i ShBA-së në Stamboll, shkruan në raportet e tij drejtuar Departamentit të Shtetit se qeveria kushtetuese nuk duhet vetëm t'i kontribuonte zhvillimit të shoqërisë osmane, por po ashtu edhe të lehtësonte presionin mbi qytetarët amerikanë, përfshirë misionarët. Në fund të vitit 1908 kufizimet ndaj shtypjes së librave dhe udhëtimeve të misionarëve u ndërprenë. Rregulli i ri i Perandorisë u mirëprit nga Kongresi Amerikan. Senati dhe Kongresi kaluan rezoluta në të cilat përshëndetën dhe i uruan fat qeverisë së re otomane.

Me gjithë këtë panoramë të përmirësuar të qëndrimit osman ndaj misionarëve amerikanë në këtë kohë, ajo që do të shohim në kalvarin e gjatë të udhëtimit të heroit tonë, Charles Telford Erickson në Shqipëri, qoftë në Tiranë gjatë vitit të tij të parë në vendin tonë, 1908 – 1909, qoftë në Elbasan në vitet 1909-1912, nuk e mbështet këtë konstatim as të Kongresit dhe as Senatit amerikan. Të paktën jo në Shqipërinë e viteve të fundit të sundimit osman.

Aventura e gjatë e misionarëve amerikanë në Perandorinë Osmane përfundoi në vitin 1918 me rënien *de facto* të kësaj të fundit. Pas 4 vjet kaosi, në vitin 1923 Mustafa Qemali themeloi Republikën Turke. Në këtë kohë filloi një periudhë e re e veprimtarive të misionarëve në rajon, por rrethanat dhe kushtet nuk ishin më të mira se më parë.

Por le të shohim se si Erickson-i e filloi jetën e vet si misionar në Shqipëri, në këtë cep të Perandorisë, dhe çfarë vuajtjesh dhe mjerimesh, çfarë privacionesh dhe mungesash, çfarë presionesh, dramash dhe tragjedish familjare pësoi ai në emër të qëllimeve të tij të larta për edukimin, arsimimin, ngritjen morale, emancipimin, përparimin e popullit shqiptar.

ERICKSON-ËT NË SHQIPËRI - 1908

Erickson-i me familje arriti në Korçë më 8 shtator 1908. Aty ai gjen një ndikim të fortë amerikan, që shfaqej në stilin e ndërtesave dhe në planimetrinë e rrugëve, një element që i atribuohet faktit se disa prej elitës së qytetit ishin arsimuar në Amerikë. Po ashtu, ai gjeti aty shumë të rinj shqiptarë, të cilët kishin kaluar disa kohë në Amerikë si emigrantë. Ata ishin kthyer në vendlindje për t'u ribashkuar me familjet e tyre ose për t'u martuar. Por ajo që vuri re ai dhe që i bëri më shumë përshtypje ishte se në qytet po ngrihej një valë e vërtetë kundërshtimi dhe mospajtimi ndaj sundimit turk. Ai menjëherë i vihet mësimit të historisë së Shqipërisë, të vendit ku do të kalonte shumë vite të jetës së vet.

Aty ai gjen skocezin Phineas Kennedi dhe të shoqen, të cilët ishin vendosur disa muaj më parë në misionin e tyre në Korçë. Veç atyre ishin edhe motrat Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi, të cilat kujdeseshin për shkollën anglo-amerikane të vajzave. Një vëlla i tyre punonte për Shoqërinë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja, ndërsa një vëlla tjetër i tyre sapo ishte vrarë në rrugë. Brenda disa ditësh Erickson-i u familjarizua me qytetin dhe mësoi shumë gjëra që kishin të bënin me konfliktet që ekzistonin midis shqiptarëve dhe pushtuesve osmanë. Midis njerëzve

të parë që takoi aty ishte edhe Grigor Cilka, i cili sapo kishte dalë nga burgu osman.

Korça iu duk Erikosnit një vend shumë i bukur dhe me të tëra kushtet për familjen e tij. Por, siç thotë ai, ai nuk kishte ardhur aty për të shijuar rehatinë, të cilën e kishte me bollëk në Amerikë.[21] Ai kishte ardhur me një mision të madh, të cilit do t'i kushtonte tërë jetën. Shumë shpejt ai arriti të shijonte mikpritjen shqiptare në një dasmë në të cilën e ftoi Grigor Cilka. Aty ai pa bukuritë e dasmës shqiptare, ritet, vallet, muzikën dhe urimet. "Zoti iu shtoftë me djalë!" Ky ishte urimi të cilin ia drejtonin çiftit herë pas here. Aty, atij i ra në dorë libri "Brenga e Ballkanit" e Edit Durhamit, të cilin e lexoi me një frymë. Më vonë ai do të bëhej një mik i ngushtë i saj dhe do të punonin së bashku për çështjen shqiptare, do të udhëtonin bashkë nëpër Shqipëri dhe do të bashkëpunonin me Shoqatën Anglo-Shqiptare të Londrës, bashkë me Aubrey Herbertin dhe Nevingtonin.

Më 13 shtator 1908 Erickson-i shkoi në Kishën e Shën Thomait dhe kreu shërbesën e tij të parë aty. Fjalën e tij e përktheu njëra prej motrave Qiriazi. Ndërkohë ai kishte filluar menjëherë të mësonte Biblën në gjuhën shqipe.

Më 18 shtator Erickson-ët festonin 13-vjetorin e martesës. Edhe për këtë u kujdes Grigor Cilka. Carrie, e shoqja, dhe Erickson-i u takuan në shtëpinë e tij me mësueset Myrta Qiriazi dhe zonjushën Ekridan Bunko. Në vijim të ditëve në Korçë ai predikoi në kishë, bashkëbisedoi me korçarët dhe mësoi aq shumë gjëra për këtë qytet të bukur. Ai mësoi nga korçarët se Perandoria Osmane, që pas vdekjes së Skënderbeut, e kishte pushtuar Shqipërinë. Por megjithatë turqit asnjëherë nuk i kishin vënë nën kontroll të plotë malet veriore të Shqipërisë, ku ndikimi latinizues ishte i fortë dhe ku ishte e përqendruar pakica katolike. Ai vuri re se një pjesë e madhe e popullsisë e kishte pranuar fenë islamike dhe se pjesa më e madhe e popullsisë fshatare nuk ngrihej dot mbi gjendjen e apatisë dhe varfërisë për shkak të sistemit feudal. Aty vihej re se kishte filluar të rritej ndjenja kombëtare. Shkaku i kësaj ishin padrejtësitë që i bëheshin popullit shqiptar. Kjo kishte nisur

[21] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no. 1, Box. No. 2, Folder No 3

së voni me Traktatin e Shën Stefanit të vitit 1878, i cili u jepte territore të tëra shqiptare fqinjëve të saj lakmitarë. Ky traktat përbënte fillimin e ndarjes së trojeve shqiptare. Ai mësoi se edhe Kongresi i Berlinit i vitit 1878 e thellonte edhe më shumë këtë proces. Të dyja këto akte ndërkombëtare kishin demonstruar veprim të plotë armiqësor ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve. Nga brenda, zgjedha turke po bëhej përherë dhe më e padurueshme. Këtu Erickson-i mësoi, që në ditët e para, se si, për të kundërshtuar këtë situatë, shqiptarët kishin krijuar Lidhjen e Prizrenit për mbrojtjen e të drejtave të kombit shqiptar si një mjet për të shmangur aneksimin e territoreve shqiptare. Anëtarët e Lidhjes gjithashtu shqyrtuan mundësinë e një Shqipërie autonome të përbërë prej katër vilajetesh të populluara prej shqiptarëve: Kosovë, Shkodër, Manastir dhe Janinë. Kjo kundërshtohej ashpër prej autoriteteve turke, si një hap i shqiptarëve drejt pavarësisë.

Përkundër faktit që Lidhja e Prizrenit u shpërnda, shpirti i nacionalizmit shqiptar jetoi. Në vitin 1879, një grup intelektualësh shqiptarë që jetonin në Stamboll ndërmorën formimin e "Shoqërisë së të shtypurit të shkronjave shqipe", por autoritetet turke nuk tregonin asnjëfarë respekti për dëshirat e shqiptarëve. Madje, aty nga viti 1908, kur turqit e rinj, të cilët po kurorëzonin fitoren e një revolte të suksesshme ndaj sulltanit dhe regjimit të tij të vjetër, ndryshe nga ajo çfarë prisnin shqiptaret, e kundërshtuan me forcë rritjen e nacionalizmit shqiptar. Shqiptarët në fillim i varën shumë shpresat te një transformim i mundshëm dhe treguan njëfarë mbështetjeje për xhonturqit. Por kur ata filluan të kontrollonin Shqipërinë me dorë edhe më të hekurt se vetë sulltani, duke kërkuar t'i nënshtronin shqiptarët, duke i thirrur në shërbimin ushtarak të detyrueshëm dhe rritur taksat, u duk qartë për shumë shqiptarë se revolucioni xhonturk nuk ishte në fakt asgjë tjetër veçse një vazhdim i një politike osmane edhe më të ashpër se më përpara, por me parulla të reja[22].

Siç shihet Erickson-i, dinte fare pak rreth së kaluarës sonë kur për herë të parë

[22] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no. 1, Box. No. 2, Folder No 3. 4. Letters from Ch. T. Erickson to Barton, American Board of Commissioners of Foreign Missions – European Turkey Missions. 1900-1912.

hyri në Shqipëri. Gjatë qëndrimit të tij të shkurtër në Korçë, ai vendosi që të bënte çdo përpjekje për t'u përshtatur me jetën shqiptare. Për këtë ai i hyri menjëherë mësimit të gjuhës shqipe. I ndërgjegjshëm për misionin e tij, me qellim hapjen e një shkolle djemsh, ai e pa shumë shpejt se Korça nuk ishte vendi i duhur për të filluar misionin e tij. Përveç kësaj, Korça ishte shumë në brendësi të vendit. Por Erickson-i kishte edhe një problem tjetër. Në respekt të punës së tij misionare, ai dëshironte më shumë t'i hynte një sfide për hapjen e një misioni në Tiranë, një qytet i cili mbetej edhe nën ndikimin mysliman, edhe nën atë të qeverisë otomane. Njohjen e tij të menjëhershme me anë të veçanta të jetës në Korçë e tregon qartë letra e tij e dytë dërguar mikut të tij Tedi:[23]

Korçë, 2 tetor 1908:

I dashur Ted,

"…duket se janë disa qindra, në mos mijëra korçarë, të cilët kanë marrë sëmundjen e mënyrës më të keqe të të veshurit si tek ne. Ata vishen alla frënga dhe më përshëndesin me një anglishte të përthyer si kjo:

"Har ju? Ju Merikan? Yes, Ai bin to Merica. Hau ju like Korça? Yes, veri nice bat Merika beter. Make damn lot money in Merika…."

I ftuar në shtëpitë e tyre, ai sheh mikpritjen, por edhe bukuritë e jetës së korçarëve, sidomos qëndismat e rrobave të përdorimit të përditshëm. Ai i përshkruan kështu kostumet e korçarëve:

"Në kostumet e tyre, gratë shqiptare janë të shkëlqyera, me një hijeshi të jashtëzakonshme dhe të bukur. Qëndisma të paçmuara të dantellave, mëndafshit dhe ngjyrave të shndritshme e zbukurojnë pamjen e tyre krejt, krejt të veçantë."

Erickson-i e vijon letrën e tij dërguar mikut të tij Ted me fjalët:

23 Po aty.

"Unë jam thellësisht në dashuri më Korçën, përkundër imitimeve që i bëjnë Amerikës këtu. Është vërtet një qytet shumë tërheqës dhe kjo bie në sy sidomos kur shkon në shtëpitë e korçarëve. Zona e tregut lë shumë për të dëshiruar, por dihet se unë nuk e kërkoj lumturinë tek tregu.

Kjo është një tokë e pluguar ndërkohë që ajo që unë dua është ta përdor plugun tim në një tokë të parrëmuar. Unë nuk do të isha i lumtur të bëj diçka që ata e kanë parë dhe ndoshta bërë më parë. Prandaj dua t'i kapërcej malet. Më në fund unë e di dhe e kam mësuar këtu se ka një anë tjetër të malit. Nuk e di se sa njerëz janë andej matanë, por e di se këtu janë pak ata që kanë qenë ndonjëherë në Durrës, Tiranë, Elbasan apo Shkodër. Dhe largësia më e madhe midis këtyre qyteteve nuk është më shumë se njëqind e pesëdhjetë milje. "

Erickson-i ka vënë re që në fillim dallimet që ekzistonin midis Veriut dhe Jugut të Shqipërisë, por po aq mirë kupton edhe se këto dallime nuk janë aspak qenësore:

"Janë dy shqiptarë që i duken të çuditshëm njëri-tjetrit: Gega i Veriut dhe Toska i Jugut. I pari ilir në rrënjët e tij racore, ndërsa i dyti epirot. Dhe prapëseprapë unë mësova se dallimi gjuhësor midis tyre është fare i vogël, më i vogël se dallimi i dialekteve të Veriut dhe të Jugut në Itali apo dallimi midis Yorkshire dhe Devonshire në Angli. Mezi pres të nisem. Më pret rruga e re."

Erickson përshkruan po ashtu edhe jetën brenda një familjeje shqiptare:

"Në një shtëpi tjetër na shërbeu një nuse shumë e bukur, e cila duket se sapo ka ardhur si gruaja e njërit prej djemve të familjes. Është gjithmonë një zakon si për myslimanët, ashtu edhe për katolikët apo ortodoksët shqiptarë, që ajo të zbatojë këshillat e vjehrrës në mënyrën se si ta qeverisë shtëpinë. Gjithashtu, kur ka martesa me përkatësi fetare të ndryshme midis çiftit, nusja merr fenë e dhëndrit…

Unë mësova se oxhaku është vendi i shenjtë për jetën shqiptare. Termi "oxhak" ndryshon nga termi "shtëpi". Këtu shqiptarët i kanë mbajtur të paprekura zakonet,

traditat dhe idealet, të cilat tek ata janë ruajtur të shenjta që prej kohëve më të lashta, që datojnë përtej kohës së Homerit. Babai është zoti i shtëpisë. Mund të ketë tri madje katër breza shqiptarë që jetojnë nën të njëjtën çati.

Në Shqipëri nuk veprojnë ligje të tilla islame të sheriatit, ku burri mund të mbajë shumë gra. Por nëse gruaja nuk lind, atëherë me marrëveshje ajo i lejon burrit të marrë grua tjetër, e cila garanton të ardhmen e brezave me fëmijët që do të sjellë në jetë."

I juaji Ç. T. Erickson[24]

Një nga plagët e shoqërisë shqiptare ishte arsimi. Një prej problemeve më të dukshme ishte praktika e qeverisë turke për të inkurajuar përdorimin e alfabeteve të tjera në gjuhën shqipe. Por shqiptarët po përpiqeshin me çdo mjet për të kryer një reformë arsimore. Midis datave 14 dhe 22 nëntor 1908, u mbajt Kongresi Kombëtar i Alfabetit të gjuhës shqipe i mbledhur në Manastir, me qëllim që të përshtatej një alfabet i përbashkët. Pas disa ditësh u krijua i ashtuquajturi Komiteti i Alfabetit, i cili do të formulonte një propozim. Në planin e tyre, ithtarët e konsideruan arsimimin si mjet për të nxitur nacionalizmin shqiptar.

Erickson-i sheh se edhe qëndrimet e tij me ato të Finehas Kenedit, nga pikëpamja e përhapjes së protestantizmit, ishin të ndryshme. Kenedi ishte një ungjillor që besonte se vetë ishte i shenjtë. Ndërsa Erickson-i mendonte:

"Unë vetë preferoj të paktën gjatë viteve të mia të para në Shqipëri të jem njeriu më i përunjur që vetëm mëson. Unë do të dëshmoj se sa afër jam me jetën e popullit shqiptar, fizikisht, mendërisht dhe shpirtërisht. Nuk dua të mësoj vetëm gjuhën e tyre, por edhe të mendoj si ata. Unë do të jem aq i lidhur me jetën e popullit shqiptar, saqë dhimbjet, brengat, përndjekja, shtypja, shekujt e errët të pushtimit nën zgjedhën turke të bëhen edhe të miat. Unë do të mësoj virtytet e tyre dhe do të kërkoj të nxis

[24] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no. 1, Box No. 2, Folder No.2. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no. 1, Box No. 2, Folder No. 5. Letters from Ch. T. Erickson to Barton American Board of Commissioners of Foreign Missions – European Turkey Missions, 1900-1912.

ata dhe kështu të jem i vlefshëm për vlerësimin dhe besimin e tyre. Në këtë mënyrë, unë shpresoj t'i ofroj shërbimin tim tërë këtij kombi"[25]

Nisur nga këto motive, ai mezi priste t'u ofronte shërbimin e vet Shqipërisë dhe shqiptarëve. Duke mos e parë Korçën si vendin që kishte nevojë për të, vendosi të nisej për Tiranë në një rrugë që edhe sot mund të jetë e vështirë.

Më datën 1 tetor 1908, Erickson-i vetë i pestë, bashkë me Grigor Cilkën dhe familjen Kenedi paketuan çdo gjë dhe u nisën për udhë. Udhëtimi u bë në drejtimin lindje -jug-perëndim, nga Korça në Sarandë. Në fakt ishte një udhëtim që ndodhte shumë rrallë të bëhej edhe prej vetë shqiptarëve ose karvanëve pushtues osmanë. Rruga, siç mund të merret me mend, ishte aq e vështirë dhe aq me pengesa. Grupi flinte ku të mundej nëpër hanet që rrallë gjendeshin dhe në mjedise ku mungonin gjërat themelore të jetës, të mbushur pa dyshim edhe me insekte dhe parazitë. Udhëtimin e fillonin çdo ditë në orën pesë e gjysmë të mëngjesit dhe vazhdonin deri në muzgun e mbrëmjes. Por në çdo rast nuk mungonte bukuria e jashtëzakonshme natyrore dhe mikpritja shqiptare. Në një ndalesë në Leskovik ata u pritën nga beu i asaj ane me të gjitha të mirat e Zotit që kishte ajo kohë.[26]

Pas disa ditësh ata arritën në Sarandë në muzgun e datës 7 tetor 1908. Gjëja e parë që i ra në sy Erickson-it ishte kaltërsia e mrekullueshme e detit Jon, që shpalosej sapo doli në kodrën mbi qytetin e Sarandës. Një pamje marramendëse pas atij udhëtimi të gjatë nëpër male, fusha dhe monopate. Pas kësaj ata morën një varkë, e cila i sorollati nëpër det për orë të tëra, derisa arritën në Korfuz. Me fëmijët dhe Carrien të rraskapitur ai u vendos në një hotel ku pa dhe shijoi diçka që ishte krejtësisht ndryshe nga ato që kishte lënë në anën tjetër të detit, në Shqipëri. Por Erickson-i nuk ishte nga ata që lakmonte rehatinë. Ai kishte një mision, dhe në misionin e tij ishte edhe regjistrimi i çdo gjëje që shihte. Ishte kjo një edukatë e marrë në shkollat që kishte kryer, apo një cilësi e tij vetjake? Kjo pak rëndësi ka.

[25] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no.1, Box No. 2, Folder No. 3.

[26] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no. 1, Box No. 2, Folder No. 3.

Ajo që është e rëndësishme është se bazuar pikërisht në këto shënime të tijat ne arrijmë të konstruktojmë tërë trajektoren e tij të lidhur me Shqipërinë. Kështu, nga Korfuzi edhe pse i rraskapitur nga rruga, ai menjëherë ulet dhe i shkruan mikut të vet Çum:

Korfuz, 8 tetor 1908

I dashur plaku Çum,

"Ka kaluar një muaj që kur iu nisa letrën e parë që këtej dhe çfarë përvoje ka qenë kjo e imja që atëherë! Një prej gjërave që ia vlen t'ua tregoj është shërbesa që bëmë në Ditën e Zotit. Pastori vendas, Grigor Cilka, bashkëshortja e të cilit ishte me zonjën Ellen Stone[27] në duart e brigandëve bullgarë duke lindur fëmijën në kushtet e pengmarrjes, kishte paguar për shërbimin. Kjo u bë me të gjitha nderimet, plot bukuri e dinjitet. Ishte një solemnitet i lehtë për atë që e ndien veten të jetë në tokën e shenjtë. Dhoma e vogël ku ishim mbledhur ishte tej mase e mbushur me stola të bëra për nxënësit e shkollës. Ata ishin të ulët dhe të parehatshëm, por e kënduara ishte shumë frymëzuese. Psalmet tërhoqën vëmendjen e të gjithëve dhe, edhe pse për mua u mbajt në një gjuhë të pakuptueshme, ajo më dha përshtypjen se ishte e sinqertë, e devotshme dhe elokuente."

"Në anën tjetër mësova diçka, i dashur Ted: Këtu shoh burra shqiptarë të cilët kanë qenë në Amerikë dhe që janë aq krenarë për vendin e tyre të ri Amerikën, që shesin mend me rrobat e tyre të reja, që janë kthyer pranë grave të tyre, ku besnikëria, virtytet dhe pastërtia e tyre morale në jetë kurrë nuk mund të vihet në dyshim."

"Ndërkohë të tjerë, beqarë, kanë ardhur për të zënë njeriun e jetës dhe zgjedhin midis vajzave më të bukura të vendit, përfshirë edhe ato të shkollës sonë, sepse me paratë që kanë në Amerikë, me mënyrat e huaja të sjelljes që kanë fituar, i kanë shanset më të mira për të marrë virgjëreshat më të bukura të qytetit."

[27] Erickson Collection,Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no.1, Box No. 2, Folder No. 2.

Erickson megjithatë nuk lë pa përmendur në letrën e tij edhe ndryshimet që dalëngadalë po ndodhnin në Shqipërinë e asaj kohe dhe pikërisht:

I dashur Ted,

Një djalë i ri, i cili kishte parë Kolegjin Robert në Stamboll, vendosi ta dërgonte motrën e tij të studionte atje. Ai vinte nga një familje e njohur muhamedane, shumë e lidhur me fenë. Nuk ishte e lehtë ta hapte këtë çështje në familje para nënës dhe babait. Megjithatë ai ia arriti që, falë këmbënguljes së tij, vajza të shkonte në shkollë. Pas ikjes së vajzës në Stamboll, doli problem i madh me të afërmit, të cilët e konsideruan këtë si një turpërim të tërë fisit. Pas një viti vajza u kthye tërësisht e ndryshuar, e mësuar dhe e zbukuruar si një trëndafil i bukur. Tërë fisi mblidhej për të dëgjuar rrëfimet e saj nga qyteti, librat, shkolla… Të gjithë të afërmit u mrekulluan nga tregimet dhe zhvillimi që kishte pësuar vajza. Kur erdhi koha për t'u kthyer në shkollë, njëra nga hallat që kishte folur më shumë kundër vajtjes së mbesës së saj në Stamboll, erdhi dhe tha:

"Dua edhe unë ta dërgoj vajzën time atje. Si mund ta bëj këtë?"

Nesër thonë se do të jetë një anije për Durrës. Atje na pret një aventurë e re. Deri tani kemi parë mjaft sa të kuptojmë se sa vështirësi, sa rreziqe, sa pengesa të tjera na presin. Qeveria turke nuk është aspak miqësore me misionarët e Bordit Amerikan. Përvojat e këtyre misionarëve gjatë tetëdhjetë vjetëve të pranisë së tyre në këtë Perandori mbajnë dëshmi dhe fakte të pafundme.

Si mund të presim ne që ata të na lejojnë të zëmë një pjesë tjetër të Perandorisë, pra Shqipërinë, kur ata vetë në fakt nuk kanë arritur ta pushtojnë atë asnjëherë?

Kenedëve nuk iu lejua për gjashtë muaj të hynin dhe as të bënin një tur në Korçë. Cilka u burgos dhe e tërë familja dhe miqtë menduan se ai do të dënohej me vdekje atje. Megjithatë, Kushtetuta e liroi atë dhe na la edhe neve të futeshim pa shumë vështirësi. Por pyetja që bëjnë misionarët është: Sa do të zgjasë kjo? Dhe në fakt unë i

shoh të tërë shumë skeptikë nga frika se Turqit e Vjetër thjesht kanë vajtur tek berberi dhe kanë rruar mjekrat, në vend që të "pendoheshin" dhe të rrëfenin gjynahet që kanë bërë. Tani janë përsëri turq por "të Rinj".

Çfarëdo që të na presë, na duhet të themi: Zot, na jep qëndresën si ushtarë të mirë të Jezusit"

Paqe, paqe e plotë! E ardhmja jonë e tëra e panjohur!

Juaji

Charles Telford Erickson[28]

Kështu Erickson-i mbyll kapitullin më të shkurtër të jetës së tij me Korçën, për të hapur një tjetër me aq shumë ngjarje, aventura, tragjedi dhe, për hir të së vërtetës, me shumë pak gëzime. Por ai tashmë e kishte vendosur të ardhmen e vet, e cila do të ishte pazgjidhshmërisht e lidhur me Shqipërinë.

[28] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no.1, Box No. 2, Folder No. 4.

KORÇË – SARANDË - KORFUZ - DURRËS - TIRANË

Pasi kaluan nga Saranda në Korfuz dhe nga Korfuzi në Durrës, në mbrëmjen e 8 tetorit 1908 Erickson-ët dhe i tërë grupi zbarkuan në portin e Durrësit. Mendja e Erickson-it kishte punuar gjatë tërë udhëtimit për atë që e priste në Tiranë. Hapja e një shkollë shqipe atje, natyrisht, ishte shqetësimi i tij kryesor, i cili dallgëzonte bashkë me valët e detit të asaj dite tetori të atij viti aq interesant për familjen e tij. Meditimet e tij i ndërpreu shfaqja e qytetit të lashtë të Durrësit. Ngadalë po i afroheshin bregut dhe tani duhej të merrej me zbarkimin e familjes, fëmijëve dhe plaçkave. Ja si e përshkruan Erickson-i këtë udhëtim:

16 tetor 1908

Durrës – Tiranë

U nisëm nga Korça për në Tiranë dhe ja tek jemi. Largësia ajrore është 70 deri 75 milje, pak më shumë se një orë me një tren ekspres amerikan. …Kemi qenë gjashtë ditë e net në udhëtim në një largësi prej 75 miljesh, por ajo që kemi parë e përjetuar është e paimagjinueshme…varfëri e patregueshme. Shpirti, gjendja mendore, fizike e këtij populli na u shfaq në atë mënyrë, që në Korçë do na duheshin vite për ta parë. Dhe tani ne mund ta dëshmojmë atë që pamë, por kjo që pamë vërtet më trondit, Ted..!

*Kur zbarkuam në portin e Durrësit, menduam se çfarë do të kishin thënë Augusti ose Cesari në atë kohë kur ky vend quhej: "**Durrahium, civites et delectabilis**", një qytet i pasur dhe i bukur. Unë besoj në mbretërimin dhe aristokracinë e Romës."*

Por le të kthehemi tek momenti i zbritjes në Durrës. Sapo u ulën në tokë, duke ndihmuar njëri-tjetrin, të përfshirë nga ndjenja nga më të ndryshmet, aty u dëgjua zëri i butë i një të riu në gjuhën gjermane:

"Guten Abend"

Ai zë vinte nga një djalë, i cili kthehej pas dhjetë vjetësh mërgim nëpër Egjipt, për të takuar familjen e vet. Ai quhej Konstandin Kortova. Fliste frëngjisht, gjermanisht, italisht, turqisht dhe, pa dyshim, shqip. Konstandini i ndihmoi të sapoardhurit në Durrës, i dërgoi ata në hotel dhe i ndihmoi që të vendoseshin aty. Aq i sjellshëm dhe i gatshëm u tregua ai me ta, sa Erickson-i e quajti atë si një dhuratë të dërguar nga vetë Zoti. Më vonë, kur Erickson-i do të thellohej në historinë e Shqipërisë, do të shkruante përveç të tjerash për Durrësin:

"Aty Cezari dhe Pompeu e zgjidhën midis tyre çështjen e Perandorisë Lindore. Pompeu e kishte shtabin e tij në Durrës, ndërsa Cezari në Apoloni. Më vonë, kur Cezari u vra, Oktaviani, djali i tij i birësuar erdhi në Apoloni, aty ku kishte qenë student në universitetet e mëdha të luftës dhe të artit grek. Dhe beteja që i dha atij fitoren mbi Antonin, duke qenë tanimë Cezar Augusti, u zhvillua pikërisht brenda brigjeve shqiptare. Aty ai më vonë ngriti qytetin e Nikopolisit për të festuar fitoren. Ciceroni, gjatë disa muajve të syrgjynosjes, qëndroi në një shtëpi në Durrës. Aty ai jo vetëm vizitohej prej fisnikërisë së kohës pasi një numër i madh syresh i kishin shtëpitë e tyre të përhershme atje"[29].

Por le të lëmë historinë e Romës dhe të Durrësit dhe të merremi me udhëtimin 7-8-orësh të Erickson-ëve drejt Tiranës, atë ditë të 9 tetorit 1908. Ata u nisën në orën 7.30 të mëngjesit. Erickson-i e përshkruan këtë udhëtim si një kalim nëpër një vend tërësisht të lënë pas dore dhe tejet të largët me qytetërimin bashkëkohor

[29] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no1, Box No. 2, Folder No. 4.

të Perëndimit. Në atë udhëtim mbi kalë ai ecte dhe mendonte se ndoshta, pas heqjes qafe të robërisë osmane, hapi tjetër më i rëndësishëm për shqiptarët ishte lufta kundër analfabetizmit. Ai sapo kishte lexuar diçka nga Sami Frashëri, i cili thoshte:

> *"Shqiptarët nuk mund të ekzistojnë pa gjuhën shqipe dhe kjo e fundit nuk mund të ekzistojë pa alfabetin e vet dhe pa shkollat e veta"*[30].

Erickson-ët u vendosën në një shtëpi në Rrugën e Dibrës. Pjesa tjetër e grupit, Grigor Cilka dhe Kenedët u kthyen menjëherë në Korçë. Shtëpia në Rrugën e Dibrës ishte një shtëpi tipike bejlerësh tiranas me dy kate. Dritaret ishin të mëdha dhe mbuloheshin me perde të bukura. Ajo shtëpi kishte qenë më parë e banuar prej një konsulli italian. Gjithsesi, ajo duhej pastruar, por për të gjetur pastruese në atë kohë ishte vërtet e vështirë. Kështu, ai pajtoi dy gra rome, të cilat erdhën dhe e pastruan shtëpinë nga tërë ato vjetërsira.

Tirana ishte shumë ndryshe nga Korça. Ndërsa në Korçë kishte një gjallëri, e cila dukej e një natyre shumë perëndimore, Tirana ishte shumë orientale në çdo aspekt.Veshjet me pamje turke dallonin nga ato të Korçës. Shumë gjëra vërtet ishin ndryshe. Por Erickson-i këtë donte, të ishte në një vend ku ai të bënte punë të cilat i vlenin shoqërisë shqiptare. Dhe e para punë në radhë do të ishte: arsimimi. Sapo gjeti pak kohë, ai nisi t'i shkruante përsëri mikut të tij, Tedit, lidhur me dyshimet që herë pas here e kaplonin kur mendonte se e kishte marrë edhe familjen me vete në një mision kaq të vështirë, të largët, në një vend të harruar dhe plot rreziqe:

> *I dashur Ted,*
>
> *Unë e di çfarë mendon ti për mua. Edhe në mendjen time e njëjta gjë qëndron, mbi kokën time si shpatë e Demokleut. Është çështja e gruas dhe e fëmijëve. Po, po kjo është! Ndoshta me mua çdo gjë është në rregull, t'ia kushtoj jetën time një çështje kaq të madhe. Por a kam të drejtë t'i bëj ata ta ndajnë tërë këtë me mua? Po të*

[30] Memories of Ismail Kemal Beu.

flas miqësisht, as vetë nuk e di, dhe dyshoj nëse do ta di ndonjëherë, përfundimisht, qartazi, plotësisht…

Këtu më del se shqiptarët janë njerëz me të cilët njeriu mund të merret tek për tek me ta. Por ata përbëhen prej grupesh familjare. Oxhaku është altari i tyre, të cilin e ka ndërtuar vetë kombi. Feja që i ka mbajtur ata në tërë mundimet, parimet, idealet, zakonet, të cilat janë dukur tek ta më shumë se vlera e vetë jetës i ka pasur rrënjët në jetën e familjes. Po si do ta bëj jetën time një pjesë jetësore të tyre, të bëhem një prej tyre me mendje, me trup dhe me shpirt, nëse nuk e sjell familjen time dhe të ngre edhe unë oxhakun tim midis tyre?!

Është edhe një gjë tjetër, që shkon shumë më thellë sesa thjesht problemet e modernizimit. Vendet e tjera ballkanike po bëhen copa-copa me njëra-tjetrën. Si përherë, secila mundohet të përshtatë modele europiane dhe secila prej tyre ka dikë mbrapa që e mbështet, ka padronin e vet, midis Fuqive të Mëdha: Greqia ka Britaninë e Madhe; Serbia, Rusinë; Rumania ka Francën, Bullgaria, Gjermaninë, me Fuqitë e tjera të gatshme për të futur hundët. Mos gabo të mendosh se ka kurrfarë esence të ëmbël apo ndihmë që jepet pa interes ndaj këtyre vendeve në Ballkan.

Për mirë apo për keq, Shqipëria nuk ka pasur kurrë padronin e saj. Ka qenë vasale e Turqisë, po. Prandaj është 70 % myslimane në mes të popujve të tjerë të Ballkanit, popullsia e të cilit është e krishterë në masën më të madhe. Përse fuqitë europiane të krishtera nëpër shekuj nuk kanë treguar interes për mirëqenien e Shqipërisë? Përse krishterimi, pasi e përdori Shqipërinë si një portë hyrëse për ndërsimin e kryqëzatave gjatë të cilave ajo u shkatërrua, u plaçkit dhe u përdhunua, e ka humbur tërë interesin ndaj saj? Përse duhej të luftonte ajo kundër forcave të panumërta ushtarake të sulltanit, e vetme? Këtu e rrethon një mister i madh.

Sido që të jetë, unë jam i lumtur që kemi ardhur të gjithë bashkë.

I juaji

Erik[31].

[31] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no.1, Box No. 2, Folder No. 4.

Tani Erickson-i është vendosur në Tiranë. 20 tetori i vitit 1908 ishte edhe dita e fundit e Ramazanit. Ai sheh se si festohej kjo festë fetare në Tiranë, takohet me bejlerët dhe autoritetet e qytetit. Me ta bisedon për hapjen e shkollës së djemve dhe merr premtime nga shumë prej tyre se do t'i sillnin fëmijët në shkollën e tij. Ai shëtit në kodrat përmbi qytet, duke përsëritur fjalë të gjuhës shqipe, që sapo i kishte dëgjuar dhe mësuar. Por kushtet e banimit, edhe pse nga më të mirat në Tiranën e atëhershme, ishin aq të pazakonshme për Carrien, gruan e tij, sa ai ishte thuajse çdo ditë nën furinë delirante të kërkesave të saj për t'u kthyer në shtëpinë e tyre. Me tre fëmijë të vegjël, me një grua që deri kur vdiq, asnjëherë nuk u pajtua me veprimet e tij misionare, kuptohet që jeta bëhej edhe më e vështirë. Por Erickson-i nuk ishte nga ata burra që dorëzohej, cilado të ishte vështirësia dhe e çfarëdo natyre të ishte ajo, familjare, ekonomike apo shtetërore.

Jeta e familjes Erickson ishte aq e kufizuar dhe me aq pak gjëra për t'u gëzuar, sa ç'mund të ishte vetë Tirana e atij viti. Xhonturqit po dilnin në skenën e politikës turke, por asgjë nuk dukej se do të ndryshonte në të mirë të shqiptarëve. Por ishte e vështirë të mendoje se Carrie do të pajtohej ndonjëherë me këtë jetë. Një ditë ajo iu afrua të shoqit dhe i tha:

> *"Telfordi im i dashur, të lutem, kur do të vijë ajo piano? Të paktën, kur të vijë ajo, unë do të kaloj kohën duke luajtur me të dhe e tërë familja përqendrohet aty".*

Çfarë kërkesë e çuditshme do t'i dukej në atë kohë çdo mendjeje fqinji të Erickson-ëve në Rrugën e Dibrës!

Nga tetori i vitit 1908 deri në mars të vitit 1909 Erickson-ët jetuan në kushtet më minimale të jetesës ose, tek e fundit, në kushtet që ofronte koha në atë qytet të rënduar nga nata e gjatë dhe e errët osmane. Një ditë Erickson-i shkoi në Durrës. Aty qëndroi në shtëpinë e Konstandin Kortovës, i cili ftoi edhe konsullin italian. Ky i fundit thirri edhe konsullin austriak Charles Walla[32], me të cilin Erickson-i do të bëhej një mik i ngushtë dhe që do t'i gjendej në ditët e vështira që do të pasonin. Ai shëtiti kodrave të Durrësit, pa me sytë e vet muret e vjetra të qytetit,

[32] Charles Walla, konsull austriak në Durrës gjatë një periudhe të gjatë në prag të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, mik i ngushtë i popullit shqiptar dhe pa dyshim i familjes së Ericksonit. (Shënimi im – MB)

akuaduktin, rrënojat e mureve të Perandorisë Romake dhe amfiteatrin antik. Për të Durrësi ishte një qytet i lashtë, plot histori. Aty kishte histori me Cezarë dhe Augustë. Por mendjen e tij e brente ideja se a do të bëhej ndonjëherë ky popull i lashtë pjesë e familjes së madhe moderne të njerëzimit. Kaq shumë ishte lënë pas dore, sa edhe njeriu më optimist dhe më i durueshëm, si Erickson-i, e kishte të vështirë ta parashikonte një gjë të tillë. Erickson-ët, të mësuar për një muaj rresht me ndihmën bujare që i dha i riu Kostandin Kortova, i cili përkthente për ta çdo ditë nga shqipja në gjuhën gjermane, do ta humbitnin atë më në fund, pasi atij i duhej të kthehej në Kajro. Dhe kështu ndodhi.

Çështja e komunikimit me vendasit tani bëhej një gjë tejet e rëndësishme. Erickson-i dilte çdo ditë në pazar me një bllok shënimesh në dorë. Ai ishte aq i etur për të mësuar gjuhën shqipe dhe aq i vëmendshëm ndaj çdo fjale, sa tërë shitësit e pazarit të Tiranës bëheshin gati për t'i shpjeguar fjalët për të cilat ai pyeste sapo e shihnin tek jepte ballë afër dyqaneve të tyre. Kështu ai shumë shpejt u bë i njohur thuajse në tërë Tiranën e asaj kohe me 12 mijë banorët e vet.

Si për shumë të huaj të tjerë, çështja e komunikimit të shqiptarëve me tundje koke po dhe jo, ndryshe nga popujt e tjerë, përbënte problem. Edhe Erickson-i pat një përvojë të tillë të cilën na e përshkruan shumë bukur në shënimet e tij. Pas ikjes së Konstandinit, atij i duhej të merrej vesh vetë me banorët e Tiranës. Kështu një ditë ai kalon pranë një dyqani frutash dhe sheh pjeshka shumë të mira në një shportë dhe ca pjeshka të fishkura në një shportë tjetër. Shitësi e pa atë të përqendruar tek pjeshkat e mira dhe e pyeti nëse donte ca prej tyre. Erickson-i tundi kokën poshtë e lart në shenjë pohimi. Por kjo u mor si mohim nga shitësi. Pastaj ai bëri me dorë tek pjeshkat e fishkura. Erickson-i tundi kokën majtas e djathtas në shenjë mohimi. Por shitësi e mori për pohim, peshoi dy okë pjeshka të fishkura dhe ia dha Erickson-it. Ai mori ato që nuk deshi. Që prej asaj dite ai bënte kujdes që të mohonte dhe të pohonte ndryshe nga sa bënte në Amerikë. Çfarë zakonesh të ndryshme![33]

[33] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no.1, Box No. 2, Folder No. 5. Është interesant të vëmë re se Ericksoni shpesh përdorte emrin Erik, si shkurtim. Në të vërtetë, kur fola për herë të parë me nipërit e tij në ShBA, Donald Johnson-in, mbesën Mary Alice Morris dhe iu thashë se sa i madh ishte gjyshi i tyre Ch.T.Erickson më thanë: "Për ne ai ishte Gjyshi ynë Erik, shumë i mirë dhe i dashur."

Në ecejaket e tij nëpër qytet e sidomos në pazar, ai vinte re se si kasapët e Tiranës e mbanin mishin të ekspozuar ndaj mizave dhe insekteve. Ata e shisnin mishin aty ku e thernin dhe nuk bënin aspak kujdes për ruajtjen e tij nga insektet, mizave dhe grerëzat. Një ditë ai ndërhyri tek një prej kasapëve duke i tërhequr vërejtjen për mizat që ndotnin mishin dhe si rrjedhojë helmonin njerëzit. Kështu ishte shitur mishi në Tiranë që kur njeriu kishte filluar të shiste dhe të blinte mish. Një ditë Erickson-i i tregoi kasapit tiranas një dollap që e kishte ndërtuar në shtëpinë e tij si shembull higjiene. Nuk vonoi shumë dhe jo vetëm kasapi që e mësoi Erickson-i, por tërë kasapët e Tiranës bënë të njëjtën gjë.

JETA E FAMILJES ERICKSON MIDIS TIRANASVE

Jeta e familjes Erickson në Tiranë mund të tërheqë kureshtjen e lexuesit më shumë se shumëçka tjetër. Pa përmendur këtu ndjesinë e rëndë që shkaktonte prania e autoriteteve turke në çdo segment të jetës, familjen Erickson e rëndonin edhe sëmundjet që godisnin pa reshtur herë njërin, herë tjetrin anëtar të familjes. E para që i ndiente të tëra këto vuajtje ishte Carrie. Jo shumë kohë më parë Erickson-i e kishte ndërprerë punën e tij misionare në Ragun ngaqë Carrie kishte kaluar një gjendje depresive të padurueshme për shkak të gjendjes së vështirë atje. Ata u kthyen ne Amerikë dhe Carrie pësoi një përmirësim të menjëhershëm. Por Erickson-i ia kishte kushtuar jetën e tij punës misionare. Kështu, ai erdhi në Shqipëri duke patur edhe miratimin e Carriet, e cila priste që një mision i tillë në një vend europian të ishte shumë më i mirë dhe më i ndryshëm se ai në Ragun. Natyrisht, ajo u ballafaqua me një situatë aspak të mirë, edhe në vendin europian të premtuar nga i shoqi. Sëmundjet e herëpashershme, mungesa e ndihmës mjekësore, epidemitë e vazhdueshme, të tëra këto e bënin jetën e saj edhe më të vështirë. Edhe pse Erickson-i kishte filluar të shoqërohej me familje bejlerësh të Tiranës, si me ato të njëfarë Ferhat Beu dhe Masar Beu, e ndonjë tjetër, prapëseprapë jetën e Carriet nuk e ndryshonte dot asgjë. Gjithnjë e më shumë ajo po bëhej problem i përditshëm i familjes. Fëmijët i qëndronin tek koka. ndërsa ajo vetëm ankohej dhe

i lutej të shoqit ta kthente në shtëpi në vendin e saj.

Përpara kësaj situate, Erickson-it i duhej përsëri të merrte një vendim të ngjashëm me atë që mori kur u kthye nga Burma në Amerikë. Por kësaj radhe ai nuk veproi ashtu. Dukej se puna e tij misionare ishte lidhur aq shumë edhe me misionin, edhe me detyrimin moral që ndiente ndaj një populli me të cilin ai tashmë kishte filluar të lidhte jetën dhe të ardhmen e tij. Tani nuk kishte më kthim mbrapa. Ai e shihte Shqipërinë si një vend ku puna e tij do të ndikonte në jetën e njerëzve. Ndërprerja e misionit në vendin tonë për Erickson-in ishte si një braktisje e parimeve të veta, por edhe lënia në errësirë e një populli me të cilin po lidhej gjithnjë e më shumë. Njohja e virtyteve, historisë, në fakt tragjedisë që kishte pllakosur këtë popull, u bënë edhe nxitësit kryesorë të veprimtarisë së tij në atë vit të parë në Shqipëri dhe më tej.

Me gjithë situatën e rëndë që ekzistonte në shtëpi me Carrien, ai vazhdonte të mësonte fjalë shqipe. Një ditë, kur u kthye në shtëpi, ai i tha Carriet me një ndjenjë gëzimi: "Sot kam mësuar një varg të gjatë fjalësh në gjuhën shqipe". Carrie iu përgjigj: Po fjalët: "go home i ke mësuar?"[34]

Carrie, edhe pse ishte në një gjendje të rëndë shpirtërore, madje depresive, nuk vonoi dhe i dha Erickson-it lajmin se ajo priste fëmijën e katërt. Erickson-i, me stoicizmin e tij dhe besimin e madh se kjo ishte punë e Zotit, u gëzua dhe mori të gjitha masat e mundshme për të pritur ardhjen në jetë të fëmijës së tyre. Ai njoftoi qendrën e vet në Boston, prej nga erdhi përgjigjja se asaj i ofrohej shërbim mjekësor në Selanik. Kështu Erickson-ët e mbyllën vitin 1908, një periudhë shumë interesante për një misionar dhe më 2 janar 1909 u nisën për në Durrës. Në largim e sipër ata u përcollën me shumë respekt e dashuri nga banorët vendas të Tiranës, ndër të cilët familjet e Fuat dhe Masar Beut.

Erickson-i kishte marrë masa për karrocën dhe kuajt e duhur për të ndërmarrë

[34] Anglisht: Kthehu në shtëpi!

atë udhëtim. Ata e lanë Rrugën e Dibrës dhe kaluan nëpër Rrugën e Durrësit, nën peshën e mallit që lanë pas tek tiranasit, dashurisë për Tiranën, dhimbjes për ditët e vështira dhe pasigurinë për atë që i priste. Në Durrës, Erickson-i menjëherë shkoi tek miku i tij Charles Walla, konsulli austriak, i cili mbante edhe përgjegjësinë për qytetarët amerikanë në Shqipëri, në bazë të një marrëveshjeje të nënshkruar midis qeverisë amerikane dhe asaj austriake për shërbime konsullore në zonat ku nuk arriheshin nga shërbimi konsullor amerikan.

Charles Walla ishte njeriu që iu gjet shumë herë Erickson-ëve. Në atë ditë janari të vitit 1909 ai i priti miqësisht, por, përveç kujdesit për ta, nuk harroi t'i kujtonte Erickson-it se situata rreth e rrotull nuk ishte aspak e mirë. Ai i kujtoi se në jug shqiptarët po luftonin që të mbronin trojet e tyre nga grekët, ndërsa në veri po luftonin edhe për tu çliruar nga perandoria edhe për të ruajtur trojet e tyre nga serbët. Ndërkohë, nuk ishte çudi që një ditë të shihnin Italinë tek do të përpiqej të merrte Vlorën. Konsulli austriak, përfaqësues i një vendi përherë mik i vendit tonë, e kishte parashikuar me saktësi tërë lojën që do të bëhej në kurriz të Shqipërisë tre vjet më vonë dhe gjatë thuajse tërë kohës sa Erickson-i qëndroi në Shqipëri. "Askush nuk e di se sa do të zgjasë terrori i Sulltan Abdylhamidit në këto anë, por ju duhet të keni shumë kujdes", i kujtoi ai Erickson-it.[35]

Për çudi, pasi kishin ikur nga Tirana në Durrës, Erickson-i mori një letër nga Bostoni, e cila e urdhëronte atë të kthehej përsëri në Tiranë, ku do t'i sigurohej një mami që do të kujdesej për Carrien gjatë shtatzënisë. Ata kaluan dy javë në ditët dimërore me diell të Durrësit. Aty ata mësuan për tërmetin e tmerrshëm që kishte goditur Mesinën në Itali, i cili mori jetën e 155 000 vetëve.

Pas disa ditësh në Durrës, ata u kthyen përsëri në Tiranë. Kësaj radhe atyre iu duhej të meremetonin një shtëpi tjetër dhe ta kthenin atë në vend banimi, duke pajtuar ustallarë, pastrues dhe romë. Natyrisht kthimi në Tiranë ishte një zhgënjim

[35] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no. 1, Box No. 2, Folder No. 5.

i madh për Carrien. Një sasi e madhe plaçkash të nisura nga Bostoni prej disa muajsh pritej dita ditës të arrinin në Durrës. Erickson-i priste t'i vinin pakot të cilat kishin bërë një tur rreth e rreth botës nga një anije në një tjetër, për të ardhur një ditë aty ku duhej. Kështu në fund të janarit 1909, Erickson-i vajti përsëri në Durrës. Miqësia e tij me Konstandin Kortovën tani ishte kthyer në një miqësi me familjen e tij. Ai vajti tek Kortovët dhe aty gjeti si përherë mikpritje, respekt dhe natyrisht ushqim e raki shqiptare, me të cilën ai po mësohej dalëngadalë. Pastaj takoi përsëri mikun e tij Charles Walla. Në kthim për në Tiranë, me duarbosh për shkak se nuk kishin arritur gjërat e postuara nga Bostoni, ai bleu disa enë kuzhine për shtëpi. Carrie u gëzua sa për enët aq edhe për kthimin e tij, pasi ajo nuk e duronte vetminë pa të.

Më 12 mars 1909 Carrie mbushte 37 vjeç. Fëmijët, secili sipas mënyrës së vet, mundoheshin të bënin diçka sa më të bukur për mamin e tyre aq të lodhur dhe të sëmurë. Ajo vetë, pas një krize të rëndë, u rikthye përsëri në dashurinë e asaj familje që jetonte me trishtimin e saj, largësinë nga atdheu, frikën nga përndjekjet, pasigurinë e jetës, të motivuar nga një burrë që mbarte në vetvete vlerat të mëdha dhe që i kishte vënë vetes një mision i cili nuk do të sprapsej kurrë çfarëdo që të ishin pengesat që i dilnin përpara.

Më 25 mars 1909, tetë muaj pas nisjes nga Bostoni, arritën gjërat e duhura në shtëpinë e Erickson-ëve. Ato ishin shpërthyer, shpartalluar, shprishur, por jo vjedhur. Tani Carrie do të shijonte jetën e saj në shtëpi me mjetet të cilat për kaq kohë i kishin munguar. Por as kjo nuk e bënte atë të ndihej e lumtur. Në anën tjetër, gjithçka aty e bënte Erickson-in të ndiente se ai ishte aty me një mision të caktuar, prej të cilit as që mendohej se do të hiqte dorë, edhe nëse do të ndodhte më e keqja.

Ndërkohë që Erickson-ët rrekeshin të ndërtonin jetën e tyre në Tiranë dhe të shtonin komunikimin me banorët vendas të qytetit, më 13 prill 1909, Sulltani i Kuq Abdylhamidi u shfronësua prej truprojës së vet. Parlamenti turk u kthye në një

fushë beteje dhe shumë vetë mbetën të vrarë ose të plagosur. Pushteti ra në dorë të Sulltan Reshatit. Xhonturqit tani kishin marrë fuqi të plotë dhe Erickson-in e shqetësonte fati i shkollës shqipe, e cila varej krejtësisht prej tyre, në një kohë kur tashmë ishte vendosur përdorimi i shkronjave latine për shkrimin e saj.

Përkundër tërë kësaj jeta e familjes Erickson në Tiranë vazhdonte me tërë ngjyrimet e kohës. Ai vetë, përveç takimeve me tiranasit, shëtitjeve në malin e Dajtit, leximeve pa fund rreth historisë së Shqipërisë, merrej edhe me kopshtin dhe kultivimin e perimeve dhe zarzavateve. Familjen e shoqëronin ngjarjet e rëndomta të përditshme. Një ditë Pauli i vogël, ndërsa po luante me një shkrepëse në dhomën e tij, i vuri flakën jorganit dhe pa se dhoma u mbush me tym. I lemerisur, ai thirri të atin, i cili po merrej me kopshtin dhe nuk e dëgjoi. Atëherë ai iu kthye nënës së vet, e cila dergjej në shtrat. Ajo siç ishte, u ngrit me shpejtësi dhe bashkë me fëmijët arritën të shuanin zjarrin.

Më në fund arriti edhe pianoja. Natyrisht ardhja e një pianoje në atë kohë në Tiranë përbënte diçka jo të zakonshme. Për ta vendosur atë në katin e dytë, Erickson-it iu desh të sharronte shkallët që të bënte hapësirë për vendosjen e saj. Ardhja e pianos ishte për Carrien një nga gëzimet më të mëdha. Është e lehtë të mendohet se çfarë përshtypjeje bënte tingulli i pianos në shtëpinë e Erickson-it te kalimtarët e rastit në Tiranën që kishin dëgjuar vetëm zërin e myezinëve dhe dajret e ndonjë ahengxhiu.

MËDYSHJET TIRANË – ELBASAN

Më 11 maj 1909 vjen në Tiranë Kenedi, i cili kishte sjellë me vete një raport të Misionit dhe një propozim për Erickson-in që të shihej mundësia e kalimit të tij në Elbasan. Për këtë ai mendonte se Elbasani, si një pikë takimi e dy degëve të shqipes, gegërishtes dhe toskërishtes, dhe si një qytet më liberal me prani të grupeve të ndryshme fetare, mund të ishte një qytet ku të bëhej punë më e mirë misionare, sidomos në drejtim të arsimimit të popullsisë.

Kenedi dhe Erickson-i folën gjatë në lidhje me situatën politike brenda Perandorisë, për revoltat që kishin shpërthyer anembanë, por sidomos për përpjekjet e shqiptarëve për të ruajtur vendin e tyre nga copëtimi. Pastaj, ata vendosën të bënin një udhëtim për në Elbasan, ku do të shihnin vetë me sytë e tyre kushtet që ishin atje. Rrugës për në Elbasan ata ndaluan në Kavajë dhe takuan Gjon Koliakën. Shtëpia e tij do të bëhej baza e përhershme e Erickson-it. Me të do ta lidhte një miqësi e gjatë dhe e shtrenjtë. Koliaka kishte një motor me vajguri, i cili bluante drithin, kuptohet një gjë tejet e rrallë për atë kohë në Shqipëri. Ishte pikërisht ky takim i Erickson-it me Koliakën që u bë fillesa e një ideje për të hapur një shkollë bujqësore në Kavajë, gjë të cilën ai do ta kthente në realitet plot 15 vjet më vonë. Koliaka, duke i treguar pamjen e bukur të fushës drejt Durrësit dhe drejt jugut, malit të Tomorit, i tha Erickson-it se ai ishte i gatshëm t'i jepte atij një tokë të

mrekullueshme, kodrinore, për ndërtimin e shkollës. Ai i ofroi atij ta ndihmonte me mësime të mekanikës dhe me çdo mjet tjetër.

Gjon Koliaka kishte përfunduar studime mekanike në Maltë. Aq i dhënë ishte ai pas arsimit, sa iu lut Erickson-it që kudo që ta hapte shkollën, ai do të shkonte të punonte për të, në Tiranë, Elbasan apo gjetkë. "Nuk dua ta lë Kavajën", i tha ai, por ne kemi kaq nevojë dhe, për të mësuar të rinjtë, do ta bëja këtë me shumë dëshirë. Natyrisht një sipërmarrje e tillë për Erickson-in ishte ende shumë larg.

Të nesërmen ata u nisën për në Elbasan. Rrugës, në Peqin, u ndaluan nga autoritetet turke, të cilat pas një pengese të shkurtër për dyshimet që patën, i lëshuan ata të vazhdonin udhëtimin e tyre nëpër kënetat e Shkumbinit, derisa arritën në qytet. Aty Erickson-i takoi njërin prej patriotëve më të mëdhenj shqiptarë, me të cilin do të bënin punë të mëdha për Shqipërinë. Ishte Lef Nosi, i cili kishte udhëtuar edhe në Amerikë. Mbrëmjen e parë në Elbasan ata e kaluan së bashku, duke vënë kështu themelet e një shoqërie të gjatë e të dobishme.

Lef Nosi, bashkë me Erickson-in, shëtitën nëpër qytet dhe panë disa vende për banim, por edhe për hapjen e shkollës që kishte në mendje Erickson-i. Ata vizituan dy shkolla turke dhe disa objekte të tjera, me shpresë hapjen e shkollës së Erickson-it. Erickson-i nuk vonoi dhe u kthye. Me të vajtur në Tiranë, provuan të gjenin edhe ndonjë vend tjetër, madje shkoi edhe më në veri, në rrugën Tiranë - Shkodër.

Në mbrëmjen e 22 majit të vitit 1909 familja Erickson mori pjesë në një dasmë-synetllëku në Tiranë. Aty, për herë të parë ata panë ritualin oriental të synetit. Gra të veshura me kostume, po ashtu fëmijët e bërë synet. Ishin jo pak, por 75 djem të moshave të vogla të cilët ishin bërë synet. Dasma shoqërohej nga një aheng evgjitësh. Burrat pinin duhan dhe raki. Një pamje tërësisht e panjohur, e çuditshme dhe interesante për "amerikanët e Tiranës".

Jeta e përditshme e Erickson-ëve në Tiranë ishte thuajse e njëjte me atë të çdo familje vendase. P.sh., evgjitët e lagjes vidhnin vezët e pulave, ndonjë djalë çapkën

i vidhte patat, në anën tjetër ai bënte pazar për çdo gjë me tregtarët e vegjël. Por mendja e tij punonte vetëm e vetëm si të hapte një shkollë shqipe. Meqë kjo ishte bërë edhe objekt i bisedave të vazhdueshme dhe të pandërprera me qytetarët e Tiranës, natyrisht qëllimi i tij kishte rënë në sy të turkoshakëve, fanatikëve dhe autoriteteve otomane të qytetit.

Korrespondenca me drejtuesit e misionit në Boston dhe me ata të Ballkanit nuk jepte shpresa të mëdha për investimet që Erickson-i donte të bënte për arsimin. Megjithatë, ai këmbëngulte pa pushim. Më 29 qershor 1909, në Tiranë arriti zonjusha armene Asnif Inijian, e cila kishte mësuar për mami në Zvicër. Ajo ishte një vashë e vogël, por shumë e zonja dhe do të kujdesej për Carrien përpara dhe pas lindjes. Por, në të njëjtën kohë, Erickson-it iu shfaq një dhimbje e tmerrshme nga nervi shiatik, që ia bëri jetën shumë më të vështirë. Edhe pse vera e atij viti ishte shumë e nxehtë dhe ai shpresonte se dielli do t'i bënte mirë, prapëseprapë kjo nuk bëri efekt.

Më 4 korrik 1909, familja kishte dy festa për të festuar. Ditën e Pavarësisë së Amerikës dhe ditëlindjen e pestë të Paulit. Ajo ditë që e mbushur me shi vere, bubullima dhe vetëtima, vërshime dhe furtunë. Por Paulit të vogël as që i bëhej vonë. Ditët kalonin dhe familja u gëzua me fëmijën e katërt. Ishte data 12 korrik 1909. Kështu erdhi në këtë jetë Christel Dorothi[36]. Pa asnjë ndihmë mjekësore, veç asaj të armenes, fëmija erdhi i shëndetshëm dhe natyrisht, po të ishte Shqipëria e pavarur, do të kishte përftuar shtetësinë shqiptare menjëherë. Por jo. Ajo ishte nën pushtimin osman. Duke parë se sa e paqëndrueshme ishte situate politike dhe në mungesë të fondeve të mjaftueshme, Erickson-i vendosi ta kthente maminë në shtëpinë e vet. Po hynte gushti i atij viti dhe situata politike sa vinte e përkeqësohej. Në Shkodër, rreth një mijë e pesëqind kryengritës, të udhëhequr nga kleri katolik me në krye bajraktarët e çdo fisi dhe një prift françeskan në krye, marshuan në

[36] Christel Dorothy, fëmija i katërt i Erickson-ëve ka jetuar deri vonë dhe ka lënë pas katër fëmijë në ShBA. (Shënimi im – MB)

qytet dhe lidhën besën për të luftuar kundër pushtuesit shumë shekullor. [37]

Papritmas, një ditë, një grup nxënësish u shfaqën para shtëpisë së Erickson-it, duke bërtitur: "Spiun, tradhtar!", "Ikni që këtej brenda pesë ditësh!". Ishte një grup fanatikësh, të cilët protestonin kundër mësimit të gjuhës shqipe në shkolla. Erickson-i u ankua tek prefekti, por ai e siguroi që ishin vetëm një grup i vogël arabësh, të cilët ishin paralajmëruar të mos dukeshin më aty.

Ishte përsëri Charles Walla ai që u gjend përsëri aty për të ndihmuar Erickson-ët. Ai i tha se trazirat politike po shtoheshin dhe se një erë e re kryengritjesh po frynte në tërë vendin. Ndërkohë Perandoria, e trembur nga shpërbërja po bënte përpëlitjet e saj të fundit. Por nuk vonoi dhe xhandarmëria turke i dërgoi fjalë Erickson-it të paraqitej tek qendra e tyre. Ata i paraqitën atij një telegram të dërguar nga qeveritari turk i Durrësit, i cili i kërkonte ndjesë që nuk vinte dot në Tiranë dhe i kërkonte Erickson-it që ai vetë të shkonte dhe ta takonte atë në Durrës, pasi jeta e tij ishte në rrezik. Charles Walla e këshilloi atë të shkonte patjetër në Durrës. Ai vetë, Walla pra, dhe prefekti i Tiranës do të kujdeseshin për familjen dhe fëmijët në Tiranë ndërkohë që ai do të ishte në Durrës. Kështu në orën 2 të mëngjesit të datës 28 korrik 1909, ndërkohë që qyteti ishte në gjumë, ai u nis për në Durrës. Sapo arriti në Durrës, para mesditës, ai vajti tek konaku i qeveritarit dhe e kërkoi atë. Për habinë e tij ai kishte ikur, siç i thanë, në Tiranë. Vallë çfarë ishte kjo? Ndonjë kurth? Apo donin ta përzinin me anijen e parë që prekte brigjet e Durrësit? Ndërkohë erdhi edhe vetë Charles Walla dhe ata bashkë nisën një telegram për në Stamboll tek ambasadori i ShBA-së, pasi Walla vetë mund të bënte shumë pak, pa patur bashkëpunim me ambasadën amerikane. Gjithë kësaj situate kaq të vështirë i shtohej edhe dhimbja e padurueshme që kishte kapluar Erickson-in nga nervi shiatik. Pas dhjetë ditësh në krevat, Charles Walla e njoftoi Erickson-in se e shoqja nuk qëndronte dot më e vetme në Tiranë, prandaj duhej bërë gjithçka që të bashkoheshin. Më e keqja ishte se dikush i kishte kërcënuar

[37] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no. 1, Box No. 2, Folder No. 5.

se do t'ua rrëmbenin fëmijët dhe Carrie kishte kaluar tërësisht jashtë kontrollit. Ndërkohë, nga Ambasada Amerikane nuk kishte ardhur asnjë njoftim.

Përfundimisht, Carrie bashkë me fëmijët, me Christelin e vogël në krahë u nisën për në Durrës, por një turmë e nxitur nga turqit ua preu rrugën. Kështu u desh ndërhyrja e mikut të tyre Ferhat Beut, që ata të mund të shkonin dhe të vendoseshin në hotelin "Osmanie". Dy shërbyeset shkuan tu bënin pazarin. Ndërkohë Erickson-i dërgonte letra sa në Stamboll, sa në Boston dhe, më në fund, botoi edhe artikuj në gazetën kongregacionaliste në Harford, ku shpjegonte se çfarë po bëhej ndaj misioneve në Shqipërinë e pushtuar nga osmanët.

Më në fund familja u bashkua në Durrës më 15 gusht 1909. Ishte një gëzim i madh që ishin përsëri bashkë, sado që thuajse të gjithë ishin të sëmurë. Carrie dhe Irili me malarie, Erickson-i me malarie dhe me nervin shiatik. Atë të diel gushti, aty erdhën Kenedët, doktor dhe zonja Morris Ford të Bordit Amerikan, Cilka dhe Dako. Ata kaluan tërë ditën bashkë me Erickson-ët. Ditën tjetër ata pagëzuan beben e vogël Christel Dorothy. Më pas kaluan disa ditë të bukura në Durrësin bregdetar nën nxehtësinë e diellit dhe freskinë shlodhëse të e detit.

Në vijim të ditëve në Durrës, një të diel ata të gjithë vajtën në kishë për një shërbesë fetare. Aty kishte edhe misionarë të tjerë të ardhur nga vende të largëta, si Alice Wharton Jones. Është e habitshme të mendohet se si në Durrësin e atëhershëm këta misionarë lexonin Biblën në shqip, mbanin meshë dhe flisnin për shkollat në gjuhën shqipe.

Më 31 gusht 1909 Erickson-ët festuan ditëlindjen e Loisit me të ftuar Kristo Dakon dhe zonjushën Jones. Durrësi i atyre ditëve për ta u bë një qendër e bukur shëtitjesh. Ata dilnin kodrave, ngjiteshin e zbrisnin dhe bisedonin për historinë e tij të lashtë. Një ditë, ata morën lajmin se më 21 prill 1908, pra më shumë se një vit më parë, dr. Frederik Albert Cook kishte zbuluar Polin e Veriut dhe flamuri amerikan ishte ngritur atje për të treguar epërsinë amerikane, e cila po ndihej dhe rritej çdo ditë në botë. Në një prej atyre ditëve, Kristo Dakoja kthehet prej Elbasanit dhe sjell

lajmin se në atë qytet po ngrihej Shkolla Normale me 50 nxënës, por që kishte nevojë për mësues. Me të marrë këtë lajm, Erickson-i i dërgon një telegram Lef Nosit, në të cilin e njofton se ai do të zhvendosej menjëherë në Elbasan. Kështu familja, me ato pak gjëra që ua solli nga Tirana Charles Walla, merr rrugën për Elbasan për t'u vendosur atje edhe për një periudhë tjetër kohe të jetës së tyre në Shqipëri. Tri ditë rrugë në këmbë e me kuaj nga Durrësi në Elbasan ishin një torturë tjetër për fëmijët e vegjël, Carrien e sëmurë dhe vetë Erickson-in, i cili thuajse ishte bllokuar prej nervit shiatik. Ishte data 19 shtator 1909.

Rrugës për në Elbasan ata qëndruan një natë në Kavajë. Hani ku u vendosën ishte aq i ndyrë, aq i papërshtatshëm, me aq shumë parazitë, sa ishte e pamundur të qëndrohej. Por mikpritja e Gjon Koliakës do të ishte shpëtimi i tyre, të paktën për atë natë. Ai i mori të gjashtë Erickson-ët në shtëpinë e vet dhe amerikanët, që nga më i madhi e deri tek Christeli e vogël, panë pastërtinë, ndjenë ngrohtësinë dhe shijuan ushqimin e mrekullueshëm dhe bujarinë e asaj familjeje. Veç të tjerash, fakti që vetë Koliaka fliste anglisht i bëri ata të ndiheshin shumë më mirë.

Ditën tjetër ata udhëtuan drejt Peqinit. Aty kaluan një natë në teqenë e këtij fshati, dhe u ë me bujari prej dervishit të teqesë. Erickson-i, edhe pse i sëmurë me nerv shiatik, nuk harroi të shkruante në kujtimet e veta se sa ekzotik ishte qëndrimi i tyre në atë shtëpi, ku nuk munguan gjitha të mirat e kohës. Pastaj vijuan rrugën për në Elbasan. Ishte një mrekulli që kuajt ishin të stërvitur për të kaluar ata lumenj me aq shumë ujë, pa pësuar gjë të keqe.[38]

[38] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no. 1, Box No. 2, Folder No. 5.

NJË FILLIM I RI - NË ELBASAN

Me të arritur në Elbasan, ata u pritën nga Lef Nosi i cili u kujdes për vendosjen e tyre në shtëpinë ku do të qëndronin. Nosi dhe Kristo Dakoja më pas vazhduan punën e tyre me angazhimet që kishin për Shkollën Normale. Aty kishte plasur një debat i madh se kush do të ishte drejtori i saj. Xhonturqit kërkonin të ishte një drejtor mysliman, ndërsa këta donin që të ishte një i krishterë.

Lodhja e tmerrshme e asaj rruge mbi samarët e kuajve i bëri ata të lëshoheshin përtokë dhe në të vetmin krevat që gjendej në atë shtëpi. Shtëpia ku u vendosën ata në Elbasan ishte tërësisht e papërshtatshme. Në të nuk kishte asgjë nga ato që përmbushnin qoftë edhe kushtet minimale për një jetesë të një familjeje normale. Pas një jave, një pronar dyqani elbasanas i mori ata në shtëpinë e vet në katin e dytë. Aty ndezën zjarr në një oxhak dhe e tërë familja, ndonëse e sëmurë, u ndje pak më rehat. Ericksonin e mori Kristo Dakoja dhe e dërgoi në llixhat e Elbasanit, për të bërë një kurë kundër shiatikut. Me t'u kthyer në Elbasan, ata u vendosën në një shtëpi, të cilën Ericksoni e përshkruan si një vend që Shkumbinin e kishte në anën lindore. Matanë ishte Shpati. Kulla e Sahatit të qytetit dukej që nga shtëpia me dritare të rrethuara prej ullinjve.

Ajo që e mundonte Ericksonin më shumë ishte pyetja që kishte filluar t'i

qëndronte në mendje: A ia vlente vërtet ta bënte tërë këtë që po bënte me familjen e vet? A ishte kjo gjëja e duhur? A ishte vërtet më e rëndësishme dëshira për të ndihmuar dhe ndriçuar një popull kaq të vuajtur dhe të lënë pas dore sa gjendja në të cilën ishte katandisur familja dhe ai vetë? Kur mendonte se edhe ambasadori Oskar Shtraus në Stamboll, nuk tregonte as më të voglin interes, kjo pikëpyetje bëhej edhe më e madhe.

Kur mëson për vuajtjet e Ericksonit dhe natyrisht për vuajtjet edhe më të mëdha të familjes, të fëmijëve të tij, atëherë pyetja e parë që të vjen në mendje është: Vallë çfarë e shtyu këtë njeri të jetonte në Shqipëri? A nuk mund të jetonte me familjen dhe fëmijët e vet në Amerikën e pasur e të zhvilluar të asaj kohe, por vinte dhe përplasej me gjithfarë vështirësish në Shqipëri? Natyrisht, një ndër përgjigjet e kësaj pyetjeje do të ishte ajo që e kishte shprehur që në ditët e para kur i shkruante mikut të tij Tedi,[39] se me gjithë dilemën që e shoqëronte në këtë sipërmarrje, ai kishte vendosur të jetonte midis këtyre njerëzve, t'i kuptonte dhe t'i ndihmonte ata, të jetonte me ta dhe si ata. Dhe që ta bënte këtë, ai duhej të jetonte me ta dhe si ata. Ndryshe misioni i tij do të ishte i pakuptimtë. E ndoshta pikërisht kjo e bëri atë që mos t'i ndahej Shqipërisë dhe shqiptarëve deri në ditën e fundit të jetës së tij. Por kostoja e kësaj për Ericksonin do të ishte shumë e lartë.[40]

[39] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

[40] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

JETA E ERICKSONËVE MIDIS ELBASANASVE[41]

Ndërkohë që Ericksonët u vendosën në Elbasan, Veriu i Shqipërisë vlonte nga kryengritjet antiosmane. Mijëra shqiptarë nën udhëheqjen e Isa Boletinit po organizonin kryengritjen e Veriut. Ndërkohë Turqit e Rinj po merrnin çdo masë për t'i parandaluar ata. Serbët dhe malazezët po përgatiteshin që të përfitonin nga kryengritjet shqiptare, për të rrëmbyer tokat tona, sapo të dilnim nga sovraniteti otoman. Situata ishte aq e turbullt, e paqartë dhe gati e paparashikueshme, sa për çdo të huaj që gjendej në Shqipëri, në atë kohë, gjëja e parë që duhet t'i shkonte ndërmend ishte të largohej sa më parë që andej. Por jo Ericksonit.

Në tetor, i gjendur pa gjërat kryesore të jetesës, ai mendoi se Kristo Dakoja do ta ndihmonte t'i sillte gjërat e duhura nga Tirana. Dhe kështu ndodhi. Ai vajti dhe solli me vete shumë prej gjërave që kishin lënë atje. Ishte një inventar i nevojshëm, ku përfshiheshin krevatet, makina qepëse, një sobë për zjarr etj. Ishte një periudhë ku, përveç situatës aq të rëndë politike me turqit, atyre iu duhej të luftonin me malarien, sëmundjet, parazitët, ndërsa Ericksoni vetë edhe me nervin shiatik. Përpjekjet e tyre për të festuar Festën e Falënderimeve më 25 nëntor 1909 nuk qenë të suksesshme për shkak të gjendjes së Carriet dhe mungesave të mëdha

[41] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

që ekzistonin. Megjithatë, Ericksoni pati një gëzim të veçantë kur mori numrin e radhës të gazetës *Missionary Herald*, me një shkrim të mrekullueshëm për punën e tij, botuar nga dr. Fordi. Ata u vendosën në një shtëpi më të përshtatshme, me kushte pak më të mira ndonëse edhe ato nuk ishin as diku afër qoftë edhe për standartin e një familje normale shqiptare. Bashkë me të ai arriti të gjente një objekt me qira për hapjen e shkollës, të cilën ëndërronte ta hapte sa më shpejt.

Marrëdhëniet e Ericksonit me vendasit në Elbasan u bënë shumë të ndryshme dhe shumë të habitshme. Ndërsa Dervishi i Elbasanit u tregua shumë bujar me të dhe shumë i afërt dhe i pranueshëm, me gjithë besimet krejtësisht të ndryshme fetare që ushtronin ata, prifti ortodoks grek u tregua shumë armiqësor. Madje ai kërkoi nga policia turke që të verifikonte se përse kishte ikur ai nga Tirana dhe përse duhej të mirëpritej në Elbasan kur Tirana e kishte përzënë. Por miqtë e tij, Kristo Dako dhe Lef Nosi, ishin përherë pranë, duke e inkurajuar dhe ndihmuar që të përmbushte misionin e vet, hapjen e shkollës dhe mundësisht edhe të një spitali apo klinike. Për këtë të fundit ai ishte udhëzuar nga Bostoni dhe fondet ishin garantuar.

Meqë nervi shiatik i Ericksonit nuk po përmirësohej, ai vendosi të shkonte në Napoli për llixha bashkë me Earlin 10-vjeçar. Ishte fundviti 1909. Vërshimet e pafund e penguan atë herën e parë, por ia doli të shkonte herën e dytë. Në ditën e parë të vitit të ri 1910 ata u gjendën në hotel "Konstitucion" në Durrës. Ericksoni kurrë nuk mund të kalonte nëpër Durrës pa u takuar me mikun e tij Charles Walla. Edhe atë natë e thirri atë dhe e ftoi për darkë. Të nesërmen me një avullore u drejtuan drejt Brindisit.

Pasi zbritën në tokë bënë një udhëtim të këndshëm me tren. Ericksoni iu nënshtrua kurës së llixhave, shëtitën bashkë me Earlin dhe pas dy javësh morën rrugën e kthimit. Sapo arritën në Durrës, i dorëzuan disa gjëra që kishin marrë për Charles Hallën, i dërguan një telegram Carriet që kishin arritur shëndoshë e mirë dhe pritën të gjenin ndonjë qiraxhi për Elbasan. Pasi i mblodhën tëra gjërat

që kishin ardhur nga Amerika dhe ato që morën në Itali, të ndihmuar nga Gjergj Kortova, pas dy ditësh ata arritën në Elbasan. Me të arritur në Elbasan, ai shkoi të shihte një tokë në rrugën që të shpinte për në Manastir, diku mbi Urën e Gurit të Shkumbinit dhe filloi punën për shkollën dhe spitalin, ëndrra e tij e përhershme.

Ndërkohë situata politike sa vinte e rëndohej. Në Stamboll, një grup i madh deputetësh turq kërkonin ndalimin e alfabetit shqip në shkollat shqipe, gjë që krijoi revolta të jashtëzakonshme midis shqiptarëve. Gregor Nosi, një patriot elbasanas, e shoqëronte atë përgjatë kodrave të Elbasanit, duke pa rë çdo pëllëmbë të asaj toke të bukur me livadhe dhe korije të bukura. Në shtëpi ai kujdesej që Earli të mësonte frëngjisht me Kristo Dakon në mëngjes dhe të merrte mësime matematike mbrëmjeve.

Beteja për alfabetin në Elbasan kishte marrë forma nga më të ndryshmet. Ndërkohë që patriotët shqiptarë bënin çdo përpjekje për të hapur shkollat shqipe dhe përdorur alfabetin e Manastirit, turqit, nga ana tjetër, organizuan një demonstratë. Ata u bënë thirrje dymbëdhjetë mijë vetëve për të demonstruar, por dolën jo më shumë se treqind vetë. Ndërkohë të njëjtën gjë bënë patriotët. Demonstrata e tyre pati mbi katër mijë pjesëmarrës. Në atë tubim mbajti një fjalim të shkurtër një patriot i quajtur Dervish bej Biçakçiu[42]. Kjo pati një ndikim shumë të madh tek populli i Elbasanit dhe Ericksoni vetë ndjeu se populli i qytetit dhe i tërë vendit po zgjohej.

Më 3 mars 1910 Ericksoni mori përsëri rrugën për Tiranë. Pasi takoi mikun e tij Gjon Koliaka në Kavajë dhe konsullin austriak Charles Walla në Durrës ai vajti në Tiranë, mori ato plaçka që kishin mbetur, përfshirë edhe pianon e Carriet, kaloi nga nënprefektura me shpresë se do të takonte kajmekamin dhe u kthye në Elbasan.[43]

[42] Enciklopedia e Arësimit në Elbasan – Lexo Dervish Biçakçiu.

[43] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

Por sikur të mos i mjaftonin telashet me autoritetet osmane dhe as sëmundja e rëndë e shiatikut, atij iu shtuan edhe marrëdhëniet me Bordin e Misionarëve, e sidomos me Kenedët. Ndërkohë që i ishte premtuar se do të financohej një shkollë industriale, paratë nuk po vinin. Kjo e bënte pozitën e tij edhe më të vështirë, në mos të pamundur. Në qytet ishte hapur fjala se Rrokfeleri, në Amerikë, kishte lëshuar kushtrimin se do të ndërtonte shkolla në tërë botën me paratë e tij dhe kjo bëri që Dervish Beu të vinte tek shtëpia e Ericksonit dhe të kërkonte që të shkonin bashkë në Amerikë tek filantropi amerikan dhe të merrnin para për shkollat shqipe. Ishte kjo një ide krejt qesharake e tij, por natyrisht me qëllim shumë të mirë.

Më 17 prill 1910, Ericksoni u nis për në Stamboll dhe që andej do të shkonte në Samokov, Bullgari, ku do të mbahej një mbledhje vjetore e Bordit të Misioneve në Ballkan. Atë e përcollën fëmijët, Carrie dhe i kudo-gjenduri i përhershëm Kristo Dakoja, i cili e prezantoi me shokun e tij Gjon Besantoshin, i cili po udhëtonte për në Strugë. Ata udhëtuan atë ditë deri në Qukës, ku bënë një natë pushim, pas një ditë me shi dhe reshje, që i kishte lagur deri në palcë. Arritën në Strugë vonë dhe u vendosën në hanin e një patrioti shqiptar të njohur me emrin Abdullah bej Efendiu. Më pas ata u takuan me banorët e zonës së Goricës, të cilët gjendeshin para një telashi të madh me qeverinë turke. Një deputet i parlamentit turk, i njohur si Gaxhi Aliu, iu kishte premtuar atyre se po të votonin për të, ai do t'u hiqte çdo lloj takse qeveritare. Banorët kështu kishin bërë. Por deputeti kishte marrë mandatin dhe kishte ikur në Stamboll dhe nuk dukej më, ndërkohë që taksidarët kishin ardhur dhe kërkonin të vilnin taksat. Më në fund ata ranë dakord që të paguanin nëse paratë do të përdoreshin për të hapur shkolla shqipe dhe për rregulluar rrugët e zonës së tyre. As për këtë nuk ranë dakord dhe kjo nxiti revoltën e shtatë mijë shqiptarëve të Dibrës, të cilët lidhën besën të luftonin krah për krah kundër administratës turke.

Ericksoni e vazhdoi udhëtimin e tij nëpër Ohër, në një mot të lagësht e me llohë. Kaluan një natë në Resnjë dhe të nesërmen në mbrëmje arritën në Manastir. Aty u takua tërë grupi, amerikanët e Shkollës së Vajzave, zonja Klark, zonja Kenedi,

zonjusha Parashqevi Qiriazi dhe zonja Cilka. Të nesërmen ata organizuan takimin e tyre në Shkollën e Vajzave në Manastir. Aty ranë dakord që një shumë prej dy mijë dollarësh t'i jepej Ericksonit për hapjen e shkollës, me shpresë që paratë e tjera do të mblidheshin në Amerikë dhe më pas të vazhdonte punën. Të nesërmen ata udhëtuan për në Selanik. Një pjesë e madhe e misionarëve të Ballkanit u mblodhën në shtëpinë e Haskellsit. Aty u mblodhën të zotët e shtëpisë, burrë e grua me katër fëmijët e tyre, zonjusha Froelich nga Zvicra, doktor House dhe z. Kuper. Të nesërmen nga Selaniku, ata morën rrugën për në Stamboll. Që andej shkuan tek Kolegji Robert. Pas një dite në kolegj, të nesërmen ata udhëtuan me tren për në Bullgari dhe arritën në Samokov, ku u bashkuan me miq të tjerë misionarë, si z. Çambers, dr. Marsh dhe zoti e zonja Ostrander.

Ditën tjetër, ata filluan një konferencë në shkollën e Samokovit, e cila kishte mbushur 50 vjet që nga çelja e saj. Ajo kishte nxjerrë nga dyert e saj, deri në atë kohë, 800 studentë. Në mbledhjen e Samokovit u vendos që sapo të gjendej vendi, të ndërtohej shkolla në Elbasan, të financoheshin punimet fillestare dhe Ericksoni të merrte udhën për Amerikë, për të mbledhur fonde të reja. Kjo ishte një arritje e madhe për Ericksonin dhe për qëllimet e tij për të ndërtuar shkollën në atë qytet. Rrugën në kthim nëpër Stamboll, Ericksoni e shfrytëzoi për të bërë një kërkim në librat për Shqipërinë dhe shqiptarët mbi historinë dhe origjinën tonë, subjekte që kishin tërhequr vëmendjen e tij të përditshme. Pastaj takoi ambasadorin amerikan në Stamboll, të cilit i parashtroi shqetësimet e tij në lidhje me ngacmimet nga administrata turke dhe kërkoi mbrojtje nga ambasada. Më pas ai u kthye në Elbasan dhe iu bashkua familjes, pas një udhëtimi të gjatë që kishte ngjallur shpresa për realizimin e ëndrrës së tij të madhe – hapjen e shkollës në Elbasan.[44]

[44] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

MBRETËRIMI I TERRORIT

Përpjekjet e Ericksonit për të marrë tokën e duhur për shkollën e tij në Elbasan vazhdonin odisenë e tyre. Nga njëra anë paratë vonoheshin, por pengesa më e madhe ishin pronarët, të cilët, kur shihnin se një i huaj donte ta blinte atë, e rritnin çmimin deri në atë masë sa çdo pazar me ta ishte i kotë. E njëjta gjë ndodhte edhe me shërbimet. Në një banjë tetëditore në llixhat e Elbasanit, bashkë me një ndihmës vendas të tij, Jasharin, ai pagoi dy herë më shumë sesa vendasit për shërbimet që i kishin ofruar. Por as aty ai nuk e kaloi kohën thjesht duke kuruar nervin shiatik. Banjat kishin gjurmë të kulturës romake dhe mendohej se në atë kohë aty kishte patur një koloni, e cila e kishte trajtuar llixhën ashtu siç dinin romakët.

Korriku i atij viti kaloi duke u marrë me gjetjen e tokës. Natyrisht gjërat asnjëherë nuk shkonin siç duhej. Revolta kundër turqve rritej, refugjatët në Veri ndërronin vend herë në Mal të Zi e herë në Shkodër. Kjo kishte efekt në çdo pjesë të vendit. Por për momentin detyra kryesore ishte blerja e tokës për shkollën. Në përpjekjet e përditshme dhe pazaret që bënte nëpërmjet një sekseri hebre, të quajtur Abraham Efendiu, ai arriti të binte dakord me një pazar i cili ishte vërtet shumë i shtrenjtë. Por papritmas punët morën përsëri një kthesë tjetër. Kristo Dakoja, ky njeri i shkolluar në Kolegjin Oberlin në Amerikë, u arrestua

dhe u mbajt në burg. Shtëpia e tij u kontrollua, por për fat ushtarët ishin shqiptarë dhe në vend që t'i merrnin librat, e mbyllën derën e dhomës ku ishin ato dhe e vulosën. Lef Nosi, si përherë iu gjet atij, duke e ndihmuar që të kishte diçka për të fjetur dhe të nesërmen e nisën për Manastir. Ericksoni e mori këtë si një presion që bëhej për të mbyllur çështjen e shkollës së tij dhe të punës së misionit, duke filluar me një vendas. Që prej disa kohësh otomanët po përpiqeshin të mbyllnin Shkollën Normale duke nxjerrë lloj-lloj pretekstesh, si bie fjala, kërkonin diplomat e mësuesve, nxirrnin probleme financiare e plot gjëra të tjera. Por nuk vonoi dhe doli edhe arsyeja e vërtetë e arrestimit të Dakos, i cili ishte botimi në "Bashkimin e Kombit" të një artikulli, më 20 maj 1910, në të cilin thuhej:

> *"Një ushtar i liruar nga një batalion që ishte dërguar në fillim kundër shqiptarëve në Kosovë solli lajmin se ushtria qeveritare po vriste pleqtë dhe gratë e shqiptarëve sapo binin në duart e tyre, në një mënyrë që është e vështirë të përshkruhet. Ushtari thotë se i kishte parë me sytë e vet ushtarët që kishin rrëmbyer një plak afërsisht 100 vjeç dhe ia kishin goditur kokën me kondakët e pushkëve. Një grua që ishte gjetur e vrarë në fushëbetejë, thoshte ushtari, po luftonte kundër ushtrisë me tre djemtë e saj dhe me duart e saj kishte vrarë 13 ushtarë. Ushtria e zuri atë të gjallë dhe urdhëroi ta vrisnin në mënyrën më barbare. Në fillim i prenë gjinjtë, më pas veshët e hundën dhe pastaj i gjymtuan trupin, derisa e bënë copa-copa."*[45]

Shkrimi ishte botuar në shqip dhe në turqisht dhe kjo kishte bërë aq shumë përshtypje në Veri, saqë Shefqet Turgut Pasha kishte urdhëruar arrestimin edhe të autorit, edhe të botuesit. Gazeta ishte dërguar nga Elbasani dhe ishte nënshkruar me pseudonimin "Kamani", por thuhej se e kishte shkruar vetë Dakoja. Botuesi ishte dërguar në Gjakovë, ku edhe do të përgjigjej para një gjykate ushtarake. Edhe Dakoja po ashtu do të dërgohej atje. Në pak ditë ai do të martohej me zonjushën Qiriazi, e cila ishte drejtore e Shkollës së Vashave në Korçë. Ata i kishin kërkuar Ericksonit që të shkonte dhe t'ua organizonte ceremoninë e martesës.

Më 12 korrik familja festoi njëvjetorin e datëlindjes së Christelit me ato

[45] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 2.

çfarë patën në ato kushte që ishin. Ndërkohë Ericksoni shoqërohej me patriotët elbasanas çdo ditë. Natyrisht që Lef Nosi mbetej gjithnjë njeriu që e prezantonte atë me miq të rinj të qytetit[46].

[46] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

DASMA E KRISTO DAKOS NË MANASTIR; HAPJA E SHKOLLËS "ERICKSON" NË ELBASAN

Dita e martesës së Kristo Dakos erdhi dhe Ericksoni u nis për në Manastir bashkë me një karvan prej 25 kuajsh. Dasma, ashtu siç e përshkruan Ericksoni, nuk kishte asgjë të ngjashme me atë çfarë ndodhte anembanë trojeve shqiptare. Në Dibër Shefqet Turgut Pasha vazhdonte të arrestonte, të burgoste, torturonte dhe vriste shqiptarët. Në anët e tjera të vendit mbretëronte terrori. Por Ericksoni e organizoi dasmën e tyre sikur asgjë të mos ndodhte rreth e rrotull. Ai u lut për çiftin e ri dhe i bekoi ata. Në sy të të gjithëve ai pyeti nëse e pranonin njëri-tjetrin për burrë e grua. Dakoja u përgjigj me të madhe, ndërsa Sevastia me zë të ulët. Pastaj, nën tingujt e një orkestre ata gëzuan me gjithë të mirat, deri vonë. Të nesërmen Ericksoni u nis për Elbasan, ndërsa çifti i ri iku për në Selanik.[47]

Me gjithë vështirësitë e jashtëzakonshme që dilnin, qoftë nga pala pushtuese dhe administrata e saj, qoftë nga burokracitë dhe ngurrimi i drejtuesve të misionarëve në Ballkan dhe në Boston, prapëseprapë ai ia doli që të hapte shkollën në shtëpinë e tij. Aty një numër i mirë djemsh vinin dhe mësonin thuajse çdo ditë. Por martesa e Dakos, i vetmi mësues i gjuhës shqipe, e ngadalësoi mësimdhënien. Me emrin e mirë që kishte fituar Ericksoni, arriti që ta hapte shkollën në një

[47] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

objekt tjetër në anën e kodrave të Elbasanit, duke marrë bekimin dhe simpatinë e tërë banorëve të të gjitha feve aty. Por me të filluar, autoritetet turke e konfiskuan atë menjëherë. Ata e përligjën këtë veprim me gjoja nevojën e jashtëzakonshme që kishte qeveria për atë objekt, për ta kthyer në një magazinë baruti. Sikur kjo të mos mjaftonte, Carrie kishte filluar të bëhej edhe më histerike. Në vend të huaj, pa ditur gjuhën, pa njohur zakonet, pa një njeri që të këmbente një fjalë me të, në një shtëpi me kushte tejet të vështira, ajo bëhej përherë e më e egër dhe më e paduruar. Një ditë ajo kishte dalë nga shtëpia dhe Ericksoni mezi e gjeti diku në një rrugë periferike të qytetit, ulur mbi një gur, të përfshirë nga lotët, mjerimi dhe vuajtja shpirtërore. E keqja ishte se as qeveria amerikane nuk tregonte ndonjë kujdes ndaj tij dhe kërkesave të tij për mbikëqyrje konsullore. Kërkesat e tij vazhdimisht kishin rënë në veshin e shurdhër të Ambasadës Amerikane në Stamboll. Tëra këto ishin kthyer në një vuajtje të pafund për Ericksonin. Me sa duket në misionin e tij ai ndiente detyrim edhe më të madh për t'i shkuar deri në fund asaj që kishte nisur, pavarësisht sakrificave që duheshin bërë.

Ericksoni ishte miqësuar me dy prej burrave më të shquar të qytetit të Elbasanit, në fakt dy burra me emra të mëdhenj në historinë e Shqipërisë. Njëri prej tyre ishte Aqif Pashë Elbasani, ndikimi i të cilit i kalonte kufijtë e qytetit dhe ndihej në tërë Shqipërinë. Ata rrinin shpeshherë bashkë dhe ndanin pikëpamjet me njëri-tjetrin. Një ditë Aqif Pasha i thotë Ericksonit:

> *"Unë e di se ju keni ardhur në Shqipëri për të bërë punë të mira, për t'i edukuar shqiptarët dhe aftësuar ata që të jenë më pak fanatikë dhe të urrehen më pak me njëri-tjetrin. Nëse ju do t'ia arrini kësaj, ne mund t'ia dalim të zgjidhim problemin më të madh që ka kombi ynë. T'u jepet shqiptarëve vetëm një fe dhe kështu të bashkohen në një vëllazëri shpirtërore. Por, për të arritur këtë, ju duhet të përfitoni nga rasti i kësaj mundësie të jashtëzakonshme, e cila na është dhënë në këtë kohë që po flasim, kur udhëheqësit tanë kudo që janë, e dinë nevojën e madhe që kemi dhe janë përgatitur të punojnë dhe sakrifikojnë për të. Do të ishim të pashpresë nëse presim që cilado prej tri feve të vjetra që gjenden këtu, ajo muhamedane, e krishterë romake apo*

ajo ortodokse, të përfshijë dy të tjerat dhe shqiptarët të bashkohen në një fe të vetme. Kanë ndodhur aq shumë gjëra të panevojshme, përplasje deri në gjakderdhje midis tyre; ka patur përzierje të panevojshme të politikës nga jashtë në këto ngatërresa, me qëllim thartimin e këtyre marrëdhënieve midis shqiptarëve bazuar në dallimet fetare deri në nxitje vëllavrasëse. E gjitha kjo ka patur si qëllim ta bënte bashkimin tonë të pamundur".

"Protestantizmi mund ta mundësojë këtë, sepse ai është i lirë nga këto pengesa dhe nxit arsimimin, përparimin, lirinë politike dhe fetare, drejtësinë shoqërore, të gjitha këto që neve na nevojiten dhe që ne i ëndërrojmë dhe i dëshirojmë kaq shumë. Por ju duhet t'i bindeni maksimës amerikane: "Koha është flori". Nëse ndodh ndonjëherë, kjo do të merrte shumë kohë."[48]

Por jo vetëm Aqif Pashë Elbasani, por edhe Lef Nosi, që bënte pjesë në një grup tjetër fetar, atë ortodoks, i thotë Ericksonit:

"Ne e dimë se ju e keni shëruesin e duhur, i cili, po t'i jepet popullit tonë, do t'ia shpëtojë jetën. Por çfarë po bëni ju për këtë? Ju vetëm sa na e tregoni atë. Kur ju kërkojmë ta hapni dhe të na e jepni ta pimë, ju na thoni: 'Prisni pak se ende nuk jemi gati'. Ne po vdesim. Nëse vërtet na doni dhe nëse doni të na ruani, hapeni ilaçin e sëmundjes dhe na shëroni. Nëse nuk e bëni këtë, ju lutem na lini të provojmë diçka tjetër ose na lini të vdesim në paqe".[49]

Biseda e Ericksonit me dy patriotët shqiptarë tregon se sa thellë kishte hyrë ai në shqetësimin e patriotëve shqiptarë dhe se përse në fakt ai ishte kaq i dhënë dhe i njohur me çështjen shqiptare në tërësi. Është koha kur Luigj Gurakuqi, me të cilin ai u njoh personalisht, kishte ardhur nga jashtë dhe ishte vënë në krye të Normales së Elbasanit. Ai u njoh gjithashtu me Sotir Pecin, i cili ishte dërguar nga Vatra, Boston. Në fakt shkolla nuk kishte as tekstet e duhura, por mësuesit bënin si bënin me një mimeo-graf[50], i cili ishte sjellë nga Vjena. Puna e Normales po

[48] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 2.

[49] Po aty.

[50] Makinë e kohës për shumëfishimin e mësimeve, në mungesë të librave dhe testeve shkollore. (Shënimi im – MB)

përparonte aq shpejt, shenjë kjo e etjes së jashtëzakonshme që kombi kishte për dije dhe gatishmërinë e bijve dhe bijave të tij për ta ndihmuar atë në atë orë të re të zgjimit kombëtar.

ARRATI NË MALET E ELBASANIT[51]

Ndërsa dukej se Normalja po përparonte dhe shqiptarët nga të gjitha anët po vërshonin drejt shkollës së tyre, turqit ndërmorën masa të tilla saqë miqtë patriotë të Ericksonit zhdukeshin një nga një. Dikush vritej, tjetri arratisej, dikujt i konfiskohej pasuria, tjetri kërcënohej me vdekje. Vjeshta e vitit 1910 hyri e mbushur me krime të tilla, ndërkohë që luftëtarët morën malet. Emri i Shefqet Turgut Pashës u bë sinonim i vdekjes, ndërsa emri i Sulltanit të Kuq kishte hijen e vdekjes së zezë.

Ericksoni u bë dëshmitar i vizitës që sulltani bëri në gusht të vitit 1910. Në fillim ai e mbushi qytetin me dhjetë mijë ushtarë, të cilët mbyllën çdo shteg hyrjeje apo daljeje të qytetit. Menjëherë ai shpalli gjendje të jashtëzakonshme për tri ditë. Pastaj vijoi bastisja shtëpi më shtëpi për të kërkuar, konfiskuar dhe ndëshkuar tërë ata që kishin ndonjë gjë të shkruar në gjuhën shqipe. Qyteti u mbush me të burgosur që kishin bërë "të njëjtin faj" që nga Tirana e deri në Elbasan. Xhamia e qytetit, e cila nuk ishte aq larg nga shtëpia e Ericksonit, u kthye në një vend torturash dhe kolonat e saj u gjakosën nga rrahjet publike që iu bëheshin shqiptarëve arsimdashës. Në këtë sipërmarrje të vështirë u përfshinë turkofilë, grekofilë, spiunë, tradhtarë të njohur në qytet, të cilët raportonin tek autoritetet pushtuese. Libra, fletore dhe

[51] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

tekste shkollore, të cilat në asnjë vend të qytetëruar të botës nuk do të përbënin kurrfarë rreziku, u trajtuan sikur të ishin armët më të rrezikshme, u grumbulluan, u spërkatën me vajguri dhe u dogjën në mes të ditës, në mes të qytetit. Po aq u kërkuan, u konfiskuan dhe u grumbulluan për t'u transportuar për në Stamboll shpata, armë të dekoruara me gur të çmuar, argjend dhe flori, me filigramë dhe zbukurime të të gjitha kohërave, edhe pse ndoshta të dala nga koha për përdorim, por shumë të bukura dhe me vlera artistike. Shumë prej këtyre armëve mund të ishin ruajtur që nga koha e Skënderbeut. Por të gjitha u mblodhën dhe si një thesar i paçmuar u mblodhën pamëshirshëm dhe u hodhën në tregun e Kapallëk Çarshisë[52], në Stambollin e plakur perandorak. Ndërkohë një qytetar britanik i Shoqërisë Biblike Britanike ishte rrahur në rrugë ndërsa donte të shkonte tek shtëpia e Ericksonëve. Kujdestari Jashar nuk shkonte dot për të blerë gjërat e nevojshme për familjen. Një elbasanas i veshur me fustanellë ishte rrahur keqas ende pa arritur tek shtëpia për shkak të veshjes të tij kombëtare shqiptare marrë si shenjë nacionalizmi. Babai i teqesë u rrah barbarisht nën pretekstin se kishte armatim në shtëpi, por në fakt arsyeja ishte se ai predikonte nacionalizëm. I tërë qyteti i ishte nënshtruar terrorit. Ky terror nuk mund ta linte as Ericksonin dhe familjen e tij të paprekur. Kështu, nuk vonoi dhe një patrullë turke dha ballë përpara shtëpisë së tyre. Ata kishin synim të kërkonin për armë. Ericksoni iu përgjigj atyre:

"Unë jam amerikan dhe ju nuk keni të drejtë të më bastisni. Ju duhet të komunikoni ose me Ambasadën Amerikane në Stamboll, ose me Konsullatën Austriake, e cila mban përgjegjësi për qytetarët amerikanë të vendosur në këtë vilajet. Unë jam këshilluar me të dyja palët dhe kjo është përgjigjja ime."[53]

Skuadra turke me bajoneta të ngritura u largua me premtimin se do të ktheheshin përsëri sapo të merreshin vesh me zyrat përkatëse. Ndërkohë që ata ishin aty, kujdestari i shtëpisë, Jashari, erdhi për të sjellë postën, por ata nuk e lejuan.

[52] Kapalk Carsi – Pazari i Mbuluar – në Stamboll midis xhamisë Eminönü dhe Top Kapa Sarayit - Qendra më e vjetër tregtare osmane e themeluar në shekullin e 16-të. Sot ajo është ende e tillë, e përdorshme dhe ruan vlera të jashtëzakonshme muzeale. (Shënimi im – MB)

[53] Erickson.Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5

Atëherë Ericksoni i thirri: "Hidhe për tek unë që andej!" Jashari bëri kështu. Diku nga mbrëmja rojat u njoftuan të largoheshin, ndërsa Jashari u lejua të hynte renda.

Operacioni u mbyll me mbledhjen e pesëdhjetë deri në gjashtëdhjetë mijë armëve anembanë qytetit. Por radha i erdhi edhe Ericksonit. Një qytë pushke goditi ashpër derën e jashtme të shtëpisë dhe zëri i oficerit turk u dëgjua me forcë: "Jashtë, jashtë!" Bimbashi turk çirrej e bërtiste. Ericksoni aq u ndje i vrarë nga ky veprim, aq edhe u çlirua shpirtërisht, pasi e konsideronte veten pjesë të këtij populli e të këtij vendi. Ai do të ndihej keq nëse do të "privilegjohej". Ai i raportoi misionit të vet lidhur me këtë:

> *"E dija se kishte ardhur radha ime. Për çudinë time kjo më dha një ndjenjë lehtësimi. Unë kisha vënë në rrezik gjithçka timen për këtë popull, familjen, shtëpinë, pasurinë, duke e zgjedhur me qëllim të plotë dhe duke e quajtur atë pasuri si të tyren. Kurrë nuk kisha kërkuar dhe as kisha marrë ndonjë përfitim."*[54]

Tani ai do të ndeshej me bimbashin, të cilin e njihte personalisht. Ericksoni nuk ngurroi t'i thoshte ato që deshi, edhe pse e pa se ai kishte një skuadër me ushtarë me bajoneta të hapura:

> *"Unë të njoh për mik dhe do të lë të futesh në shtëpinë time, por nuk do të lejoj të hapësh sirtarë dhe dollapë, të cilët t'i nuk ke të drejtë t'i kontrollosh.*[55]*"*

Ata kontrolluan aq sa iu tha Ericksoni dhe në ikje e sipër e pyetën: "Po përse e ke vënë jashtë flamurin amerikan?". "Sepse desha t'u tregoj ushtarëve që kjo është shtëpia e një amerikani dhe, nëse do të ndërmerrnin ndonjë hap të pamatur, këtë do ta bënin duke e ditur këtë fakt". Ata e pranuan argumentin dhe u larguan për të vazhduar punën e tyre të ndyrë, duke rrahur dhe keqtrajtuar thuajse çdo burrë në qytet.

Por nuk vonoi shumë dhe ata u kthyen përsëri me argumentin se shtëpia e Ericksonit ishte më shumë se nëntë orë larg nga konsullata më e afërt amerikane

[54] Po aty

[55] Po aty.

në rajon. Ata hynë brenda dhe këtë radhë morën tërë veprat letrare, poezitë dhe abetaret, "Historinë e Skënderbeut", pjesë nga liturgjia dhe psalmet e shkruara prej Ericksonit vetë. Këto mjaftuan për ta që Ericksoni të konsiderohej si i rrezikshëm dhe të urdhërohej të largohej menjëherë. Ishte një situatë tepër e rëndë. Carrie e shtrirë vajtonte për jetën e saj dhe Amerikën që nuk e kishte më. Ericksoni iu tregoi kushtet në të cilat gjendej familja, por ata i thanë se nuk kishin punë me tjerët, por vetëm me atë. Këtë fat kishte tërë qyteti, "Pse do të bësh ti përjashtim", i tha një prej oficerëve, si për t'i kujtuar se Ericksoni vetë kishte zgjedhur të vuante me këtë popull të mjerë.

Erdhi koha që të niseshin. Në fakt çdo gjë në shtëpinë e tyre ishte katrahurë. Carrie as që e dinte ku ishte. Fëmijët ishin të tronditur, Christeli e vogël vetëm qante. Pak para se të dilnin, Ericksoni i kërkoi bimbashit dhe mytesarifit që t'i jepnin urdhrin e largimit me shkrim. Ata i rrëfyen se kishin frikë ta jepnin këtë urdhër në një formë të shkruar, por do t'i telegrafonin valiut në Manastir.

Karvani i Ericksonit e mori edhe një herë udhën, siç do të bënte edhe herë të tjera në Shqipërinë e rrënuar nga pushtimi dhe pushtuesit. Me Carrien gjysmë të ndërgjegjshme për atë çfarë po ndodhte, fëmijët e vegjël, dy nga dy nëpër kuaj, me një evgjit dhe Jasharin, ai mori rrugën. Nuk vonoi dhe me ta u bashkua një i krishterë, Pedro, i cili besnikërisht arriti të kalonte tërë pritat e Turgut Pashës, për të mos e lënë familjen amerikane të vetme në rrugëtimin plot rreziqe dhe pritat që mund ta prisnin. Rruga e Ericksonëve drejt arratisë në një vend krejtësisht të panjohur ishte një ankth i vërtetë. Me shumë pak ushqime, pa ditur se ku do të shkonin, çdo gjë ishte në mëshirë të Zotit. Udhëtimi nëpër shtigje dhe monopate, nëpër gropa, përrenj e gryka, ishte pa dyshim një pelegrinazh i detyruar, që e bën çdo njeri t'i dhëmbë shpirti dhe zemra. Por Ericksoni, me bindjet e veta të thella fetare, moralin e lartë njerëzor, përkushtimin ndaj kauzës së tij, që ishte e njëjtë me atë të shqiptarëve, e përballoi edhe këtë.

Natën e parë ata e kaluan në fshatin Gjurë në Hanin e Babës. Të gjithë fjetën

bashkë në një dhomë dhe e vetmja që nuk çante fare kokën për atë që ndodhte rreth e rrotull ishte Christeli. Hani ishte në një kullë prej guri me frëngji të vogla. Por lodhja e udhës kishte bërë të veten dhe asgjë nuk bënte më përshtypje. Të nesërmen ata vijuan për në Strugë dhe që andej me një karrocë për në Manastir. Pas dy vjetësh nëpër Shqipëri, udhëtimi i tyre pati një kthim të plotë aty ku ishte nisur, në Manastir. Shkolla, toka, ëndrrat për të arritur diçka në atë mision për Ericksonin tani ishin më të mjegullta se kurrë. Shumë aventura të tjera e prisnin Ericksonin. Por e tëra ishte një aventurë që kishte koston e vet familjare. Në radhë nuk ishte vetëm Carrie, e cila tanimë thuajse kishte humbur edhe pikën e fundit të durimit.[56]

[56] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

NË INTERNIM – MANASTIR, 10 SHTATOR 1910

Arritja e Ericksonëve në Manastir mund të ishte shoqëruar me një pritje prej martiri nëse ai do të luante rolin e viktimës bashkë me familjen e tij. Ai u rrethua nga simpatia dhe keqardhja e të gjithëve. Por ai nuk ishte një luftëtar që kërkonte dekorata për ato që bënte dhe as për vuajtjet që përjetonte. Jo, aspak. Ai menjëherë u paraqit tek konsulli austriak në Manastir, Baroni Bornamica. Manastiri në atë kohë ishte i mbushur me konsullata të huaja, por konsulli austriak shquhej për bujarinë, mirësjelljen, respektin dhe, veç të tjerash, për pamjen e tij madhështore. Natyrisht, ashtu si Charles Walla në Durrës, ai iu gjet menjëherë Ericksonit. Por fuqia e tij ishte shumë e kufizuar dhe mendohej se Ambasada Amerikane në Stamboll, në të vërtetë, nuk po luante ndonjë rol të madh për të. Aty Ericksoni mësoi se Grigor Cilka ishte në Sofje, Kristo Dakoja në Bukuresht. Ai mori vesh gjithashtu edhe për dy vëllezërit Kaloshi nga Dibra, Lanin dhe Ibrahimin, të cilët ishin burgosur për shkak të revoltave në Dibër. Por ajo që e dëshpëroi më shumë ishte burgimi në Brusa dhe më pas dënimi me internim të përjetshëm që i ishte shqiptuar Lef Nosit.

Më 24 tetor 1910 ishte ditëlindja e Sulltanit. Për këtë ishin marrë masa të rrepta gjithandej. Në mbrëmje, ndërsa Ericksoni me Earlin kishin blerë disa gjëra

dhe po ktheheshin në shtëpi, ata vunë re se disa policë iu ishin vënë prapa. Ata e shpejtuan hapin dhe vunë re se edhe policët bënë të njëjtën gjë. Më pas Ericksoni i tha Earlit se duhej të vraponin dhe të kuptonin nëse ata ishin duke i ndjekur apo ishin në shërbim, në punën e tyre. Doli të ishte e para. Kur arritën tek dera e shtëpisë, ata e kapën Ericksonin dhe e qëlluan me shkopinjtë që mbanin me vete, ndërsa ky i fundit i bërtiti të birit të futej brenda. Menjëherë doli Carrie t'i ndihmonte, por policët e Sulltanit e shtynë edhe atë brenda me forcë. Kështu, Ericksoni përfundoi në karakoll, në stacionin e policisë, i rrahur dhe i dërrmuar. Ai protestoi dhe kërkoi t'i vinte konsulli austriak që të ishte i pranishëm në atë që po ndodhte. Turqit ranë dakord dhe e morën Ericksonin në Bashki dhe e çuan tek Drejtori i Policisë. Ai nuk ishte aty, kështu që Ericksoni përfundoi në kapanonin e policëve. Aty gjeti edhe policë shqiptarë, me të cilët filloi një bisedë rreth qëllimeve të tij për mbarëvajtjen e kombit shqiptar dhe përndjekjet që kishte pësuar deri tani. Ai vuri re se shumë prej policëve iu pëlqyen ato që u tha dhe se shprehën simpati për të dhe kauzën që ai përfaqësonte. Më pas ai u dërgua tek prefekti, i cili i tha se një gjykatë ushtarake kishte dhënë urdhër që ta dëbonte atë prej Manastirit. Më pas e kthyen tek reparti ushtarak. Ericksoni mendoi shumë gjëra të këqija për veten, por në fakt përfundoi tek Konsullata Austriake. Zëvendëskonsulli austriak Çikofski dërgoi telegrame në ambasadën e vet si dhe njoftoi për arrestimin e Ericksonit në Ambasadën Amerikane në Stamboll.

Prej këtej, ai vajti në shtëpi dhe kështu pasuan disa ditë të qeta, të cilat Ericksonit iu dukën mjaft të gjata. Pastaj ai vendosi të shkonte në Stamboll dhe të takonte Oskar Shtrausin, ambasadorin e ShBA-së në Stamboll. Atje ai u takua me disa diplomatë amerikanë, kaluan një darkë të këndshme, folën dhe lozën gjatë dhe të nesërmen ai takoi vetë ambasadorin Shtraus.

Në takimin që patën ambasadori Shtraus i tregoi Ericksonit bisedën e mëposhtme që kishte bërë me ministrin e Jashtëm të Perandorisë, Rifat Pashën. Ky i fundit njihej si njeri shumë i sjellshëm dhe zotëri i vërtetë dhe të dy diplomatët kishin vendosur t'i flisnin njëri-tjetrit pa doreza, pa protokoll dhe pa regjistruar

bisedën. Ja çfarë i tregoi ambasadori Ericksonit në atë takim:

Oskar Shtraus: Ju lutem, a s'më thua cila është arsyeja e vërtetë e tërë këtij zemërimi ndaj Ericksonit? Nga tërë raportet që ne kemi për të, ai del të jetë një njeri i padëmshëm dhe i sinqertë, që përpiqet t'i bindet ligjit, që kryen punë të cilën ia ka ngarkuar Bordi Amerikan i Misionarëve. Ju i keni lejuar misionarët të punojnë në të gjitha anët e Perandorisë. Po me këtë çfarë keni? Çfarë përjashtimi bën Ericksoni?

Rifat Pashai: Po do të tregoj, z. Shtraus. Ericksoni nuk është me të vërtetë amerikan, por shqiptar. Pa dyshim që ai mund t'ju ketë bindur ju dhe Bordin se ai është amerikan, por ne e dimë më mirë se askush tjetër këtë. Ne e kemi mbikëqyrur atë që kur erdhi në Tiranë. Janë dërguar raporte të përditshme tek valiu ynë në Manastir, për jetën dhe veprimtarinë e tij, hap pas hapi. Ne e dimë se ai nuk është amerikan, por shqiptar, për arsyen e thjeshtë se nuk ka amerikan që ta zotërojë gjuhën shqipe siç ka bërë ai, në më pak se dy vjet. Vetëm një shqiptar mund ta bënte këtë. As zyrtarët tanë turq, të cilët kanë kaluar më shumë kohë se ai atje dhe janë ekspertë të gjuhës, që janë përpjekur aq shumë për të marrë njohuri të nevojshme sa ta flasin atë gjuhë, nuk ia kanë dalë kaq shpejt sa ky. Pastaj, sikur të mos mjaftonte kjo, ai jeton dhe vepron pikërisht si një shqiptar; ai ka bërë udhën e vet thuajse në tërë qarqet e brendshme të jetës së tyre shoqërore dhe private. Madje edhe shtëpitë e myslimanëve tanë janë të hapura për të, haremi e gjithçka, dhe ajo që është edhe më e rëndësishme, ata e vizitojnë shtëpinë e tij aq lirshëm dhe madje edhe hanë bukë në shtëpinë e tij . Nuk ka të huaj që ia arrijnë kësaj. Ai duhet të jetë shqiptar."[57]

Ericksoni ndjeu një lehtësim dhe kënaqësi shpirtërore, edhe pse biseda ishte bërë me kushte që të mos merrej në shënim. Kjo bisedë e bëri Ericksonin të ndihej edhe më afër me shqiptarët, edhe pse në fakt tani kthimi prapë atje ishte thuajse tërësisht i pamundur. Prandaj ditën tjetër ai vajti dhe bisedoi me njëfarë dr. Paton, një prej njerëzve kryesorë të misioneve në Ballkan. Ata biseduan shumë gjëra që kishin të bënin me blerjen e tokës në Elbasan dhe me vijimin e punës së Ericksonit

[57] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

në Shqipëri, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Më pas ai takoi të ngarkuarin me punë të ambasadës, z. Karter, me të cilin shqyrtuan mundësinë e rikthimit të Ericksonit në Elbasan.[58]

[58] Po aty.

ÇËSHTJA "ERICKSON" NË SHQIPËRI, MIDIS DASH DHE QEVERISË OSMANE[59]

Historia e dëbimit, arrestimit dhe takimit të Ericksonit në Stamboll është pasqyruar në një korrespondencë të gjatë, e cila gjendet në Departamentin e Shtetit Amerikan (DASH). Për të kuptuar më mirë shqetësimin e shtetit amerikan, le të shohim të përmbledhur pjesë të kabllogrameve të shkëmbyera për këtë çështje. Kjo do të japë vërtet një tablo interesante e asaj që ndodhi me Ericksonin dhe këmbënguljen e tij për të mos u shkëputur nga Shqipëria, pa kryer misionin e tij.

Ambasada amerikane, Kostandinopojë, 17 tetor 1910

Kabllogram:

Si u përzu Ç.T.Ericksoni, shtetasi amerikan nga Elbasani, prej autoriteteve turke.

I ngarkuari me punë i Ambasadës:

Drejtuar Departamentit të Shtetit:

Zotëri, kam nderin t'ju transmetoj bashkëngjitur një kopje dhe përkthimin e një kabllograni të konsullit austriak në Manastir, drejtuar Ambasadës Austriake në

[59] Arkivi i DASH, File nr. 367, 112, 4/1/2/3/4/5/6.

Konstandinopojë, si dhe kopjet e dy letrave bashkëngjitur. Të gjitha kanë të bëjnë me dëbimin nga qyteti i Elbasanit i Reverend Charles Telford Erickson, një qytetar amerikan, i cili ishte detyruar prej autoriteteve turke që papritmas të linte shtëpinë dhe të ikte me gjithë familjen në rrethana tejet të rënda e shkatërrimtare drejt qytetit të Manastirit, pa urdhër me shkrim, dhe pa asnjë arsye bindëse.

Dua t'ju raportoj se faktet e paraqitura prej konsullit austriak në Manastir, i cili është i ngarkuar me mbrojtjen e interesave amerikane, provojnë se autoritetet turke në Elbasan kanë vepruar në mënyrë të padrejtë, duke dëbuar një qytetar paqësor amerikan nga shtëpia, pa dhënë asnjë arsye se ku bazohej veprimi ndaj tij.

Zoti Erickson, i cili është një misionar amerikan, rezulton të jetë një burrë i qetë që nuk fyen, i edukuar dhe i sjellshëm. Ai përpiqet të blejë një tokë në Elbasan, me qëllimin e vetëm që të hapë aty një shkollë dhe një spital nën kujdesin e Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet e Huaja në Boston, Masaçusets. Pas një shqyrtimi të kujdesshëm, unë munda të konstatoj faktin se autoritetet turke e shohin këtë burrë si një dëshmitar të masave të ashpra ndëshkimore që ata po zbatojnë kohëve të fundit kundër shqiptarëve. Siç jam njoftuar, ai është shumë i respektuar dhe i pëlqyer prej shqiptarëve. Prandaj turqit kanë përdorur masa të tilla për ta hequr qafe. Mund të merret me mend se përse qeveria otomane kundërshton me forcë themelimin e një shkolle amerikane në Elbasan, ku shqiptarët, në vend të gjuhës turke, të mësojnë gjuhën e tyre amtare me të gjitha mjetet. Qeveria otomane është qartësisht e vendosur që turqishtja të jetë gjuha e vetme e shkollës në Shqipëri. Unë jam njoftuar prej z. Peet, se misionarët e mësipërm nuk janë ngatërruar në mësimdhënie, në pritje të plotësimit të kërkesave për pasurinë.

Dua gjithashtu të sjell në vëmendjen tuaj faktin se z. Erickson ishte objekt i një trajtimi të njëjtë edhe prej autoriteteve osmane në Tiranë, në vitin 1909. Në atë rast, edhe pse me atë çështje u mor ambasada jonë në Portën e Lartë, z. Erickson nuk u kthye më tek ai vend, por e mori banesën e tij në Elbasan, ku që atëherë po përpiqet me çdo kusht të blejë një copë tokë me shpresë se do të ndërtojë një shkollë dhe një

spital. Kështu ai kishte paguar një shumë parash, me të cilën kishte siguruar titullin e pronësisë në kohën kur e dëbuan nga Elbasani. Është e kuptueshme se autoritetet otomane e bazojnë një trajtim të tillë ndaj z. Erickson tek propaganda që bën ai për shkrimin e shqipes me shkronja latine.

Unë i kërkoj Departamentit të Shtetit që të ndërhyjë për kthimin e Ericksonit dhe familjes së tij në Elbasan. Në takimin që pata me Grand Vezirin dhe me ministrin e Jashtëm pashë se ata të dy bënë të paditurin rreth kësaj çështjeje. Ministri i Jashtëm vuri në pah se ka patur shumë trazira në atë rajon dhe duket se i jep pak rëndësi ngjarjes, duke siguruar vetëm se ai do të marrë informacion në lidhje më këtë.

Duke kërkuar udhëzime nga Departamenti i Shtetit mbi çështjet e mësipërme, dua t'ju kujtoj me forcë se qeveria otomane duhet të mbahet përgjegjëse për dëmtimet e shkaktuara prej një trajtimi të tillë ndaj këtij qytetari amerikan prej autoriteteve turke në Elbasan. Prandaj duhet të hiqen menjëherë kufizimet dhe të lejohet kthimi i tij në Elbasan. Dhe për këtë duhet të këmbëngulet sa më shumë.

Hoffman Philip

I ngarkuar me punët e ministrit për Çështjet e Jashtme

Ambasada Amerikane Kostandinopojë

Departamenti i Shtetit Amerikan

Uashington, 1 nëntor 1910

Veprimi i qeverisë osmane konsiderohet prej Departamentit të Shtetit si një veprim i paparalajmëruar dhe drejtpërdrejt në shkelje të neneve të traktatit të nënshkruar midis dy shteteve që në vitin 1830. Ambasada udhëzohet të kërkojë heqjen e menjëhershme të kufizimeve të sotme kundër kthimit të Ericksonit në Elbasan dhe ruan të drejtën

që, në të njëjtën kohë, të kërkojë kthimin e tërë të drejtave dhe kompensimeve për dëmtimet e bëra[60] *etj.*

Korrespondenca midis Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Stamboll dhe Departamentit të Shtetit në Uashington ka vazhduar që nga data 17 tetor 1910 deri më 21 janar 1911, kur Rifat Pashai, ministri i Jashtëm i Perandorisë Osmane njoftoi se Ericksoni ishte i lirë të qëndronte në Manastir dhe, nëse kthehej në Elbasan, ai do të merrte vetë tërë përgjegjësitë dhe rreziqet për veten dhe familjen e tij.

Në letrën e mëposhtme Rifat Pashai njofton Departamentin e Shtetit si më poshtë:

Ministri i Punëve të Jashtme i Perandorisë Osmane

Drejtuar Ministrit Amerikan në Ambasadën Amerikane

Përkthim (nga osmanishtja)

PORTA E LARTË, MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Z.Ministër,

Kam patur nderin të marr notën verbale nr. 142, datë 7 dhjetor, të cilën ju mirësisht ma dërguat dhe ku më njoftoni se z. Erickson përkohësisht ka hequr dorë nga ideja e të kthyerit në Elbasan dhe do të shkojë në Manastir për t'iu bashkuar familjes së vet.

Kjo më jep kënaqësinë e veçantë t'ju siguroj me këtë rast se z. Erickson do të gëzojë në Manastir tërë garancitë dhe siguritë të cilat qeveria perandorake është përherë e lumtur t'u sigurojë të huajve në këtë territor. Më duhet t'ju njoftoj se Porta e Lartë gjendet në rrethana të pazakonshme dhe shumë gjëra janë jashtë kontrollit të saj, çka i bën të domosdoshme masat e përkohshme të ndërmarra ndaj z. Erickson.

Me respekt ..etj.

RIFAT PASHA[61]

[60] Arkivi i DASH, File Nr. 367.112. Er 4/3/4/5/6.

[61] Arkivi i DASH, File nr 367, 112, er 4/1/2/3/4/5/6.

Ericksoni u kthye në Manastir, ku gjeti fëmijët e tij, Carrien në një gjendje thuajse të çmendur dhe miqtë e tij të përhershëm, që nuk i ndaheshin kurrë, Grigor Cilka, Kristo Dako dhe kujdestari i tyre, Jashari. Kështu, ditët kaluan dhe viti i ri 1911 po afrohej. Viti 1910 po mbyllej, duke lënë pas sëmundje për të dhe për Carrien, përndjekjen nga turqit, shkatërrimin e gjërave të shtëpisë nga ushtria, shkollën e lënë në mes, punë të tëra të mbetura përgjysmë. Nuk ishin për të mos u vlerësuar edhe keqkuptimet me Bordin e Misionarëve dhe mungesa e fondeve, pastaj tri udhëtime në Stamboll, një në Bullgari dhe një tjetër në Manastir për martesën e Kristo Dakos dhe Sevasti Qiriazit dhe, më në fund, arrestimi dhe internimi në Manastir. Por a duhej të dëshpërohej për këtë? Jo. Ai besonte se kishte bërë atë që duhej dhe do të përpiqej ta bënte këtë përsëri deri në frymën e fundit.[62]

[62] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

LUFTË, URI DHE MURTAJË NË MANASTIR

Kohë të vështira po vinin për Perandorinë dhe veçanërisht për Shqipërinë. Kryengritjet në veri po zgjeroheshin. Sulltan Mehmeti V[63] premtoi se do të vizitonte Kosovën dhe të shpallte një falje të përgjithshme për kryengritësit. Ai gjithashtu lëshoi një dekret për të lejuar hapjen e disa shkollave shqipe. Por në Shqipërinë Qendrore autoritetet osmane vazhdonin të çarmatosnin njerëzit, të dënonin nacionalistët dhe patriotët, të jepnin gjykime të rënda ndaj tyre. Ndërkohë në zonën e Manastirit kishte pllakosur edhe kolera.

Në Manastir Ericksoni shihte çdo ditë trupat ushtarake të perandorisë, të cilat merrnin udhën drejt Shqipërisë, të pajisur me çdo lloj armatimi të kohës. Një numër i madh i patriotëve shqiptarë ishte mbyllur në burgje. Në Manastir gjendeshin shumë prej tyre. Ericksoni mezi i siguronte lejet për të shkuar dhe për t'i vizituar ata. Ai shkonte tek ta përherë i mbushur me ushqime dhe sende të nevojshme. Por kjo nuk zgjati shumë, pasi shumë prej të njohurve të tij shqiptarë në burgun e Manastirit u transferuan në burgje të tjera në Turqi.

Kjo situatë kaq e turbullt pasqyrohej në çdo hap të jetës së Ericksonit. Kështu,

[63] Mehmed V Reshad, 1844 – 1918, Sulltani i 35-të i Perandorisë Osmane. Ai ishte i biri i Sulltan Abdülmexhidit. Ai qëndroi në fron nga data 27 prill 1909 – 3 korrik 1918. (Shënimi im – MB)

atij i duhej të paktën të mendonte për fëmijët. Ai vendosi që Loisin ta dërgonte në Shkollën e Vajzave në Stamboll. Për të do të kujdeseshin dy miqtë e tij amerikanë, dr. dhe zonja Peet. Ndërsa Earli do të shkonte në Zvicër me tren. Ndodhi që atë e thirrën për një konsultë në Stamboll dhe e dërgoi vetë Loisin. Më 14 shkurt 1911 ai e nisi Earlin me tren nga Selaniku për në Vjenë, ku do ta prisnin disa miq të tij dhe që andej të shkonte tek zonja Froelich. Ai arriti mirë dhe Ericksoni u qetësua vetëm kur mori një letër prej saj, ku i thoshte se ai ishte shëndoshë e mirë. Natyrisht ishte një gjë e vështirë ta dërgonte një fëmijë të asaj moshe, pa ditur gjuhën në një vend tjetër. Por jeta në Shqipëri, që prej më se dy vjetësh, e kishte kalitur edhe vogëlushin Earl, dhe ai do t'ia dilte mbanë.

Gjatë kësaj periudhe Ericksoni ndiqte me gëzim vendosmërinë në rritje të shqiptarëve për të hedhur tej zinxhirët e zgjedhës turke. Për herë të parë, ai pa shumë grupe shqiptarësh, që më parë ishin të përçarë, të organizonin qëndresë të përbashkët, me qëllim çlirimin prej sundimit turk. Gegët në veri dhe toskët në jug ishin ngritur kundër zgjedhës turke. Mërgimtarët tanë shqiptarë në Stamboll, në Rumani, Bullgari, Zvicër dhe Egjipt ishin bashkuar në një ide dhe kishin hartuar një program kombëtar me kërkesa të qarta, ndër të cilat tri ishin ato më kryesoret:

1. Gjuha shqipe të njihej dhe të mbështetej si gjuhë zyrtare në shkolla, në shtypin e lirë dhe në marrëdhëniet tregtare.
2. Taksat e mbledhura nga qeveria turke të shpenzoheshin për zhvillimin e rrugëve, industrisë dhe në arsimit në Shqipëri,.
3. Katër vilajetet e Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës, të cilat përbëheshin në shumicë absolute nga popullsi shqiptare, të bashkoheshin nën një qeveri autonome me një qeveritar shqiptar.

Aty nga viti 1911, megjithëse qeveria turke vuri re se po e humbiste aftësinë e saj, qoftë për ta kontrolluar, qoftë për ta shtypur farën e nacionalizmit shqiptar, ajo bëri premtime boshe për gjoja reformë arsimore. Në mars të vitit 1911, turqit e ndryshuan pamjen e jashtme të politikës së tyre të shtypjes, dhe urdhëruan të

hapeshin shkolla në Shqipëri duke përfshirë, në programin e tyre, edhe mësimin e gjuhës shqipe me alfabetin latin.

Megjithatë, as patriotët shqiptarë dhe as Ericksoni nuk u gënjyen prej këtyre premtimeve, të cilat dukej qartë se jepeshin për të përfituar kohë për ushtrinë turke. U premtua se do të hapeshin shkolla, por mësimi do të bëhej në turqisht, se do të futeshin shqiptarët në administratë, por vetëm turkofilët, se do të bëheshin hekurudha dhe rrugë, por vetëm për përdorim ushtarak. Si pjesë e një plani për të qetësuar protestat gjithë popullore anembanë Shqipërisë, Sulltani zbarkoi në një tur të ashtuquajtur të dëshirës së mirë ndaj zonave të trazuara në Shqipëri. Ai arriti në Manastir më 20 qershor 1911 pasi kishte vizituar qendra të tilla si Shkupi, Prishtina dhe Kosova në një vizitë katërditore. Turqit organizuan një paradë të madhe në qytet, të cilën Ericksoni e ndoqi nga dritarja e shtëpisë ku rrinte bashkë me disa miq të tij. Sulltani dukej më shumë i vdekur se i gjallë. Prapëseprapë, vizita e Sulltanit iu siguroi turqve një periudhë pak më të qetë përpara stuhisë, pasi rebelimi pësoi një zbutje të përkohshme. Pa dyshim që me shpërthimin e luftës midis Turqisë dhe Italisë në Afrikë, më 29 shtator 1911, regjimi turk vari shumë shpresa për një periudhë paqeje në Shqipëri.

Ngjarjet ndiqnin njëra-tjetrën dhe Ericksoni gjendej përherë në mes të vorbullës së tyre. Miqtë e tij herë burgoseshin, herë internoheshin, pastaj liroheshin, pastaj kapeshin përsëri. Më 8 korrik policia turke hyri në Shkollën e Vajzave në Korçë. Ata thyen derën e dhomës së Kenedit dhe morën çfarë deshën e çfarë gjetën. Aty ishte roja, Pandi Logoreci, i cili nuk mundi të bënte asgjë për t'i ndaluar. Fill pas kësaj u arrestua Grigor Cilka, u mbajt në Manastir në karakoll dhe më pas u dërgua në burgun e Korçës, por një turmë e madhe që protestonte në mbrojtje të tij i bëri turqit ta lironin. Kur mendon sot se çfarë sakrificash kanë bërë njerëzit tanë të asaj kohe për gjuhën shqipe, një nderim i madh dhe i pafund vjen nga shpirti për ta. Dhe natyrisht nderim po aq i madh, në mos edhe më i madh, shkon tek Ericksoni dhe Kenedi, këta burra që kishin vënë gjithçka në rrezik për arsimimin e popullit shqiptar[64].

[64] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

KRISTO DAKO, PISHTAR I ARSIMIT[65]

Më 30 maj Kristo Dakoja, bashkë me C.R. Crane, një misionar nga Çikagoja, u nis nga Manastiri për në Shkodër. Në Elbasan ata qëndruan dy ditë dhe panë tokën e Ericksonit ku mendonte të ndërtonte shkollën. Me këtë rast Crane ofroi bursa për katër djem të cilët, do të shkonin në Kolegjin Robert në Stamboll. Ata e vijuan rrugën për në Tiranë, ku u bllokuan prej kajmekamit, i cili nuk donte t'i lejonte të shkonin më tej. Këmbëngulja e Crane-s ishte e tillë sa u tha policëve turq se mund ta ndalnin vetëm nëse do ta vrisnin. Kështu ata vijuan për Krujë. Aty mësuan se malësorët e Mirditës e kishin sulmuar Lezhën. Kështu ata ndërruan drejtim, duke përdorur një varkë nga Durrësi për në Shkodër. Në Shkodër Dakoja u arrestua sapo arriti aty dhe u mbajt nëntë ditë në paraburgim. Ishte Crane që nëpërmjet konsullatës austriake dhe ruse ia doli ta lironte atë nga burgu. Pastaj ata e vijuan udhëtimin për në Mal të Zi, ku u takuan me Edit Durhamin. Simpatia e Crane-s për kryengritjen u rrit pa masë, saqë ai dërgoi këtë telegram nga Vjena:

> *"Situata në Shqipëri është tej masë kritike. Turqia ka mbledhur pesëdhjetëmijë trupa në një ditë marshimi, në kufirin malazez. Kushtet e banorëve janë të padurueshme.*

[65] Kristo Dako (1876–1941), patriot shqiptar i fillimit të shekullit të njëzetë i lindur në Korçë. Ai emigroi në fillim në Bukuresht, Rumani, ku studioi për matematikë. Më pas shkoi në ShBA dhe bëri një master në filozofi. Veprimtaria e tij në dobi të arsimit shqiptar është gjerësisht e njohur. Ai u martua me Sevastinë, një nga motrat e njohura Qiriazi, dhe ishte mik i ngushtë i Ericksonit. (Shënimi im – MB)

Turqit po i shkatërrojnë tëra krahinat, duke vrarë të burgosurit, refugjatët, gratë dhe fëmijët, duke djegur shtëpitë dhe të korrat dhe duke hedhur në erë kishat. Një numër i madh shqiptarësh të gjallë, përfshirë gra dhe fëmijë, janë zënë ngushtë midis dy krahëve të ushtrisë turke dhe shpëtimi i tyre është i pamundur. Njëzet e pesë mijë gra dhe fëmijë janë arratisur për në Mal të Zi dhe atje po vdesin nga uria, pasi i vetmi ushqim për ta është bari i zier dhe rrënjët."[66]

Në anën tjetër, në Manastir plasi kolera. E tëra kjo ndodhi kur një tregtar e korruptoi doktorin që lëshonte raporte për kolerën dhe mori një raport të rremë për një zonjë që vdiq prej epidemisë. Raporti e lejonte tregtarin të vazhdonte punën në dyqanin e tij. Si rrjedhojë, kolera u përhap dhe i ati dhe dy vëllezër vdiqën në pak orë. Nuk vonoi dhe tmerri e vdekja kapluan tërë qytetin. Pesë mijë deri në dhjetë mijë vetë mendohet të kenë vdekur prej asaj epidemie. Mijëra banorë u shpërndanë në drejtime të panjohura pa ndihmë mjekësore, pa kushte higjienike të përshtatshme, pa ndihmë. Manastiri u kthye në një qytet të shkretë. Mënyra e vetme e luftimit të sëmundjes u bë mbyllja e çdo objekti ku mendohej se kishte një të prekur nga sëmundja. Të sëmurët liheshin në mjerimin e tyre, derisa vdisnin. Një tmerr i patreguar pllakosi gjithçka. Të vdekurit, herë-herë me pirgje, dezinfektoheshin me gëlqere dhe dërgoheshin në varre të përbashkëta. Të tjerët liheshin nëpër vendet e tyre për t'i gjetur dikur të vdekur, pluhurosur me gëlqere dhe për të vijuar të njëjtën praktikë. Nuk kishte asnjë masë qeveritare dhe revolta kishte arritur kulmin. Ericksoni mori vesh se gjysma e një ushtrie turke prej një mijë vetash kishte vdekur rrugës nga kolera.

Kishte disa rrethana që e kishin penguar Ericksonin ta dërgonte Loisin në shkollë. Në moshën dhjetëvjeçare asaj i nevojitej të ulej në bankat e shkollës dhe të mësonte. Prandaj, më 11 shtator 1911 ai bashkë me të dhe me zonjën Froelich kaloi nëpër stacionin e karantinës, iu nënshtruan inspektimit dhe dezinfektimit. Lois-i dhe Froelich-i i hipën trenit dhe i dhanë lamtumirën Ericksonit.

[66] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

Në tetor Ericksoni mori një telegram nga Grigor Nosi dhe Kenedi, ku i shpjegohej se qeveria kishte kundërshtuar t'u jepte titullin e pronësisë dhe kishte ngritur një komision për të bërë një vlerësim bashkë me mytesarifin. Situata në Stamboll ndryshonte përditë. Kabineti i Haki Pashës ra, ndërsa njëfarë Said Pashai formoi një kabinet të ri me Qemal Pashain ministër të Jashtëm dhe të Brendshëm. Këta burra ishin më shumë pro-anglezë dhe liberalë dhe të lidhur me xhonturqit. Kështu Ericksoni mori udhëzime të shkonte drejt Elbasanit në rastin më të parë të mundshëm, duke pasur edhe mbështetjen e Ambasadës Amerikane.

Burgosja dhe internimi, në fakt, i kishte bërë mirë familjes. Niveli i jetesës aty ishte shumë i mirë dhe i afrohej gati atij amerikan. Gjatë asaj kohe në internim, ai kishte bërë përmirësim të madh edhe me nervin shiatik. Por ajo që gezoi më shumë ishte ardhja në jetë e një engjëlli tjetër, më 19 gusht 1911. Ajo mori emrin, Grace Elizabeth Erickson[67]. Ajo solli shumë gëzim në familje, me gjithë kushtet e rënda të Carrit. Një mjek grek i qëndroi pranë asajt para dhe gjatë lindjes. Tani familja, edhe pse e zvogëluar nga ikja e Loisit dhe Earlit, u shtua përsëri me Greisin e vogël. Kështu Ericksoni u kthye edhe një herë në Elbasan, për të rifilluar kalvarin e mundimeve midis shqiptarëve, por i lumtur, i përkushtuar dhe i bindur në atë që do të bënte për ta, duke jetuar mes tyre si një njeri i barabartë. Pas një udhëtimi pa probleme, më 12 tetor 1911 ai arriti dhe siguroi një shtëpi të madhe, por të mbajtur keq, e cila u bë vendi i tij i jetesës dhe klasa e përkohshme për nxënësit e shkollës së tij[68].

[67] Në kohën kur po përfundonte ky libër së shkruari, me ndihmën e At Artur Liolin, kreut të Kishës Orthodokse Shqiptare në ShBA, u mësua se Grace Elizabeth Johnson, e bija e C.T.Erickson jetonte ende ne moshën 101 vjeçare në Boston dhe kishte katër fëmijë dhe shumë nipër dhe mbesa. (Shënimi im – MB)

[68] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

...PËRSËRI NË ELBASAN

Nga fundi i vitit 1911 ndjesia e zhgënjimit të Ericksonit ishte kthyer në pasiguri në lidhje me statusin e ardhshëm të përpjekjeve të tij për arsimin. Pas tre vjet përpjekjesh, relativisht të pafrytshme, Ericksoni përsëri mbeti i bindur se të paktën një zgjidhje e pjesshme, me marrjen e një cope tokë, do t'i hapte rrugën ndërtimit të një shkolle.

Më 31 tetor 1911 Ericksoni u vendos në një shtëpi tjetër në Elbasan. Shtëpia ishte e madhe, me shumë dhoma, por asnjë nuk ishte në gjendje të mirë përdorimi. Ai bleu njëqind rrënjë pemësh dhe rrushi. Ai mendonte që me këtë të bënte një pemëtore dhe ta kthente në një model për tërë qytetin. Ai futi gjithçka që kishte sjellë nga Manastiri në atë shtëpi, si dhe mori krejt çfarë kishte mbetur në shtëpinë e mëparshme, përfshirë edhe pianon e Carriet, e cila tashmë nuk ngjante më me një instrument muzikor.

Pastaj shkoi dhe takoi njërin nga bejlerët më të mëdhenj të Elbasanit, i cili zotëronte shumë toka, jo vetëm aty, por deri në Peqin. Me të folën gjatë për mundësinë e blerjes së tokës për shkollën. Më 12 dhjetor ai mori një letër nga Peet-i, i cili e përkrahte që të ecte përpara me projektin, çfarë tregonte se ambasada në Stamboll kishte rënë në një farë ujdie me qeverinë turke, për Ericksonin. Odiseja

e tokës do të vazhdonte edhe për shumë kohë dhe në fakt nuk do të zgjidhej asnjëherë. Biseda pa fund me bejlerët e Elbasanit, korrespondenca me ambasadën në Stamboll, presioni nga autoritetet turke, të gjitha e bënin këtë çështje një nyje gordiane. E megjithatë, Ericksoni vendosi që një pjesë të shtëpisë së tij ta përdorte për shkollën e djemve. Ai mori një mësues që jepte gjuhë dhe histori nga shkolla ortodokse greke.

Sërish, edhe janari dhe shkurti i vitit 1912, kaluan pa ndonjë përparim të bërë në këtë drejtim. Më në fund, më datë 4 mars 1912, Ericksoni u njoftua se qeveria turke synonte ta përdorte tokën për të cilën interesohej Ericksoni për fermë. Ericksoni u xhindos prej kundërshtimit të vazhdueshëm turk për marrjen e tokës në pronësi. Gjatë tre muajve të tjerë në vijim, ai vijoi të simpatizonte rritjen e veprimtarive të patriotëve shqiptarë kundër autoriteteve turke. Disa oficerë turq iu bashkuan kryengritjes së shqiptarëve, për të hedhur poshtë qeverinë e turqve të rinj. Ericksoni e shihte se ushtria turke ishte në prag të humbjes së kontrollit, gjithandej. Në tërë vendin, në prag të revolucionit, Elbasani dukej si qendra e këtij cikloni.

Më 3 prill 1912 Ericksoni u thirr për një takim në Sofje në kuadrin e hapjes së një misioni atje. Pastaj bëri një ndalesë në Stamboll dhe u kthye në shtëpi. Por situata shëndetësore me Carrien sa vinte e përkeqësohej. Kjo ishte një tjetër brengë e këtij njeriu në përpjekjet e tij për të bërë diçka të mirë në këtë botë. Në fakt me tre fëmijë të vegjël, ajo ishte vazhdimisht e mërzitur për dy tjerët që i kishte larg: Earli në Zvicër dhe Loisi në Stamboll.[69]

[69] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

DHE MALET RRETH TIJ

Situata, në dukje e qetë, u përkeqësua menjëherë dhe në qershor të vitit 1912, pas një presioni të ushtrisë turke, e tërë familja u detyrua të arratisej në malet e Elbasanit. Duke pasur parasysh rrethana të tilla dhe i vendosur për të mos e lënë Shqipërinë përsëri, Ericksoni e mori familjen dhe iku nëpër male, ku jetuan për një farë kohe. Miqtë e tyre të mirë i ndihmuan të gjenin një stan për çobanë, pa dritare. E vetmja dritë që hynte aty ishte ajo e diellit ose e ndonjë druri apo pishe. Natyrisht që për orendi në një stan të tillë, në malet e largëta shqiptare të asaj kohe, as që mund të bëhej fjalë. Enët dhe mjetet e tjera të përdorimit ishin aq të vjetra, sa mund të thuhet se ishin njësoj si ato që kishin përdorur pellazgët.

Në atë vend malor, Ericksonët e jetonin jetën secili në mënyrën e vet. Gjithçka të kujtonte kohërat parahistorike, kur njeriu dhe natyra ishin pothuajse një. Natyrisht, asnjeri nuk ishte as i kënaqur, por as i qetë. Carrie përditë e më shumë degradonte edhe fizikisht, edhe mendërisht. Christelin e vogël e kishte zënë lija e dhenve dhe ishte pa asnjë ndihmë mjekësore. Amerikanët, në atë vend të largët ishin kthyer në ditët e hershme të njerëzimit kur me sëmundjen bëhej si bëhej, pa asnjë mjet, ilaç, mjek apo shërbim. Ericksoni tashmë ishte bërë edhe

mësues, edhe predikues, edhe agronom, edhe mjek, edhe kujdestar. Gjithçka. Por vetëm për familjen e vet dhe fëmijët, që mundohej t'i edukonte në ato kushte veçimi nga bota. Kur kushtet e banimit në të njëjtin vend u bënë të padurueshme, ai bashkë me Carrien ndërtuan një si dhomë në brinjë të një bregu dhe u futën bashkë me Christelin dhe Greisin. Natyra ishte shumë e bukur, pamja fantastike, ditët verore të nxehta, netët shumë të freskëta. Por kur shiu dhe rrebeshi fillonin, atëherë gjithçka ndryshonte dhe natyra shfaqte anën e saj të egër dhe, pse jo, edhe të frikshme për këta njerëz të mirë.

Edhe aty Ericksoni vazhdonte të merrte raporte dhe fjalë për luftën dhe mësoi se prijësit shqiptarë, në një takim në Fushë-Kosovë, kishin parashtruar trembëdhjetë kërkesa, plotësimi i të cilave i siguronte Shqipërisë autonomi të plotë politike. Ata kërcënonin se nëse nuk iu plotësoheshin kërkesat, do të marshonin drejt Stambollit. Disa oficerë turq iu bashkuan shqiptarëve në një revolucion që rrëzoi qeverinë e xhonturqve. Shqipëria Veriore tanimë ishte në duart e shqiptarëve, ndërsa forcat turke ishin dorëzuar. Diku nga 1 gushti i vitit 1912 pesë qytete shqiptare kishin rënë në duart e kryengritësve. Hasan Prishtina ishte vënë në krye të forcave dhe po marshonte në krye të një ushtrie që mendohej të ishte e përbërë prej pesëdhjetë mijë burrash.

Qeveria turke, e përfshirë në luftë me Italinë, e kërcënuar nga përkeqësimi i pozitës ushtarake në Shqipëri, pranoi shumicën e kërkesave. Megjithatë, një marrëveshje përfundimtare nuk u arrit asnjëherë. Për Serbinë, Malin e Zi dhe Bullgarinë ndryshimi i rrethanave u pa jo vetëm si një mundësi për të shtrirë kontrollin e tyre mbi tërë ato territore, njëherë e një kohë nën sundimin turk, por gjithashtu për të shkatërruar lëvizjen shqiptare për autonomi. Si rezultat i kësaj, gjatë dimrit të vitit 1912, Ballkani papritmas u bë një fushëbetejë sapo Lufta e Parë Ballkanike filloi jo zyrtarisht në një seri sulmesh kufitare. Në këto rrethana, Ericksoni vendosi ta kthente familjen nga mali. Kështu ai u vendos përsëri në Elbasan.[70]

70 My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

AKSIDENTI I EARLIT NË ELBASAN DHE VDEKJA E TIJ NË ZVICËR.

Me t'u kthyer në Elbasan, ata filluan t'i vendosnin gjërat nëpër vendet e duhura. Por papritmas, sikur të mos mjaftonin ato që kishin ndodhur, herë në internim e herë në arrest, herë në mal e herë nën kërcënim, një ngjarje tronditëse e goditi familjen, ngjarje që do të kishte një pasojë të jashtëzakonshme në jetën e secilit prej tyre, dhe pikësëpari në jetën e Earlit.

Earli po luante me Paulin në bodrumin e shtëpisë kur u rrëzua një shkallë dhe e goditi atë pak mbi veshka. Atë e morën menjëherë, e shtrinë në krevat dhe i vunë kompresa të nxehta. Një doktor i atyshëm shkoi dhe e vizitoi, i dha ca ilaçe dhe e leu me një farë vaji. Në fillim u duk sikur u përmirësua, por pastaj situata u keqësua me të vjella, temperaturë dhe ethe të pandërprera. Ai u zverdh i tëri dhe dukej se puna do të shkonte keq. Gjendja po ndërlikohej dhe po precipitonte në kushte tejet të rënda.

Në mbrëmjen që pasoi, ai vazhdoi të villte dhe të kishte komplikacione, të cilat në dukje kishin shenjat e një apendiciti. Nuk kishte asnjë mundësi mjekësore dhe situata po përkeqësohej drejt së pashpresës. Në fillim u fol për një doktor që mund të vinte nga Manastiri, por dukej se koha nuk premtonte. Pastaj u fol për një tjetër në Durrës. Përsëri pa shpresë. Ericksoni përdori disa ilaçe, që mezi i

gjeti dhe mendoi se situata do të përmirësohej. Por jo! Pas dhjetë ditësh përpjekje për rikthim në gjendje normale, dukej se e vetmja rrugë e shpëtimit të tij ishte udhëtimi jashtë vendit. Por tani, me doktorin më të afërt në Trieste, koha ishte një faktor përcaktues. Plani u bë që vajza e Ericksonit, Lois, të udhëtonte bashkë me të vëllain dhe babain, ndërkohë që zonja Erickson do të qëndronte e do të kujdesej për tre fëmijët tjerë: Christel, Grace dhe Paul.

Më 8 tetor 1912, në mes të përgatitjeve të Ericksonit për nisjen për Durrës, u njoftua lufta midis Malit të Zi dhe Turqisë. Më 17 tetor Bullgaria, Greqia dhe Serbia i shpallën luftë Turqisë. Menjëherë qeveria turke arriti një marrëveshje diplomatike me Italinë, duke i dhënë fund luftës në Afrikë, kështu që ajo mund të konsolidonte fuqinë e saj ushtarake në Europë. Shpallja e luftës pati një efekt të thellë në qytetin e Elbasanit, duke e hedhur atë në një gjendje histerie të papritur. Si rezultat i kësaj, disa ditë përpara se Ericksoni dhe dy fëmijët e tij të fillonin rrugën drejt Durrësit, ku mund të hipnin në një avullore për Trieste, gjendja u bë edhe më e vështirë. Ata e vunë Earlin në një vig për ta transportuar. Vigu ishte bërë me dy direkë të gjatë druri, që mbaheshin me një cohë që krijonte një lloj barele të shtruar me rroba sa më të buta, për të shmangur tronditjet e mëdha që do t'i shkaktonin vuajtje të padurueshme. Me ta u nis Cilka, si përherë i gjendur pranë Ericksonëve, në të mira dhe në të këqia. E tërë kjo ngjante më shumë sikur po transportonin një të vdekur. Thuajse i tërë qyteti doli dhe krijoi një kordon në të dyja anët e rrugës ku po kalonin ata. Carrie me fëmijët e vegjël, Paulin, Christelin dhe Greisin në gji, i përcollën deri në një farë vendi. Ishte një ditë e zymtë, e rëndë, fatale për tërë qytetin. Ajo tragjedi që po ndodhte kishte lënë pa frymë tërë qytetin. Ata ishin mësuar me tragjedi pas tragjedie. Por tragjedinë e këtij miku nuk e mbante dot as durimi shqiptar i mësuar në shekuj të gjatë robërie. Ditën e parë nuk përparuan dot më shumë se deri në Peqin. Të lodhur, të rraskapitur ata kaluan një natë në hanin më të parë për të rifilluar udhëtimin, por me pak shpresa për të zënë avulloren e radhës në Durrës. Natën tjetër arritën deri në Kavajë. Si përherë, dera e Koliakavë ishte e hapur. Ai vajti bashkë me Loisin dhe me Earlin e bërë petë

nga sëmundja e lodhja dhe kaluan një natë të mirë, të paktën në kuptim të vendit ku bujtën.

Në mëngjes, ata u nisën për Durrës, por ishin edhe 27 kilometra për t'u përshkuar. Në orën 4 të pasdites ata iu qasën anijes. Deri aty gjërat nuk kishin shkuar aq keq. Ata po u afroheshin brigjeve të detit dhe kishin arritur deri në një pikë sa ta shihnin anijen me të cilën do të udhëtonin. A do ta arrinin atë apo jo, kjo ishte një pyetje torturuese. Më në fund arritën. Morën një varkë dhe e lanë Cilkën që të kujdesej për gjërat për të cilat kishin nevojë në Shqipëri dhe iu afruan avullores. Arritën mirë dhe hipën në anije, duke u ndier se do të rehatoheshin sado pak. Por jo, nuk kishte qetësi as aty. Pas pak minutash, kapiteni i anijes doli nga kabina dhe, pasi e përshëndeti Ericksonin, i kërkoi një raport mjekësor për djalin e shtrirë e të molisur. Ai kishte frikë se mos ai mbarte ndonjë sëmundje ngjitëse dhe infektonte pasagjerët, ose vdiste në anije dhe shkaktonte probleme të tjera. Kështu që duhej garanci, ose duhej të zbrisnin nga anija. Doktor Simoni në Elbasan nuk kishte dhënë ndonjë raport të tillë. Ku ta gjenin? Anija duhej të nisej për 20 minuta. Për çudi një konsull austriak as që e prishi terezinë për këtë punë. Ericksoni me një shpejtësi që mund të ketë vetëm një prind që e sheh fëmijën e vet në atë gjendje, shkoi dhe e gjeti doktor Hobdarin në shtëpinë e tij dhe e solli atë më shpejtësi në anije. Earlin e sëmurë ai e la aty, si peng që anija të mos nisej. Doktor Hobdari e vizitoi djalin, e lëshoi raportin dhe u kthye mbrapsht. Ericksoni donte ta paguante, por të tëra paratë ia kishte lënë Cilkës. Kështu që doktori jo vetëm që nuk mori para, por pagoi edhe për varkën, edhe për hamallin që e gjeti në shtëpi, pa u mërzitur aspak.

Ç'virtyte të larta mbartnin shqiptarët! Çfarë njerëzie me vlera të rralla, mendonte Ericksoni tek anija po nisej. Njerëz që ia transportuan djalin, qyteti që e përcolli, strehimi gjatë udhëtimit tek miq si Koliakët, vizita pa para nga doktor Hobdari... Çfarë tjetër mund të kërkojë njeriu nga njerëz të tillë me kaq vlera e virtyte njerëzore!?

Anija u nis me një orë vonesë. Por të paktën u nis me Earlin, Ericksonin e Loisin në kuvertë. Ata do të arrinin në Trieste më 20 tetor 1912. Ericksoni vrapoi për në spitalin më të parë. Doktori i parë që takoi e mori Earlin në pavijon. Ai e vizitoi djalin e shkretë dhe e përjashtoi mundësinë e ndonjë apendiciti. Por infeksioni kishte bërë punën e vet dhe kishte mbledhur sasi të mëdha qelbi nën vete. Ata u munduan t'ia reduktonin abscesin dhe ta qetësonin. Pas një jave Earli ndihej pak më qetë dhe me më pak dhimbje. Megjithatë ai nuk ngrihej dot.[71]

…DHE…

Ndërkohë që Earli e kishte marrë pak veten, Ericksoni dhe Loisi vajtën në kishën amerikane të qytetit të Triestes, shëtitën pak dhe mediuan për kontrastin e madh që ekzistonte midis këtij qyteti dhe atij të Elbasanit. Pastaj takuan konsullin amerikan Ralf Totten, i cili u soll shumë mirë me ta. Tri javë më vonë, ata shkuan në Zvicër me një letër rekomandimi nga një mjek i quajtur Esher, për profesor Ruks në Lozanë. Earli nuk kishte shumë dhimbje, kishte filluar të fliste dhe të hante më mirë.

Gjatë rrugës me tren, Earli u ndje më i qetë deri tri orë para arritjes, kur Ericksonit iu desh ta mbante me kompresa të ngrohta. Sapo zbritën, atij iu kthye po ajo situatë që kishte në Shqipëri dhe u detyruan që menjëherë të shkonin në spital. Po atë natë ai u operua dhe iu nxor një sasi e madhe abscesi nga nga trupi. Nga mëngjesi Ericksoni u largua për pak kohë duke menduar se Earli do të përmirësohej. Por i çuan fjalë që të shkonte urgjent tek djali, pasi ishte përkeqësuar shumë. Ai po kalon vërtet një situatë të vështirë, i tha infermierja, e cila bashkë me doktorin ishin munduar t'ia largonin dhimbjet të cilat i kishin kapluar tërë trupin. Dalëngadalë po i zvogëlohej pulsi, aq sa nuk i kapej më tek kyçi. Ndihej vetëm një rrahje e lehtë e dobët e zemrës në tëmth. Këmbët iu ftohën dhe mezi i kërkoi të atit t'ia ngrohte duke ia fërkuar. Gjaku në thonj i ngriu dhe filluan të nxihen.

[71] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

Ericksoni e fërkonte atë butë-butë. Ndërsa po e fërkonte, ai e pyeti të birin:

– A ndien gjë Earli im i dashur?

– Po ndiej nxehtësi, babë. M'i mbaj duart.

Ai, pasi i kapsalliti sytë tre-katër herë, i mbylli përgjithmonë në duart e të atit.

Ishte një moment shkatërrimtar, dëshpërues, tmerrues, i pabesueshëm, i dhimbshëm, për Ericksonin. Ai nuk ishte përgatitur t'i bënte ballë tërë kësaj. Por ai ishte aty, në krahët e babait të vet, që e kishte marrë të tërin në vete dhe e kishte larë në lot. Ai e dinte se Earli nuk do t'i përgjigjej më kurrë, por prapë e thërriste, "Earl, Earli im". Menjëherë mendja i shkoi tek diçka po aq e keqe sa vdekja e djalit: Si do t'ia jepte lajmin nënës së tij? Çfarë do t'i thoshte? Çfarë do të ndodhte kur t'ia kumtonte lajmin e kobshëm? Asaj që e donte aq shumë. Tani ai frikësohej më shumë se asnjëherë kobit: A do të ndalonte e tëra kjo, këtu? Po kur ta marrë vesh ajo, si do ta durojë këtë tmerr! Kjo do të ishte shumë më shumë sesa mendonte ai se mund të mbante. Por çfarë i ra njeriut e nuk e duroi!?

Pastaj shkoi në hotel dhe i tregoi Loisit. Ajo që ishte aq e lidhur me të, shpërtheu në një të qarë të papërmbajtshme, që ia këputi zemrën të atit. Tani ai vetë duhej të mblidhte veten, në mos do të humbiste edhe vajzën. Loisi mendonte se Earli do të shërohej dhe ata të dy do të vijonin mësimet së bashku në Zvicër. Por jo. Tani ajo do t'i dilte jetës e vetme për zot.

Ericksoni thirri z. Aleks Southrland, një pastor i kishës protestante angleze, tek i cili Loisi dhe ai ishin lutur një javë më parë, i tregoi çfarë kishte ngjarë dhe e lanë që të takoheshin. Ata shkuan tek Konsulli Britanik, u morën me përgatitjen e qefinit dhe arkivolit, pastaj dërgoi një telegram në shtëpi nëpërmjet konsullit austriak në Durrës. Të dielën u bë një funeral. Ishte data 16 nëntor 1912. Përpara shërbesës fetare Ericksoni e hapi arkivolin dhe vendosi një tufë me lule në duart e bardha të ftohta të kufomës, nga një për çdo anëtar të familjes një më të madhe për

të ëmën dhe me këtë akt të fundit dashurie njerëzore ai e la atë të prehej i qetë.

Pastori Southerland e drejtoi shërbesën. Kisha e vogël ishte e mbushur plot e përplot, përfshirë edhe infermieren, Fraulinën Marie, e cila tregoi për Earlin një përkujdesje të rrallë, dashuri të pashoqe dhe mjeshtëri profesionale. Ai i kishte besuar asaj.

Varri i Earlit kishte numrin 336 në një varrezë rrëzë kodrës, pikërisht sipër spitalit. Ericksoni u kujdes edhe për mbjelljen dhe prerjen më vonë të barit që do të mbinte mbi atë filiz që e humbi jetën në Shqipërinë e dashur të Ericksonit. Përpara se të nisej për në Gjenevë, Ericksoni e vendosi Loisin në konviktin e Madam Pache Lu Paisible në Lozanë. Ajo ishte shkollë për mësimin e gjuhës frënge, e frekuentuar më së shumti prej vajzave nga mosha pesëmbëdhjetë deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeçe. Shërbesat fetare bëheshin në kishën anglo-amerikane dhe zonja Southerland do ta takonte Loisin shpesh, kështu që ajo nuk do të ndihej aq e vetmuar. Një të premte mbrëma, ai i la lamtumirën Loisit të vogël dhe iku ngadalë, duke u zvogëluar në çdo hap që hidhte në shikimin e lotëve që rridhnin çurkë nga sytë e pafajshëm të vajzës. Të nesërmen ai udhëtoi nëpërmjet Alpeve me trenin që kaloi pranë Liqenit të Gjenevës.[72]

[72] Bazuar në tregimin e Phyllis Cole Braunlich në librin "Stone Pillow" dhe në My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

MEDITIME NË UDHËTIMIN E KTHIMIT NË SHQIPËRI

Pasi kaloi një natë në Milano, një ditë në Venecia dhe dy ditë në Trieste me miqtë e tij, Ericksoni mori një anije për në Durrës. Avullorja nga Triestja në Durrës ishte e vjetër, por e rehatshme me pak pasagjerë. Kjo ia shtoi vetminë pasi nuk njohu njeri aty, por i dha edhe mundësinë që të jetonte me dhimbjen e madhe që i kishte shkaktuar Earli. Në parmakët e anijes tek vështronte valët, apo në dhomën e gjumit ku përpiqej të prehej sado pak, ai ndiente se thellë brenda tij ishte thyer diçka e madhe, ishte shkaktuar një krater vullkanik dhimbjeje, i cili nuk do të mbyllej kurrë. Dhimbja i shtohej edhe më shumë kur mendonte se ai kërthi prehej atje pikërisht se ai, kundër dëshirës së të shoqes dhe këshillave të tërë njerëzve që e donin, ishte kthyer përsëri në Elbasan. Por tani ai ishte thjesht një numër, 336, dhe një kujtim i hidhur, që do të ecte me të gjatë tërë jetës së tij, i varur në qafë si një medaljon i fshehur, i kujtimit të një dashurie të përjetshme. Ai iu kthye besimit të tij se një ditë do të takohej me të, në një jetë tjetër, me atë që në këto katër vjet të qëndrimit në Shqipëri e kishte patur edhe djalë, por edhe shok, edhe bashkudhëtar në shëtitje, halle, mjerime dhe gëzime, nëse kishte ndonjë të tillë. Këto po mendonte kur anija iu qas brigjeve të Durrësit.

Lamtumirë, biri im, derisa të takohemi përsëri dhe Zoti të mbajttë afër, duke vështruar midis teje dhe meje sa kohë që jemi larg njëri-tjetrit. Amen![73]

[73] Po aty.

SHQIPËRIA E PAVARUR – ERICKSONI NËN ARREST NGA PUSHTUESIT SERBË, DHJETOR 1912[74]

Gjatë mungesës së Ericksonit në Shqipëri kishte ndodhur diçka shumë e rëndësishme. Shqipëria ishte shpallur e pavarur, por ushtrinë pushtuese turke e kishte zëvendësuar ajo pushtuese serbe. Forcat e ushtrisë serbe jo vetëm kishin marrë kontroll mbi Shqipërinë e Veriut, por serbët ishin, gjithashtu, siç raportohej, në prag të marrjes së portit të Durrësit në bregdetin e Adriatikut. Por Austria dhe Italia e panë me frikë ekspansionin serb në drejtim të bregdetit të Adriatikut, pasi kjo mund të paraqiste një kërcënim ogurzi ndaj interesave të tyre.

Më 25 tetor 1912, Bertoldi, ministri i Jashtëm i Austrisë, gjatë një konference të mbajtur në Ballplatz, e bëri fare të qartë se Serbisë duhej t'i mohohej çfarëdolloj e drejte për aneksim territorial në bregdetin Adriatik, sepse një lëvizje e tillë në drejtim të pushtimit jo vetëm do të shkelte parimet e nacionalitetit, por gjithashtu do të interpretohej nga Austria si një shenjë e marrëdhënieve jomiqësore me Serbinë në të ardhmen.

Më 4 nëntor 1912, Italia vendosi të përkrahte qëndrimin e Austrisë kundër përcaktimit serb ndaj Adriatikut. Tri ditë më vonë, ministri i Jashtëm italian San Xhuliano, e njoftoi ambasadorin francez Jules Cambon se Austria dhe Italia kishin

[74] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

bërë një marrëveshje që të mbështesnin autonominë e Shqipërisë. Xhuliano i shpjegoi Cambonit se ai vetë ndiente se ruajtja e autonomisë së Shqipërisë do të ishte e dobishme për të ardhmen e paqes në Europë. I njëjti mesazh i ishte komunikuar edhe ambasadorit rus. Për disa vëzhgues, këto fuqi të Adriatikut i frikësoheshin mundësisë që Durrësi të bëhej një port rus. Rusia sigurisht që e mbështeti etjen ushtarake të aleatit të saj Serbisë në drejtim të Adriatikut. Ajo e shihte atë si një avanpost në Adrtiatik, si një hap të mundshëm drejt ndikimit rus edhe në Ballkan, edhe në Mesdhe. Për udhëheqësit e lëvizjes kombëtare shqiptare ambiciet serbe kishin implikime të rënda. Patriotët shqiptarë tani ndesheshin jo vetëm me Turqinë në largim e sipër, por edhe me lakmitë e fqinjëve për aneksim territoresh. Megjithëse më 28 nëntor 1912, Ismail Qemali dhe patriotët shqiptarë shpallën pavarësinë dhe formuan qeverinë e përkohshme, kontrolli i tyre në vend ishte tejet i kufizuar. Ata filluan punën menjëherë për njohjen diplomatike. Megjithatë, fuqitë Europiane, të mësuara me fuqinë që mbarte Ballkani për grindje dhe luftëra, u treguan të matura.

Kjo ishte situata kur Ericksoni, më 1 dhjetor 1912, zbriti në portin e Durrësit për ta gjetur atë port të pushtuar nga serbët. Edhe pse i dërrmuar nga tragjedia që i kishte ndodhur dhe familja tashmë e copëtuar sa nga ndarja, sa nga dhimbja, ai gjatë rrugës nuk harroi të mendonte edhe për atë që e priste në Shqipëri. Pasiguria e tij rreth trajtimit që mund të pësonte kur të arrinte në portin e Durrësit u "zgjidh" me të mbërritur aty, sepse ai u arrestua menjëherë dhe përfundoi në burg, pa iu dhënë asnjë shpjegim. Serbët, të cilët kishin pushtuar portin, pasi i lanë pasagjerët të zbarkonin, e ndanë atë prej të tjerëve pa asnjë shpjegim, pa e marrë në pyetje, por thjesht e "përplasën" në burgun e doganës. Pas një ore apo më shumë, aty erdhi një oficer dhe i tha se ai ishte i dyshuar dhe do të mbahej ca ditë nën arrest. Ai e gjeti veten në burg me shpresën se serbët do të silleshin më njerëzisht se otomanët, mësuesit e tyre, por kjo nuk i rezultoi të ishte kështu.

Qelia ku e futën nuk kishte as krevat, as rroba fjetjeje, as ushqime, asgjë prej gjëje. Asgjë nga ato që kishte me vete nuk iu lejua t'i merrte me vete. E vetmja gjë

që e lejuan të bënte ishte një telegram që ia dërgoi Carriet me tekstin:

> *"Kam arritur këtu shëndoshë e mirë, por më duhet të rri ca ditë më urdhër të komandantit."*[75]

Telegrami jo vetëm që u pre në pjesën e fundit, por nuk u transmetua kurrë, me pretekstin se Lufta Ballkanike i kishte prerë të tëra linjat e komunikimit. Madje, oficeri i tregoi se Shqipëria e Mesme tani kishte rënë në duart e serbëve, që nga Durrësi deri në Elbasan.

Në qelinë e burgut, Ericksoni mendohej për tërë atë kalvar vuajtjesh që ai dhe familja e tij kishin përjetuar gjatë këtyre katër vjetëve të jetës në Shqipëri. Udhëtime të vështira, kushte jetese më poshtë sesa minimale, malarie, nervi shiatik, sëmundja nervore e Carriet, internimi e më pas burgosja nga turqit në Manastir, jeta në male dhe, së fundmi, vdekja e Earlit. Të tëra këto mendime u ndërprenë kur nga hekurat e trasha të dritares së qelisë në bodrum, e cila ishte thuajse paralel me tokën, pa këmbët e një djali që lozte aty pari. Atij menjëherë i vajti në mendje t'i dërgonte një letër mikut të tij austriak, konsull në Durrës. Ai e shkroi atë menjëherë në gjuhën shqipe dhe bashkë me një monedhe të mbështjellë në të ia hodhi nga dritarja djalit. Çdokush në këtë botë do të mendonte se ai djalë do të merrte monedhën dhe do të hidhte letrën. Por jo Ericksoni. Ai i njihte mirë shqiptarët tashmë. E prapëseprapë, edhe nëse ajo ndodhte, Ericksoni kurrë nuk do ta merrte vesh se kush ishte ai fëmijë. Por për Ericksonin ai ishte shqiptar. Shqiptari që për Ericksonin kishte një cilësi të rrallë, besën dhe fjalën.

Ajo letër ia vlejti. Konsulli austriak, pasi mori letrën, vajti dhe e takoi atë në burg. Ai e ndihmoi me ushqime, madje edhe me korrespondencë me konsullatën e tij në Trieste. Ericksoni mundi që me ushqimet që i sillte austriaku të tërhiqte edhe gardianët në anën e vet, duke iu dhënë herë njërit e herë tjetrit diçka nga gjërat e veta. Pas afro një jave ai u nxor nga izolimi ku mbahej dhe u çua para një gjyqi ushtarak, i përbërë prej një anëtari të vetëm të trupit gjykues, që ishte një major

[75] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

serb. Aty ai pa se kjo nuk kishte aspak të bënte me çështje juridike. Majori serb e akuzoi atë se ishte një veprimtar i çështjes shqiptare, një armik i betuar i shtetit serb dhe për këtë dënimi më i lehtë që mund t'i jepej ishte dëbimi i menjëhershëm nga Shqipëria. Kështu, vendimi mori formën e prerë dhe ai duhej të merrte anijen e parë që nisej për në Itali.

Por Ericksoni nuk mund të ikte dhe të linte familjen e tij në mëshirën e fatit dhe të serbëve në Elbasan. Prandaj i tha majorit se ai duhej të shkonte pranë familjes, ku kishte gruan dhe tre fëmijë në Elbasan. Ata e prisnin atë që të kthehej. Pas një debati të gjatë për këtë, më në fund majori i dha leje që të shkonte në Elbasan, të paraqitej në policinë serbe atje dhe brenda njëzet e katër orëve të merrte familjen dhe të largohej menjëherë. Kështu u bë, por jo aq lehtë sa ç'e bënte serbi atë punë![76]

[76] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

KTHIM NË MORT NË ELBASAN - DËBIMI NGA SERBËT PUSHTUES[77]

Ai u nis për në Elbasan, në atë rrugë të tmerrshme me moçale, në kohë shirash e vërshimesh të atij dhjetori të vitit 1912. Hyri në Elbasan përmes pazarit. Dyqanxhinjtë dhe njerëzit që u gjetën aty e rrethuan Ericksonin menjëherë dhe iu drejtuan me pyetje thuajse njëherësh.

"– Ku është çuni, ku e ke çunin?"

Ericksoni iu foli atyre me shqipen e tij me theks amerikan:

– "Kuni vdik. Vdik."

Në mesin e shqiptarëve pllakosi një heshtje mortore. Pastaj njëri prej tyre iu drejtua:

"Erik, pash atë Zot na thuaj se kjo nuk është e vërtetë. Na thuaj se nuk është e vërtetë. Të lutem, na thuaj!"

Por Ericksoni, stoik siç ishte, bëri shenjë me gishtin e madh të dorës, poshtë, që ai kishte mbaruar. Në sytë e tyre ai pa aq shumë dhimbje dhe mëshirë. Në fakt ai i njihte shqiptarët për burra aq të fortë, për njerëz që kishin kaluar aq shumë peripeci në jetë, që e duronin dhimbjen, edhe kur ajo u prekte palcën. Por ja tani ata ishin ligështuar për djalin e tij. Ericksoni e ndjeu se ky ishte ligështim për

[77] "Stone Pillow", written by Phyllis Cole Braunlich.

mikun e tyre jeta e të cilit kishte marrë një kuptim të ri midis shqiptarëve. Humbja e djalit ishte njëra anë e dhimbjes, por dhimbja tjetër ishte si do t'i jepej ky lajm Carriet, nënës së djalit dhe gruas së tij të dashur. Ai arriti në shtëpi. Hapi derën e oborrit dhe pa të shoqen. Ajo iu drejtua menjëherë:

"- Erik, ku është Earli?"

Ericksoni me një ndjenjë faji dhe dhimbje të thellë i tregoi asaj çfarë kishte ngjarë. Carrie, tërësisht e papërgatitur për këtë lajm, ra shakull përtokë në një vaj dhe kujë që të këpuste shpirtin. Ajo disa ditë më parë kishte marrë një kartolinë nga Earli, i cili e siguronte nënë e vet se ishte bërë mirë dhe se do të kthehej shpejt. Dhe ja tani. Ai ishte i vdekur dhe e ëma nuk ia kishte parë fytyrën e zbetë dhe as gurin e varrit. Tronditja, vaji, mjerimi që pllakosi shtëpinë ishin të kuptueshme. Por edhe më keq se kaq shihte se ata nuk kishin kohë tashmë të merreshin me këtë tragjedi. Urdhri ishte i prerë. Ata duhej të largoheshin menjëherë. Kështu Ericksoni i vetëm, në mes të një nëne që vetëm vajtonte dhe të tre fëmijëve aq të vegjël, sa nuk e ndihmonin dot me asgjë, filloi të paketonte gjithçka që mundi për t'i bërë gati për udhëtimin e largët. Ndërkohë, turma - turma elbasanasit vinin e shkonin, duke e ngushëlluar për djalin. Kur e përshkruan këtë ngjarje, Ericksoni thotë:

"Shpesh një fjalë për tragjedinë, një pyetje, një vështrim, një shtrëngim dore, përbëjnë gjuhën universale të zemrave të tyre dhe janë më të ëmbla se çdo gjë tjetër njerëzore".[78]

Pasi kishte paketuar gjithçka ai vendosi të udhëtonte. Tek dera qëndronte një rojë serbe në gatishmëri. Po më çfarë do ta bënte këtë? Qyteti ishte vënë në darën e pashpirt të ushtrisë serbe. Jo vetëm qytetarët, por edhe kafshët e qytetit. Ushtria serbe kishte konfiskuar çdo kalë që kishte gjetur aty. Për t'i shpëtuar kësaj ose mobilizimit për interesat e ushtrisë serbe, tërë kuajt ishin dërguar nëpër male, në stane apo tek njerëzit e njohur të tyre. Kjo situatë e bënte të pamundur transportimin e familjes drejt Durrësit. E vetmja zgjidhje ishte të merreshin disa kuaj të romëve, që nuk iu ishin dashur serbëve për shkak se ata ishin aq të lodhur

[78] Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

e aq gërdalla, sa nuk i hynin në punë askujt. Dhe kështu bënë. Por që në nisje, sa po bëheshin gati të ngarkonin, një skuadër serbe arriti dhe iu kërkoi që çdo gjë të kalonte nën një kontroll të rreptë. Ata hapën gjithçka edhe një herë nga e para, zbrazën arkat e librave, shkapërderdhën çdo gjë që kishin nëpër thasët dhe kutitë dhe i lanë të shpërndara në dysheme. Midis tyre kishte shumë shënime të Ericksonit dhe shumë libra shqip. Natyrisht, ashtu si për turqit vetëm pak kohë më parë, edhe për serbët këto ishin më shumë se armë, më shumë se mjete lufte. Prandaj edhe i morën, ua konfiskuan dhe i zhdukën përgjithmonë.

Në atë situatë, me fëmijët që qanin, me Carrien e lemerisur nga humbja e djalit dhe tërë këtë batërdi, Ericksonit nuk i mbetej gjë tjetër veçse t'i lutej Zotit dhe ndoshta të ngushëllonte veten me parimet e tij misionare të sakrificave më të mëdha në emër të një qëllimi të lartë njerëzor. Kafazi i tij besnik, Aliu, më në fund kishte gjetur ca kuaj të romëve, tek të cilët shpresonte se mund ta bënin rrugën deri në Durrës. Kështu ata u nisën nën kërcënimin e bajonetave serbe, ashtu siç ishin, në një udhëtim aq të mundimshëm, sa nuk ka pendë ta përshkruajë. Kaluan përmes qytetit të Elbasanit. I tërë qyteti kishte dalë t'i përcillte. Ata ndien mëshirën, dhimbjen e atyre njerëzve, pështpërimat, valëvitjen e duarve të lamtumirës, bekimin që po merrnin prej tyre. Kaluan Zaranikën, ecën nëpër baltovinat drejt Peqinit dhe u ulën të bënin një pushim. Ericksoni kishte bërë ca ushqime gati për drekën e fëmijëve dhe pranë një burimi ai filloi t'i ushqente ata. Papritmas, pa një djalë të ri, hipur në një kalë, tek tërhiqte nga pas edhe një kalë tjetër. Të dy kuajt ishin të shëndetshëm e të fortë. Djali erdhi drejt Ericksonëve dhe zbriti nga kali. E lidhi atë në një pemë dhe iu drejtua atij:

> *"Babai im e pa që ju u nisët me kuajt gërdalla të romëve dhe natyrisht e kuptoi se ju nuk mund të arrinit kurrë në Durrës me të tillë kuaj. Më dërgoi turr e vrap në mal ku i kishim fshehur kuajt tanë që mos të na i rrëmbejnë serbët dhe më tha të shkoja t'i merrja e t'i sillja ty për të bërë udhëtimin. Ja ku i keni. Hipuni këtyre dy kuajve dhe udha e mbarë!"*[79]

[79] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

Natyrisht, në një ditë si kjo, në mendjen e Ericksonit nuk mund të shkonte ndonjë fjalë tjetër më e bukur se ajo që "*miku njihet që është mik, në të ngushtë e në rrezik*". Kjo ishte një vepër samatariane e kryer nga një njeri të cilin as e kishte njohur, as nuk do ta takonte më kurrë. Këtë virtyt shqiptar ai jo vetëm e kishte provuar deri tani shumë herë, por edhe do ta himnizonte tërë jetën e vet në veprat e tij të bukura për Shqipërinë, por edhe në librat që shkroi më pas.

Kështu udhëtimi i Ericksonit vijoi me orë e ditë. Por edhe kësaj radhe, ai nuk do ta harronte mikun e tij Gjon Koliakën. Kaluan një natë aty dhe të nesërmen, që me natë, morën rrugën me kalldrëm dhe arritën në Durrës. Kur arritën, fëmijët ishin të dërrmuar, të lodhur dhe të molisur. Ata u vendosën në një han. Pushuan ca dhe hëngrën bashkë me Aliun, kujdestarin e tyre besnik, dhe Mihalin, që i kishte përcjellë që nga Elbasani. Aliu shpërtheu në vaj, iu lëshua Ericksonit në gjoks dhe qau me ngashërim. Ishte data 14 dhjetor 1912, datëlindja e trembëdhjetë e Earlit. Ericksoni nuk ia përmendi këtë Carriet, për të mos i kujtuar asaj brengën e brengave. Duke parë diellin që po venitej në perëndim, Ericksoni u përpoq të lexonte në të një mesazh për zemrën e tij të vrarë dhe të vetmuar. Por ja tek erdhi edhe çasti kur do të largoheshin, por jo pa vështirësi. Forcat serbe që kontrollonin portin e morën Ericksonin tek një zyrë përpara një oficeri serb. Ai i përsëriti të njëjtat akuza, duke shtuar se kishte mbajtur mbledhje dhe fjalime me shqiptarët kundër serbëve. Ericksoni iu drejtua atyre:

> *"Po si është e mundur, kur unë kam qenë tërë kohën nën vëzhgimin e forcave serbe, një herë si i burgosur në Durrës dhe më pas në Elbasan!?"*

Komandanti vijoi duke e akuzuar sikur ai ishte në fakt shkaktari i Luftës Ballkanike! Por më në fund e lëshuan dhe të gjithë së bashku i hipën avullores austriake "Lloyd" dhe u larguan edhe një herë nga Shqipëria nëpër Brindisi dhe më pas në Lozanë, Zvicër. Atje menjëherë Ericksoni, bashkë me Carrien, Paulin, Christelin dhe Graisin shkuan të shohin Loisin. Që aty, të tërë së bashku, shkuan tek numri 336, ku prehej njeriu më i dashur i tyre, tashmë i ndarë nga kjo jetë. Por Ericksoni, i rryer me jetën e pa gjithçka në atë formë që ishte edukuar.

Me katër fëmijë të bukur që ia kishte dhënë Zoti, ai e pa përsëri jetën me optimizëm dhe me dritë në fund të saj. Këtu morën fund ironikisht edhe përpjekjet e tij misionare, për t'u hapur udhën veprave të tjera të tij të bukura në të mirë të popullit dhe kombit shqiptar. Edhe pse kishte përjetuar vërtet më të keqen në Shqipëri: presionet e turqve, internimin, burgosjen, keqtrajtim, pengesat në punën e tij misionare dhe edukative, humbjen e djalit, burgosjen nga serbët, përzënien me dhunë, sëmundjen e rëndë nervore të Carriet, malarien, shiatikun, shpërndarjen e fëmijëve nëpër vende të ndryshme, jetën në male për t'u mbrojtur, prapëseprapë, asnjë nga këto nuk e detyruan dot ta braktiste Shqipërinë. Përkundrazi, ai iu qas edhe më tepër vendit tonë në forma të tjera të ndryshme, të cilat lexuesi do të ketë rastin t'i mësojë në kapitujt që vijojnë.[80]

[80] My retreat from civilization: Memories of Alice Welsh – Erickson. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 3.

ECEJAKET E ERICKSON-IT NË SHQIPËRINË E PAVARUR[81]

Ndërkohë që Ericksoni po largohej, çështja e Shqipërisë po bëhej shqetësimi serioz i fuqive të kohës. Statusi i ardhshëm i vendit tonë ishte vënë në dyshim të plotë, për shkak se vetë paqja në Europë ishte seriozisht e kërcënuar. Ambasadorët e gjashtë vendeve më të mëdha Europiane u takuan në Londër, për të diskutuar situatën në Ballkan, me shpresë se do të gjenin një zgjidhje të mundshme në atë që u quajt Konferenca e Ambasadorëve në Londër. Që prej fillimit të konferencës, përfaqësuesi austriak e bëri të qartë se ekspansioni serb drejt brigjeve të Adriatikut ishte diçka që kundërshtohej prej vendit të tij, plotësisht. Por që nga nisja, këto gjashtë Fuqi të Mëdha kishin rënë në një mendje që ta njihnin një Shqipëri autonome, e cila, në të njëjtën kohë, i jepte Serbisë dalje në një port të lirë ose neutral shqiptar, nëpërmjet një hekurudhe ndërkombëtare nën kontrollin Europian.

Brenda gjashtë muajve në vazhdim, fuqitë duhej të zgjidhnin një princ për të udhëhequr Shqipërinë. Ndërkohë që një komision ndërkombëtar duhej të formohej për ta drejtuar vendin. Ndonëse kjo marrëveshje i dha fund rrezikut të menjëhershëm për luftë, nuk i shoi dot forcat shpërthyese që ende vërtiteshin nëpër Ballkan.

[81] "Stone Pillow", written by Phyllis Cole Braunlich.

Në dukje diplomatët e Shteteve të Bashkuara, duke mos e ditur se Ericksonët ishin larguar nga Shqipëria, dhe se po banonin në Lozanë të Zvicrës, menduan se ishin ende diku brenda vendit. Më 21 dhjetor 1912, Uilliam Rockhill, ambasadori amerikan në Stamboll, i bëri të njohur ambasadës austro-hungareze, e cila ende kishte konsullin e vet në Durrës, se ishin të shqetësuar rreth sigurisë së familjes Erickson, për të cilën nuk kishin asnjë raport që kur ata ishin në Elbasan. Që atëherë kishin kaluar dy muaj dhe asgjë nuk ishte dëgjuar për fatin e tyre. Nuk ka dyshim se ndërprerja e komunikimit në Ballkan, si rezultat i luftës, shpjegon humbjen e kontaktit. Gjatë tërë kësaj kohe asgjë nuk dihej për Ericksonët dhe vendndodhjen e tyre.

Përderisa luftimet vazhduan në shumë pjesë të Shqipërisë, Ericksoni nuk bëri plane për kthim të shpejtë. Megjithatë ai përsëri vazhdoi të ndiqte zhvillimet ndërkombëtare në lidhje me të ardhmen e statusit të Shqipërisë. Në dritën e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të mbajtur në Londër, Ericksoni vendosi të bënte një tur informues në Angli, me shpresë që të ngrinte interesin publik për të ardhmen e shtetit të ri shqiptar. Kështu ai shkoi në Angli dhe që andej u mundua të shfrytëzonte çdo lloj njohjeje personale për të bërë të njohur çështjen shqiptare.

Prej andej ai i shkroi mikut të tij Bell Barton, ku me zemër të thyer i fliste për humbjen e djalit të madh dhe përpjekjet për ta rimarrë veten pas asaj humbjeje. Por, edhe pse tashmë larg Shqipërisë, atij përsëri nuk i ndahej shpirti që andej. Në vijim të letrës ai shkruante:

> *"Në lidhje më planin tonë, do të desha lejen tuaj që të punoj këtu në Angli për të mbledhur fonde për refugjatët shqiptarë, të cilët janë me mijëra. Unë shpresoj të krijoj edhe një grup miqsh të cilët kanë shumë simpati për atë vend dhe të na japin mbështetje të rëndësishme. Anglia është shumë e interesuar për Shqipërinë dhe në fakt ajo ka miq të fortë në atë vend të cilët kanë dhënë ndihma në mënyrë të pavarur. Mendoj se do të ishte gjë shumë e madhe nëse do të tërhiqnim bashkëpunimin e tyre me ne. Sa i takon vajtjes në Amerikë, preferoj ta lë çështjen të hapur tani për tani. Ne*

do ta lëmë Paulin, djalin tonë, këtu, bashkë me motrën e tij, Lois. E ndiejmë se nuk mund ta marrim atë me vete në Shqipëri përsëri, sa për punë të shëndetit, aq edhe të shkollës. Për habinë time zonja ime, Carrie gëzon shëndet të mirë dhe gjendet në një gjendje të mirë mendore dhe të qetë.

Me urimet më të mira dhe bekimet e rastit për Vitin e Ri për ju dhe zonjën Barton

Charles Telford Erickson[82]

Kjo letër tregon se Ericksoni ende mendonte të kthehej në Shqipëri, madje me gjithë familje. Gjatë qëndrimit në Angli ai dha intervista nëpër gazeta fetare, si p.sh. tek "*The Christian*" në Londër, më 13 mars 1913, intervista me titull "*Albania and its people*"[83]. "*The Salvation of Albania*:[84] "*Përse duhet të ndihmojmë*?" në British Congregationalist, 20 mars 1913, dhe "*Agonizing Albania*". Në "*The Record*", 11 prill 1913, ai i përshkroi shqiptarët si një popull superior, të cilët ishin paraqitur mbrapsht në mënyrën më të qëllimshme dhe të padrejtë në pjesën tjetër të Europës. Ericksoni në mënyrën më zemërhapur i tha intervistuesit se ai donte të shfrytëzonte çdo rast, për t'i treguar popullit anglez rreth shqiptarëve. Njëri nga gazetarët që e intervistoi, i impresionuar prej Ericksonit, e quajti atë në shkrimin e vet: "Një njeri me vizion."

Ericksoni përmendi planet e tij për ndërtimin e një spitali në Shqipëri si dhe përpjekjet për të nxitur interesat financiare britanike dhe investime të tjera të mundshme. Ai nuk harroi të përmendte edhe shumë nevoja bazë të shtetit të ri, si hekurudhat, fabrikat, elektricitetin, vajgurin, shkollat, metodat moderne të bujqësisë etj.

Në vijim të përpjekjeve diplomatike të bëra prej Fuqive të Mëdha për të arritur njëfarë paqeje në Ballkan, më në fund ato arritën një sukses të përkohshëm

[82] Letter from C. T. Erickson to Barton American Board of Commissioners of Foreign Missions – European Turkey Missions 1900-1909 Vol IV.

[83] Erickson i referohet librit "Albania and its people" shkruar nga William Henry Green - The Princeton Review (Oct 1857). (Shënimi im – MB)

[84] Shpëtimi i Shqipërisë.

me nënshkrimin e Traktatit të Londrës më 30 maj 1913, rezultat i Konferencës së Ambasadorëve, gjë që bëri të ndalte Lufta e Parë Ballkanike. Në dritën e këtyre zhvillimeve të favorshme, Ericksoni la Londrën më 4 qershor 1913.

Është për t'u vënë re pikërisht ky çast historik për Shqipërinë, pra Konferenca e Ambasadorëve në Londër, kohë kur, jo rastësisht, Ericksoni gjendej aty, pikërisht në atë vend dhe në atë qytet. Këtu nuk ka vend për të diskutuar nëse ai vetëm mori pjesë apo luajti ndonjë rol të caktuar në tërë atë ngjarje historike për Shqipërinë, por, nga ana tjetër, nuk mund të neglizhohet fakti që ai, në momentet e rëndësishme të historisë së Shqipërisë, që kur shkeli në tokën shqiptare, u gjend, në një mënyrë apo në një tjetër, i pranishëm. Këtë do ta shohim në rrjedhë të këtij libri, por në këtë rast nuk duhet të harrohet edhe fakti tjetër se ai u bë një mik i ngushtë e Aubrey Herbert-it[85], i cili ishte aq aktiv në politikën angleze për çështjen shqiptare, personazh që do ta shohim më vonë së bashku me Ericksonin në një ngjarje gati surreale.

Ai u nis nga Stacioni Viktoria i Londrës për në Paris, Lozanë dhe më pas në Shqipëri. Në udhëtim e sipër ai ndaloi për të parë varrin e të birit në Lozanë, por e gjeti jo të mirëmbajtur, megjithëse, sipas rregullit, komuna duhej të kujdesej për të për njëzet vjet. Pagoi ca para për këtë dhe u nis të takonte dy fëmijët e tjerë, Loisin dhe Paulin, të cilët ishin në shkollën La Chataignerie. Fëmijët të gëzuar u lëshuan në krahët e tij. Ata ishin përmalluar për babain e tyre, por edhe të lumtur nga kujdesi që tregonte çifti Shvarc për ta.

Pastaj udhëtoi drejt Triestes ku do të takohej me z. Henry W. Nevinson dhe zonjën Edith Durham, që të dy miq të mëdhenj dhe njerëz që ishin të interesuar për fatin e Shqipërisë. Me ta udhëtoi drejt Shqipërisë zonja Durham, mikja e madhe e shqiptarëve. Autorja e librit "Brenga e Ballkanit" i kishte bërë një shërbim të jashtëzakonshëm çështjes shqiptare. Ata po shkonin që të bënin vlerësime rreth dëmeve të luftës. Ericksoni ishte i pasigurt në lidhje me udhëtimin e tij të pafinancuar, sepse, megjithëse lufta kishte përfunduar zyrtarisht, ai përsëri merrte

[85] Aubrey Herbert.

raporte të pafavorshme mbi situatën në Ballkan, që tregonin dështimin e hapur të Konferencës së Londrës për të zgjidhur çështjet kritike të dëmeve të luftës.

Më 11 qershor 1913, grupi i vogël i vëzhguesve arriti në Çetinjë, kryeqyteti i Malit të Zi. Ericksoni e gjeti qytetin të molepsur nga ndjenjat e tepruara nacionaliste malazeze. Në fakt nacionalizmi malazez ishte tërësisht i mbështetur dhe i varur nga përkrahja që i jepte Rusia. Me të arritur në qytetin e Shkodrës, ata panë me sytë e tyre pasojat shkatërrimtare të luftës. Mbi qytet ishin zbrazur 17 000 deri në 25 000 predha topash. Katedralja e madhe ishte kthyer në qendër strehimi për 20 000 refugjatët shqiptarë, shtëpitë e të cilëve ishin rrënuar. Kjo ishte diçka dëshpëruese për ta. Aty kishte mungesa ushqimesh. Çmimet në treg ishin tej mase të larta. Si rezultat, shumë njerëz vuanin nga uria për vdekje. Dilte qartë se banorët e Shkodrës nuk kishin dalë paq prej duarve të malazezëve. Gjërat ishin po aq keq edhe në qytetin e Krujës, kryeqyteti i Skënderbeut. Aty plaçkitja ishte puna e përditshme e ushtrisë serbe. Gjatë bisedave me disa njerëz në Krujë, Ericksoni mësoi se shumë prej shqiptarëve aty, viktima të luftës, fatkeqësisht e mbivlerësonin ndikimin që grupet vëzhguese dhe raportuese kishin mbi Fuqitë e Mëdha.

Aty nga 18 qershori 1913, ky grupi i vogël udhëtoi për Tiranë. Ericksoni vajti tek shtëpia ku kishte qëndruar katër vjet më parë dhe pa me mall vendin ku familja e tij jetoi, u shtua, gëzoi, por më shumë vuajti. Pastaj i çoi fjalë Fuat bej Toptanit, një ndër miqtë e tij tiranas, i cili u afroi mysafirëve të largët strehë dhe mikpritje shqiptare. Situata ishte aq e trazuar, sa në çdo rast aty i huaji mund të shihte diçka të re që ndodhte. Ndërkohë që ishin tek shtëpia e Fuat Beut, një grup dibranësh kishin ardhur dhe raportonin për barbarizmat që ishin ndërmarrë ndaj tyre nga fqinji i tyre sllav. Më e keqja po ndodhte edhe atje, si në çdo cep të Shqipërisë, e cila tashmë ishte jo vetëm e cunguar nga fqinjët, por edhe pre e grabitjeve, plaçkitjeve, vrasjeve, terrorit dhe shfarosjes. Tëra të pabërat dhe të pathënat po ndodhnin kundër një kombi që sapo kishte dalë nga një mynxyrë e vjetër, për të filluar jetën me një mynxyrë të re, edhe më të keqe.

Prej aty, ata vijuan drejt perëndimit për në Durrës. Atyre iu mjaftuan dy ditë për të parë, dëgjuar dhe dëshmuar krejt çfarë po ndodhte edhe aty. Pastaj vijuan drejt Elbasanit, nëpërmjet Kavajës. Ajo që Ericksoni dhe Nevinsoni panë dhe dëgjuan në Peqin ishte e patregueshme. Demir Pashai i Peqinit iu tregoi atyre se si pas një qëndrese të fshatarëve ndaj serbëve pushtues, ata ua kishin bombarduar shtëpitë, vrarë anëtarët e familjeve dhe më pas, ata që ishin kapur, ishin shkuar në bajoneta, copëtuar trupat dhe disa qenë varur në degët e pemëve, për t'u dhënë mësim të tjerëve. Gjatë qëndrimit të tij në Elbasan, Ericksoni pa me sytë e vet ndikimin e humbjes ushtarake të Perandorisë Osmane. Dyzet e dy ushtarë turq të veshur keqas, mbetje e ushtrisë së Xhavit Pashës, kaluan mes për mes qytetit në udhëtimin e tyre në kthim për në Stamboll.

Pasi Ericksoni me shokë përfundoi udhëtimin e vet në Shqipëri, që nga Shkodra deri në Vlorë, vuri re se rifillimi i luftës në Ballkan ishte shumë i afërt. Serbia ishte e pakënaqur me vendimet që ishin marrë për të mos e lejuar të dilte në Adriatik. Në të vërtetë çfarëdo zgjidhjeje tjetër do të haste në kundërshtimin e Austrisë, e cila nuk e lejonte zgjerimin e fqinjëve të vet sllavë në jug të perandorisë. E gjetur nën ethet e zgjerimit, Serbia iu turr Bullgarisë dhe kërkoi një pjesë të Maqedonisë. Kur zyrtarët bullgarë iu përgjigjën me një kërkesë të tyre për të marrë kontrollin e plotë mbi Maqedoninë, grekët, të cilët po ashtu kishin pretendime territoriale në rajon, iu bashkuan Serbisë kundër Bullgarisë. Antagonizmi në rritje midis dy vendeve papritmas shpërtheu më 28 qershor 1913 kur Mbreti Ferdinand i Bullgarisë e urdhëroi ushtrinë e tij të stacionohej në Maqedoni, për të sulmuar forcat greke dhe serbe. Edhe Mali i Zi, i zhgënjyer me atë çfarë solli Lufta e Parë Ballkanike, iu bashkua Serbisë në shpalljen e luftës. Që prej 12 korrikut 1913, edhe Rumania, edhe Turqia i ishin futur luftës.

VUAJTJET DHE NEVOJAT E SHQIPËRISË, SHKRIME NË "THE ECONOMIST" LONDËR [86]

E tërë ajo atmosferë, e përshkruar më sipër, e vëzhguar dhe studiuar me kujdes nga Ericksoni, pasqyrohet në njërën prej revistave më prestigjioze të botës "The Economist", në pranverën dhe verën e vitit 1913. Kontributi i Ericksonit për ta sjellë tragjedinë shqiptare në faqet e kësaj reviste është një ndër gjërat e shumta që ai bëri. Për të patur tërësisht të qartë këtë, po sjellim serinë e artikujve të botuar nga "The Economist" me emrin e Ericksonit, madje edhe reagime të serbëve ndaj tyre.

The Economist

17 maj 1913

Botuesit të "Ekonomistit"

Zotëri,

Duke ditur interesin tuaj të madh për kushtet ekonomike në territoret e prekura nga Lufta Ballkanike, a mund t'ju paraqes kushtet që ekzistojnë tani për tani në Shqipëri? Unë jam drejtor i Bordit Amerikan të Misionarëve të Huaj në Shqipërinë

[86] Arkivi i revistës "The Economist", Londër, 17 maj 1913, faqe 1150-1151.

Qendrore me qendër në Elbasan. Ndonëse me pushtimin e qytetit prej serbëve ne (gruaja ime, fëmijët dhe unë) u përzumë me urdhër të tyre, kemi mundur të vijojmë të jemi në kontakte të vazhdueshme me situatën.

Përpara se të iknim prej aty, unë arrita të mbledh informacione që kishin të bënin me pushtimin serb prej liderëve shqiptarë në Elbasan, Peqin, Kavajë dhe Durrës.

Ata më thanë se ushtria turke, në udhëtimin e tyre në largim për të shpëtuar, drejt Manastirit, kaloi nëpër Elbasan, rreth dy javë para se forcat serbe të vinin aty. Gjatë qëndrimit të tyre disaditor në qytet ata lypën derë më derë dhe dyqan më dyqan për një copë bukë, pa patur një kacidhe në xhep. Shumë prej tyre ishin të veshur keq dhe pa armë. Në asnjë rast ata nuk përdorën dhunë dhe as nuk plaçkitën. Kur erdhën trupat serbe, komandantët e tyre dhanë fjalën se, nëse qyteti nuk bënte qëndresë, do të garantonin jetën dhe pasurinë e të gjithëve. Këto kushte u respektuan nga pala vendase dhe këtë e di fare mirë. Komandanti i serbëve u prit nga përfaqësuesit e qytetit si aleat dhe mik.

Pastaj erdhi ushtria. Veprimi i parë që bënë ishte marrja me forcë e tërë bukës që gjendej nëpër furra publike, duke i lënë fëmijët dhe gratë e qytetit pa të. Madje edhe brumi nuk u la të piqej. Pastaj iu turrën vendeve ku kishte drithë, të cilat u zbrazën menjëherë, bashkë me ushqimet për kafshët. Në shumë raste u thyen kasat e parave dhe u mor çfarë kishte brenda. Shumë karvanë kuajsh, që ishin marrë për shërbimin e transportit për ushtrinë, u mbajtën peng. Një numër i madh fshatrash në rrethinat e Elbasanit, të krishterë dhe muhamedanë, iu plaçkitën dhe iu vodhën jo vetëm ushqimet dhe drithi, por edhe mëndafshi e qëndisjet e grave.

Edhe vetë prifti ortodoks u ndalua prej ushtarëve. Atij iu grabitën paratë, ora, thika dhe çizmet. Më pas e rrahën dhe e lanë të shkonte në shtëpi. Në raste të tjera unë mora vesh për burra të cilët u morën nga shtëpia me duar të lidhura mbrapa dhe pastaj u qëlluan, sepse nuk iu kishin dhanë ushqime ushtarëve. Natyrisht neve na shkoi mendja se urdhri që na u dha për të ikur nga Shqipëria brenda njëzet e katër orëve nën vëzhgimin e bajonetave të ushtarëve serb ishte një prej metodave që ata po përdornin për të nënshtruar vendin.

Kam biseduar kohët e fundit me një drejtues shqiptar të afërt me Esat Pashën për faktin se vendi ishte shtrënguar të ballafaqohej me urinë. Ushqimet janë mbaruar. Vendit thuajse i janë mbaruar kafshët, delet, dhitë, lopët, qetë, kuajt, të rrëmbyer ose të lënë pa ushqim dhe të ngordhur. Nga ana tjetër janë djegur ullinjtë. Në vend ekziston frika e shpërthimit të ndonjë kolere apo sëmundje shfarosëse. Unë kam marrë raporte se në Dibër janë djegur qindra fshatra, ndërsa në Kolonjë janë djegur dyzet dhe njëqind e pesëdhjetë në Janinë. Raporte të tjera flasin se këto metoda ushtrohen gjithandej ku shkelin serbët.

Në tërësi kjo është një pamje tmerrësisht e errët, që e gjejmë në çdo anë të Shqipërisë. Po shqiptarët nuk kanë dëshirë ta përdorin çështjen e luftës kundër turqve në dëm të aleatëve. Çfarë lufte që bënë ata në dy anët e largëta të vendit të tyre, në Shkodër dhe Janinë! Edhe ata mund t'u bashkoheshin një mijë herë aleatëve kundër turqve. Por ata nuk e bënë këtë, sepse panë se çfarë lakmish kishin aleatët ndaj tyre. Turqia, nga ana tjetër, e braktisi Shqipërinë, tërhoqi trupat dhe municionet nga i tërë vendi, përveç Shkodrës dhe Janinës. Kështu që shqiptarët, të lënë pa armë, as sa për të mbrojtur shtëpitë dhe vatrat e tyre, u bënë pre e lehtë për armiqtë e tyre. Ndërkohë ata, në pjesën më të madhe, reaguan paqësisht, pasi shpresonin se Europa do të ishte e drejtë me ta.

Nevojat e shqiptarëve janë aq të mëdha dhe të panumërta, sa është vështirë t'i renditësh. Por nevoja e parë sigurisht është për pesë mijë sterlina për t'i përdorur për farëra, për mbjellje toke dhe ushqime, sa mos të vdesin nga uria. Më vonë me asistencë sistematike duhet t'u sigurohen kafshët bujqësore, të rindërtojnë shtëpitë e djegura dhe të furnizohen me ndihma mjekësore.

Unë planifikoj të shkoj atje më 1 qershor dhe çfarëdo fondi që të më besohet për këtë qëllim do të administrohet me kujdesin më të madh. Gjithashtu, në qoftë se pas një turi nëpër Shqipëri vë re se kushtet janë më pak se kaq të tmerrshme sesa i përshkrova më lart, unë do ta quaja detyrën time të korrigjoj çfarëdo gjëje të thënë këtu dhe që nuk përkon me realitetin. Por, tani për tani, unë jam i sigurt se asnjë popull në Ballkan nuk ka kaq nevojë për ndihmë dhe që e meriton më shumë atë dhe simpatinë e Anglisë sesa shqiptarët. Tek e fundit, ata janë viktimat dhe jo fitimtarët – janë preja

dhe jo plaçkitësit.

I juaji, C.T.Erickson

21 Platts Lane, Hampstead, Londër

Letra e Erickson-it "*Vuajtjet dhe nevojat e Shqipërisë*" si duket i kanë mërzitur shumë armiqtë e Shqipërisë dhe të vetë Erickson-it, serbët. Kështu më 3 qershor 1912, serbia Elizabeth Kristiç i dërgon revistës 'The Economist" letrën e mëposhtme, e cila u botua më 13 qershor 1913. Kjo letër dëshmon vërtet se sa shumë Erickson-i kishte hyrë në jetën e shqiptarëve dhe sa shumë ishte bërë halë në sy për armiqtë tanë. Ai tani njihej edhe si një njeri me dije të mëdha për Ballkanin, prandaj edhe artikujt e tij mund të botoheshin në një organ kaq të njohur si "The Economist". Argumentet që jep serbja Kristiç janë qesharake në krahasim me ato që jep Erickson-i. Për të patur më të qartë këtë le të ndjekim më poshtë polemikën:

"VUAJTJET E SHQIPTARËVE"[87]

Letër botuesit

Zotëri,

Zoti Erickson ju ka dhënë përshtypjet e tij në lidhje me pushtimin serb në rrethinat e Elbasanit. Më lejoni, ju lutem, t'ju jap disa hollësi rreth ushtrisë në rrethinat e Shkodrës. Unë mund të bëhem dorëzane për atë që qeveria serbe dërgoi një shumë bujare tek Shefi i Shtabit, me qëllim që të jepnin shpërblimin e duhur për çdo gjë të konfiskuar në rrethin e Shkodrës. Unë e di shumë mirë që udhëzimet janë zbatuar dhe peshkopët e Nansitit, Sepias dhe Lezhës do të dëshmojnë të njëjtën gjë. Priftërinjtë ishin si bankierë dhe, siç e pranuan përpara oficerëve serbë, çmimet ishin të ulëta dhe të pranueshme. Siç e gjejmë në fjalët e peshkopit Kolleti (Colleti) kurrë nuk ka mbretëruar një mirëqenie dhe qetësi publike e tillë në këto anë sa ç'ekziston

[87] British National Archive, London: "The Economist", Londër, 7 qershor 1913, faqe 1406-1407.

tani. Vështirësitë në transaksionet monetare janë shtuar, fillimisht kur u provua se shqiptarët e krishterë përpiqeshin të shisnin lopët e fqinjëve të tyre myslimanë trupave serbe me çmime tmerrësisht të larta; dhe, së dyti, kur fjala ishte për të kthyer kuajt e regjistruar tek pronarët e tyre ndërkohë që kishte dhjetë kërkues për të njëjtën kafshë. Në një rast të tillë peshkopi i dëshpëruar u dorëzua dhe iu kërkoi oficerëve serbë që të zgjidhnin midis rivalëve, cilin të preferonin. Ushtarë të paaftë serbë, me të cilët unë vetë kam biseduar hapur mbi këto çështje, kur askush nuk mund ta parashikonte këtë fushatë shpifjesh, u ankuan për privacionet dhe vështirësitë, ndërkohë që çantat e vogla të floririt po iu shpërndaheshin shqiptarëve nëpër kamp. Fiset asnjëherë nuk u gjetën në ndonjë luftim, por qëndruan pas ushtrisë serbe në pritje për të plaçkitur dhe vjedhur sapo lufta të fitohej. Një komandant serb më tregoi se pas betejës, diku jashtë Lezhës, në të cilën shqiptarët miqësorë e mbajnë asnjanësinë si zakonisht, ai marshoi drejt fshatit Kosmaç dhe e gjeti atë në flakë, sepse të krishterët shqiptarë kishin vajtur aty përpara tij dhe kishin shkatërruar çdo gjë, madje edhe barin e thatë tek i cili kishin shpresë të mbanin bagëtinë. Myslimanët, për të shpëtuar kishin ikur, me përjashtim të një familjeje, pjesëtarët e së cilës ishin shumë të vjetër. Një rojë ishte vendosur për rreth kasolles së tyre për t'i mbrojtur prej vëllezërve të tyre shqiptarë të krishterë, prej të cilëve ata frikësoheshin. Burrat e Ashtës, një fshat tradicionalisht në gjak me Kosmaçin, jetonin në paqe me serbët këtu, në veri të Shqipërisë. Në largim e sipër të trupave serbe, peshkopi i Lezhës kërkoi të paktën një skuadër të vogël që të qëndronte për të shmangur kthimin e anarkisë së mëparshme. Është pa dyshim e sigurt se ushtarët që po ngrinin nga të ftohtit dogjën çdo copë druri që gjetën për të shpëtuar jetën ndërkohë që po e rrethonin Shkodrën. Siç është cituar, një i afërt i Esat Pashës, që unë mund të them se ishte një vëlla i Esat Pashës në Tiranë, e pranoi qëndrimin e butë dhe bujarinë e trupave serbe.

Unë mund të flas më pak rreth asaj çfarë ndodhi në Elbasan, por njeriu mund t'i kuptojë me lehtësi batalionet e uritura pas kapërcimit të tmerrshëm që bënë nëpër Alpet Shqiptare, duke kërkuar për çdo kothere buke që gjendej aty, edhe pse i lanë, disa orë pa bukë, ata qytetarë që ata vetë i kishin çliruar prej zgjedhës turke.

Që shqiptarët nuk kishin dëshirë t'i ndihmonin turqit, kjo është një deklaratë jashtëzakonisht e vështirë për t'u bërë po të shohim atë që ndodhi menjëherë pas deklarimit të armiqësive. Trupat serbe, të cilat në fillim kaluan kufirin, kishin rënë jo në ato turke, por direkt në ato shqiptare, që ata vetë i kishin furnizuar me armë. Nuk mund të mohohet se mijëra syresh i luftuan turqit në Kumanovë, duke mos marrë parasysh marrëveshjen me Isa Boletinin. Një ushtar, miku im, ishte therur me thikë në zemër në Merdra (Mjeda ndoshta, shënimi im, M.B.) në Shqipëri kur po përqafoheshin pas një dorëzimi të trilluar. Thika i ishte ngulur në shpinë dhe nëna e viktimës më tregoi se i gjeti gjashtë plagë të tjera në trup, që ishin shkaktuar pas së parës që shkaktoi vdekjen. Në Ferizaj (autorja e quan Ferizoviç, shënimi im, M.B.) komandanti i kalorësve serbë Amar, një izraelit në besim, ishte djegur dhe qëlluar për vdekje, pasi skuadra e tij ishte mirëpritur prej banorëve në qendrën shqiptare. Shqiptarët muhamedanë, si rregull, janë edhe më të egër se turqit dhe nuk i ndal asgjë kur ngatërrohen me kaurët.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, me aq sa kam pasur unë në dorë, e kam parashtruar çështjen e përndjekjes së të krishterëve shqiptarë katolikë, vuajtjet e të cilëve janë shpërfillur nga Europa dhe nuk mund të ndihem ndryshe veçse mirënjohëse ndaj atyre kombeve, sakrificat e të cilave janë bërë për të mirën e tyre.

Cilatdo të jenë motivet, ato më njerëzoret janë përzier dhe ky është një fakt. Shqipëria është çliruar, jo prej shqiptarëve, por prej ushtrisë serbe.

E juaja,

Elizabeth Kristich[88]

28 Kossoska, Belgrade, Servia

3 qershor 1913

[88] Elizabeth Christitch.

Por, siç do të shohim, Erickson-i vazhdon me artikujt e vet si një gazetar i dërguar në terren. Ai vijon me artikullin:

VUAJTJET E SHQIPTARËVE

Drejtuar botuesit të "The Economist"

Zotëri,

Unë jam në gjysmën e rrugës në turin tim nëpër Shqipëri dhe përsëri kërkoj mirëkuptimin e botuesve tuaj për të më lejuar të them atë që kam parë dhe dëgjuar deri tani.

I kalova tri ditë në Shkodër. Dëmtimet në qytet prej bombardimeve, po të konsiderojmë numrin e predhave të hedhura, të mëdha dhe të vogla, të cilat thuhet se jenë prej 17 000 deri në 25 000, nuk ishin aq të mëdha. Ndoshta 60 shtëpi janë shkatërruar tërësisht prej predhave të mëdha. Prej një numri të madh të tjerash ka vrima të mëdha dhe të vogla nëpër çati dhe mure. Midis tyre është edhe Konsullata Britanike.

Konsulli vetë, z. N.Summa, e pa me sytë e tij rënien e predhës dhe tmerrin që shkaktoi ajo në mes të familjes, të cilët për fat të mirë shpëtuan, përveç konsullit vetë, i cili u plagos në kokë.

Unë besoj se asnjë konsullatë nuk u ka shpëtuar dëmtimeve. Konsullatës italiane i ra një predhë e madhe në dhomën e fjetjes, por, fatbardhësisht, konsulli kishte vendosur një natë më parë të mos flinte në shtëpi. Katedralja, një ndërtesë madhështore, e cila në atë kohë mbante nja 2 000 refugjatë u kthye në një objektiv të veçantë. Tridhjetë e nëntë predha të vogla e të mëdha ranë mbi të dhe përreth saj. Njëra prej kubeve u shkatërrua, murit kryesor iu shkaktuan shumë vrima, ndërsa dhoma ku ruheshin gjërat vetjake të refugjatëve mori flakë dhe u shkatërrua.

Qëkurse filloi rrethimi, shumë njerëz kanë bërë biznes me fitim të madh, duke iu shitur gëzhoja turistëve. Për një gëzhojë tunxhi të madhe turke ata kërkonin 12 franga.

Pa dyshim që në qytet kishte ankth të madh, për shkak të mungesës së ushqimit gjatë ditëve të fundit të rrethimit. Gjellët shiten aq shtrenjtë, sa pak janë ata që i blejnë. Një familjeje të zakonshme i është zvogëluar racioni ditor në 50 dërhem bukë për pesë vetë. Për këtë ata paguajnë 3 franga. Pjesa tjetër gërmon rrënjët e barit dhe i gatuajnë me pak brumë dhe i hanë. Kafshët, të cilat ngordhin prej urisë, përfshirë edhe kuajt, përfundojnë në gojën e banorëve të varfër, për të mos vdekur urie vetë. Sikur të kishte zgjatur rrethimi një javë ose dhjetë ditë më shumë, me siguri do të kishte pasur humbje jetësh njerëzore edhe më të mëdha. Këtu njerëzit ndahen më dysh kur është fjala për rolin e luajtur prej Esat Pashës në vrasjen e Hysen Riza Beut, komandantit turk, ndërkohë që ai po shkonte në shtëpinë e tij, pasi kishte dalë nga ajo e Esatit. Fakti që nuk është ndërmarrë hetim në këtë çështje dhe nuk është bërë asnjë përpjekje për të kapur vrasësin, flet për të keq. Nga ana tjetër, shpjegimi më bindës është si vijon. Garnizoni ishte në shkallën e tij më të lartë të gatishmërisë. Dukej se kishte një mënyrë për të dalë nga situata, por një mënyrë që komandantët nuk pranuan ta merrnin përsipër: Të ngrinin flamurin shqiptar mbi qytet dhe mbi kështjellë. Fiset malësore kishin dërguar një lajmëse grua, e cila solli fjalën se po të bëhej kjo, ata do të vinin për të ndihmuar qytetin. Në këtë takim të oficerëve ishte vendosur të bëhej pikërisht kjo. Në kthim nga mbledhja Hysen Riza Beu u qëllua, siç thuhet, prej oficerëve xhonturq, të cilët kundërshtonin ta ulnin flamurin turk. Pas vrasjes, Esat Pasha ia mbathi i frikësuar për jetën e tij në kështjellë, ku gati sa nuk u kthye në një të vetë-burgosur deri në fund të rrethimit. Në një takim me të para dy ditësh në shtëpinë e tij në Tiranë, ai m'u ankua me zemërim për fiset malësore, të cilat nuk shkuan ta ndihmonin që nga fillimi, pasi, nëse do ta kishin bërë këtë që në fillim, malazezët do të ishin përzënë menjëherë. Kjo pa dyshim që është e vërtetë; por ana tjetër e kësaj historie është se, kur Esat Pasha dhe trupat e tij shkuan në Veri për të mbrojtur Shkodrën, atij iu kërkua të deklaronte pavarësinë e Shqipërisë. Nëse ai do të vendoste flamurin shqiptar në krye të ushtrisë së tij dhe ta çlironte

vendin si nga turqit, ashtu edhe nga malazezët, ata do t'i bashkoheshin atij deri tek më i fundit. Përgjigjja e tij ishte se ai po luftonte për të mbrojtur Turqinë dhe se nuk njihte Shqipëri të ndarë prej saj. Kjo ngjan jashtëzakonisht shumë me lojën e fatit të luftës, në të cilën ai luajti për anën e gabuar me qëllim që të fitonte. Keqardhja më e madhe e tërë kësaj historie është se këta njerëz, duke qenë të vendosur për të luftuar ndaj Turqisë, pa marrë parasysh asnjë rrezik, u mashtruan prej premtimeve mikluese të Malit të Zi. Këta të fundit u dukën sikur thjesht do ta ndihmonin Shqipërinë të bëhej e lirë dhe më pas do të tërhiqeshin. Prandaj kjo barrë bie mbi malazezët. Ata u munduan të parandalonin ushtrinë e Esat Pashës që të mos arrinte në Shkodër. Unë pashë një vend ku nja 38 shqiptarë përpiqeshin t'i zinin pritë një tabori të trupave të rregullta të nizamëve. 33 prej këtyre 38-tëve u vranë në vend.

Pastaj ushtria la prapa pamjen tmerruese të një vendi të djegur, të shkatërruar dhe të plaçkitur. Një familje afër Lezhës, e quajtur Dedë Tosku, humbi një pasuri që mund të llogaritet nga 6 000 deri në 8 000 sterlina, me shtëpi, drithë, ushqime, veshje, gjëra shtëpiake, artikuj të ndryshëm, para, kafshë, e vlera tjera. Thuajse tërë rrugës pashë vetëm tek-tuk ndonjë bimë të mbjellë, pasi që nga shtatori i vitit të kaluar territori bie herë në duart e një ushtrie e herë të një tjetre. Vetëm javën e fundit pat ca përpjekje shumë të kufizuara për të bërë ndonjë punë bujqësie, por ishte e pamundur, pasi kafshët e punës në përgjithësi ishin vjedhur. Më e keqja ndodhi kur 52 vetë, nga të cilët katër gra, u qëlluan, u varën ose u çanë me bajoneta si hakmarrje për vdekjen e një serbi në duart e një kryengritësi, të cilin këta njerëz nuk e njihnin dhe që nuk kishin as lidhjen më të vogël me të. Unë nuk dua ta ngarkoj këtë letër edhe më, që në fakt mund të mbushet pafundësisht me të tilla histori tërësisht të vërteta. Duke parë se çfarë ishte bërë, ne vetëm mund të përsërisim fjalët e gjeneralit amerikan Sherman: "Lufta është një ferr, e egër, e ashpër, mizore, shkatërrimtare e çdo gjëje fisnike dhe të virtytshme. Ajo i vlen vetëm epsheve dhe pasioneve djallëzore dhe lë pas plagë, vragë dhe shkretim, gjëra të cilat shekujt nuk mund t'i shërojnë".

Më lini të sjell në vëmendjen e lexuesve tuaj këtë fakt të mrekullueshëm: Shqiptarët janë akuzuar si gjysmë të egër, njerëz që nuk njohin ligjin, që jetojnë në luftë,

gjakmarrje dhe plaçkitje, që lemerisen njësoj ndaj së mirës edhe ndaj së keqes. Tani, për gati dy muaj, ata janë lënë pa një udhëheqës, pa qeveri, pa polici, pa administratë civile, pa gjykata drejtësie. Prapëseprapë, gjatë tërë udhëtimit tonë nga Shkodra në Durrës, pamë një popull të qetë, paqësor, që punonte fuqishëm për të ribërë edhe një herë bashkërisht fatin e vet të shkatërruar dhe të përthyer. Të krishterë dhe myslimanë, krah përkrah, pa bërë asnjë krim dhe asgjëkund. Ata më thanë: "Ne jemi dele pa çoban, ndërsa kullota jonë është shkatërruar. Europa na ka premtuar mbrojtje dhe qeverisje. Ne po presim prej saj." Gjithandej hasim në të njëjtën përgjigje ndaj pyetjes: "Çfarë kërkoni? "Një princ protestant europian, i cili të jetë asnjanës ndaj çdo fuqie apo pale." Nëse kjo nuk do të arrihet, atëherë lëreni Anglinë të marrë përgjegjësinë dhe të dërgojë një Komisioner të Lartë bashkë me komisionerë të tjerë, që të drejtojnë departamentet e ndryshme dhe të organizojmë shtetin tonë." Idenë e një qeveritari amerikan, si një zgjidhje të mundshme për të dalë nga hullia ngatërrestare europiane ata të gjithë e pranojnë me zjarr.

Shqiptarët janë një popull me histori të lashtë, të pasur në tradita, të fortë në karakter, të aftë për të arritur rezultate të shkëlqyera. Por ata janë mashtruar, shfrytëzuar, shtypur, pushtuar aq shumë herë, sa kësaj radhe ata janë të vendosur të sigurohen në besnikërinë e miqve të vet. Një princ, një qeveritar ose një komisioner që vjen tek ky popull, me sinqeritet dhe përkushtim, jo egoist ndaj interesave të tyre, do t'i gjejë ata lehtësisht të qeverisshëm, besnikë ndaj udhëheqësit dhe të gatshëm për të përmbushur detyrimet e tyre.

Unë shpresoj dhe lutem që turpi, të cilin Fuqitë e Mëdha europiane nuk mund t'ia heqin vetvetes, duke lejuar një racë që jeton mu tek dera e tyre, e lënë në prapambetje nëpër shekuj edhe tani në kohën e qytetërimit tonë modern, do të lahet tanimë në një mënyrë të ndershme dhe bujare. Ai komb që bëhet mik i vërtetë i popullit shqiptar në këtë kohë që ata presin, do të nderohet përjetë dhe do të marrë uratën e pavdekësisë.

Unë shpresoj se në një artikull të mëvonshëm do t'ju tregoj diçka për mundësitë që ka aty për investime të huaja, për burimet e shumta, por të pazhvilluara të këtij vendi.

Unë jam zotëri Charles Telford Erickson

Durrës, Shqipëri, 20 qershor, 1913[89]

Më pas ai vijon me artikullin tjetër :

KUSHTET NË SHQIPËRI[90]

Botuar në gazetën "The Economist" Londër

19 korrik 1913

Drejtuar botuesit të "The Economist"

Zotëri,

Udhëtimi im në Shqipëri përfundoi dhe do të desha të përcjell tek lexuesit e gazetës suaj disa prej përshtypjeve të mia.

Së pari, në lidhje me vetë njerëzit. Që ata kanë vuajtur përtej çdo imagjinate njerëzore, këtë as që mund ta vërë njeri në dyshim, pas këtij udhëtimi që bëra. Por të bie në sy se ata nuk ankohen për atë që ka ndodhur dhe as përpiqen të përftojnë kapital prej fatkeqësisë së vet.

Ata po kthehen në ato vende ku ndihen të lirë të shkojnë dhe po përpiqen të mbjellin drithërat me shpresën se do të arrijnë të korrin ato që mbjellin. Ata janë shumë më shumë të etur për të folur për të ardhmen sesa për të kaluarën dhe gjithandej vihet re një dëshirë, në zemrat e popullit, që Anglia të marrë drejtimin e vendit, për të organizuar një qeverisje me ndonjë princ ose princeshë angleze, që të gjendej për fronin e tyre. Ata do t'i jepnin një njeriu të tillë tërë besimin dhe nderimin që nuk mund

[89] British National Archive, London: "The Economist", Londër, 20 qershor 1913, faqe 1564-1565.

[90] British National Archive, London: The Economist, Londër, 19 korrik 1913, faqe 2011-2012.

t'ia kalojë asnjë popull tjetër për sovranin e tyre. Ata po i japin Europës, sot në këto ditë të vështira, një shembull të shkëlqyer të karakterit të tyre të jashtëzakonshëm. Për muaj të tërë ata u ndanë tërësisht prej botës, ndërkohë që ushtritë e huaja u lëshuan si bisha për ta bërë pre, për ta plaçkitur e dhunuar, duke u shkatërruar fshatra të tëra deri tek banori i fundit – burrë, grua dhe fëmijë. Më pas ata ikën dhe shqiptarët e gjejnë veten pa qeverisje, pa polici, pa një të ardhur, madje as pa një pullë poste për të dërguar një letër. Dhe përsëri që nga Shkodra deri në Vlorë, kudo që toka është e lirë prej malazezëve, serbëve dhe grekëve, vendi është në paqe, i qetë dhe i sigurt. Myslimanë e të krishterë, njësoj, janë të tërë së bashku, duke pritur me durim ditët dhe javët deri kur Europa të vendosë atë që duhet të vendosë për ta. Për mua kjo është një gjë e mrekullueshme dhe meriton mirënjohje nga e tërë bota.

Kjo duket sikur e lë mënjanë qeverinë e përkohshme të Vlorës, por në të vërtetë nuk është kështu. Edhe ata po presin për një fjalë nga Europa, por ndërkohë po bëjnë më të mirën e mundshme për të nxjerrë vendin nga kaosi ku e kanë lënë turqit.

Ata po fillojnë një shërbim postar pa pulla, po marrin drejtimin e shërbimeve doganore dhe raportojnë të ardhura brenda dy muajve më shumë sesa raportonin turqit në një vit. Ata po emërojnë zyrtarët lokalë në tërë territorin, duke bashkuar një forcë policore. Po ashtu ata po bëjnë plane për hapjen e shkollave këtë vjeshtë, të paktën 50 syresh, në qendra të ndryshme. Gjuha shqipe ishte e ndaluar prej qeverisë turke në shkollat shqiptare, prandaj është e pamundur të gjenden mësues për më shumë se 50 shkolla. Për më tepër, shpirti i këtyre njerëzve është i pastër. Ata janë seriozë, të sinqertë, të përkushtuar ndaj përparimit të kombit të vet. Ditë e natë mendja e tyre punon vetëm për vendin e vet. Ata nuk kanë kurrfarë rehatie. Flenë në dysheme, shpesh nuk e kanë vaktin e bukës, udhëtojnë në distanca të largëta për të arritur punën, janë përherë të gatshëm të takojnë dhe të flasin me njerëzit. Çdo bujk i fshatit mund të shihet, të takojë dhe të flasë me presidentin ose anëtarët e kabinetit të tij. Por, nga ana tjetër, nuk ka asnjë gjykatë që të ketë një vend për gjykimet.

Unë qëndrova dy ditë krejtësisht në mes tyre dhe besoj se kapitalet angleze dhe

amerikane do të ishin plotësisht dhe përzemërsisht të mirëseardhura këtu. Ata e dinë se vendi i tyre është i pasur në burime natyrore, por se sa i pasur është, nuk e dinë. Por ata duan investitorë të cilëve do t'u besonin. Atyre investitorëve të cilët nuk plaçkitin, shfrytëzojnë dhe i hedhin tej këto burime.

Këtu ka pyje të pafundme pishash dhe bredha 30 metrash të lartë siç ka masive të tëra me lisa e dushqe të reja. Këtu ka rezerva vajguri, që shfaqen në sipërfaqe. Këtu ka miniera qymyri, bakri dhe floriri. Këtu ka fusha të gjera, të begatshme dhe të kultivueshme. Këtu mund të ngrihet një industri e shkëlqyer e vajit të ullirit, e cila pret të zhvillohet dhe është po aq premtuese sa ato në çdo rajon tjetër prodhues të vajit në vende të tjera të botës. Këtu gjendet baza për një industri të madhe të përpunimit të leshit dhe ka vend për rritjen e miliona deleve. Këtu mund të rritet pambuku dhe orizi në fusha të gjera të ujitura prej lumenjve, të cilat sot për sot derdhen kot në det. Këtu ka vend për mullinj, fabrika, makineri bujqësie, për rrugë, për hekurudha; kjo e fundit, nëse do të planifikohej si duhet, do të ishte ndërmarrja më me interes.

Kryeqytetet e Europës janë vetëm disa orë larg. Ato me popullsinë e tyre të stërmadhe për t'u ushqyer mund të gjejnë këtu një kopsht natyror, të rritur në egërsinë e vet me shqopa, trëndafila të egër, të patëharrur dhe të mbushur me gjembaçë. E vënë në duar të afta mjeshtërish kjo mund të bëhet shumë shpejt një kontribuuese e rehatisë dhe lumturisë së botës dhe mund të kthehet në vetvete në një tokë të paqes dhe pasurisë. Atyre që e vënë në dyshim këtë të vërtetë, do t'u kujtoja përgjigjen që Filipi i pat dhënë pyetjes që i bëri Nathanaeli: "A mund të dalë diçka e mirë nga Nazareti?". Filipi iu përgjigj: "Eja dhe shihe vetë nëse nuk beson!"

Në anën tjetër, aty qëndron edhe problemi njerëzor, që nuk mund të mos merret parasysh. Një vlerësim me rezerva i vdekshmërisë foshnjore këtu kap shifrën pesëdhjetë për qind dhe mund të shkojë edhe deri në 65 për qind. Sëmundjet ngjitëse dhe infektive thjesht shpërthejnë dhe shpërndahen si një zjarr, që askush nuk përpiqet ta shuajë, duke marrë përpara fshatrat dhe qytetet. Ujëra e ndenjura gjenden rreth çdo qendre banimi, e madhe apo e vogël qoftë. Aty shpërndahet malaria dhe mushkonjat

gjenden gjithandej. Malet me plehra e mbeturina, në oborret ose në rrugët ku luajnë fëmijët, ushqejnë milionat e mizave. Ndërkohë, liqene të shkëlqyera malore dhe burime ujore gjenden gjithandej; njerëzit pinë ujë prej përrenjve të turbullt në afërsitë e vendit ku banojnë. Ato vetë mbartin sëmundje të ndryshme. Edhe pse vendi ka lumenj pa fund dhe një rrjedhë të shkëlqyer të ujërave drejt detit, pasi është një vend malor, përsëri asnjë rrëke nuk është përdorur për nevoja shëndetësore, qoftë edhe në një qytet. Kështu që zhvillimi i burimeve të tokës do të ketë një ndikim shumë të madh mbi shëndetin dhe mbarëvajtjen e kombit.

Pastaj vjen problemi i arsimimit. Si kudo tjetër, ku ka pasur dorë Turqia, edhe me arsimin në Shqipëri ka krijuar një rrëmujë të paimagjinueshme. Njerëzit janë lënë në padijen më të thellë. Shkollat nuk janë lejuar për shumicën e popullsisë. Në disa qytete dhe qendra banimi janë lejuar disa shkolla turke, por në përgjithësi hoxhallarët kanë mbledhur ca djem nëpër mejtepe, të cilëve iu kanë mësuar Kuranin. Përveç kësaj, nëpër shkolla është bërë një propagandë, ca italiane dhe ca më pak austriake në bregdet, në mes të fiseve katolike të veriut. E njëjta gjë ka ndodhur me ato ortodokse në jug. Këto të fundit kanë qenë tërësisht të përkushtuara ndaj shndërrimit të popullit shqiptar në atë grek. Gjuha amtare e këtij kombi nuk është lejuar asnjëherë të mësohej në shkollë. Historia e tyre e shkëlqyer, si ajo moderne, si ajo e lashtë, letërsia, shkenca, industria, gjeografia, tregtia, këto janë mbyllur dhe vulosur për njerëzit me shtatë vula.

Këto probleme të ndryshme të këtij kombi, ekonomike qofshin ato, apo shoqërore, industriale apo edukative, janë një kompleks që është jashtë vëmendjes së atyre njerëzve që kanë të bëjnë me ta. Këtu vjen natyrshëm thirrja që i drejtohet karakterit tonë njerëzor. Të ndreqim këtë padrejtësi të bërë ndaj këtij kombi, që gjendet tek dyert tona dhe na takon neve që t'ia hapim portën e jetës këtij kombi – kjo është arsyeja përse ata bëjnë thirrje tek ne sot.

Sir Eduard Grey, në darkën e fundit të pelegrinëve tek ambasadori amerikan ka thënë:

"Ne i shohim çështjet me interes të tërë botëror me të njëjtën ndjesi dhe afërsi".

Sigurisht, këtu është një çështje në të cilën popujt britanikë dhe amerikanë mund t'i bashkojnë forcat për t'iu përgjigjur thirrjes së këtij kombi.

"Ejani dhe na ndihmoni"!

Dhe unë do të shtoj: "Drejtojini ata nga drita"!

Unë mbetem, zotëri,

I Juaji me nderime

Charles Telford Erickson

Vlorë, Shqipëri, 2 korrik 1913[91]

Pas këtij turi në Shqipëri, në shtator Erickson-i u kthye në Amerikë bashkë me dy vajzat e vogla, Christel dhe Grace, duke lënë Paulin dhe Loisin në Zvicër. Gradualisht Bordi Amerikan caktoi një program për një mbledhje fondesh si mirënjohje për punën që kishte bërë Erickson-i në Shqipëri, që arriti në rreth njëzet e pesë mijë dollarë.

Takimi vjetor i Bordit në lidhje me Këshillin Kombëtar të Kishës Kongregacionale u hap në Kansas City, në Misuri. Komiteti vuri në program një fjalim të Erickson-it, ku ai do të tregonte historinë e tij në Shqipëri. Bordi vendosi që të mos kishte mbledhje fondesh në atë takim, pasi ishte kundër rregullave të tij. Erickson-i e tregoi historinë e tij në një mënyrë tepër prekëse. Pastaj u ul. Moderatori ia kaloi fjalën folësit të radhës, por aty ndodhi diçka e papritur. Një pjesëmarrës nga lozha u ngrit dhe bërtiti me të madhe:

"Z. President, u ngrita që të protestoj. Ju e keni sjellë këtë njeri këtu, që të na prekë kaq shumë me tregimin e tij, por na keni ndaluar të drejtën të shprehim

[91] British National Archive, London: The Economist, London, 19 korrik 1913, faqe 2011-2012.

simpatinë tonë për popullin shqiptar dhe dëshirën për të ndihmuar punën e Erickson-it. Unë do të jap një mijë dollarë për të hapur një fond për një spital dhe kërkoi që të bëhet një mbledhje fondesh prej dhjetë minutash, që të plotësojmë fondin e duhur."

Edhe presidenti, edhe punonjësit e tij u ngritën në këmbë dhe kundërshtuan sjelljen e këtij pjesëmarrësi, por nuk mundën të ndalonin njerëzit, të cilët për dhjetë minuta mblodhën dhjetë mijë dollarë. Brenda pesë gjashtë muajsh u mblodh një fond prej njëqind mijë dollarësh për shkollë dhe spital në Shqipëri. Kjo ndodhi në Kishën e Shën Paulit në Minosota. Po ashtu ata menduan për ngritjen e një kishe me të njëjtin emër në Shqipëri.

Më vonë Erickson-i do të shkruante:

> *"Nuk ishte e lehtë që me një histori të tillë, për një vend si Shqipëria, të cilën ata as që e dinin se në çfarë kontinenti gjëndej, të mblidhje aq para".*[92]

Duke ditur se ai nuk do ta bindte tërë botën me historinë e Shqipërisë, Erickson-i i tha Bordit se ai kishte vendosur të shkruante historinë e atij vendi sipas përvojës së tij, duke përfshirë atë që ai mësoi nga historia e popullit shqiptar në mbrojtje të identitetit të vet kombëtar. Dhe e bëri atë në një seri librash tashmë të përmbledhur në gjuhën shqipe.[93]

[92] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 6.

[93] Siç është thënë, edhe në raste të tjera në këtë libër, Erickson-i shkroi pesë libra, ashtu siç kishte premtuar, por nuk i botoi kurrë përveç asaj "Little Man and the Cosmos". Ato janë pjesë e kësaj serie për jetën dhe veprën e tij në vijim.

FLAKA E LUFTËS BALLKANIKE

Më 31 korrik 1913, Lufta e Dytë Ballkanike pati një ndalesë pas një marrëveshjeje armëpushimi, e cila u shoqërua më pas prej traktateve shtesë të paqes. Por shtetet ballkanike mbetën një fuqi baruti potenciale, sepse Serbia këmbëngulte që të mbante territoret në veri të Shqipërisë. Më 18 tetor 1913, zëdhënësi i Austrisë, Bertchold-i, dërgoi një ultimatum ku e urdhëronte atë të hiqte dorë nga pretendimet territoriale në Shqipëri:

> *"Është e domosdoshme për Perandorinë që qeveria e Serbisë të vazhdojë me tërheqjen e menjëhershme të trupave të cilat kanë përparuar përtej kufijve të vendosur nga Konferenca e Londrës, duke pushtuar territore që përbëjnë pjesë të Shqipërisë. Qeveria mbretërore dhe perandorake shpreson se qeveria serbe nuk do të vonojë të largojë trupat prej territorit shqiptar brenda një jave. Nëse nuk përmbushet kjo, atëherë qeveria perandorake dhe mbretërore me keqardhje do të detyrohet të përdorë tëra mjetet e duhura për të siguruar përmbushjen e kërkesave të veta"*[94].

Pas tërheqjes së zemëruar të Serbisë, del se përplasja e menjëhershme midis dy vendeve ishte e pashmangshme. Rrezikut i një lufte tjetër ishte në horizont dhe

[94] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

shtetet ballkanike vazhduan të manovrojnë për të zënë pozita sa më të favorshme, secila për veten e vet.

Brenda Shqipërisë vetë, kishte ardhur një kohë pasigurie dhe kaosi politik. Megjithëse Princ Vidi u zgjodh mbret i Shqipërisë, më 26 shkurt të vitit 1914, atij vetëm bagazhi i kishte arritur në Shqipëri. Ai nuk arriti në Durrës deri më 7 mars 1914. Mbretërimi i tij ishte paraparë të dështonte që prej ditës së parë të fillimit kur ai kishte marrë përsipër të bënte atë punë, pasi fuqitë përgjegjëse për emërimin e tij ishin të tëra në mospajtim me njëra-tjetrën. Italianët, p.sh., e shihnin atë si një pro-austriak dhe pro-gjerman.

Në këto rrethana Erickson-i planifikoi të takohej me disa patriotë shqiptarë dhe të fliste me ta mbi zhvillimet politike. Por, për fat të keq, Shqipërisë po i shtohej një barrë tjetër e rëndë. Ishte Lufta I Botërore. Shpërthimi i saj e tronditi shumë Erickson-in, pasi dukej se çfarëdo procesi politik tanimë ishte i pamundur në Shqipëri. I privuar nga çdo lloj mbështetjeje nga fuqitë europiane, Princ Vidi e gjeti veten të pamundur për ta udhëhequr vendin. Pas gjashtë muajsh kaosi politik, ai iku nga Shqipëria më 3 shtator 1914, pa abdikuar nga froni. Në mendjen e Erickson-it situata ishte rënduar për shkak të paaftësisë së Fuqive për të vendosur mbi të ardhmen e Shqipërisë. Franca dhe Rusia favorizonin ndarjen e Shqipërisë, ndërkohë që Anglia dukej se kishte vendosur të mos mbante kurrfarë pozicioni të vetin. Erickson-i ndjeu se zgjidhja përfundimtare do të bëhej në një konferencë paqeje që duhej të mblidhej pas luftës.

Në këto rrethana, Erickson-i shkoi në Romë për t'i diskutuar këto çështje me Ismail Qemalin dhe disa miq të tij. Në rrugën e bërë me traget nga Durrësi në Bari ai u takua me krye-shërbëtorin e Princ Vidit, i fundit nga ata që tashmë e kishin lënë ose po e linin Shqipërinë. Ai iu ankua Erickson-it për Esat Pashën, sepse i kishte vjedhur koleksionin prej 170 palë të brendshmeve të princeshës Vid, të blera të gjitha në *Channel* në Paris. Po ashtu dëgjoi tërë intrigat e thurura ndaj Mbretit Vid nga Esat Pasha dhe këshilltarët e tij të gjashtë Fuqive të Mëdha, që e

rrethonin atë. Secili prej këshilltarëve të Mbretit kishte një agjendë personale për kombin që përfaqësonte, secili në dëm të Shqipërisë, ndërsa pritej të ndihmonte këtë mbret kukull.

Gjatë bisedës me Ismail Qemalin, Erickson-i mësoi se ai ishte në hapat e parë të punës për formimin e një grupi, i cili do të përgatitej për të përfaqësuar interesat e Shqipërisë në një konferencë paqeje, që do të mbahej kur të vinte koha. Më 26 tetor 1914 situata në Shqipëri mori një drejtim krejt tjetër sapo ushtarët italianë zbarkuan në portin e Vlorës. Erickson-i shumë shpejt kuptoi se pushtimi italian ishte një operacion strategjik, i cili, përveçse nuk kishte asgjë të mirë për Shqipërinë, i hapte udhën edhe Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi, për të kërkuar edhe një herë "pjesët e tyre të lakmuara" të territoreve shqiptare.

Erickson-i erdhi në përfundimin e dhimbshëm se, sapo Italia të kuptonte se Gjermania, Austria dhe Turqia do të mundeshin nga kjo luftë, ajo do të përparonte drejt formimit të një protektorati mbi të gjithë Shqipërinë.[95]

[95] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

VLORA DHE PUSHTIMI ITALIAN

Në vijim të dy vjet e gjysmë që pasuan, forcat italiane e përdorën Vlorën si një bazë ushtarake strategjike. Më 19 qershor 1917, Thomas Nelson Page, ambasadori amerikan në Romë i raportoi Sekretarit të Shtetit, Robert Lansing, se Italia kishte si qëllim ta pushtonte Vlorën përgjithmonë. Më 22 qershor 1917, Ualter Hines Page, ambasadori amerikan në Londër, po ashtu i dërgoi një letër sekretarit Lansing, ku sqaronte edhe më tej qëllimet aneksuese italiane ndaj Shqipërisë. Ai shtoi se veprimtari të tilla ishin në kundërshtim me parimet e sovranitetit dhe të integritetit të kombeve të vogla. Edhe pse Erickson-i nuk e kishte këtë informacion të fshehtë dhe nuk i dinte këto komunikime dhe qëndrime të diplomacisë amerikane, ai prapëseprapë mendonte dhe besonte se ShBA-ja duhej të merrte përgjegjësinë kryesore në konferencën e paqes së pasluftës për mbrojtjen e shtetit të sapo formuar shqiptar, duke iu referuar qëndrimit se:

> *"…shtetet e vogla të botës kanë të drejtë të gëzojnë po atë respekt për sovranitetin dhe integritetin e tyre territorial që e kanë kombet e mëdha e të fuqishme dhe unë pres dhe këmbëngul që t'i kenë"*[96].

Pikërisht në këto kohëra të turbullta për Shqipërinë, kur një zë pro saj ishte gjë e rrallë, Erickson-i i dërgoi letrën e mëposhtme Sir Eduard Grejt, sekretarit

[96] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 2.

britanik të Marrëdhënieve me Jashtë. Ai besonte se Sir Eduard Grej jo vetëm që e njihte më mirë se kushdo çështjen shqiptare, por kishte edhe më shumë përgjegjësi për të, si rezultat i faktit që Konferenca e Ambasadorëve mbante emrin e kryeqytetit të tij, dhe nënshkrimin e tij.

Shkodër, Shqipëri, 22 mars 1915

Letër në dorëshkrim në gjuhën angleze

Shkëlqesisë së tij, Sir Eduard Grey

Londër, Angli[97]

Zotëri,

Duke ditur shumë mirë interesin Tuaj mbi Shqipërinë, nuk besoj se do të ma merrni për keq që po ju shkruaj në këto kohë përgjegjësish të mëdha që ju mbani. Unë po ju përshkruaj disa fakte që kam mbledhur dhe vëzhguar gjatë udhëtimit tim të tashëm në Shqipëri, në fillim në Vlorë. Unë pashë 30 000 deri në 35 000 frymë njerëzish, refugjatë nga Epiri, të gjithë muhamedanë të përzënë prej fshatrave të tyre prej grekëve.

Ata kanë humbur gjithçka që kishin, disa prej tyre edhe shuma të mëdha që kapnin mijëra sterlina dhe tani gjenden të grumbulluar, të tërë së bashku, në një magazinë në mes të mjerimit dhe urisë vdekjeprurëse.

Statistikat tregojnë se një popullsi prej 170 000 vetash ka humbur çdo gjë ndërkohë që 100 000 tjerë janë refugjatë me pak më shumë ose më pak pasuri, ende të mbetura, por që nuk guxojnë të kthehen më atje. Tani, së fundmi, një numër i madh i tyre, u vra edhe pse iu ishte dhënë garanci për jetën. Vlerësohet se një e treta e

[97] Center for Albanian Studies, London, File: Edward Gray on Albania, Document Nr 5

numrit të përgjithshëm të refugjatëve kanë vdekur prej urisë, qëndrimit në diell dhe sëmundjeve. Ndoshta ky vlerësim mund të jetë zmadhuar, por që ky është një numër shumë i lartë është pa as më të voglin dyshim e sigurt. Edhe pse të strehuar në një xhami në Vlorë, këtë dimër, 64 vdiqën dhe vetëm 80 mbijetuan. Unë jam tronditur prej numrit të madh të grave të mbetura pa burra dhe fëmijëve jetimë, pasi burrat kishin vdekur nga uria për t'u lënë ushqim tjerëve.

Konsulli italian më tregoi se furnizimi me misër mund të zgjasë vetëm edhe disa ditë më shumë dhe pastaj ata nuk dinë çfarë të bëjnë. Disa familjeve iu janë dhënë racione pa pagesë, por ato janë të pamjaftueshme. Ato shoqërohen përherë me sasi të mëdha gjethesh dhe gjemba gomari, që i hanë nga uria e tmerrshme. Sa për të tjerët, ata ose duhet të blejnë, ose të ikin me duar bosh. Midis tyre gjeta ndjesi shumë të hidhura kundër Italisë. Ata thonë:

"Ne po vdesim urie për hatër të Esat Pashës. Brenda vendit, shumë kilometra larg vendit, shitet misri me çmim normal, ndërsa në Vlorë shitet dyfish". "Rebelët" e lejojnë drithin të vijë aty një herë, por pastaj fshehtazi e dërgojnë tek Esat Pasha në Durrës. Kështu pjesa tjetër mbetet pa furnizim. Ndjenja kundër Esatit është e hidhur kudo. Gjithkush beson se ai merr para jo vetëm nga Italia, por edhe nga Greqia. Serbia dhe Mali i Zi punojnë për interesat e tyre. Kryengritës të ndryshëm në Shqipëri janë përgatitur të bashkohen, të harrojnë dallimet midis tyre dhe të formojnë një qeveri shqiptare nëse Esati mënjanohet. Por, për aq kohë sa ai mbetet në Durrës, kjo është e pamundur. Shumë prej tyre shkojnë aq larg, sa të konstatojnë se këto kushte të anarkisë janë ushqyer dhe nxitur me qëllim që t'u jepet rasti që, kur të vijë koha, ta ndajnë Shqipërinë e mbetur midis Fuqive dhe pikërisht kjo është ajo çfarë bëhet tani këtu.

E sigurt është se Shqipëria po i humbet me shpejtësi të gjithë miqtë e vet dhe nëse Anglia nuk do të zbatojë parimet e mbrojtjes së kombeve të vogla dhe t'i sigurojë Shqipërisë ekzistencën e saj të pavarur, ajo është e vdekur.

Shkëlqesia Juaj,

Nga këndvështrimi i kombeve të tjera, Shqipëria duhet përdorur si një peng për të paguar haraçet e politikave të njëri-tjetrit, ose për të përgatitur terrenin për pushtimin dhe kontrollin e saj në të ardhmen. Paradoksale si duket, dr.Dillon kishte plotësisht të drejtë kur shkruante:

"Shqiptarët janë populli më demokratik, më pak fanatik dhe më i lehti për t'u qeverisur në tërë Europën Kontinentale, aq të kollajshëm sa një tufë delesh".

Sa i takon programit: Kur të kthehem në Romë, unë do të përpiqem të gjej çfarëdo ndikimi, sado i vogël të jetë. Qeveria qendrore duhet ta heqë qafe Esat Pashën dhe të sjellë në vend të tij të tërë udhëheqësit së bashku në konferencë. Ajo vetëm fiton po të ndërmarrë këtë hap dhe nuk humbet asgjë. Çfarëdo të ngjasë, konferenca do të duhet të organizojë një qeveri provinciale me një komisioner në krye, i cili do të kërkonte një vend asnjanës, një president apo një këshill, që të ndërmarrë ndryshime derisa të vijë koha e Konferencës së Paqes dhe të jetë përcaktuar përfundimisht statusi i Shqipërisë. Personalisht, do të desha të shihja një amerikan në krye, sepse ai do të ishte i lirë nga paragjykimet europiane, sepse pritej më mirë, se do të punonte për kapitalin e vendit dhe lehtësimin e vuajtjeve të gjithanshme që zotërojnë këtu sot.

Si model qeverisjeje të përhershme unë besoj se Shqipëria duhet të zgjedhë Zvicrën ose Shtetet e Bashkuara. Duhet të formohen kantone me një qeveri vendore dhe përfaqësim për frymë popullsie nën një qeveri federale. Një prej gabimeve kryesore të bëra në përpjekjet e mëparshme është se shqiptarët vetë nuk janë dëgjuar në formimin e qeverive të tyre. Sikur të ishin këshilluar, sikur të ishin futur në këshill, sikur t'u ishte respektuar besnikëria e tyre, "Besa" e tyre, atëherë nuk do të kishte kryengritje.

E çuditshme, aq sa mund të duket, se shqiptarët janë stërvitur tashmë me këtë formë të qeverisjes në një mënyrë aq të lirshme dhe do t'i qëndronin shumë natyrshëm këtij plani. Çfarëdo që të ndodhë me ndryshimet politike dhe gjeografike të Europës, Shqipëria – duhet – të mos ndahet. Krimet e pushtimit belgjian zbehen përpara shtypjes dhe keqtrajtimit që kanë përjetuar shqiptarët ndër shekuj. Shqipëria e ndarë do të bëhet një vend i pashërueshëm në jetën politike të Ballkanit dhe të Europës.

Shqipëria e bashkuar do të marrë përsëri një vend të nderuar midis kombeve dhe drejtësisë, besimin e atyre që shoqërohen me të në këtë orë të errët të historisë së saj.

Unë mbetem zotëri

I Juaji me respekt:

Charles Telford Erickson[98]

Kjo ishte gjuha me të cilin heroi i librit tonë iu drejtua Sir Eduard Grey-it. Pasi u largua nga Shqipëria Erickson-i iu bashkua Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe shërbeu në rajonin e Pulias në Itali, atje ku uria po bënte kërdinë. Çfarëdo që bënte e kudo që shkonte, në mendjen dhe zemrën e tij shqetësimi më i madh mbetej fati i Shqipërisë. Kështu ai propagandonte, shkruante letra, fliste më dashuri e pasion për ne shqiptarët dhe historinë tonë. Në një veprimtari të organizuar në mbrëmjen e datës 12 nëntor 1915 nga Shoqëria Anglo-Amerikane në Napoli, ai mbajti ligjëratën e mëposhtme, të cilën e ka lënë vetë të konspektuar. Në fakt ky konspekt përbën platformën e librit të tij të ardhshëm, "Shqiptarët - Enigma e Ballkanit". Ai e titullonte leksionin:

SHQIPËRIA - FËMIJA I KOMBEVE[99]

Rrugëtimi i gjatë i Izraelit, i bërë i pavdekshëm prej historianëve dhe rapsodëve me këngët dhe historitë e tyre, është kthyer në një nga frymëzimet më të mëdha të njerëzimit. Këto rapsodi na mundësojnë ta besojmë këtë ndodhi si të vërtetë.

Kështu kombe të tjera dhe perandori të mëdha, persët, fenikasit, egjiptianët, grekët apo romakët, të drejtuar nga udhëheqës ambiciozë dhe të ushqyer me plaçka dhe pushtime,

[98] British Museum Collection, London: Letër e Ericksonit dërguar Sir Edward Grey,.

[99] Leksion i mbajtur në Shoqatën Anglo – Amerikane në Napoli. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 2.

rrëmbyen shumë toka dhe përfshinë në rrjetat e tyre fise dhe gjuhë të panumërta, duke iu dhënë kështu emra të mëdhenj perandorive. Historia e tyre është shkruar në monumente madhështore dhe në faqe të shkruara që nuk i lënë ato të harrohen.

Fitimtarët e botës, që i shkruan emrat me gjak, kasaphanë apo në vepra fisnike, e kanë pavdekësuar vetveten dhe popujt e vet me bëmat e pafund. Prej tyre bota ka dalë në një dritë më të shndritshme dhe në një ditë më të kthjellët. Egjipti, vendi i misterit dhe i magjisë, jetonte me dhimbjet e lindjes që sillnin para njerëzimit zotat, altarët e të cilëve ishin ndërtuar në shumë toka të largëta dhe të çuditshme. Ai i lidhi urat e vdekjes dhe varrit me toka dhe troje përtej shtëpive të pavdekshme.

Fenikasit u dhanë detarëve Yllin Polar, Persia tregoi misterin e qiejve, duke i dhënë kuptim muzikës së tyre, deri tek kufijtë e mundësisë njerëzore, të lirë prej frikës dhe terrorit. Ajo i dha zë vetë adhurimit.

Kaq lart këto dhe perandori të mëdha të botës kanë qëndruar në historinë e njerëzimit, kaq të theksuara janë ngjarjet e mëdha, sa popuj të vegjël dhe ngjarje më të vogla janë mbuluar prej sfondit të tyre dhe përhumbur nga harresa.

Kjo nuk duhej të ishte kështu. Duhet që sa më shumë të jetë e mundur të çmbështillet lëmshi i nakatosur i historisë dhe të zbulohet vepra e çdo kombi e çdo populli dhe t'i jepet secilit vlera dhe vendi që meriton.

Ai që lind i pari, megjithëse trashëgon titullin dhe pronësinë, nuk përbën vetë familjen, pasi janë tërë të tjerët që i bashkohen dhe e mbështetin kreun e tyre. Kështu ndodh edhe me këtë të lindurin e parë midis kombeve, Aleksandrin e Madh, ndërtuesin e një perandorie botërore, në të cilën ishte mbledhur kultura dhe shkëlqimi, lavdia dhe pushteti i Lindjes antike.

Prej gjenisë së tij, qindra kombe dhe popuj qenë bashkuar nën të njëjtin emër. Ai ishte gjysmë shqiptar që në lindje e ndoshta edhe i tëri, prej dy prindërve. Dhe përsëri, ky fakt ka mbetur pothuajse tërësisht i panjohur në histori. Plutarku në librin e tij për

Aleksandrin e Madh dhe Pirron, këmbëngul se ekzistonte një gjuhë e përbashkët midis maqedonasve dhe epirotëve, e ndryshme nga greqishtja. Straboni thotë të njëjtën gjë, duke shtuar se shumë syresh ishin dygjuhësorë, që flisnin edhe greqisht, dhe që kjo ndodhte njësoj edhe në Iliri. Ai përmend katërmbëdhjetë kombe që popullonin veçmas Epirin. Po ashtu ai flet për një popullsi të madhe që u zhvillua aty në atë kohë. Po kush ishin ato fise tjera moderne shqiptare, që sot ua pushtojnë territorin, prej të cilëve rrjedhin direkt dhe drejtpërsëdrejti pasardhësit e tyre?

Ka qenë fati i Shqipërisë që të mos i ndërpritej kurrë historia. E rrethuar prej kombesh dhe perandorish të tjera, atyre ua kanë thithur gjakun si shushunja, i kanë përdorur për të rritur madhështinë e vet, madje edhe duke ia marrë heronjtë e saj dhe duke i përdorur për të treguar vetëm madhështinë e tyre.

Biondelli[100] *thotë:*

"Populli shqiptar i ka përshkuar shekujt e historisë, duke i dhënë njerëzimit gjenitë e trimërisë, duke gjunjëzuar mendjemadhësinë e Republikës Greke, të Mbretit të Persisë dhe atij të Babilonisë. Me ndihmën e princeshës së Maqedonisë, mposhtën fuqinë e Romës, lehtësuan mizërinë e Tarantinos, frenuan për një farë kohe krishterimin, pastaj përparimin e shpejtë të islamizmit. Përveç kësaj, ata ngritën fronin e Mbretit të Sicilisë, atë të Greqisë, por kurrë nuk iu është dhënë atyre vendi që meritojnë në histori. Ata përherë, qoftë prej shkrimtarëve të lashtë, qoftë prej atyre modernë, janë damkosur si barbarë. Tëra arritjet e tyre në emër të të tjerëve kanë hyrë në historinë e vendit ku ka ndodhur bëma dhe jo në historinë e heronjve të këtij kombi, që e kanë kryer vetë bëmën.

Është dëshira ime, me aq sa të mundem, që të ftilloj historinë e tyre nëpër fijet e lëmshit dhe t'u tregoj shkurtazi historinë e këtij populli të vogël, emri i të cilit asnjëherë nuk është përmendur apo shquar nëpër kronikat e historisë së botës. Vendi i tij ka qenë përherë në sfond. Shërbimeve të mëdha që i ka bërë njerëzimit gjithmonë iu është vënë një emër tjetër. Territori i tyre ka qenë gjithmonë "fusha e vërtetë" e

[100] Literature Populare d'Epirus, Revista Europa, 1846.

kombeve ndërluftuese, afër dhe larg. Ata kanë qenë përherë bash ai "dashi i kurbanit" i mëkateve të të tjerëve dhe për rrjedhojë i dënuar me braktisje mes maleve të veta të egra, për të ardhur deri në ditët e sotme si një relikte e kohërave të lëna shumë, shumë prapa dhe të plandosura në harresë.

Jeta jonë moderne është aq e panjohur për ta, sa ç'është jeta e tyre e panjohur për ne. Kjo jetë, siç shpaloset, është njëherësh edhe një romancë, edhe një tragjedi. Ajo është e pasur në veprime të cilat e kanë ngritur tërë botën edhe më lart. Kalorës endacakë të një epoke morali paganësh, ata luftuan për mbrojtjen e virtytit dhe nderit, edhe të vetë fesë së krishterë, me një qëllim aq fisnik e të vërtetë, sa edhe shumë të famshmit kalorës të oborrit të Mbretit Artur.

Pionierë të qytetërimit, ata i ndriçuan rrugën Lindjes drejt Europës dhe nëpërmjet Europës deri tek ai vend ku ai shndriste mes bukurisë më hyjnore, aty tek ai vend që u bë zemra e tri perandorive më të mëdha botërore të historisë. Pikërisht në to ata derdhën jetën e tyre, thesarin e tyre. Ata u bënë gjeneralë për ushtritë e tyre, papë për Kishën, perandorë për shtetet, që një ditë virtytet e tyre të zhdukeshin në harresë… Që një ditë të gjendeshin për vete të parë prej syve me përçmim, poshtërim, qortim dhe turp. Epitetet që kam vënë re t'u vihen atyre janë si këto: "barbarë, të dhënë pas krimit dhe gjakderdhjes, armiq të qytetërimit dhe idealeve të tyre, vrasës të njëri-tjetrit thjesht dhe krejt për të shuar epshin e gjakut, fanatizmin fetar ose grindjet përçarëse. Një popull dhe një shtet që ka humbur të drejtën për të jetuar, ata janë një e keqe që duhet të zhduket si një fole grerëzash në anë të udhës, ose një fole ujqërish pranë një vathe delesh".

Më lejoni atëherë t'ju paraqes historinë dhe karakterin e këtij populli, që ju të gjykoni bazuar në meritat e tij, në të drejtën e këtyre njerëzve për të jetuar dhe punuar pas një kohe kaq të gjatë mjerimi. Ata, besoj unë, kanë të drejtën të jetojnë si çdo popull tjetër dhe madje të kërkojnë edhe të drejtën hyjnore që iu takon.

Le të fillojmë që nga antikiteti i tyre: Kaukazi, i shtypur prej hordhive të lindjes, i rrethuar prej veriorëve, prej Detit Kaspik në lindje dhe Deti i Zi në perëndim.

Përsëri duke kërkuar të dilnin në tokat livadhore të jugut me tufat e tyre, këta mërgimtarë lëvizën në paralel me luginën e Danubit, duke ndarë një degë drejt jugut në Gadishullin e Ballkanit. Tjetra vijoi drejt veriut, Gjermanisë dhe veriperëndimit të Europës. Ndoshta ballkanikët ishin të parët që u vendosën dhe më vonë pionierët që u detyruan ta bënin udhëtimin e tyre drejt veriut dhe zonave të tjera më pak mikpritëse. Në brigjet veriore të Mesdheut dhe të Egjeut dhe në dy brigjet e Adriatikut u vendosën këta popuj të quajtur në histori pellazgë (Pyll, gjind).

Është e gjithëpranuar teoria se ilirët, epirotët dhe maqedonasit e lashtë janë paraardhësit e shqiptarëve modernë dhe të tria ato fise ishin pasardhës të pellazgëve. Ata ishin bujq dhe çobanë, adhurues të devotshëm të zotave dhe vendeve të shenjta, të cilat gjendeshin në majat më të larta të maleve të tyre. Tomori ishte vend i Orakullit të Dodonës, me të cilin u këshillua Paridi, i biri i Priamit. Prifërinjtë e quajtën gjuhën e Tomorit primitive, njëzanore, të përmbledhur. Iliada nuk do të ishte shkruar dot po të mos ishte Troja. Dhe ky ishte një qytet pellazg. Paridi ishte një çoban dhensh, një bari shqiptar; Ajaksi, një gjakpirës me gjak shqiptar; Kasandra, profetja, e cila parashikoi rënien e Trojës, përqeshej prej njerëzve që e mendonin atë vetëm si një ëndërr. Emri i saj është kombinacion i fjalës "qesh" dhe asaj "andërr" Qesh-andërr – Këshandërr - Kasandër. Historia e Uliksit është shqiptare prej fillimit në fund. Laertus – vjen prej fjalëve shqipe "me le", të lindësh, dhe "urtë", Le-urtë, që do të thotë të lindësh i urtë, të jesh i mençur. Penelopa, e cila ra dakord të martohej përsëri, edhe pse nuk e kishte përfunduar qefinin e vdekjes së të shoqit, e endte atë ditën dhe e prishte natën. Emri i saj vjen nga ndërthurja i fjalëve shqipe "Pen - e– lyp".

Studimet e gjuhës shqipe zbulojnë një përqindje të caktuar fjalësh të huazuara nga latinishtja, gotishtja, sllavishtja dhe turqishtja madje dhe nga anglishtja. Por këto gjenden në një përpjesëtim shumë më të ulët sesa ato në gjuhët e tjera europiane. Në të vërtetë, është një mrekulli e historisë që ky popull ka arritur të ruajë gjuhën e tij në rrjedhë të dyzet shekujve të kaluar nën pushtimin e dikujt tjetër. I lidhur me malet e veta, populli i shqiponjave, jo vetëm që u kap fort pas shkëmbinjve të vendit të vet, por ruajti gjithashtu gjuhën, traditat dhe tiparet e veta kombëtare. Dhe ata përsëri gjenden

aty. Raca të tjera janë lindur, kanë bërë udhëtimin e tyre, janë rritur, janë plakur dhe kanë vdekur ndërkohë që ky popull ka jetuar ashtu në mëvetësinë e vet parake, të vetmuar, të paditur dhe të panjohur.

Unë jam interesuar të gjurmoj historinë e tyre që nga ditët e lashta deri në të sotmen. Të zbuloj lidhjet e tyre me Perandorinë Romake, kur Decius-i, Cladius-i, Aurelean-i, Probus-i, Diocletian-i, Maxmillian-i, Galdrius-i, Konstandin-i, Lieinius-i, Jovanius-i, të gjithë bij të fshatarëve shqiptarë, e bënë rrugën e tyre drejt mantelit të purpurt dhe fronit perandorak, ose kur Cesari dhe miku i tij Mark Antoni e luftuan Pompeun nga Durrësi drejt Farsalias. Rruga e njohur Egnatia, aq e zënë me trafikun e gjithëllojshëm që lidhte Romën me Kostandinopojën, kalonte nëpër qytetet ilire të mbushura plot.

Lidhjet e tyre me Perandorinë e Bizantit ishin shumë të forta, por sa përfituan ata prej shkatërrimit të saj, duke u bashkuar në një shtet, gjysmë të pavarur, të tërë së bashku që nga Epiri, Iliria dhe Maqedonia Perëndimore? Ka patur periudha luftërash sllavizuese, por që nuk kanë lënë dot thuajse asnjë shenjë të sllavizimit të tyre. Më pas pat tendenca turqizuese, por që ata i bënë ballë, duke shënuar çaste kulmore për vetë njerëzimin, siç është rasti kur Skënderbeu mbrojti vendin për 24 vjet me radhë në shekullin e 15-të. Më pas veshën edhe veladonin e papës së Romës me Klementin e tyre XI, Papa Alban.

Më poshtë Erickson-i vazhdon me leksionin e tij përpara Shoqërisë Anglo-Amerikane, me shpjegime rreth historisë së Shqipërisë nën pushtimin osman, pastaj me burimet natyrore, pasuritë, pyjet e bukura, mineralet, ujërat, popullsinë, fenë etj. Për të vijuar me kushtet në të cilat gjendeshim shqiptarët në atë kohë, duke u ndalur tek karakteri i shqiptarit:

Trimëria njihet kudo ku përmendet emri i shqiptarit. Ai nuk është i njohur sa duhet si kavalier, kur vjen puna tek gratë; për nderin ai vdes pa iu dridhur qerpiku. Mikpritja e tyre është më unikja në botë. Etja për pasuri e panjohur midis tyre e nxjerr edhe më në pah mungesën e veseve kombëtare. Ai është tepër i fuqishëm, por deri tani pa

ndonjë nxitje të dukshme. Ata janë poetë prej natyre. Por, mbi të gjitha, ata janë patriotë. Instinkti i racës është më i thellë se çdo gjë tjetër.

Më pas Erickson-i e vazhdon ligjëratën e tij në rritje, duke iu referuar autorëve të huaj për shqiptarët nën titullin:

Ja çfarë thonë të huajt për shqiptarët:

Hequate: *"Historia e Shqiptarëve na jep prova të shkëlqyera të energjisë, zgjuarsisë dhe veprimtarisë së tyre. Ata kanë ruajtur traditat dhe mënyrat kalorësiake, të cilat i janë kënduar heronjve të mesjetës. Ata i kanë dhënë përherë individualitete të shkëlqyera Greqisë së lashtë, Perandorisë Bizantine, Turqisë, madje edhe Greqisë moderne"*

Rene Pinon de Deux Mondes Paris: *"Shqiptarët prej race, prej gjuhe, prej zakonesh, prej fesë, janë të shquar dhe qëndrojnë veçmas nga tërë popujt e tjerë të Ballkanit. Ata kanë një individualitet qartazi të përcaktuar. Përpos problemeve me fqinjët e tyre në kufi, grekët në jug apo sllavët në veri dhe verilindje, ata kurrë nuk e kanë mallkuar dhe as janë ndeshur me njëri-tjetrin. Pushtuesit fqinjë janë përpjekur t'i asimilojnë, por gjithmonë kanë dështuar. Vezir i Madh në Stamboll apo çoban i vetmuar në malet e Pindit, për arsye qartësisht të përcaktuara shqiptari është një aristokrat, një njeri i lirë dhe fisnik."*

Bullgarët në Maqedoni e përkulin shpinën ndaj armikut deri tek shati e tek dheu. Për turqit, shqiptari në anën tjetër është mbreti i maleve, gjahtar, çoban, ushtar apo bandit, që përçmon punën e detyrueshme, që e bën atë të quhet sllav. Ai nuk pranon t'i bindet askujt tjetër përveç zakoneve të tij; ai nuk kërkon tjetër mbrojtje përveç asaj që ia afron arma e vet. Historia e tij është në harmoni të plotë me karakterin dhe vendin e vet.

Historie de Turkie, Lavallee*: "Shqiptarët janë të shkathët, të matur, bujarë dhe heroikë, kur është fjala për të mbrojtur fisin e tyre, familjen dhe vendin. Jashtë ata janë luftëtarët e paepur të Aleksandrit, të Pirros, Dioklecianit, Skënderbeut dhe sulltanëve*

të Bizantit."

Lord Bajroni, *një admirues i popullit shqiptar: "Mbi gurët e Sulit dhe malet e Pargës edhe sot gjenden mbetjet e një race, e cila vazhdon të rikrijojë nënat e tyre dorike. Gjaku i Herakliut ende rrjedh nëpër damarët e tyre".*

Garibaldi *në një letër dërguar princeshës shqiptare Dora D'Istria, edhe ajo një shqiptare, i shkruante asaj: "Çështja e shqiptarëve është e imja. Sigurisht që unë do të isha i lumtur t'i kushtoja gjithçka që ka mbetur nga jeta ime këtij populli krenar".*

Françesko Crispi, *që edhe vetë ishte shqiptar, në maj të vitit 1900 shkruante: "Shqiptarët kanë në vetvete tërë elementet që duhen për të formuar një shtet të pavarur më mirë edhe se serbët, edhe se bullgarët dhe do ta përfshinin vetveten në një jetë të qytetëruar me tërë karakterin e një shteti europian të mirë."*

Së fundmi ***Gladstone*** *në vitin 1880 deklaronte: "Çdo popull i shtypur ka të drejtë të heqë qafe zgjedhën dhe, nëse shqiptarët janë lodhur nga keqqeverisja turke dhe dëshirojnë të jenë të pavarur, urimet e mia më të mira shkojnë tek ata. Kur plani juaj të ketë sukses, kur flamuri turk të zhduket dhe pavarësia e Shqipërisë të shpallet zyrtarisht, atëherë Anglia do të jetë shteti i parë që do ta njohë atë pavarësi. Unë do të bëj gjithçka që mundem për t'i bërë edhe të tjerët ta njohin dhe ta ndjekin atë shembull."*

Por "i sëmuri i Bosforit" ishte më i vlefshëm për politikën europiane sesa autonomia e Maqedonisë dhe e Shqipërisë. Në vend të asaj pasuan erërat braktisëse të rebelimit dhe revolucionit, anarkisë dhe vrasjeve politike, shtypjes dhe mizorisë, torturës dhe dhunës, nëpërkëmbjes, mospajtimit dhe korrupsionit, me paratë e huaja dhe intrigat e pafund. Të tëra këto u mbollën në këtë tokë të shkatërruar, që sot Europa dhe e tërë bota të vjelin frytet e hidhura të asaj shakulline.

Por ky fëmijë i kombeve, edhe sot është një tingull zemre, siç ka qenë edhe mijëra vjet më parë. Zoti e di, ndoshta Ai do t'u tregojë atyre rrugën që i shpie nga një botë e

prapambetur drejt shtigjeve më të larta të paqes, nderit dhe vëllazërimit, në vitet që do të vijnë."

Ngjarjet e Luftës së Parë Botërore e gjetën përsëri Erickson-in në Europë. Ai u vendos në Zvicër dhe për disa kohë zëvendësoi një pastor në një kishë në Lozanë. Ai vendosi të kthehej përsëri në Shqipëri, por kësaj radhe ishte e pamundur. Ai i kërkoi ambasadës së vet në Romë të pajisej me një pasaportë, por kjo nuk u arrit. Në rrethana të tilla ai i hyri një punë madhështore, e cila do të zgjaste shumë vite – studimi i historisë së Shqipërisë në tërësi. Për këtë ai shfrytëzoi materiale të pasura, mblodhi informacion kudo që mundi për librin që do të shkruante dhe që gjendet tashmë në serinë e këtij botimi. Ai kishte ndërmend të shkruante diçka plot fakte, gjë që do të rriste krenarinë e kombit shqiptar për të kaluarën e vet.

Më 26 tetor 1914 italianët zbarkuan në Vlorë gjoja për të mbrojtur Shqipërinë. Ky pushtim bëri që Greqia, Mali i Zi dhe Serbia të ngriheshin dhe të pushtonin toka të shqiptarëve. Pushtimi italian u dha krahë veprimeve banditeske greke brenda territoreve shqiptare. Gazetat franceze shkruanin se, nëse Greqia dhe Italia lejoheshin të hynë aq thellë në Shqipëri dhe ta ndanin atë midis tyre, atëherë përse të mos lejoheshin edhe Serbia dhe Mali i Zi, të cilat po bënin një luftë kaq të shkëlqyer në mbështetje të Antantës dhe të lejoheshin të merrnin gjysmën e Veriut? Pa dyshim, Rusia qëndronte hapur në krahun e pretendimeve të tilla. Erickson-i filloi të shkruante librin e tij dhe në një letër që i dërgonte z. Bell i thoshte:

"Kapitulli i fundit i librit tim për Skënderbeun më ka interesuar pafundësisht dhe nëse ai i intereson lexuesit qoftë edhe një çerek të asaj që më ka interesuar mua, do ta shes atë me një frymë. Unë kam folur me shumë njerëz, edhe përpara Shoqërisë Anglo-Amerikane në nëntor. Këtu kam miq shqiptarë që i shoh shpesh. Duket se poema për Skënderbeun më ka dalë nga shpirti".[101]

[101] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

SKËNDERBEG

Ti dorën nuk e zgjate drejt skeptrit njollagjak,
As i trishtë nuk kërkove të shprishurën kurorë,
Përballë i dole që vetë të merrje hak,
ndaj atij tirani djemrrëmbyes e idhtak,
Që dheun tënd kishte shtënë në dorë.

I flake tej nderet e pafundme imperiale,
Dhe lavdinë ndër vite të fituar,
të mbroje folenë e vendit tënd, trazuar,
Si shqipe-shqiptare gjokszbuluar,
Prej morisë së pafund të shigjetave, i sulmuar.

U zhveshe nga një fe që të kishte ndarë,
Nga shtëpia, babai, nëna dhe altari,
Dhe varrose një dashuri,
Tinëzare, por të bukur, tretur, ëmbëlsi,
Për at' dhe, fe e truall që t'la i pari.

Si dikur Zoti yt, drejt vdekjes t'i shkove,
Ndërsa bota krejt e qetë të kundronte,
Pa luajtur qoftë dhe gishtin për shpëtim,
Pa rrahur një herë duart për tëndin guxim,
Kur kombit tënd si shi gjaku i kullonte.

Shpirt martir, eja prapë dhe hakmerru!

Nga pluhuri ngrije atë flamur, në lartësi!

Bëhu edhe një herë për ne, frymëzim,

Për kryqin e ndritur deri në amshim,

Dhe pamjes së largët të Lirisë, silli përjetësi![102]

[102] Kjo vjershë është gjetur në Arkivin e Center for Albanian Studies, London, nga studiuesi Bejtullah Destani.

ME KRYQIN E KUQ AMERIKAN NË ITALI – MENDJEN TEK SHQIPËRIA

Në mars të vitit 1918, Erickson-in e kapi një sëmundje që gati i mori jetën. Sapo e mori veten, ai vendosi të dërgonte Paulin dhe Loisin në Amerikë. Për ta do të kujdesej miku i tij Enoch Bell. Ai do t'i vendoste në një shkollë. Fill më pas ai shkoi të shërbente për Kryqin e Kuq Amerikan, në pozitën e drejtorit për Italinë Juglindore në krahinën e Pulias, një prej më të varfrave në atë vend. Gjendja atje ishte tejet e mjerueshme. Inflacioni kishte arritur shifra të paimagjinueshme. Nuk kishte ushqime dhe as ilaçe. Malaria bënte kërdinë. Ushtarë të plagosur në luftë dhe të liruar nga ushtria gjendeshin gjithandej. Ajo që dukej se ishte më e ngutshme ishte ushqimi i fëmijëve. Kishat, murgeshat, infermieret, të tërë ishin në këmbë për të bërë më të mirën, për të shpëtuar popullsinë. Gratë, familjet, gjithkush ishte mobilizuar për të tejkaluar situatën e tmerrshme që mbizotëronte.

Por mendja dhe zemra e Erickson-it punonte atje, në Shqipërinë e pushtuar. Në Vlorë ishin italianët, grekët në Korçë, ndërsa serbët dhe malazezët në veriperëndim dhe verilindje. Por në rrjedhë të luftës gjërat ndryshuan. Francezët zëvendësuan grekët në Korçë, italianët në Gjirokastër. Forcat britanike, franceze dhe ato italiane i zhvendosën forcat malazeze dhe serbe nga Shkodra. Këto ndryshime u bënë më shumë për të shpëtuar popullsinë shqiptare nga zhdukja sesa për ndonjë strategji të caktuar. Me largimin e austriakëve, menjëherë kishin hyrë italianët në Shqipëri, pa

iu lënë kohë shqiptarëve që të bëheshin njëherë zot të shtëpisë së tyre. Megjithatë, sapo erdhi koha për Konferencën e Paqes në Paris, populli shqiptar u tregua i vendosur që të kishte palën e vet përfaqësuese aty me çdo kusht.

Me 11 nëntor 1918 qeveria gjermane nënshkroi një armëpushim të diktuar në shtabin e mareshalit Ferdinant Foch me shefin e shtabit të Forcave Aleate. Kjo shënonte fundin e luftës. Një ndjesi e fortë lehtësimi dhe gëzimi përfshiu pjesë të tëra të botës së shkatërruar nga kjo luftë. Në këtë kohë, Mehmet Konica, i cili kishte përfaqësuar Federatën Panshqiptare Vatra për disa vjet në Londër, u kthye në Shqipëri për të punuar me udhëheqësit e ndryshëm shqiptarë për Konferencën e Paqes që pritej të bëhej. Kështu, më 24 dhjetor 1918, u mblodhën në Durrës 54 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, por pa delegatët e Vlorës, të cilët nuk i lejuan autoritetet italiane të merrnin pjesë. Këtu u themelua edhe një qeveri e përkohshme, e cila lëshoi këtë deklaratë:

> *"Delegatët, të cilët kanë besim të plotë në deklaratën e bërë prej Fuqive të Mëdha të Antantës, në emër të mbrojtjes së të drejtave të kombeve të vogla, duke u mbështetur në parimet fisnike të shpallura nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Uillson, në lidhje me vetëvendosjen e popujve, duke iu referuar në mënyrë të veçantë vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, 1912-1913, e cila e ka njohur dhe shpallur Shqipërinë një shtet të lirë dhe të pavarur, e konstituon vetveten si një qeveri të përkohshme, për t'u ballafaquar me situatën e sotme brenda vendit. Shkëlqesia e tij Turhan Pasha është caktuar Kryetar i Qeverisë së Përkohshme, ndërsa Shkëlqesia e tij Prenk Bib Doda zëvendës i tij .[103]"*

Delegatët që u zgjodhën për në konferencë ishin Turhan Pasha[104], Mehmet Konica[105] (ministër i Jashtëm), dr. Mihal Turtulli, monsinjor Bumçi dhe Mithat bej

[103] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 6.

[104] Turhan Pashë Përmeti politikan shqiptar i Perandorisë Osmane dhe më vonë Kryeministër i Shqipërisë. Ai ka qenë guvernator i Kretës në vitet 1895-1896 dhe ambasador i perandorisë në Shën Petërburg. Pas shpalljes së pavarësisë ai shërbeu dy herë si Kryeministër i Shqipërisë, në vitin 1914 nën Princ Vidin dhe në vitin 1918 deri në janar 1920 kur Kongresi i Lushnjës, zgjodhi qeverinë e vet. Ai drejtoi delegacionin e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris, 1919. Vdiq në vitin 1927. (Shënimi im – MB)

[105] Mehmet Konica, atdhetar shqiptar, dy herë ministër i Jashtëm i Shqipërisë. Ai ishte i pranishëm në Konferencën

Frashëri.

Delegacioni shkoi në Paris për t'u ballafaquar me shumë probleme, ndër të cilat i pari ishte që Shqipëria nuk kishte të drejta legjitime për të marrë pjesë në konferencë, edhe pse kishte hequr aq shumë gjatë asaj lufte të përgjakshme. Në fakt, mijëra shqiptarë kishin luftuar me forcat aleate, me ato amerikane, britanike, franceze dhe italiane. Një regjiment shqiptar snajperësh citohej për vlerat ushtarake që kishte prej gjeneralit Henry, komandant i trupave franceze të Orientit. Ishte ky që e quante regjimentin e snajperëve shqiptarë si një prej regjimenteve më të mira të Francës, komentonte majori Reynard – Laspinasse, qeveritar i deleguar në krahinën e Korçës.

Shqiptarët e Amerikës, po ashtu, kishin filluar të organizonin dhe të pajisnin një forcë të madhe të shpejtë gjatë luftës për t'u vënë nën komandën e kolonel - leitnantit britanik, Aubrey Herbert. Edhe qeveria amerikane, edhe ajo britanike e kishin dhënë miratimin për këtë, por Italia e kundërshtoi dhe ky projekt u hodh poshtë. Armëpushimi ndërpreu furnizimet dhe u dha fund veprimeve të Kryqit të Kuq në Itali. Duke ditur se sa nevojë kishte në Shqipëri për ndihmën e Kryqit të Kuq, Erickson-i shkoi në Romë dhe kërkoi që mallrat e mbetura nëpër magazina të dërgoheshin në Shqipëri. Atij iu ofrua që ta drejtonte operacionin dhe kështu ai u largua nga Bari për në Romë, duke u lënë një lamtumirë kolegëve italianë të atjeshëm. Në largim e sipër, kur po ndahej me miqtë e vet italianë, ai u tha:

> *"Italianët janë një popull shumë i dashur për mua, pasi qeshin dhe qajnë shumë lehtë, si fëmijë. Kështu që, nëse Shqipëria është dashuria ime e parë, siç është në të vërtetë, më duhet të them se popullit italian i jap vendin e dytë, fill pas saj."*[106]

e Ambasadorëve në Londër, 1913, anëtar delegacioni në Konferencën e Paqes në Paris, 1919, pjesëmarrës në Kongresin e Lushnjës, 1920, ambasador i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar 1922 – 1925 dhe aide-de camp i Mbretit Zog 1930. (Shënimi im – MB)

[106] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

DELEGAT NDERI I VATRËS NË KONFERENCËN E PAQES NË PARIS[107]

Erickson-i ndihej i mbushur me një ndjenjë të fortë keqardhjeje për çmimin njerëzor të luftës. Në një kontekst më të gjerë, ai kuptoi se fuqitë fitimtare europiane nuk ishin në pajtim të plotë me parimet e vendosura në *Katërmbëdhjetë Pikat* e paraqitura nga Presidenti Wilson, veçanërisht për atë që kishte të bënte me të drejtat e kombeve të vogla. Tashmë, gëzimi i trazuar për "paqe e drejtësi" i Wilson-it kishte filluar të zbehej, për t'u pasuar menjëherë prej motiveve nacionaliste të frymëzuara prej propagandës së luftës. Në veçanti, në Europën Juglindore, shumë e dashura Shqipëria e Erickson-it ishte tashmë objektivi i pasluftës me lakmitë e fqinjëve të saj. Prej fillimit të Konferencës së Paqes Erickson-it i dukej se statusi i ardhshëm i Shqipërisë mund të kompromentohej prej çështjeve të trashëguara nga Traktati i Londrës i vitit 1915 dhe lakmive për kontrollin e ardhshëm të Adriatikut.

Duke ndier urgjencën për të patur disa zëdhënës të çështjes kombëtare me profil të lartë, të cilët do të dinin çfarë të kërkonin dhe si ta kërkonin tek Woodrow Wilson-i, një grup i nacionalistëve shqiptarë nga Vatra e Bostonit, e kontaktuan Erickson-in në Romë dhe i kërkuan atij që t'i bashkohej delegacionit të tyre të

[107] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

sapoformuar në Konferencën e Paqes në Paris. Erickson-i jo vetëm që e pranoi kërkesën për t'u bërë i pari amerikan i lindur në Amerikë që përfaqësonte kombin shqiptar, por ai mezi e priti rastin për t'i shërbyer përsëri kombit tonë. Gjatë luftës, ai ishte thellësisht i shqetësuar për të ardhmen e Shqipërisë. Tani ai, edhe një herë, do t'i kushtonte energjitë e tij çështjes së saj. Italianët, të cilët ishin në zotërim të Shqipërisë, deshën të formonin vetë një delegacion "shqiptar" për Konferencën e Paqes – që me fjalë të tjera do të thoshte një dorë e zgjatur proitaliane.

Pasi i vlerësoi pengesat e mundshme, ai kuptoi se një prej vështirësive kryesore do të ishte mungesa e një qeverie zyrtare shqiptare pas lufte. Federata Panshqiptare e Amerikës Vatra, gjithashtu, e ndërgjegjshme për situatën delikate, siguroi fondin e nevojshëm financiar dhe i ofroi Erickson-it një pozicion si delegat nderi, për t'i përfaqësuar në konferencë. Në fakt, ky ishte një veprim shumë i zgjuar i "Vatrës" në mbrojtje të çështjes shqiptare në Paris. Erickson-i filloi të punonte nga afër me Mehmet Konicën, i cili do të bëhej ministër i Punëve të Jashtme në qeverinë e përkohshme.

Erickson-i, duke e njohur mirë situatën e vështirë në të cilën gjendej Shqipëria, hulumtoi dhe mësoi pikërisht në atë kohë, për herë të parë, rreth disa prej dispozitave të Traktatit të fshehtë të Londrës të vitit 1915. Ai ishte i tërë në favor të aneksimit të trojeve shqiptare dhe ishte nënshkruar prej Italisë, Britanisë së Madhe, Francës dhe Rusisë. Erickson-it i takon merita e veçantë që siguroi një kopje të këtij traktati. Pasi e shqyrtoi atë, ai arriti të kuptonte se, sipas dispozitave të tij, Shqipëria nuk ekzistonte më si një shtet i pavarur. Në mënyrë të veçantë, dy prej dispozitave i jepnin Italisë kontrollin virtual mbi Shqipërinë. Këto ishin:

> *Neni 6: Italia do të ketë sovranitet të plotë mbi Vlorën, ishullin e Sazanit dhe territorin rrethues gjerësisht të mjaftueshëm për të siguruar mbrojtjen e këtyre pikave… Italia ngarkohet të përfaqësojë shtetin shqiptar në marrëdhëniet e mëpastajme me jashtë…*

Erickson-i e dinte se Shqipëria ishte konstituuar zyrtarisht si shtet i pavarur dy vjet e gjysmë para këtij traktati, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Tani fuqitë europiane ishin gati ta mbanin atë në kushtet e parashtruara nga

Traktati i Fshehtë i Londrës i vitit 1915, një traktat në të cilin Shqipëria nuk ishte nënshkruese. Ishte krejt e qartë për Erickson-in se çështja e ruajtjes së pavarësisë së Shqipërisë nuk do të zgjidhej nëpërmjet bashkëpunimit me italianët. Përpara se të ikte për Paris, Erickson-i vendosi të bënte një vizitë tek Thomas Nelson Page, ambasadori amerikan në Itali, me qëllim që të diskutonte pozicionin e delegacionit shqiptar, i cili ishte gati tashmë të shkonte në Paris. Duke shpresuar se ambasadori do t'i jepte ndonjë ndihmë, Erickson-i i prezantoi Mehmet Konicën, ministrin e Jashtëm të qeverisë së sapoformuar të përkohshme të Shqipërisë. Gjatë bisedës së tyre, Konica u përpoq ta bindte ambasadorin që delegacioni amerikan në Paris të siguronte një leje për Konicën, që të përfaqësonte qeverinë e përkohshme të Shqipërisë në Konferencën e Paqes[108]. Ky takim ishte tërësisht jo produktiv, gjë që shkaktoi zhgënjimin e Erickson-it. Duke bërë e zhbërë krejt çfarë mundi në Romë, Erickson-i u nis për në Konferencën e Paqes në Paris. Me të arritur atje, atij iu desh të kalonte disa ditë për të pikasur ku gjendeshin anëtarët e delegacionit amerikan, të cilëve ai do t'u paraqiste pozicionin e delegacionit shqiptar.

Në hotelin "Crillon", Erickson-i e diskutoi situatën ballkanike, me dr. Lybyer, një ekspert amerikan i Ballkanit, i cili ishte një ndër pjesëtarët e kontingjentit amerikan në Paris. Erickson-i iu qas dr. Lybyer duke i thënë se, nëse ShBA-ja do të merrte një status të mbrojtësit të Gadishullit të Ballkanit, që do të thoshte një mandat amerikan mbi Shqipërinë, mundësia që të kishte luftëra në të ardhmen, të cilat përfshinin edhe Amerikën, do të minimizohej jashtë mase shumë. Erickson-i vetë ishte i mendimit se fuqitë fitimtare ishin përfshirë nga ethet e ambicieve imperialiste dhe udhëheqësit europianë thjesht po i bënin qejfin Presidentit Wilson për idetë e tij. Në këtë bisedë, Lybyer-i filloi të ndiente pasionin e Erickson-it dhe ndjenjën e përgjegjësisë për statusin e ardhshëm të popullit shqiptar.

Që prej 15 shkurtit të vitit 1919, delegacioni amerikan, i cili dukej se i njihte veprimtaritë e Erickson-it, u informua se përfaqësuesit e qeverisë së përkohshme të Shqipërisë në Paris ishin, Turhan Pasha, kryetar, Mehmet Konica, ministër i

[108] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

Punëve të Jashtme dhe Charles Telford Erickson-i, delegat nderi. Në këtë mënyrë Erickson-i iu fut një pune titanike për të informuar Presidentin Wilson mbi të drejtën e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi. Por le të shohim kush ishte vetë ky president.

PRESIDENTI WILSON[109]

Thomas Woodrow Wilson u lind në Staunton të shtetit Virxhinia më 28 dhjetor 1856 dhe vdiq më 3 shkurt 1924. Familja e tij kishte emigruar në Amerikë në vitin 1807. Deri në moshën dhjetëvjeçare ai nuk shkruante dot, pasi vuante nga disleksia. Në vitin 1879, Wilson-i ndoqi shkollën e drejtësisë në Universitetin e Virxhinias për një vit, por nuk u diplomua dot, pasi shëndeti i tij i dobët e detyroi të kthehej në shtëpi në Wilmington, Karolina e Veriut. Më pas studioi dhe i kaloi edhe provimet e dhomës së avokatëve të Amerikës. Në prill të vitit 1883, ai aplikoi në universitetin "Johns Hopkins" për të studiuar për një doktoratë në histori dhe shkenca politike, të cilën e kreu tre vjet më vonë. Në vitin 1902, ai zëvendësoi Francis Landey Patton në krye të Universitetit Princeton. Në vitin 1910 ai u zgjodh President i Shoqatës Amerikane të Shkencave Politike. Shumë shpejt ai vendosi ta linte postin që kishte në krye të universitetit dhe të hynte në politikë. Kështu u zgjodh guvernator i shtetit të New Jersey në vitin 1911. Popullariteti i Wilsonit si guvernator i dha një shtysë për të kandiduar për president të ShBA-së. Kështu ndodhi, dhe më 4 mars 1913 ai bëri betimin si presidenti i 28-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai u rizgjodh përsëri në vitin 1916.

[109] Marrë nga biografia e Woodrow Wilson-it, shkruar nga John Milton Cooper, Jr, botuar nga shtëpia botuese "Vintage", New York, 2009.

Wilson-i, që nga viti 1914 deri në fillim të vitit 1917, u përpoq ta mbante Amerikën larg nga Lufta e Madhe Botërore. Ai u përpoq të bëhej ndërmjetës mes palëve ndërluftuese, por as aleatët, as Fuqitë e Mëdha nuk i morën seriozisht kërkesat e tij. Republikanët, të udhëhequr nga Theodore Roosevelt-i e kritikonin ashpër kundërshtimin e tij për të bërë shpenzime për luftën. Por Wilson-i gëzonte mbështetjen e elementëve paqësorë, sidomos grave dhe kishave, me argumentin se ndërtimi i një ushtrie të fortë do të provokonte vetëm luftë.

Mandatin e dytë në vitin 1916 ai e fitoi me parullën: "A ju mbajta larg nga lufta?!". Wilson-i nuk deklaroi se do të futej në luftë, por ai asnjëherë nuk e përjashtoi tërësisht përfshirjen në të. Në fjalimin e tij të 2 shtatorit, 1916, Wilson-i e paralajmëroi Gjermaninë me një gjuhë të kujdesshme për nëndetëset që morën jetët e amerikanëve, duke iu thënë se kjo nuk do të tolerohej. Kështu, edhe pse kundër luftës, në prill të vitit 1917, Wilson-i i kërkoi Kongresit të shpallte luftën. Në vitin 1918 ai shpalli *Katërmbëdhjetë pikat* e tij të famshme për vetëvendosjen e kombeve. Ky ishte një këndvështrim i tij për një botë të pasluftës, ku mund të shmangeshin konfliktet e tjera të tmerrshme.

Më 4 korrik 1918, ai bëri një shëtitje në lumin Misisipi me anijen historike të quajtur Mayflower[110]. Në bord kishte një numër drejtuesish të komuniteteve të ndryshme, midis të cilëve edhe Fan Nolin, në atë kohë drejtues i "Vatrës", në Boston. Gjatë atij udhëtimi, Noli pati mundësinë t'i shpjegonte Presidentit çështjen shqiptare, lakmitë grabitqare të fqinjëve, lojërat e Fuqive të Mëdha europiane, nevojën për ndihmë nga ShBA-ja, si i vetmi vend me një politikë të qartë dhe të drejtë ndaj kombeve të vogla. Presidenti e dëgjoi atë me vëmendje dhe i premtoi se:

> *"Unë do të kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes në Paris dhe atë zë do ta përdor për Shqipërinë".*[111]

Në vitin 1919, ai shkoi në Paris për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes dhe për ndjekur nga afër krijimin e shteteve të reja, që dilnin nga perandoritë e

[110] Edwin Jacques: The Albanians: An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present.

[111] Po aty.

rrënuara. Senati, i kontrolluar nga republikanët, e kundërshtoi me forcë Traktatin e Versajës dhe pjesëmarrjen e Wilson-it në të. Megjithatë, ai u bë njeriu më i rëndësishëm i asaj konference. Më pas, po atë vit (1919), ai mori çmimin "Nobel" për paqen.

Në politikë ai ishte shumë i mprehtë dhe me gjuhë shumë të hidhur. Megjithatë, ai i kursente fjalët e ashpra ndaj Roosevelt-it. Në një rast, kur e pyetën përse nuk e sulmonte më ashpër atë, ai u përgjigj:

"Kurrë mos u përpiq të vrasësh një njeri që është duke bërë vetëvrasje!"

SHBA-ja e ruajti paanësinë, pavarësisht presionit në rritje të vendosur mbi Wilson-in. Por pas fundosjes së anijes britanike Lusitania[112] dhe mbytjes së pasagjerëve britanikë bashkë me qytetarët amerikanë në bord, Wilson-i e pati gjithnjë e më të vështirë të ruante paanësinë amerikane ndaj Gjermanisë. Më në fund ai u bind t'i hynte luftës me parullën:

"Të bëjmë një luftë për t'i dhënë fund luftës."

Kështu Wilson-i arriti të merrte miratimin e senatit më 4 prill dhe Amerika hyri në luftë datën 6 prill 1917, ditën e dekretimit të saj nga Presidenti Wilson.

Siç u tha më sipër, më 8 janar 1918, Wilson-i shpalli "*Katërmbëdhjetë pikat*" e tij të famshme dhe u bë nismëtar i idesë për një Lidhje të Kombeve, një organizatë që do të kishte synim ruajtjen e integritetit territorial dhe pavarësinë politike si për kombet e mëdha edhe ato të vogla. Me parimet e tij të shpallura botërisht Wilson-i shkoi në Paris për Konferencën e Paqes, duke u bërë presidenti i parë amerikan që udhëtoi në Europë, gjatë kohës që ishte në detyrë. Më pas ai vizitoi Papën në Romë, duke u bërë po ashtu i pari president që e vizitonte atë. Më 26 shtator 1919

[112] "Lusitania" ka qenë një anije oqeanike britanike, së cilës i ishte vënë emri i provincës së vjetër romake Lusitania, pjesë e Portugalisë sot. Ajo ishte ndërtuar në vitin 1907 dhe qarkullonte në shumë qendra, që nga Liverpuli deri në New York. Gjatë Luftës së Parë Botërore, Gjermania zhvilloi luftë të ashpër me nëndetëse kundër Britanisë së Madhe. Anija u identifikua dhe u qëllua nga një anije gjermane më 7 maj 1915 dhe u mbyt në 18 minuta. Anija u zhyt në brigjet e Irlandës dhe mori me vete 1 198 prej 1959 njerëzve që kishte në bord. 761 prej tyre shpëtuan. Kjo bëri që opinioni i brendshëm të mbështeste hyrjen e ShBA-së në luftë kundër Gjermanisë. (Shënimi im – MB)

ai pësoi një goditje cerebrale dhe u kthye në një invalid në Shtëpinë e Bardhë. Ai u mbajt larg publikut, derisa vdiq më 3 shkurt 1924.

KATËRMBËDHJETË PIKAT E PRESIDENTIT WILSON

Por le të kthehemi tek puna e delegacionit shqiptar në Paris dhe në veçanti tek puna e delegatit Erickson. Më së pari, atij i duhej të dinte se çfarë po bëhej me *Katërmbëdhjetë pikat e Presidentit Wilson*, të paraqitura prej tij si parimet mbi të cilat do të merreshin vendimet e Konferencës së Paqes në Paris. Po në fakt çfarë ishin ato pika? Mendoj se ia vlen t'i përmendim këtu, pasi shumë flitet për to dhe pak dihet se ishte pikërisht prej këtyre parimeve të Wilson-it që Shqipëria, në Konferencën e Paqes, shpëtoi pa u zhdukur nga harta, siç kishte dashur të bënte Traktati i fshehtë i Londrës.

Pikërisht tek këto pika u mbështet delegacioni shqiptar dhe Erickson-i në përpjekjet e tij për ta futur çështjen shqiptare në vëmendjen parimore të Presidentit Wilson dhe jo aq në keqardhjen për të si komb i cili vërtet rrezikohej të bëhej një monedhë kusuri për Fuqitë e Mëdha. Më poshtë le të shohim katërmbëdhjetë pikat e paraqitura nga Presidenti Wilson në Konferencën e Paqes:

1. Nuk duhet të ketë aleanca të fshehta midis vendeve.
2. Të ketë liri nëpër dete si në kohë paqeje, edhe në kohë lufte.
3. Të zvogëlohen pengesat tregtare midis vendeve.
4. Të ketë zvogëlim të përgjithshëm të armatimeve.

5. Të ndryshojnë pretendimet koloniale si në interes të banorëve, ashtu edhe të fuqive koloniale.
6. Të largohen tërë trupat nga territori rus dhe të mirëpritet qeveria e saj në bashkësinë e kombeve.
7. Të restaurohen territoret belge në Gjermani.
8. Të lirohen të tëra territoret franceze, përfshirë edhe Alsasën dhe Lorenën.
9. Të rishikohen kufijtë e Italisë, përgjatë linjave të njohura qartë të kombësisë.
10. T'u jepet pavarësi grupeve të kombeve të ndryshme në Austro-Hungari.
11. Të restaurohen kombet e Ballkanit dhe t'i sigurohet dalje e lirë në det Serbisë.
12. Të mbrohen pakicat në Turqi dhe të ketë kalim të lirë për të gjitha vendet nëpër Dardanele.
13. Polonia të shpallet e pavarur, duke i siguruar edhe dalje në det.
14. Të formohet një Lidhje e Kombeve për të mbrojtur "garancitë e ndërsjella" të pavarësisë politike dhe integritetin territorial, si të kombeve të mëdha, ashtu edhe të atyre të vogla[113].

Ishin pikërisht këto pika të cilat ishin në kundërshtim me pikat e Traktatit të fshehtë të Londrës, të 28 prillit 1915. Ky i fundit ishte arritur midis Italisë dhe Antantës dhe ishte nënshkruar prej Mbretërisë së Italisë, Britanisë së Madhe, Francës dhe Rusisë. Në këtë traktat territore shqiptare ishin shpërndanë në favor të fqinjëve të Shqipërisë. Traktati në fjalë ishte një akt jashtëzakonisht i padrejtë, jo vetëm kundër shqiptarëve, por edhe ndaj popujve të tjerë. Por ne do të ndalemi tek disa pika që kanë të bëjnë pikërisht me ne shqiptarët.

> *Neni 6. Italia do të ushtrojë sovranitet të plotë mbi Vlorën, ishullin e Sazanit dhe territoret që i rrethojnë.*
>
> *Neni 7. Nëse Italia përfiton Trentinon dhe Istrian sipas dispozitave të nenit 4, së bashku me Dalmacinë dhe ishujt e Adriatikut, brenda kufijve të përcaktuar në nenin*

[113] Wilson Collection, Paris Peace Conference 1919; 14 Points of President Wilson at the Paris Peace Conference, Paris 1919.

5, dhe Gjirin e Vlorës, sipas nenit 6, dhe nëse pjesa qendrore e Shqipërisë është rezervuar për ndërtimin e një shteti të vogël, asnjanës, autonom, Italia nuk do të kundërshtojë ndarjen e Veriut dhe Jugut të Shqipërisë midis Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë.

Neni 16. Kjo marrëveshje duhet të mbahet e fshehtë.

Kjo e fundit kishte bërë që ky traktat të mbahej i fshehtë deri në Konferencën e Paqes, por që Presidenti Wilson dha shenja të qarta se ishte në dijeni të tij. Siç do ta shohim, Shtetet e Bashkuara nuk njihnin dhe as pranonin ndonjë traktat të fshehtë, në të cilin ai vend nuk kishte qenë palë në kohën e nënshkrimit.

KONTRIBUTI I C.T. ERICKSON-IT NË KONFERENCËN E PAQES NË PARIS, 1919

Më poshtë do të japim tërë përshkrimin e përpjekjeve të delegacionit shqiptar në Paris, siç e ka përshkruar vetë C.T Erickson-i:[114]

> … *"Me të arritur në Paris, hapi tjetër që duhej të bëja ishte të gjeja ku ishte delegacioni shqiptar. Çfarë kishte ndodhur me Katërmbëdhjetë Pikat e Presidentit Wilson, të cilat ishin tërësisht në kundërshtim me Traktatin e fshehtë të Londrës? Ku qëndronin ata në lidhje me kërkesat greke për Shqipërinë e Jugut? Kështu unë u paraqita para zyrës së delegacionit në hotel "Crillon". Ishte gjenerali Blis që më priti. Ai ishte babaxhan dhe zemërbardhë, por shihej qartë se dinte shumë pak ose aspak rreth çështjeve që kisha unë ndër mend. Ai më paraqiti tek kreu i divizionit të Ballkanit, dr. W.L Westerman dhe z. Clive Day. Biseda që bëmë ishte në fakt tejet e bezdisshme për të tre ne, por jashtëzakonisht e dhimbshme për mua. Unë prisja që të paktën të ma dinin për nder që kisha aq shumë dijeni për Shqipërinë dhe shpresoja të më jepej një mundësi për t'i bindur me dijenitë që kisha për të, dhe kërkesat e mia për njohjen e saj.*
>
> *Në vend të kësaj ata më thanë:*

[114] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

Fillimisht, për sa i takonte traktatit të fshehtë, ata nuk ishin të interesuar, pasi ajo çështje kishte dalë tërësisht jashtë duarve të tyre. Sa i takon Shqipërisë së Jugut, ata më informuan se pretendimet shqiptare nuk ishin të bazuara sa duhet, pasi shumica e popullsisë, sipas tyre, ishin grekë dhe se ata ishin të gatshëm të luftonin me çdo mjet, që të mos përfshiheshin në një shtet shqiptar. Më në fund, sipas tyre, myslimanët nuk kanë ndonjë rëndësi, pasi ata ishin pothuajse tërësisht turq. Faktet që doja t'u ofroja atyre as që iu interesonin, pasi ata kishin faktet e tyre. Ata dukej se ishin hipnotizuar prej Venizellosit, kryeministër i Greqisë, dhe e citonin vend e pa vend si autoritetin që duhej të thoshte fjalën e fundit. Më në fund, unë e humba durimin. Iu thashë se prisja një qëndrim tjetër prej tyre, si amerikanë.

Po atëherë, çfarë iu mbetet "Katërmbëdhjetë pikave të Presidentit Wilson?" dhe së drejtës për vetëvendosje të kombeve të vogla, të paraqitura prej shefit të tyre? Njësoj si Shën Pauli, thashë vetë me vete:

Do t'i bëj zë Cezarit[115] *dhe dola jashtë.*

Tani problemi ishte si të arrinim deri tek Presidenti Wilson!? Tashmë Katër të Fortët e kishin izoluar dhe e kishin veçuar vetveten aq shumë nga tufa që gëlonte rreth qendrës së konferencës e që ishte me mijëra. Secili prej tyre dukej aq i fuqishëm, sa vetë zotat e Olimpit. Duke lënë mënjanë si të pafrytshme të gjitha metodat ortodokse, unë vendosa të ndërmerrja një goditje të fortë, duke shkruar një deklaratë të shkurtër rreth situatës sonë, të cilën ia drejtova jo vetë Presidentit, por zonjës Wilson, bashkë me një letër shoqëruese ku i shpjegova qëllimin tim.

Pastaj u luta për fat dhe qëndrova në pritje.

Disa ditë më vonë më erdhi një mesazh prej sekretarit të Presidentit. Ai kërkonte një deklarim të pretendimeve të Shqipërisë, siç e kishte konceptuar delegacioni ynë. Nuk dukej se fjalët vinin drejtpërdrejt nga Presidenti. Ne pritëm e pritëm tërësisht

[115] Veprat e Apostujve 25:11 "Megjithatë, nëse jam fajtor se paskam bërë diçka që meriton vdekjen, nuk kundërshtoj të vdes. Por në qoftë se akuzat që më janë bërë nga hebrenjtë nuk janë të vërteta, atëherë askush nuk ka të drejtë të më dorëzojë tek ta. Unë do t'i bëj zë Cezarit". (Shënimi im – MB)

në dëshpërim. Por, më në fund, tërthorazi, morëm një përgjigje, e cila ishte më e paparashikueshmja e mundshme.

Ishte një deklaratë e lëshuar nga Presidenti dhe botuar në Paris Press. Ajo fillimisht paraqiste shqetësimet për pretendimet e Italisë ndaj Fiumes dhe i hidhte poshtë si të bazuara thjesht në interesa dhe jo në parime.

Nuk janë në pikëpyetje "interesat" thuhej aty, por të drejtat e popujve, sundimtarët e të cilëve kurrë nuk i kanë llogaritur të drejtat e tyre si të vlefshme. Duke u zgjeruar më tej në këtë deklaratë ai e mbyllte atë me këto fjalë:

"Kufijtë tuaj do të zgjerohen në kurriz të saj (Austrisë), por jo në kurriz të shteteve të reja, të cilat kanë dalë nga rrënojat e saj… Jo vetëm që ju nuk do të keni tërë territoret shtesë që lakmoni, por unë kundërshtoj që t'ju jap edhe atë që ju është garantuar prej traktateve tuaja të fshehta. Unë refuzoj të pranoj se, meqë qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk ka qenë palë në këtë traktat, të ketë qenë në fakt edhe tërësisht e panjohur me ato që janë vendosur aty. Rrethanat e reja e kanë transformuar atë në një copë letër pa vlerë."

Kur e lexuam këtë deklaratë befasuese, pyetëm veten nëse ishte letra ime e cila i kishte dhënë Presidentit njohjen e parë të ekzistencës së atij traktati të fshehtë me Italinë. Sidoqoftë, ne kishim tashmë Yllin tonë Polar dhe nuk humbëm kohë që ta ndiqnim atë. Mëngjesin tjetër Presidentin e priste në tavolinë teksti i letrës së mëposhtme:

Shkëlqesisë së tij Woodrow Wilson,

President i Shteteve të Bashkuara

Paris, 24 prill 1919

Zotëri,[116]

A do të na lejoje ne, përfaqësuesve të një kombi të vogël, që gjithmonë i ka vlerësuar nderin, drejtësinë dhe guximin si virtytet më të larta, që t'u shprehim Juve mirënjohjen më të thellë për ndjesitë tuaja fisnike, të cilave ju i keni dhënë shprehje të tilla kaq të fuqishme? Në to ne shohim shpalljen e lirisë, njësoj si raca e zezë e vendit Tuaj i sheh të vetat në Shpalljen e paraardhësit Tuaj të nderuar, Abraham Linkolnit.

Duke ditur ndoshta më mirë se ju, se sa të thella janë rrënjët e imperializmit në Europë, se sa i paepur është egoizmi, ne frikësoheshim pa masë se mos ju dhe kolegët tuaj do të detyroheshit, përkundër tërë asaj që mund të bënit, të dorëzoheshit ose më në fund të bënit kompromis në dëm të parimeve për të cilat Amerika i hyri kësaj lufte. Kështu Shqipëria do të bëhej edhe një herë mish për top, siç është bërë kaq shpesh në të kaluarën. Deklarata juaj, e botuar këtë mëngjes, zhduk edhe gjurmën e fundit të asaj frike.

Tani ne e dimë se çështja jonë humb vetëm nëse humbet çështja juaj, sepse të dyja janë një, dhe ajo do të ndodhë vetëm nëse vetë Zoti dështon, që do të thotë, KURRË.

Z.President, Ju treguat këtë mëngjes se jeni udhëheqësi i denjë i një populli të madh e fisnik, të cilin e përfaqësoni kaq denjësisht. Në deklaratën tuaj populli amerikan do të gjejë një mesazh edhe për vete, një thirrje të një detyre të lartë e të shenjtë dhe, nëse nevojitet, vetë guximin që do të përligjë të drejtën morale të Amerikës për të udhëhequr në këtë orë të rëndë e kritike për botën.

Pranoni, z .President, mirënjohjen tonë më të thellë dhe respektin më të madh si

Shërbëtorët Tuaj më të bindur dhe plot nderim,

[116] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

Mehmet Konica

Mihal Turtulli

Charles Telford Erickson

Nënshkruar:

Ditën tjetër ne u gëzuam aq shumë, sa nuk mund ta shprehin fjalët kur morën letrën e mëposhtme nga vetë Presidenti Wilson:

Të dashur zotërinj,

E kam vështirë që në mes të një ditë kaq të ngarkuar me punë t'ju tregoj si duhet se sa shumë jam gëzuar kur mora letrën tuaj të datës njëzet e katër prill dhe se sa thellësisht i interesuar jam unë të shoh parimet e paqes së vërtetë të zbatuara me besnikërinë më të madhe.

Me nxitimin më të pashmangshëm

Sinqerisht i Juaji

Woodrou Wilson[117]

Gëzimin e madh për këtë letër të Presidentit Wilson e zbehu për Erickson-in, në një farë mënyre, një letër tjetër që Erickson-i mori nga Bordi Amerikan i Komisionerëve të Misioneve. Në kohën e Konferencës së Paqes, Erickson-i ende konsiderohej si përfaqësues i Bordit Amerikan. Bordi, në fakt, kishte pak dijeni ose nuk e kuptonte veprimtarinë e Erickson-it në Paris. Prandaj e instruktoi atë të hiqte dorë prej punës së tij atje dhe të kthehej në ShBA bashkë me familjen e tij. Megjithëse Erickson-i në fillim u mërzit pa masë prej kësaj letre, ai nuk kishte aspak ndërmend të bindej, pasi ai besonte se puna e tij në Konferencën e Paqes ishte e dobishme, jo vetëm për Shqipërinë, por gjithashtu edhe për statusin

[117] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

e ardhshëm të Bordit Amerikan në vendin tonë. Megjithëse rregullat e Bordit Amerikan ndalonin çfarëdolloj veprimtarie politik, Erickson-i theksoi se rrethanat e këtij çasti të veçantë në historinë e Shqipërisë, kërkonin prej tij të ndërhynte në mënyrë energjike në çështjen shqiptare. Me fjalë shumë miqësore, Erickson-i i shpjegoi Bordit Amerikan:

> *"….Se vendimi për të qëndruar në Paris ishte një vendim vetjak dhe jo një subjekt i konsideratës së tyre dhe se "Ne po jetojmë në kohë kritike, kur rregullat dhe rregulloret që qeverisin në kohë të zakonshme nuk mund të zbatohen dhe secili prej nesh duhet të pranojë atë detyrë e cila i parashtrohet…"*

Me keqardhje të madhe, Erickson-i paraqiti dorëheqjen duke i bashkëngjitur një kërkesë për një seancë të plotë dëgjimore rreth veprimeve të tij në Konferencën e Paqes kur të kthehej në Shtetet e Bashkuara. Duket se Bordi e pranoi letrën e Erickson-it për dorëheqje; duke mos qenë më anëtar i Bordit, ai ishte i lirë t'i përkushtohej pa asnjë rezervë shërbimit ndaj popullit shqiptar.

Por le të kthehemi tek letra e Presidentit Wilson. Katër ditë pas marrjes së kësaj letre kaq miqësore prej tij, delegacioni italian botoi një memorandum që i ishte dërguar z.Orlando, shef i delegacionit. Memorandumi ishte dërguar disa kohë para se të botohej në Paris Memorandumi për Shtyp i Presidentit Wilson, i datës 23 prill 1919. Në të gjendej edhe kjo frazë befasuese, e cila i shtangu të gjithë anëtarët e delegacionit shqiptar:

> *"Unë besoj se do të ketë një marrëveshje të përbashkët që ishulli i Sazanit[118], t'u jepet italianëve dhe ajo të mbajë edhe portin e Vlorës".[119]*

> *"Ne u stepëm prej daljes në publik të kësaj letre personale të Presidentit drejtuar Orlandos. Nëse ajo zbatohej, do ta kthente memorandumin e vet mbi Adriatikun, i cili dukej se premtonte kaq shumë për ne, në një letër pa vlerë. Çfarë tragjedie ishte që Presidenti Wilson nuk kishte patur një këshilltar personal europian në të kaluarën*

[118] Lissas në origjinal.

[119] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

e tij, i cili të kishte përvojë diplomatike e politike dhe të njihte filozofinë e tyre makiaveliste, e pashfaqur ndonjëherë në formë të tillë, me kaq qëllime të mbrapshta sa tani në Konferencën e Paqes në Paris.

Përshtypja e parë që patëm ishte se kjo ndoshta ishte një përpjekje për të zvogëluar efektin e ashpër të Memorandumit mbi Problemin e Adriatikut, të cilin Presidenti e kishte botuar dhe që italianët nuk e kishin gëlltitur dot.

Ky mund të ishte njëfarë shpërblimi i tij ndaj Italisë nëse ata do të hiqnin dorë nga pretendimet e tyre në Fiume. Do të ishte Vlora, pra, "Porta për në Ballkan", me një popullsi prej afro njëqind për qind shqiptare, që do t'i dorëzohej asaj si kompensim. Ky ishte një veprim kaq i zgjuar, i bërë nga një mendje femër, makiaveliste, kaq kontradiktore ndaj gjithçkaje që bënte Presidenti Wilson, saqë i vetmi përfundim që mund të nxirrnim ishte se ai kishte luajtur naivin në mënyrën më të zgjuar.

Këtu është edhe çelësi i tërë kësaj. Ishte çështja Fiume ajo që mbante peng punën e tërë konferencës. Sa më shumë të shtyhej zgjidhja e çështjes së saj, aq më e rrezikshme bëhej situata. Ajo mund të shpinte krejt lehtë në një luftë tjetër. Sazani i duhej dhënë Italisë gjithsesi, për shkak të rëndësisë strategjike që kishte për të. Ballë për ballë me të shtrihej porti primitiv i Vlorës, i cili po të pushtohej nga fuqitë e huaja, Jugosllavia për shembull, do t'i vinte të dyja ato vende të pasura përballë njëra-tjetrës në një largësi prej nga plumbat e pushkëve të secilës e arrinin njëri-tjetrin. Shqipëria vetë nuk do të ishte e zonja ta mbronte atë.

Po të marrim parasysh faktin se për të "shpëtuar fytyrën", Italisë i duhej të merrte kontrollin mbi ngushticën e Otrantos, atëherë e tërë çështja e Adriatikut, e cila ishte si një gjemb në këmbën e konferencës, duhej zgjidhur me një të rënë të lapsit. E zgjuar, djallëzisht e zgjuar! Kjo zgjuarsi e gjarprit ishte brenda saj madje bashkë me helmin. Ky nuk ishte asgjë tjetër përveçse një komplot i hartuar në një mënyrë dhelparake, për ta futur në shtëpi, nëpërmjet derës së pasme, të njëjtin Traktat të fshehtë, të cilin Presidenti Wilson e kishte deklaruar "Një letër pa vlerë".

I ripunuar, i trajtuar pak ndryshe, i pastruar, i lustruar, tani ky propozim na paraqitet si i mirë, pajtues, si zgjidhja më e mirë. Presidenti Wilson nuk kishte kohë të merrej me çdo gjë. Prandaj ata besonin se hileja e tyre do të fitonte. Po të bëhej kështu, Italia sigurisht që do të futej edhe brenda tokave të vendit. Por, sapo ajo ta bënte këtë, do të ngriheshin Jugosllavia dhe Greqia me pretendimet e veta.

Duke ndier rrezikun e menjëhershëm që iu kanosej shpresave dhe planeve tona, ne iu përveshëm punës për të hartuar një përgjigje, duke mos pritur as për të ngrënë mëngjesin. E keqja ishte se propozimi ishte dërguar me emrin e Wilson-it. Prandaj edhe përgjigjja duhej drejtuar pikërisht tek ai vetë. Dhe kjo po ndodhte ende pa u tharë mirë boja që ai kishte hedhur në letrën e tij për ne, disa ditë më parë. Në të kishte dinamit.

Nëse atij nuk do t'i pëlqenin ato që do të thoshim ne, ai edhe mund të kthehej kundër nesh dhe çdo gjë do të merrte fund. Po të humbnim atë mik, atëherë çdo gjë do të ngecte. Gjithsesi ne thamë se duhej marrë rreziku në sy. Dhe ashtu bëmë."

Shkëlqesisë së tij, Woodrow Wilson

President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Zotëri,

Delegacioni shqiptar iu është shumë mirënjohës për letrën tuaj aq të bukur të datës 25 prill dhe për sigurimet që Ju përsëri dhatë rreth qëllimeve tuaja për të vazhduar me vendosmërinë më të madhe përpjekjet për arritjen e një paqeje të përhershme. Duke njohur sinqeritetin tuaj rreth këtij qëllimi dhe qartësinë me të cilën ju i shihni kushtet qenësore për arritjen e një paqeje të tillë, ne guxojmë të sjellim në vëmendjen tuaj edhe një herë çështjen e Vlorës. Në Memorandumin e botuar në gazetat e mëngjesit të datës 30 prill ju deklaroni:

"Unë besoj se do të ketë një marrëveshje të përbashkët që ishulli i Sazanit t'u jepet italianëve dhe ata të mbajë edhe portin e Vlorës".

Ne habitemi, z.President, se si mund të jeni tradhtuar kështu kur përgatitët një deklaratë të tillë!

Kjo është kaq në kundërshtim me atë që keni deklaruar më parë, sa ne besojmë plotësisht se, po të mos ju ishin paraqitur argumente tërësisht të tjera, të kundërta me ato që ju bënë juve të lëshonit deklaratën e mëparshme, ju kurrë nuk do të kishit bërë këtë të sotmen. Kjo është në kundërshtim me tërë idealet e larta dhe parimet tuaja fisnike ndaj kauzës së drejtësisë njerëzore, të cilën ju e keni mbrojtur me kaq guxim dhe burrëri përpara botës.

I.- Parimi i nacionalitetit dhe e drejta e çdo kombi për të përcaktuar fatin e vet.

Vlora dhe tokat përreth saj, përfshirë ishullin e Sazanit, të cilin Italia e ka lakmuar sipas Traktatit të fshehtë të Londrës të vitit 1915, është e tëra e populluar me shqiptarë dhe aty nuk ka asnjë këmbë të huaji përveç ushtarëve dhe oficerëve italianë që venë e vijnë. Nën pushtimin italian ndoshta gjenden njerëz që thonë të kundërtën, por ato janë po aq të vërteta sa ç'mund të jetë një deklaratë e nënshkruar me pistoletë të drejtuar në ballë.

II – Parimet e moslejimit të kombeve të fuqishme për të shtypur dhe shkelur dëshirën e kombeve të vogla.

Vlora është porti kryesor i Shqipërisë (në fakt i vetmi port i mirë i Shqipërisë). Prapa saj gjenden dy pasuritë më të mëdha që ka Shqipëria sot, me aq sa dihet: depozitat e vajgurit, një minierë e madhe bitumi dhe një fushë shumë e gjerë dhe aq pjellore, sa të ushqejë tërë popullsinë e Shqipërisë dhe madje edhe të eksportojë drithëra. Nga ana tjetër, nëse Italia lejohet të kontrollojë doganat e këtij porti, kjo do të thotë shkatërrim i plotë ekonomik i një shteti të tillë të vogël e të varfër.

III.- Parimet e mbrojtjes së demokracisë kundër imperializmit.

Italia nuk i ka fshehur pretendimet e saj imperialiste në Ballkan. Gjatë pushtimit të saj ushtarak ajo ka marrë përsipër të luajë atë rol që kanë luajtur Austria dhe Rusia më parë. Ajo është përpjekur ta italianizojë Shqipërinë sipas metodave të mëposhtme:

1.- Ka hapur 200 shkolla italiane dhe ka ndaluar shkollat kombëtare, njësoj siç kishte bërë Turqia, jo shumë kohë më parë.

2.- Ka filluar ndërtimin e një hekurudhe italiane, që shkon nga Vlora në drejtim të Lindjes, pa pajtimin e popullatës vendase.

3.- Është përpjekur të japë me qira ose të shesë tokat publike të Shqipërisë, çfarë përbën një veprim me qëllime tërësisht kolonizuese.

4.- Ka ndërtuar një administratë civile italiane anembanë vendit.

5.- Nuk ka lejuar ngritjen e një force policore vendase, që të stërvitet dhe të sigurojë rendin e qetësinë.

6.- Ka përvetësuar pasuritë publike, si për shembull, hekurudhat e ndërtuara prej austriakëve, duke mos dhënë asnjë llogari për to.

7.- Ka krijuar shërbimin e vet të Postë-Telegrafit dhe një sistem monetar.

8.- Është përpjekur të nxisë trazira midis popullatës së krishterë dhe asaj muhamedane, në atë mënyrë që secila palë të kërkojë mbrojtje prej saj.

Të gjitha këto kanë shkaktuar zemërim masiv në tërë vendin dhe ne nuk e dimë nëse ju keni konstatime të bazuara nga burime të besueshme apo jo.

Sa i takon Vlorës, duke ditur etjen e Italisë për t'i zgjeruar kufijtë e saj drejt Lindjes, Shkëlqesia Juaj e ka rrëzuar një herë në mënyrën më të admirueshme kur keni argumentuar çështjen e Fiumes.

Në fakt, kjo e bën dy herë më bindëse çështjen e Vlorës. Fiume ka një popullsi të

madhe italiane, ndërsa Vlora nuk ka asnjë. Në Fiume, çfarëdolloj problemi të paraqesin të mbeturit e Perandorisë Austro-Hungareze dhe Jugosllavisë për Italinë, ata janë më të afërmit e saj dhe gjenden tek dera e saj e pasme, ndërsa Vlora nuk ka asnjë lidhje me të. Ajo nuk ka absolutisht asnjë arsye që të frikësohet prej Shqipërisë, madje kjo e fundit mund të shërbejë si zonë e largët mbrojtëse ndaj ndonjë rreziku që mund t'i kanoset asaj. Në anën tjetër, nëse italianët mbeten në Shqipëri, ata menjëherë do të sfidojnë tërë Ballkanin, do të nxisin tërë antagonizmat, do të prishin baraspeshën, si një fuqi e madhe në mes të një kombi të vogël, duke krijuar të njëjtin problem që dikur kishte krijuar Turqia dhe duke sjellë të njëjtin çrregullim dhe mallkim që e ka shoqëruar Ballkanin ndër shekuj.

Për më tepër, problemi që ju ngrini në lidhje me Fiumen, si një nevojë për vendet të cilat mbeten mbrapa, si Hungaria dhe Bosnja, pa dalje në Adriatik dhe në Mesdhe, ngelet edhe më i pazgjidhur nëse Italia merr Vlorën. Pavarësisht çfarë portesh do t'u jepen këtyre popujve, me Vlorën dhe ngushticën e Otrantos nën kontrollin e Italisë, deti Adriatik do të kthehet menjëherë në një "liqen italian", ashtu, sikundër italianët, në dritëshkurtësinë e tyre, kërkojnë ta bëjnë atë. Italia bëhet drejtpërsëdrejti një sfiduese e tërë këtyre popujve nga veriu dhe lindja, sikundër edhe ndaj shteteve ballkanike dhe krijon po atë problem në Adriatik që dikur Kostandinopoja dhe Bosfori kishin krijuar për sllavët. Veprime të tilla nuk garantojnë as paqen më të përkohshme e jo më pastaj atë të përhershme.

Por ka edhe një vlerësim tjetër për këtë. Tërë kombi shqiptar njëzëri ka një kërkesë: Traktati i Londrës i vitit 1913 ka lënë më shumë se gjysmën e territorit të saj të ligjshëm, me një popullsi 90 për qind shqiptare, në duart e Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë. Kështu, afër një milion shqiptarë mbetën jashtë kufijve në kundërshtim me tërë të drejtat e shenjta dhe vullnetin e kombit të vet. Nëse drejtësia do të vihet ndonjëherë në vend, nëse interesat e kombeve më të vogla "tani e tutje do të ruhen me ndershmëri si dhe të drejtat e atyre më të fuqishme", atëherë këto territore dhe popullata që jeton në to duhet të kthehen aty ku e kanë vendin, sipas dëshirës së vetë popullit.

Por nëse Italia lejohet të qëndrojë në Vlorë, për arsye që Konferenca e Paqes i vlerëson më shtrënguese se të drejtat kombëtare, atëherë këto arsye nuk mund të kërkohen dhe as të gjenden më as në Jugosllavi, as në Greqi, të cilat jo vetëm mbajnë territore të cilat nuk janë të tyret, por kërkojnë edhe shumë të tjera, siç janë Korça dhe Gjirokastra, për Greqinë, dhe Shkodra për Jugosllavinë. Ju do të gjeni tek këto fakte, z. President, se sa jetike është Vlora për Shqipërinë dhe do të kuptoni se shqiptarët janë të vendosur të bëjnë qëndresë me çdo kusht për të mos ia dorëzuar Vlorën Italisë.

Në emër të këtij kombi të vogël, i cili ka qëndruar kaq shumë përkundër padrejtësive shekullore që i janë bërë, duke mos patur miq apo mbrojtës midis kombeve të tjera, ne, përfaqësuesit e tij, ju përgjërohemi juve që të përdorni personalitetin Tuaj të fuqishëm, jo vetëm për ta mbrojtur atë nga poshtërimi dhe shkatërrimi i mëtejshëm, por ta ndihmoni atë në fillimin e realizmit të ëndrrës së tij për një të ardhme fisnike.

Ne jemi, Shkëlqesia Juaj

Shërbëtorët Tuaj të bindur dhe plot nderim

Nënshkruar:

Mehmet Konica

Mihal Turtulli

Charles Telford Erickson.[120]

Në këtë kohë vërshuan memorandume nga tërë anët, duke filluar nga Federata

[120] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

Panshqiptare Vatra e Amerikës, kolonitë shqiptare në Zvicër, Rumani, Turqi. Atyre iu bashkua Herbert Adams Gibbons-i[121], korrespondenti i veçantë i Associated Press, i cili i dërgoi Presidentit Wilson një telegram shumë të gjatë. Kështu bënë edhe shumë të tjerë. Më në fund, duket se gjithçka u zbut dhe nuk u dëgjua më asgjë në lidhje më këto pretendime.

Ndërkohë duket se po i vinte koha Lidhjes së Kombeve. Kjo solli një kokëçarje tjetër për shqiptarët dhe delegacionin e tyre. Një prej propozimeve të para që iu rekomandua Lidhjes kishte të bënte me Shqipërinë. Ishte Këshilli i Lartë që i propozoi Italisë që të zbuste ndjenjat e saj të egërsuara nga shkeljet e vazhdueshme. Ky propozim ishte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me të tëra pikat e Lidhjes të vendosura në dokumentin e saj themeltar dhe pikërisht:

> *Neni XXII: Paragrafi 4. Bashkësi të caktuara, të cilat më parë i takonin Perandorisë Osmane, kanë arritur në një stad të tillë zhvillimi ku ekzistenca e tyre si shtete të pavarura mund të njihet paraprakisht si subjekt i tillë, ku t'u jepen këshilla dhe asistencë administrative prej një mandatari, derisa të vijë koha kur ato të qëndrojnë në këmbët e veta. Mandatari mund të zgjidhet vetëm në bazë të dëshirës së vetë këtyre bashkësive[122].*

Duke parë kundërshtinë me nenin e mësipërm, unë e krahasova deklaratën e Presidentit Wilson, e cila kishte tundur botën, në kontrast me të dhe prita me shpresën e madhe që ai ta drejtonte edhe një herë botën drejt shtegut të paqes. Ja edhe deklarata e tij:

> *"Asnjë popull nuk mund të detyrohet të jetojë nën sovranitetin e një populli tjetër, me të cilin nuk dëshiron të jetojë. Asnjë territor nuk duhet të ndërrojë dorë, përveçse kur ka për qëllim t'u sigurojë atyre që banojnë aty një mundësi të plotë jete dhe lirie. Nuk ka paqe që zgjat ose që duhet të zgjasë, e cila nuk njeh dhe nuk pranon*

[121] Herbert Adams Gibbons ishte gazetar dhe korrespondent i huaj. Ai raportonte nga Greqia, Spanja, Turqia dhe vende tjera të Lindjes së Mesme dhe në kohë të ndryshme shërbeu për agjenci të ndryshme informacioni. (Shënimi im – MB)

[122] The Covenant of the League of Nations.

të njohë parimet se e tërë fuqia e drejtësisë së qeverive rrjedh tek miratimi i saj prej të qeverisurve dhe se nuk ka të drejtë që ekziston në botë që i kalon popujt nga një sovranitet në një tjetër, si të ishin pronat e dikujt. Çfarëdo paqeje që nuk i njeh dhe nuk i pranon këto parime, nuk ka të ardhme."[123]

Vendosini këto dy deklarata pranë e pranë, bashkë me veprimin e Këshillit të Lidhjes së Kombeve, që i ofroi Italisë Mandatin mbi Shqipërinë, dhe përpiquni që t'i kuptoni!

E vërteta mbi këtë çështje është se Konferenca e Paqes kishte hyrë në një rrugë tërësisht pa krye. Të shohim më së pari "malin" me delegacione dhe përfaqësues nga më shumë se pesëdhjetë kombe nga tërë anët e botës

Grupe pa fund kërkuesish, gjeografësh, historianësh, etnografësh, specialistësh në një numër të madh fushash, propagandistë dhe politikanë, që fusnin hundët kudo që mundeshin, duke mbushur plot e përplot zyrat, korridoret, të shpërndarë kudo e në çdo rrugë, bulevard, kafene, teatro, kinema, nëpër taksi, tramvaje, trena nëntokësorë, gjendeshin pa fund nëpër tërë qytetin e Parisit. Kudo që të shkoje, ata ishin të pranishëm. Thuhej se një mijë syresh ishin punësuar vetëm në Departamentin e Shteteve të Bashkuara. Një numër i pafund "komisionesh", për të studiuar këtë apo atë çështje, ishin krijuar si një laborator i madh ku tavolinat, mikroskopët, mostrat dhe një ushtri njerëzish ishin vënë në punë në një formë të zhurmshme, ku secili studionte mostrën e vet. Ata kishin krijuar një pamje të tillë rreth vetes, sa dukej se e tërë bota e kishte ndalur frymën aty, derisa ata të shqiptonin fjalët magjike që do të tronditnin botën me zbulimin që kishin bërë. Dhe më në fund:

"U mbars mali, polli një mi".

Ndërkohë, bash në majë të atij mali të largët, sa një objekt astronomik, qëndronte një kullë e fildishtë me katër "të pavdekshmit" olimpikë me pamje hijerëndë:

[123] Po aty.

Ja tek na hedhin ata ca dritë nga veriu dhe na del Finlanda; më pas shohin nga Kina dhe Paqësori Jugor, pastaj Afrika, Palestina, bota arabe… Ja tek është Rusia, si një pullë e madhe e zezë në hartë, që përpiqet të mbulojë, të ngrohë, klloçitë dhe nxjerrë në dritë disa lloje vezësh si republika të reja. Pastaj, sapo t'ia ketë arritur kësaj, e kthen teleskopin drejt Adriatikut dhe një pikë e errët, e vogël vihet re në lente:

"E kush është ajo?", Pyet njëri prej këtyre të Olimpit.

"Eh ajo është Shqipëria"- përgjigjet tjetri.

Pastaj tjetri që thotë:

"Mos dëgjova dikë që tha 'Mallkuar'"?!

Nganjëherë habitem se përse detyrohem t'u kushtoj vëmendje atyre modeleve, të cilave këta "*të pavdekshëm"* në kullën e tyre të fildishtë zhvilluan për një botë të re, të guximshme, ku tërë popujt e vegjël do të kishin vendin e tyre nën një diell dhe të ngroheshin nën rrezet e tij dhe të merrnin dhuratat e tij, ndërkohë që Fuqitë e Mëdha do të uleshin vëllazërisht në botën e tyre të rehatshme të Lidhjes së Kombeve, ku do të flisnin dhe këndonin së bashku himnin e tyre ndërkombëtar:

"Paqe, paqe e përsosur"[124];

Unë habitem nganjëherë kush ishte ajo, cila fuqi, çfarë autoriteti, çfarë hyjnie i ktheu sytë dhe zgjodhi atë model, që pastaj ta thërrmonte me duart e veta, ta hidhte poshtë tek këmbët, ta pështynte dhe lehtë e pa dhimbsuri ta shkelte me këmbë? A ishte ai që i ka thënë këto fjalë?

"Le ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë e në ngjasim me ne[125]*… Dhe Zoti pa gjithçka që Ai kishte krijuar dhe, ja, ishte shumë mirë"?*

---

[124] Eduard H. Bickersteth, Jr., 1875, i ka shkruar fjalët e këtij himni, i cili është marrë nga Bibla dhe përmban ndoshta fjalët e fundit të dëgjuara prej Jezusit, para se ai të thërriste "Drejt paqes së përsosur të qiellit." (Shënimi im – MB)

[125] Marrë nga Bibla, Zanafilla 1:26

Historia na ka mësuar se AI është më kërkues sesa sundimtarët e kullës së fildishtë, të cilët vizatojnë hartat e botës së Tij, duke zgjedhur për veten e tyre pikat ku vërshimet e lumenjve sjellin thesare të tjera të dhuruara prej Zotit, për të përmbushur kënaqësitë e tërë njerëzve të bekuar prej tij. Ai nuk i pëlqen njerëzit e babëzitur, as njerëzit me vese, as ata që përfitojnë prej privilegjeve të tij dhe që luajnë me zotat në kullën e tyre të fildishtë. Kur ai e zgjodhi të kishte shoqëri me fëmijët e vet në tokë, unë mendoj se ngjet më shumë se iu thoshte lajmëtarëve të vet: "Lëreni poetin Pindar[126] të shkojë tek Darka e Zotit; lëreni Sokratin në zgjuarsinë e tij të thjeshtë tokësore; lëreni Galileun me shpikjet e tij; lëreni Wendell Willkien-in[127] të mbështjellë në ëndrrën e tij!

Po! Unë mendoj se AI do ta kishte shqyer, grimcuar dhe pastaj pështyrë atë hartë me neverinë më të madhe, siç thotë Richard Rumboldi[128], nga Podi i Ekzekutimit.

> *"Kurrë nuk do ta kisha besuar se Perëndia ka dërguar ca njerëz në këtë botë, të ngrefosur, të gatshëm për të kalëruar dhe për të shkelur sipër miliona njerëzve të tjerë, të gatshëm për t'u shaluar dhe ngarë me romuzin dhe yzengjitë e këtyre shtypësve."*[129]

[126] Pindar (522–443 p.e.s.), poet lirik i njohur si poeti më i madh grek, që ka frymëzuar madhështinë, bukurinë dhe mendimin e figurave më të larta pasardhëse të tij. (Shënimi im – MB)

[127] Wendell Lewis Willkie (1892 – 1944), një jurist amerikan korporatash, ish-kandidat për president për ShBA-në në vitin 1940. Ai ishte ambasador i deleguar i Presidentit Roosevelt. Ai solli vizionin e quajtur për një "Një botë" të lirë prej imperializmit. (Shënimi im – MB)

[128] Richard Rumbold (1622–1685), një ushtar i Kromuellit, i cili mori pjesë në komplotin për të vrarë Charls-in II të Anglisë. (Shënimi im – MB)

[129] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

DITËT E KONFERENCËS SË PAQES NË PARIS, 1919

Erickson-i besonte se një numër më i madh i përfaqësuesve shqiptarë ishte i rëndësishëm për të ardhmen e çështjes së Shqipërisë në Konferencën e Paqes. Prandaj, gjatë njërit prej diskutimeve me dr. Clive Day, ai i sugjeroi atij se Hasan Prishtina mund të ftohej në Paris, duke veshur rrobën e një shefi shqiptar, me qëllim që të përfaqësonte banorët e maleve të Veriut të Shqipërisë, duke përfshirë territore të cilat i ishin dhënë padrejtësisht Serbisë dhe Malit të Zi në vitin 1913. Dr. Day, i impresionuar nga Erickson-i, e përshkroi atë si

> *"…një njeri i besueshëm, inteligjent dhe që lufton me forcë që Shqipëria të bëhet më në fund një vend i pavarur."*

Megjithëse Erickson-i vazhdonte të bisedonte me shumë anëtarë të delegacionit amerikan, ai kuptonte për ditë e më shumë se ata ishin ose të paditur, ose të painteresuar për Shqipërinë, një komb fati i të cilit po vendosej bazuar në mënyra shumë të fshehta. Në një bisedë me njëfarë C. Wright, Erickson-i arriti të kuptonte se ai punonte në dëm të interesave të Shqipërisë dhe ishte pjesë e një komploti të thurur prej Greqisë dhe Italisë, në të cilin e dyta do të merrte tri qytete: Delvinën, Tepelenën, Përmetin dhe krahinën e Gjirokastrës.

Marrëveshja e fshehtë që po qarkullonte në Paris ia forcoi Erickson-it pikëpamjen se një "Mandat amerikan" për Shqipërinë ishte e vetmja zgjidhje e mundshme e problemit shqiptar. Por Erickson-i ende nuk e dinte se disa prej deklaratave të tij ishin përfshirë prej Lybyer-it në një Memorandum të Politikës Ballkanike të Presidentit Wilson. Si rezultat i ditëve të kaluara në Konferencën e Paqes, Erickson-i kishte fituar një vlerësim të thellë për larminë e presionit politik dhe kompleksitetin me të cilin ballafaqohej Wilson-i. Në një përpjekje për t'i dhënë Presidentit disa mundësi për veprim në lidhje me situatën shqiptare, Erickson-i i bashkëngjiti një *addendum*, një shtojcë letrës së tij, duke i sugjeruar një plan alternativ, i cili mund t'i ofrohej Presidentit, në qoftë se Fuqitë e tjera të Mëdha nuk pajtoheshin me "Mandatin amerikan" për Shqipërinë.

> *"…Liga e Kombeve supozon se një mandat mbi Shqipërinë në territorin në diskutim përfshin Vlorën dhe emërimin e një komisioneri të lartë për të administruar territorin. Për arsye të qarta ai duhet të jetë një mandat amerikan"*[130].

Në rrjedhë të zhvillimeve të konferencës, Erickson-i i qëndronte idesë se ShBA-ja, duke mos patur interesa vetjake mbi Shqipërinë, ishte shteti më i pranueshëm për të marrë një mandat mbi Shqipërinë – një mandat i cili nuk do të haste në kundërshtime të forta nga kombet e tjera. Pas konsultimeve edhe me kolegët e tij shqiptarë, Erickson-i përpiloi një memorandum të titulluar: "Gjashtë arsyet përse Amerika duhet të bëhet mandatore për Shqipërinë"[131]

Duke ditur se koha po kalonte shpejt, ai ende shpresonte të bindte delegacionin amerikan për përgjegjësinë e vendit të tij për një paqe që do të zgjaste në Ballkan. Për rrjedhojë, ai iu kujtoi delegatëve në memorandumin e tij se hyrja e ShBA-së në luftë ishte bazuar mbi parime morale.

> *"Një prej këtyre parimeve ishte legjitimimi i së drejtës së kombeve të vogla dhe të dobëta për t'u mbrojtur nga të fortët."*

[130] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.
[131] Po aty.

Në këtë memorandum, Erickson-i u përqendrua në parimet e mëposhtme të çështjes së pazgjidhur shqiptare:

Që parimet nuk do të zbatohen ndaj Shqipërisë veç nëse Amerika i merr në dorë ato. Në vend të kësaj, do të vihet në jetë Traktati i Londrës. Vlora, me pjesët e brendshme, do t'i jepet Italisë, ndërsa Greqisë dhe Serbisë do t'u jepeshin territore shtesë, duke lënë një zonë të vogël neutrale në Shqipërinë Qendrore me më pak se një të tretën e territorit dhe popullsisë së saj, që do të shërbenin si zonë "ndërmjetëse" midis këtyre shteteve Erickson-i besonte se fati i popullit shqiptar varej nga integriteti i përfaqësuesve amerikanë në Paris dhe sa këta do të ruanin të drejtat e shqiptarëve për të ekzistuar si kombi i lirë.

> **"***Nëse ne tërhiqemi prej përgjegjësive të mëtejshme në rindërtimin e botës, atëherë ajo që do të lëmë nga idealet tona të luftës do të jetë humbje e madhe."*[132]

Duke parë përpara, Erickson-i besonte se, nëse Amerika do të pranonte sfidën e një *"Mandati mbi Shqipërinë"*, atëherë jo vetëm që ajo do të nxisë marrëdhënie midis grupeve ballkanike, por, gjithashtu, suksesi i saj, në të cilën një sipërmarrje paqeruajtëse do të nxiste të ardhmen e përpjekjeve diplomatike amerikane midis kombeve të tjera të botës, ishte i sigurt. Erickson-i, duke patur një ide të qartë të marrëdhënieve jetike midis politikës së jashtme amerikane dhe investimeve të huaja amerikane, nënvizoi tek delegacioni amerikan se Shqipëria nuk ishte një vend djerrë. Investimet amerikane në burimet natyrore të Shqipërisë mund të hapnin rrugën për përfitime të ndërsjella, ku fitonin edhe shqiptarët, edhe investitorët amerikanë.

Diku nga fundi i prillit 1919 delegacioni shqiptar vendosi ta dërgonte Erickson-in në ShBA, me qëllim që të vlerësonte qëndrimin e përgjithshëm të Komitetit të Marrëdhënieve me Jashtë të Senatit edhe për çështjen shqiptare, edhe për "mandatin e propozuar". Shpresohej se Komiteti i Marrëdhënieve me Jashtë do të ulte presionin e menjëhershëm të Konferencës së Paqes. Përpara se të nisej për

[132] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 4.

në Amerikë, Erickson-i, në një letër që i drejtoi Presidentit Wilson, i bënte të qartë qëllimin e misionit të tij në Uashington:

> *"Unë shpresoj të nisem për në Amerikë brenda disa ditëve, për të bërë gjithçka që mundem për të ndriçuar opinionin publik dhe senatorial mbi situatën në Ballkan dhe të siguroj mbështetje për Mandatin Amerikan mbi Shqipërinë. Unë besoj në atë që bëj, por nuk shkoj kundër dëshirave tuaja."*

Ai shkoi në Uashington. Gjatë qëndrimit atje ai kërkoi takime me shumë anëtarë të Komitetit të Marrëdhënieve me Jashtë. Gjatë një takimi me një senator, ai mësoi prej tij se sa i paditur ishte ai kur deklaroi se:

"…të gjithë njerëzit në Ballkan janë sllavë ose flasin gjuhën sllave." Më poshtë po sjellim debatin e Erickson-it në Komisionin e Marrëdhënieve me Jashtë të Senatit Amerikan:

> KRYETARI. Z. Erickson, unë do të doja të bëja një pyetje. Çfarë janë shqiptarët, etnikisht? Ju flisni për ta sikur të kenë qenë aty përpara të gjitha racave të tjera. Çfarë janë ata?
>
> Z.ERICKSON: Z. Kryetar, etnologët dhe antropologët nuk janë plotësisht të të njëjtit mendim në lidhje me origjinën e shqiptarëve, por janë praktikisht të një mendimi se ata përbëjnë një mbetje të racës pellazge, e cila ndërtoi blloqet e mëdha të gurta në Ballkan, se pas ardhjes së tyre ata ishin në tri degë.
>
> KRYETARI. Atëherë, ata janë arianë?
>
> Z.Erickson: Po. Epirotët, maqedonasit dhe ilirët flisnin të gjithë gjuhë të njëjtë ose degë të së njëjtës gjuhë.
>
> KRYETARI. Gjuha e tyre është me prejardhje ariane.
>
> Z. ERICKSON. Po, me një strukturë si latinishtja. [133]

[133] Albania: Statements of – Ch. Telford Erickson 971 C. A. Chekrezi 1001 C. A. Dako 1005: Titulli: Treaty of Peace with Germany: Hearings before the Committee on Foreign Relations, United States Senate, sixty-sixth Congress, first session on the Treaty of peace with Germany, signed at Versailles on June 28, 1919, and submitted to the Senate on July 10, 1919, by the President of the United States: Published by: Government Printing Office, Washington 1919.

Erickson-i doli tmerrësisht i zhgënjyer nga rezultati i këtyre takimeve. Jo vetëm që shumica republikane në atë komitet e kundërshtonte përfshirjen e ShBA-së në Lidhjen e Kombeve dhe përpjekjet e momentit të bëra nga Presidenti Wilson, por gjithashtu shumë prej tyre nuk ishin as të informuar dhe as të interesuar për Ballkanin. Kuptohet se sa ishin ata të interesuar për çështjen shqiptare. Por Erickson-i nuk ishte nga ata që dorëzohej.

Pasi gjeti pak ose aspak interes apo mbështetje në Uashington, Erickson-i u kthye në Paris dhe iu bashkua përsëri delegacionit shqiptar. Ai pa se gjatë kohës që kishte qenë në Uashington, fuqitë europiane i kishin shtuar përpjekjet për ndarjen e Shqipërisë. Në fillim të dhjetorit të vitit 1919, përfaqësuesit britanikë, francezë dhe amerikanë në Këshillin e Lartë, kuptuan se ajo çfarë ishte përfolur si zgjidhja e çështjes shqiptare nuk ishte gjë tjetër veçse *Një mandat italian mbi Shqipërinë* dhe dhënie asaj e sovranitetit mbi Vlorën. Erickson-i u zhgënjye nga kjo kthesë e menjëhershme e ngjarjeve. Në fakt, fuqitë europiane kishin përfituar nga ai moment në Konferencën e Paqes kur Presidenti Wilson ishte kthyer në vendin e tij. Prestigji i Presidentit në Konferencë po zbehej, pasi shumë çështje kishin mbetur të pazgjidhura. Tani filloi të dukej sikur Shqipëria nuk ekzistonte fare si komb. Erickson-i nuk i lejoi vetes të pranonte faktin e hidhur se koha dhe puna e delegacionit shqiptar kishte shkuar më kot. Por, në një mënyrë apo në një tjetër, duhej të gjendej një rrugë për të patur një rezultat pozitiv. Por si duhej bërë kjo?

Një ditë për habinë e Erickson-it u përhap lajmi se Presidenti Wilson kishte ndërmarrë një hap të drejtpërdrejtë në drejtim të mbrojtjes së kombit shqiptar. Në një kabllogram të dërguar zotërinjve Lloyd George, Clemencau dhe Frank dhe Poll, në Konferencën e Paqes në Paris ai thoshte:

> *"As unë, as populli amerikan kurrë nuk do të pranojmë që populli shqiptar, i cili ka luftuar dy mijë vjet për lirinë e tij, të sakrifikohet për hir të ambicieve politike të fqinjëve të vet."* [134]

[134] Kjo thënje e Presidentit Wilson ishte motoja e shumë letrave që Erickson i dërgonte presidentëve dhe autoriteteve tjera në Amerikë, prandaj edhe është lënë ashtu siç i ka shkruar ai në këtë libër ndonëse është përsëritur disa herë. (Shënimi im – MB)

Erickson-i tani e mori vesh se puna e bërë si pjesë e delegacionit shqiptar nuk kishte shkuar më kot. Në vend të kësaj, ata kishin kontribuar në mënyrë qenësore për të sjellë Shqipërinë dhe çështjen e saj në vëmendjen e Wilson-it. Në këtë kohë, krenaria kombëtare e shqiptarëve ishte rritur mjaft, për t'u përdorur si një pasuri e fuqishme në procesin e ndërtimit të kombit kundër agresionit të vazhdueshëm të grekëve, italianëve dhe ushtarëve serbë. Ndikime të tjera mund të kenë patur rolin e vet, por ajo e Erickson-it me siguri që ndihmoi shumë. Në kontributin e tij, ai në mënyrë korrekte vlerësoi angazhimin serioz të Wilson-it ndaj parimeve të vetëvendosjes dhe të drejtën e kombeve të vogla. Robert Johnson thotë për Erickson-in:

> *"Është me rëndësi të njohim faktin se ishte një amerikan ai që e ndihmoi qeverinë e Shqipërisë në luftën e saj për njohje."*[135]

Por vetëm në rastin e një karakteri si Wilson-i mund të kishte sukses ajo që bëri Erickson-i, pasi ishte natyra idealiste e të parit ajo që bëri që kërkesat e drejta të të dytit të merreshin parasysh.

Shumë përfaqësues të kombeve të vogla vinin vërdallë korridoreve të Konferencës së Paqes, duke kërkuar të këmbenin një fjalë me ata, të fuqishmit, të cilët besonin se po vendosnin fatin e botës. Ishin pak ata zëdhënës të kombeve të vogla, të cilët përfaqësonin popujt që kishin kërkesa po aq të drejta sa edhe shqiptarët dhe që bënë përpjekje të jashtëzakonshme për të tërhequr vëmendjen e Presidentit të fuqisë më të madhe matanë detit, që ia dolën kësaj. Shqipëria ishte një prej rasteve të pakta ku morali i Wilson-it ishte i efektshëm. Shqipëria, nëse nuk arriti të përfitonte gjithçka që i takonte, të paktën ruajti atë territor që ishte njohur nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe shpëtoi nga copëtimi i parashikuar prej Traktatit të fshehtë të Londrës. Ky ishte një sukses i madh, i cili iu atribuohet dy amerikanëve, Wilson dhe Erickson: I pari për vendimet që mori dhe i dyti për dërgimin e çështjes shqiptare tek i pari. Merita e të parit është njohur përherë, ndërsa merita e të dytit thuajse asnjëherë.

[135] Robert Lee Wolff, "The Balkans in Our Times" (New York W.W Norton and Company, Inc) 1967.

NJË MANDAT AMERIKAN PËR SHQIPËRINË

Siç e thamë, mendja e Erickson-it punonte pandërprerë tek një Mandat Amerikan mbi Shqipërinë. Gjatë Konferencës së Paqes, por sidomos gjatë vizitës në Amerikë, ai i kushtoi rëndësi shumë të madhe këtij mandati. E çuditshme, siç mund të duket, kjo është krejt e vërtetë. Erickson-i, jo vetëm e hartoi tekstin e këtij mandati, por e botoi atë në shtypin amerikan dhe e propagandoi nëpër gazeta në ShBA. Mandati amerikan mbi Shqipërinë duhet t'i ketë ardhur në mendje Erickson-it për dy arsye:

E para, në kushtet e dëshpërimit, për shkak të lukunisë që e rrethonte Shqipërinë dhe, e dyta, se e shihte Amerikën si shpëtimtarin e vetëm të tërë tokave shqiptare dhe që shuante gradualisht dhe në mënyrë të plotë çdo lloj pretendimi ndaj Shqipërisë në kushtet kur mandatori i saj ishte ShBA-ja. Po të ndiqet rrjedha e veprimeve të Erickson-it, vlerësimet e tij mbi atë që bëri Italia, si një shtet i cili "përkujdesej" për Shqipërinë, me kreditë e mëdha krejtësisht të pakthyeshme dhe pretendimet e saj territoriale, me pushtimet që pasuan njëra-tjetrën që nga viti 1915, do të kuptohet edhe më mirë qëllimi i tij. Për ta kuptuar edhe më qartë qëllimin e tij, le të shohim tekstin e plotë të dokumentit të hartuar dhe propaganduar nga Erickson-i:

GJASHTË ARSYE PËRSE AMERIKA DUHET TË BËHET MANDATORE PËR SHQIPËRINË[136]

Charles Telford Erickson, Delegat nderi i Federatës Panshqiptare Vatra në Konferencën e Paqes

Paris, maj 1919

I. PARIMET MORALE

Amerika i hyri kësaj lufte dhe e zhvilloi atë bazuar thjesht mbi parime morale. Një prej këtyre parimeve ishte të përligjte të drejtën e kombeve të vogla, të mbronte të dobëtin ndaj të fortit. Ai parim nuk do të zbatohet ndaj Shqipërisë veç nëse Amerika do ta kërkonte këtë. Në vend të këtij parimi do të zbatoheshin dispozitat e Traktatit të fshehtë të Londrës. Vlora me tokat përreth saj, të dhëna Italisë, tokat e tjera Greqisë dhe Serbisë, duke lënë një zonë të vogël të paanshme në qendër të Shqipërisë me më pak se një të tretën e territorit dhe të popullatës së saj, për të shërbyer si një "zonë ndërmjetëse", midis shteteve, një gjë e papërdorshme, që nuk i duhet askujt, e gjymtuar, as krahinë, as shtet, as komb, një pre e intrigave, e fyer dhe në gjendje rebelimi në çdo anë të saj. Kështu raca shqiptare, e cila për më shumë se dy mijë vjet e ka ruajtur integritetin e saj territorial përballë forcave më të fuqishme që i kanë rënë Ballkanit kryq e tërthor, të ardhura nga çdo anë e globit, tani copëtohet dhe shkatërrohet pamëshirshëm.

II. NË INTERES TË NJË PAQEJE AFATGJATË DHE TË QËNDRUESHME

Konferenca e Paqes me Lidhjen e Kombeve ka fuqi të plotë për t'i çliruar pakicat nga pushteti i huaj, të vendosë vijat etnike, t'u japë fund ngatërresave ndërkombëtare, të paktën në territoret e shkatërruara prej luftës, përfshirë Ballkanin. Kjo është qartazi detyra e saj e lartë në interes të një paqeje të qëndrueshme, si dhe për të

[136] State Department Decimal File, 1910 – 1929 Doc 767.74.

përligjur të drejtën e vet për të gjykuar gabimet e të tjerëve. Italia, Greqia dhe Serbia, duke pushtuar territore të populluara 90 deri në 100 për qind me shqiptarë dhe të kundërshtuara me zemërim ndaj tyre dhe çdo sundimi tjetër të huaj, nëse ligjërohen dhe miratohen prej kësaj konference, do të dënohen prej gjykimit të shëndoshë moral të botës. Amerika nuk mund të jetë edhe besnike me vetveten, edhe të pranojë një Traktat të tillë Paqeje.

III. ËSHTË NJË THIRRJE SOS DREJTUAR AMERIKËS NGA NJË KOMB NË RREZIK.

I tërë kombi shqiptar i ka kthyer sytë nga Amerika me duar të zgjatura për të gjetur mbrojtje prej saj. Të refuzosh t'i përgjigjesh një thirrjeje të tillë është si të refuzosh të ndihmosh një anije që po mbytet. Amerika, pasi investoi njëzet miliardë dollarë dhe sakrifikoi qindra mijëra djem për kauzën e lirisë dhe të drejtësisë njerëzore, nuk mund të qëndrojë e të bëjë sehir kur sheh një "Shkatërrim të Lusitanis" si kjo, në të cilën një komb po zhytet në det dhe lëshohet drejt thellësive të vdekjes.

IV. PËRLIGJ IDEALET AMERIKANE

Europa nuk është krejt e bindur se ne nuk jemi një popull materialist, paradashës, i cili do të përdorte përparësitë e tashme për të arritur epërsinë tregtare ndaj botës. Mësimi ynë i thjeshtë në Kubë dhe Filipine është harruar në Europë dhe në qoftë se tërhiqemi nga përgjegjësitë e mëtejshme në rindërtimin e botës, ajo që kemi përftuar për idealet tona nga lufta do të zhdukej e tretej.

Në anën tjetër, bëhuni fuqi mandatore në Ballkan, aty ku Europa është grindur dhe ka bërë gafa që kanë mbjellë mospajtime dhe zemërim, mjerim dhe gjakderdhje! Çlirojeni kombin shqiptar, nxirreni atë nga fatkeqësia dhe padija drejt përparimit dhe mirëqenies dhe kurorëzojeni atë me bekimet më të bukura të botës. Vendosni harmoni dhe dëshirë të mirë për fqinjësi midis racave të Ballkanit, ndihmojini ata të shpëtojnë nga frika e përbuzja dhe të zënë vend midis shoqërive dhe kombeve që udhëheqin progresin e botës, duke i hequr Ballkanit titullin e "Zonës më të rrezikshme ndaj

paqes në botë"! Kjo do t'i japë Amerikës të drejtën e përhershme dhe autoritetin e padiskutueshëm që të shpallë dhe të mbrojë idealet e saj ndaj kombeve.

V. ËSHTË NJË INVESTIM I SIGURT

Nuk nevojitet as ushtri për pushtim, as shpenzime të mëdha fondesh, nuk ka as rrezik për komplikacione të jashtme, as kundërshtim nga brenda. Nevojitet vetëm një forcë e vogël vullnetarësh për detyra policore, disa oficerë që do të stërvitin një polici vendase, disa ekspertë civilë që të organizojnë departamente të ndryshme të administratës, një qeveritar me simpati, energji dhe aftësi, një korpus punëtorësh vullnetarë, si mësues, inxhinierë, një kredi e përkohshme me disa miliona dhe kapital privat amerikan i investuar për të zhvilluar burimet aq të pasura natyrore të vendit, me fitime absolutisht të sigurta. Këto janë kërkesat për një Mandat Amerikan dhe të tëra shpenzimet mund t'i kthehen shumë lehtë shtetit, sapo burimet e saj të zhvillohen dhe të shfrytëzohen si duhet. Greqia dhe Serbia, duke besuar në dëshirën e mirë dhe në ndjenjën e lartë të drejtësisë amerikane, do të lënë grindjet e tyre territoriale me të cilat merren sapo Italia të tërhiqet prej pretendimeve të saj mbi Vlorën. Shqipëria me kufijtë e saj etnikë është thuajse sa New Jersey dhe popullata e saj sa gjysma e qytetit të New Yorkut, por shumë herë më e lehtë për t'u qeverisur. Kështu, ajo që i kërkoj Amerikës me njëqind milion njerëz nuk është aq e madhe po të kemi parasysh pozicionin që ajo mban sot në botë.

VI. I JEP AMERIKËS NJË TË DREJTË PËRFUNDIMTARE NË RINDËRTIMIN E BOTËS:

Belgjika ka pushuar së qeni një çështje e ngjashme me këtë. Franca, fisnike dhe e madhe siç është, do të mbajë përsëri barrën e vet, madje të marrë edhe barrë të reja. Por këtu gjendet një fëmijë i varfër, jetim midis kombeve, për të cilin askujt nuk i vjen keq dhe askush nuk kujdeset, i cili përditë braktiset, keqtrajtohet dhe ndoshta shkatërrohet. Sapo të hyjë në zemër të popullit të madh amerikan, këtij kombi do t'i kthehet krenaria e prindit që e sheh atë tek rritet i fuqishëm dhe i dashur, duke arritur që më në fund të jetë midis tërë kombeve të tjera si vetja. Çdo gjë do të jetë e

favorshme për të: Një territor i përcaktuar qartë, i pasur, me veçori të tëra burimesh dhe i vendosur strategjikisht në kryqëzimet e rrugëve dhe ujërave të botës. Me një fjalë, ai është një popull që i shkon për shtat zemrës dhe detyrës sonë, për rezultate të mëdha dhe me përfitime, që do t'i hapin udhë së mirës së njerëzimit dhe përpjekjet tona ia vlejnë të bëhen në emër të qëllimeve tona të shenjta. Thirrja që na drejtohet është aq e qartë sa një zë burie – a mund të dyshojë ndokush se cila do të jetë përgjigjja?[137]

Charles Telford Erickson

[137] State Department Decimal File, 1910 – 1929 Doc 767.74.

ERICKSON-I DHE PARIMET E NDËRTIMIT TË NJË SHTETI TË RI DEMOKRATIK SHQIPTAR[138]

Kur përfundoi Konferenca e Paqes, Erickson–i kishte ndjesi të përziera rreth së ardhmes së statusit të Shqipërisë dhe formës së organizimit të shtetit. Situata ishte e pastabilizuar. Disa hapa ishin bërë, italianët ishin larguar nga Vlora, por gjithçka ishte tej mase e brishtë. Megjithëse ai i detyrohej shumë Wilson–it për pozicionin e tij në mbrojtje të Shqipërisë, ai ishte i bindur se Presidenti kishte bërë gabim që nuk luftoi për një mandat amerikan mbi Shqipërinë, të cilin ai e konsideronte çelësin e zgjidhjes së çështjes së Adriatikut dhe të Ballkanit. Në vetvete ai vazhdimisht bluante idenë e ndërtimit të një shteti shqiptar modern, ndryshe nga ai që ishte në atë kohë, ende i pakonsoliduar, i ndërtuar mbi koncepte arkaike dhe me njerëz të mësuar në administratën osmane, dembelë, dritëshkurtër dhe të pazotë për të ndërtuar një administratë që të tërhiqte vëmendjen e investimeve të huaja dhe i sillte zhvillim të shpejtë vendit.

Ndërkohë që në Shqipëri qeveritë dhe shefat e tyre ndërroheshin njëra pas tjetrës, Erickson–i, i gjendur në ShBA, i shqetësuar për këtë situatë, bashkë me një grup njohësish të së drejtës së shtetit, harton një program qeveritar, sipas të cilit do të funksiononte qeveria shqiptare. Parimet mbi të cilat ai e vendos organizimin

[138] Dosja Aubrey Herbert, DD/Herbert/3/1920, Somerset County Records, Britania e Madhe, 920.

e qeverisë janë aq demokratike, aq moderne, sa ç'janë edhe sot në rendin e ri demokratik që jetojmë. Por, mbi të gjitha, spikat dëshira e tij për një Shqipëri demokratike, një shtet modern dhe një platformë e cila do të zbatohej mbi parime dhe përvoja tashmë të sprovuara në vende të tjera perëndimore. Po le ta shohim se si e formuloi ai platformën e ndërtimit të shtetit shqiptar:

Charles Telford Erickson

1527 Rhode Island Avenue

Uashington D.C. USA

6 Dhjetor 1920

NDËRTIMI I SHTETIT SHQIPTAR[139]

Fakti që Shqipëria e fillon jetën si një shtet i pavarur në këtë kohë i jep asaj një përparësi të madhe. Kombet e botës kanë eksperimentuar me shumë forma të qeverisjes, si ajo patriarkale, autokratike, monarkike (edhe absolute, edhe e kufizuar ose kushtetuese), republikane dhe komuniste. Në vendosjen e formës së qeverisjes për Shqipërinë është detyrë e udhëheqësve të saj të studiojnë këtë çështje me kujdes, të këshillohen me ekspertët, të përfitojnë prej gabimeve të të tjerëve si dhe të akumulojnë zgjuarsinë shekullore të ndërtimit të shtetit. Personalisht unë jam në favor të një "qeverie të popullit, prej popullit, për popullin", siç e përshkruan Abraham Linkolni qeverinë e Shteteve të Bashkuara. Por një formë e tillë e qeverisjes kërkon edhe ndërgjegje shumë të zhvilluar publike dhe unë dyshoj nëse Shqipëria është aty ku duhet të jetë për një formë të tillë qeverisjeje. Për atë arsye unë do të rekomandoja një monarki kushtetuese, siç është ajo që ekziston në Britaninë e Madhe. Sistemi kantonal i qeverisjes lokale, e cila ka provuar t'i shkojë kaq në mënyrë të admirueshme kushteve të njëjta në Zvicër, mund të studiohet fare mirë si një model.

[139] Po aty.

KUSHTETUTA

Sapo të jetë vendosur forma e qeverisjes, atëherë duhet mbledhur një kuvend kushtetues për përgatitjen e ligjit themelor të shtetit. Delegatët e zgjedhur duhet të përfaqësojnë tërë shtresat e popullit dhe të kenë këshilltarë e ekspertë nga vende ku ajo formë qeverisjeje është provuar e suksesshme ose ku janë vënë re defekte të caktuara. Edhe kushtetuta të vendeve të tjera duhet të përdoren për referencë.

Sapo të përgatitet kushtetuta, duhet të pranohet solemnisht prej tërë njerëzve në tëra cepat e vendit, secili duke u betuar t'i bindet asaj me jetën e vet dhe shërbimin e merituar. Kjo do të jetë një BESË kombëtare, e cila do ta largojë vendin nga bota feudale dhe të përurojë një kohë moderne dhe të re për kombin.

DITA E FESTËS KOMBËTARE

Duke e bërë këtë, do të institucionalizohet një qeveri e re në pajtim me kushtetutën dhe detyrimet zyrtare që rrjedhin prej saj dhe të përurohet me ceremoninë që meriton. Pastaj t'u dërgohen njoftime tërë kombeve me ftesa, që të dërgojnë përfaqësuesit e tyre për atë rast dhe të emërojnë përfaqësuesit e vet të përhershëm. Kjo duhet të jetë Dita e Madhe e Festës Kombëtare të Shqipërisë, siç është 4 Korriku për Shtetet e Bashkuara apo 14 Korriku për Francën.

DEPARTAMENTET E QEVERISË

Pas përurimit të qeverisë së re në pajtim me kushtetutën, secilit departament do t'i nevojitet të krijojë dhe të zhvillojë linjat e veta drejtuese të shtetit modern.

DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Do të ketë detyrën e vendosjes së marrëdhënieve miqësore dhe tregtare me vende të tjera, heqjen e keqkuptimeve dhe paragjykimeve të cilat ekzistonin në të kaluarën dhe që ekzistojnë edhe sot në shumë vende, si dhe informimin e atyre të cilët dinë pak ose aspak për Shqipërinë. Një byro e publicitetit e aftë, e organizuar dhe e drejtuar do të

jetë e domosdoshme dhe e paçmueshme në këtë departament. Prej aftësisë së treguar nga ky departament për të vendosur marrëdhënie të përzemërta dhe të afërta me vendet fqinje dhe forcës për të ngjallur besim sidomos tek Fuqitë e Mëdha, përfshirë edhe Amerikën, do të varet në masë të madhe siguria dhe zhvillimi i shtetit shqiptar.

DEPARTAMENTI I PUNËVE TË BRENDSHME

Ky departament do të ketë detyrën e sigurimit të rrugëve, hekurudhave dhe rrugëve ujore nëpër tërë vendin; në kthimin e zonave kënetore dhe të humbura në toka pjellore dhe të vendosen njerëz që të jetojnë në to; të zhvillohet një sistem modern i ujitjes; të sigurohet e tërë sasia e nevojshme me ujë të pijshëm për tërë popullatën. Ky departament duhet të zhvillojë një sistem thuajse të pakufizuar dhe pa ndërprerje të fuqisë ujore të vendit, duke e përdorur atë për manifakturë, transport, ndriçim etj. Kjo do të sigurojë gjire moderne në portet e vendit. Po ashtu të mbikëqyrë edhe ndërtesat publike. Të përzgjedhë vendet e përshtatshme për kryeqytetin dhe ndërtesat e tij moderne, jo vetëm për Shqipërinë, por për tërë Ballkanin. Ky do të ketë detyrën të rregullojë kohën e përdorimit të tokës, në mënyrë që çdo qytetar të fitojë pjesën e tij. Ky duhet të kontrollojë gjithashtu edhe pyjet, mineralet dhe burimet e tjera natyrore të shtetit në një mënyrë të tillë sa të kontribuojë për përfitimin e tërë popullit.

DEPARTAMENTI I SHËNDETIT PUBLIK

Ky departament do të merret me problemet shëndetësore, malarien, tuberkulozin, sëmundjet ngjitëse. Kujdes të madh do të tregojë për zhvillimin e fëmijëve, përfshirë ushqimin, zbavitjen dhe pastërtinë e tyre. Ajo do të jetë përgjegjëse për edukimin e mjekëve, kirurgëve, infermierëve dhe mamive, shërbimi i të cilëve duhet të jetë nën kontrollin e shtetit dhe t'u afrohet të gjithë njerëzve sipas nevojave, madje edhe më të varfërve. Spitalet, sanatoriumet, dispanseritë, ujërat termale dhe të gjitha agjencitë mjekësore duhet të jenë nën kontroll, aq sa t'u shërbejnë në mënyrë efektive nevojave të tërë popullit. Duhet të ndërmerret arsimimi për shëndetin publik dhe privat me mjetet shkollore, leksionet publike, ekspozitat e duhura si dhe publicitetin e nevojshëm, të përgjithshëm, derisa të vendosen kushtet moderne në katër anët e vendit.

DEPARTAMENTI I TREGTISË DHE BUJQËSISË

Ky departament duhet të ngarkohet me detyrën e zhvillimit të veprimtarisë bujqësore të popullit, derisa metodat shkencore të zëvendësojnë metodat e vjetra dhe kuturu që zbatohen sot. Një stacion kombëtar eksperimental dhe fermë model do të ndërtohen sa më parë të jetë e mundur për studimin e tokës dhe kushteve klimaterike, për përzgjedhjen e farërave më të mira, për rritjen e bagëtisë, për përdorimin e makinerive moderne, për zhdukjen e kolerës dhe sëmundjeve të kafshëve etj. Të gjitha të jenë në shërbim të tërë kombit. Çdo burim i mundshëm i shtetit duhet të përdoret në atë mënyrë që të japë kontributin për mirëqenien e qytetarëve të vet. Duhet të gjenden markat e huaja për mbivlerën e produkteve dhe anijeve në të cilat të transportojnë ato, duke siguruar kështu një balancë krediti jashtë, kundrejt të cilit mund të importohen gjërat e huaja. Manifakturat dhe industritë e krijuara brenda vendit do t'i shndërrojnë lëndët e para, siç janë leshi, pambuku, liri, duhani, në prodhime të përpunuara me cilësinë më të lartë. Drejtimi shtetëror dhe kontrolli i veprimtarive industriale të kombit do të forcojnë dhe mbrojnë të dobëtit, do të ulin monopolet, parandalojnë kontrollin klasor dhe do të vendosin koordinimin dhe bashkëpunimin me të gjitha departamentet e industrisë.

DEPARTAMENTI I ARSIMIT

Ky departament do të ketë si detyrë të krijojë një sistem modern të arsimimit të detyrueshëm për të rinjtë e dy gjinive në një mënyrë të tillë që t'i përgatisë ata për disa punë të caktuara, të cilat do të kontribuojnë jo vetëm për rehatinë personale por edhe të familjes dhe të shtetit. Duhet të hapen shkollat teknike dhe profesionale, përfshirë ato bujqësore për përgatitjen e atyre që kanë treguar aftësi të jashtëzakonshme si drejtues. Shkollat duhet të jenë të hapura për më të varfrit njësoj si për të pasurit, sipas aftësive të tyre. Përveç kësaj, një numër i caktuar i bursave duhet t'u jepen për studime jashtë në universitetet dhe shkollat teknike të vendeve të tjera, me qëllim që të zhvillohet trupa e ekspertëve për shërbime ndaj shtetit.

DEPARTAMENTI I POSTËS DHE TELEGRAFËS

Me zhvillimin e tregtisë, përhapjen e arsimit, qarkullimin e lajmeve dhe informacionin e njerëzve, bëhet absolutisht i domosdoshëm edhe një sistem i Postë-Telegraf-Telefonit, përfshirë edhe një stacion jo kabllor.

DEPARTAMENTI I SIGURIMIT KOMBËTAR

Unë nuk do ta heq nga mendja "Departamentin e luftës" nga funksionet e shtetit. Në vend të një ushtrie të përhershme, të veshur në uniforma ushtarake si ato në Europë, unë do të desha një forcë të vogël dhe të stërvitur më së miri të një policie të caktuar dhe gjithashtu një forcë të xhandarmërisë kombëtare, të zgjedhur me kujdes, të pajisur me kostume kombëtare. Për pjesën tjetër, unë do të zhvilloja një shkollë kombëtare, një sistem të stërvitjes kombëtare, të njëjtë me "Sokolat"[140] e Bohemisë, ku përfshihet mbajtja e armëve dhe njëzet ditë shërbim shtetit në ndërtimin e rrugëve etj. Do të duhej që çdo qytetari të aftë do t'i kërkohej të merrte pjesë ose në pamundësi të siguronte zëvendësin. Një kongres i madh do të ndihmonte një herë në vit së bashku me një ekspozitë të gjithë arteve dhe prodhimeve të shtetit, tek të cilat do të jepeshin çmimet, medaljet etj. Kongresi duhet të përfundojë me një festival të madh të festimeve të Ditës së Pavarësisë.

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Të ardhurat e shtetit duhet të rrjedhin aq shumë, sa është e mundur nga taksat indirekte. Por në asnjë rast ato nuk duhet të bëhen barrë ndaj industrisë, duke shkurajuar përpjekjet private dhe individuale. Tokat e shtetit, pyjet, minierat, hekurudhat, fuqia ujore, linjat e telefonave dhe telegrafëve, të cilat janë në duar private, kanë tendencën të bëhen monopole të mëdha, duke krijuar grindje të vazhdueshme, xhelozi dhe luftë midis punëtorëve dhe kapitalit. Ato duhet të jenë nën kontrollin e shtetit dhe të ardhurat e tyre të bëhen kështu të disponueshme në të mirë të të gjithëve. Duhet të ngrihet banka e shtetit, e cila ruan qëndrueshmërinë e vlerës së

[140] Dosja Aubrey Herbert, DD/Herbert/3/1920, Somerset County Records, Britania e Madhe. 911.

monedhës, bën negocimin e sigurimeve të qeverisë, bondeve etj., çka përbën një prej gjërave të domosdoshme. Bashkë me këtë duhet të vendoset makina shtypëse e parasë kombëtare.

GJYQËSORI

Do të ngarkohet me detyrën e përgatitjes së ligjeve dhe rregullave të reja për të zëvendësuar ato të Turqisë, ose të riorganizojë gjykatat e drejtësisë dhe të sistemit penal, të kërkojë udhëzimin dhe përgatitjen e gjykatësve dhe avokatëve për gjykatat. Mbështetur në zgjuarsinë dhe aftësinë e ushtruar këtu, do të varet në masë të madhe fuqia legjislative dhe ekzekutive e qeverisë, si dhe liria individuale e qytetarëve dhe mirëqenia e vetë shoqërisë.

VËZHGIME DHE PËRFUNDIME

Ky, në një vështrim të shkurtër, është progresi të cilin unë doja ta shihja të paraqitur dhe pranuar prej qeverisë shqiptare. Kjo nuk do të arrihet pa vështirësi serioze, marrje vendimesh të dhimbshme dhe përpjekjesh të guximshme. Në të vërtetë, unë besoj se kjo është e vetmja rrugë e mundimshme prej së cilës kjo mund të arrihet, d.m.th. për zyrtarët shqiptarë e udhëheqësit dhe të përftohet njohje të cilën ne e kërkojmë midis kombeve të botës. Kjo do të sjellë stabilitet të brendshëm, duke rritur prosperitetin dhe progresin midis tyre. Nëse nuk bëhet kjo, unë kam frikë se të njëjtat pengesa që fundosën qeverinë e kaluar, do ta fundosin edhe këtë të tashmen.

Natyrisht, vënia në jetë e këtij programi kërkon njerëz të kualifikuar dhe të stërvitur, me përvojë dhe përkushtim. Ata duhet të jenë të interesuar për zhvillimin e vendit dhe të jenë edhe organizatorë edhe konstruktorë. Këta burra nevojitet të zgjidhen me kujdesin më të madh të mundshëm. Personalisht besoj se ata duhet në pjesën më të madhe të jenë britanikë dhe amerikanë. Megjithatë, për punët inxhinierike italianët janë, gjithashtu, shumë të mirë, veçanërisht në ndërtimin e rrugëve.

Pas tërë atyre që Shqipëria ka hequr, unë, si një mik i sinqertë, do të desha ta shoh atë

të paktën duke dalë nga e kaluara e saj tragjike në një kohë moderne, të mbushur me bekimet më të mira dhe me dhuratat të cilat qielli dhe toka mund t'i japin. Burrëria dhe graria e botës, ligjet e saj, institucionet e saj, idealet e saj, fetë e saj dhe përfitimet materiale – frutat më të shijshme dhe lulet më të bukura të tërë mijëravjeçarëve të përparimit, asnjë nuk është tepër e mirë për kombin shqiptar. Për realizimin e këtyre bekimeve unë e ofroj shërbimin tim me shumë kënaqësi.

KOMISIONER SHQIPTAR NË UASHINGTON DC[141]

Qeveria shqiptare do ta vlerësonte shumë ndihmën e pakursyer që Erickson-i i kishte dhënë Shqipërisë që prej 13 vjetësh. Prandaj më 23 tetor 1920, ajo i dërgoi një letër Presidentit Wilson, ku e njoftonte për emërimin e Erickson-it si i Dërguari i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë, me qëllim vendosjen në të ardhmen të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane. Përveç suksesit të Erickson-it në Konferencën e Paqes, qeveria shqiptare besonte se vitet e tij të jetës dhe interesit të devotshëm ndaj Shqipërisë i kishin dhënë atij një njohje të rëndësishme të të dyja vendeve, gjë e cila ishte një garanci për suksesin që do të kishte në misionin e ri.

Megjithëse Erickson-i duhet të ketë qenë i nderuar me emërimin që mori, pozitat e tij të reja diplomatike në Uashington nuk ishin aq fatlume. Ishte fatkeqësi që në atë kohë Shtetet e Bashkuara nuk e njihnin zyrtarisht qeverinë shqiptare, një kusht i cili zakonisht i hap rrugën njohjes së diplomatëve të një kombi të huaj. Si rezultat i kësaj, Erickson-i ndoshta është parë në Uashington si një agjent përfaqësues i qeverisë ende të panjohur shqiptare. Gjithsesi qeveria shqiptare e dërgoi atë në Uashington bazuar në letrën e lëshuar nga Kryeministri i asaj kohe, Iliaz Vrioni. Vajtja e Erickson-it në Uashington duket se ishte pak problematike.

[141] Skeda Erickson DASH 24584-A-157.

Nga njëra anë, ai emërohet nga qeveria shqiptare, por brenda saj kishte njerëz që nuk e miratonin këtë vendim. Nga ana tjetër, qeveria amerikane nuk mund të njihte një të dërguar nga Shqipëria, qoftë edhe komisioner, sa kohë që ajo nuk e kishte njohur vetë qeverinë. Por pengesa tjetër ishte se atje gjendej me një farë statusi të dhënë nga Vatra, Kostandin Çekrezi, ose Kosta, siç njihej atje, një figurë tejet interesante, shumë i zgjuar, patriot, i shkolluar mirë, por shpesh kundërthënës në veprimet e veta. Pengesa tjetër ishte se Erickson-i ishte shtetas amerikan dhe kushtetuta amerikane nuk lejonte dhënie imuniteti për një shtet tjetër ndaj qytetarëve të vet. Por le të shohim kush ishte dhe çfarë bënte Kostë Çekrezi.

Kostandin Anastas Çekrezi (1892-1959), u lind në fshatin Ziçisht të Korçës. Ai ishte një njeri i dhënë pas dijes dhe pasi kishte mësuar disa gjuhë të huaja, punoi si përkthyes i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, që nga shpërthimi i Luftës së Parë Botërore. Më pas ai mërgoi në Shtetet e Bashkuara, duke kaluar nga Italia. Në Boston u ngarkua për një farë kohe me botimin e gazetës "Dielli". Sikundër Konica, Çekrezi studioi dhe u diplomua në Universitetin e Harvardit. Po në Boston ai botoi periodikun "Illyria", që zgjati vetëm gjashtë muaj, nga marsi në nëntor të vitit 1916, kurse në fillim të vitit 1919 u bë redaktor i së përmuajshmes së Nolit "*The Adriatic Review*", që financohej nga Federata Panshqiptare Vatra, për të përhapur informacion për Shqipërinë dhe për kauzën e saj. Gjashtë muajt e parë revista u botua nga Noli, ndërsa më 1919 këtë e mori në dorë vetë Çekrezi. Ai është autor, publicist, shkrimtar i shquar i një numri librash shqip dhe anglisht, sidomos i disa veprave të vëllimshme për Historinë e Shqipërisë, të cilat, për horizontin që hapnin, ishin mjaft të spikatura për kohën. Ndër këto libra veçohen: *Albania Past and Present*, New York 1919 (Shqipëria në të kaluarën dhe në të tashmen); *Kendime për rjeshten e funtme të shkollave filltare*, Boston 1921; *Histori e Shqipërisë*, Boston 1921; *Histori e vjetër që në kohërat e Pellazgëve gjer në rënien e Perandorisë Romake*, Boston 1921; *Histori e re e Europës*, Boston 1921; *Historia mesjetare e Europës, që nga rënia e Romës deri në rënien e Kostandinopojës* (478-1453), Boston 1921; dhe të parin fjalor anglisht-shqip, *Chekrezi's English- Albanian Dictionary*, Fjalor anglisht-shqip i Çekrezit, Boston 1923.

Ai veproi edhe si komisioner në Uashington, me një mandat të cilin nuk ishte gati ta dorëzonte lehtë, ndonëse kishte bërë një dorëheqje, për arsye shëndetësore, por që më pas ishte penduar. Këtë mandat nuk del shumë qartë nëse ia kishte dhënë qeveria shqiptare apo Vatra, marrëdhëniet e të cilit me këtë të fundit shumë herë ishin të vështira. Por e vërteta është se në kohën kur Erickson-i autorizohet të shkojë në Uashington dhe ta marrë atë detyrë, Kostë Çekrezi e ushtronte atë detyrë dhe e ushtronte në mënyrë shumë profesionale.

Në raportet e dërguara prej tij nga Uashingtoni, drejtuar Mehmet Konicës[142], ministër i Jashtëm i asaj kohe, del se ai ishte një njeri shumë i aftë dhe shumë i angazhuar. I tillë është raporti i datës 10 qershor 1920, një raport i formuluar në një mënyrë që habit për gjuhën shqipe të pastër, me trajtimin e të gjitha problemeve të marrëdhënieve me ShBA-në, që nga politika deri tek çështjet konsullore dhe shqetësimin për qëndrimin e Italisë ndaj Shqipërisë. Në atë raport ai tregon në mënyrë të hollësishme takimet e tij me senatorë dhe kongresmenë amerikanë dhe qëndrimet e tyre ndaj Shqipërisë. Çekrezi zbulon në mënyrë shumë interesante luftën që bëhej midis Senatit të Shteteve të Bashkuara dhe Presidentit Wilson, si përfaqësues të dy partive më të mëdha në ShBA. Ai përshkruan dashamirësinë e këtij të fundit ndaj vendit tonë, përkundrejt veprimeve bllokuese të shfaqura nga disa senatorë dhe kongresmenë.

Më tej ai na jep raportin e kongresit të "Vatrës" të mbajtur më datat 22-24 maj 1920, i cili shqyrtonte të gjitha çështjet që kishin të bënin me kombin shqiptar. Çekrezi jep aq shumë informacion në atë raport, sa të bën përshtypje edhe vetë renditja e gjërave ku organizata shqiptare është objekt i raporteve të tij për qeverinë shqiptare, një ndër detyrat e diplomacisë shqiptare edhe sot e kësaj dite. Natyrisht, këtu kemi të bëjmë me "Vatrën", e cila ishte përherë më e përparuar se vetë qeveria shqiptare e asaj kohe.

Po ashtu Çekrezi raporton për përpjekjet e tij të pareshtura për njohjen e qeverisë së Shqipërisë nga qeveria amerikane. Ai flet për takimin me një zyrtar të

[142] Dosja Erickson, Arkivi i MPJ, Tiranë, Dosja nr. 3.

lartë amerikan, Z. Colby,[143] me të cilin debaton për praninë e trupave greke dhe serbe në Shqipëri. Por bashkëbiseduesi i tij amerikan i përsërit tezën se Amerika nuk mund të ndërhyjë në punët e brendshme të Europës.

Edhe më interesant është takimi i Çekrezit, së bashku me gjeneralin amerikan George P. Scriven,me ambasadorin italian në Uashington. Gjenerali Scriven e kishte vizituar Shqipërinë në vitin 1918 dhe kishte shkruar një artikull të jashtëzakonshëm për shqiptarët në gusht të vitit 1918 me titull "*Recent Observation in Albania*"[144] dhe botuar në revistën më prestigjioze amerikane "*The National Geographic Magazine*". Çekrezi e raporton bisedën me ambasadorin italian si shumë të tensionuar dhe i kërkon atij që qeveria e tij ta njihte Shqipërinë. Kjo natyrisht që ishte e vështirë, pasi trupat pushtuese italiane ishin në Shqipëri dhe njohja për ta donte të thoshte largim pa kushte që andej. Por ambasadori italian e akuzoi Amerikën për politikë të padrejtë në Europë, duke iu referuar çështjes së shumëdebatuar të Fiumes dhe qëndrimin e Presidentit Amerikan Wilson në Konferencën e Paqes në Paris, të sapombyllur disa muaj më parë. Të dy, edhe Çekrezi edhe gjenerali Scriven, i kundërvihen me argumente ambasadorit italian, duke i kujtuar ato që Italia po bënte në atë kohë për të mbajtur Vlorën dhe territoret rreth saj.

Çështja e komisionerit të Shqipërisë në Uashington do të ketë qenë një mollë sherri dhe objekt debatesh për zëvendësimin e Çekrezit me Erickson-in. Natyrisht që të dy ishin njerëz të denjë për një detyrë të tillë. Por ajo që kishte bërë Erickson-i tërë ato vite për Shqipërinë nuk mund të harrohej dhe ishte shumë më e çmuar se ajo që kishte bërë Çekrezi. Gjithsesi, Erickson-i tani kishte edhe dy kredenciale shumë të rëndësishme: ish-delegat nderi në Konferencën e Paqes në Paris, mbrojtës i flaktë i çështjes shqiptare me një arritje historike në këtë drejtim dhe natyrisht, si amerikan, ai kishte lidhje shumë më të forta se Çekrezi në Amerikë. Edhe pse i pasanksionuar emërimi e tij, Erickson-i mendonte, vepronte dhe sillej si komisioner i Shqipërisë në Uashington DC. Në fakt, e keqja mbeti në anën e

[143] Skeda Erickson DASH 24584-A-156.

[144] George P. Scriven: Observation in Albania, Natinal Geographic Magazine, August 1918.

qeverisë amerikane. Ajo nuk e pranoi atë, duke arsyetuar se si shtetas amerikan nuk mund të përfaqësonte interesat e një shteti tjetër. Po e njëjta pengese kishte dalë edhe në Tiranë, ku disa anëtarë të qeverisë së Iliaz Vrionit kishin shprehur kundërshtim për dhënien e një besimi të tillë një shtetasi të huaji.

Kështu Erickson-i punon disa kohë, pa ndonjë mandat të qartë të miratuar, ndërton një rrjet miqësie dhe dashamirësish për Shqipërinë, por nuk e ushtron dot plotësisht detyrën e komisionerit të qeverisë shqiptare në Uashington. Kjo i shkon shumë për shtat edhe Çekrezit, i cili rreshton një varg pretendimesh, ndër të cilat edhe faktin që qeveria amerikane nuk i sheh me sy të mirë ata qytetarë amerikanë të cilët punojnë në shërbim të qeverive të huaja. Më 17 nëntor 1920 në letrën që Çekrezi i dërgon Mehmet Konicës, jo pa gëzim, i shpreh këtij të fundit kënaqësinë për mospranimin e Erickson-it nga qeveria amerikane.

Në të vërtetë dihet se aty nga fillimi i vitit 1920 statusi i Shqipërisë, edhe në skenën e brendshme, edhe të jashtme, ishte mjegulluar prej një morie çështjesh të pazgjidhura dhe forcave konkurruese politike. Çështja e Adriatikut mbeti edhe më tej një pengesë e madhe në anën e Shqipërisë. Ajo pengonte progresin e qeverisë së përkohshme. Turhan Pasha, si kryesues i qeverisë së pasluftës, kishte dështuar të krijonte një forcë të duhur, të aftë për të përzënë ushtrinë italiane nga Shqipëria – një prej faktorëve parësorë që çoi tek vendosja e një qeverie të re më 28 janar të vitit 1920 në Kongresin e Lushnjës. Kjo, në fakt, ishte ngjarja më e rëndësishme e ndodhur deri atëherë pas Shpalljes së Pavarësisë. Qëllimi i këtij kongresi ishte themelimi i një qeverie, e cila të merrej me çështjet që e nxirrnin vendin jashtë kontrollit ushtarak, kryesisht italian dhe francez, si dhe nxjerrjen e udhëheqësisë politike të qeverisë së Durrësit nga ndikimi italian. Kongresi u ndoq nga 56 delegatë nga tërë Shqipëria dhe zona të banuara prej shqiptarëve, si dhe përfaqësues të kolonive shqiptare në mërgim. Aqif Pashë Elbasani u zgjodh president i kongresit dhe Ferit Bera sekretar. Kongresi formoi një kabinet të ri me Sulejman Delvinën kryeministër. Qeveria e re përbëhej prej Këshillit të Lartë Kombëtar. Vendimi i fundit i kongresit ishte caktimi i Tiranës si kryeqytet i ri i Shqipërisë. Vendimet e

kongresit do t'i hapnin më pas udhën Luftës së Vlorës dhe, si rezultat, tërheqjes së përgjithshme të ushtrisë italiane nga Shqipëria. Kështu u afirmua përfundimisht integriteti territorial i vendit në vitin 1921.

Por le të kthehemi tek emërimi nga ana e qeverisë shqiptare të Erickson-it si komisioner në Uashington, madje duke i dhënë edhe detyra të qarta dhe të caktuara mirë për ato që ai duhej të arrinte atje.

Qeveria shqiptare

23 tetor 1920

Qeverisë amerikane, Uashington DC.

Bëjmë të njohur se z. Charles Telford Erickson është emëruar prej qeverisë shqiptare Komisioneri Tregtar në Shtetet e Bashkuara dhe autorizohet të kryejë këto detyra në emër të kësaj qeverie:

i. Të negociojë për gjetjen e një banke shqiptaro-amerikane.

ii. Të negociojë për vendosjen e një linje midis dy vendeve, duke ndërtuar limane, porte dhe vend ankorimi anijesh në Shqipëri.

iii. Të negociojë koncesionin për hekurudhat në Shqipëri.

iv. Të negociojë për garantimin e kontrollit të monopolit të duhanit për eksport.

v. Të negociojë për investimet e kapitalit amerikan në zhvillimin e burimeve natyrore të Shqipërisë, duke përfshirë mineralet, pyjet, produktet bujqësore dhe manifakturat.

vi. Të negociojë për garantimin e koncesionit për zhvillimin dhe përdorimin e fuqisë ujore në Shqipëri.

vii. Të veprojë si agjent tregtar i qeverisë shqiptare.

viii. Të veprojë si delegat zyrtar për Shqipërinë në të gjitha takimet tregtare dhe të natyrës

së mirëqenies publike në Shtetet e Bashkuara, në të cilat do të promovohet interesi i Shqipërisë.

ix. Të negociojë një hua kombëtare.

Zoti Erickson është i mirinformuar rreth interesave të Shqipërisë. Ai është amerikan që ka jetuar tashmë trembëdhjetë vjet nëpër Shqipëri dhe është njohur me interesat e Shqipërisë. Gjatë dy vjetëve të kaluara ai ka qenë anëtar i delegacionit tonë në Konferencën e Paqes në Paris, si një përfaqësues i Federatës Panshqiptare Vatra.

Prandaj, i kërkojmë atij ta pranojë këtë emërim dhe t'i jepet besim i plotë në emër të Shqipërisë. Duke e emëruar z.Erickson në këtë post, qeveria shqiptare ka menduar të dërgojë tek populli amerikan mesazhin e mirënjohjes së thellë, të cilën e ushqen për shërbimet e mëdha që ai i ka bërë çështjes së lirisë së Shqipërisë, për kontributin fisnik të dhënë me Kryqin e Kuq dhe organizata si ajo, për të ndihmuar dhe lartësuar popullin tonë.

Ne shpresojmë se prej këtij emërimi, lidhja e simpatisë dhe shërbimeve të cilat e kanë bërë Amerikën aq të dashur për ne, do të përforcohet edhe më shumë, dhe që bashkëpunimi më i madh me Amerikën mund të ndihmojë në detyrën e madhe të rindërtimit që shtrihet përpara nesh.[145]

I gjetur në një pozitë të vështirë me këtë emërim, i etur për të ndihmuar Shqipërinë, por edhe i mërzitur nga gjendja në të cilën e kishte katandisur familjen, Erickson-i i nis këtë letër qeverisë shqiptare:

[145] Dosja Erickson, Arkivi i MPJ, Tiranë, nr, 3, 1920.

1527 Rhode Island Avenue

Uashington DC, USA

Shkëlqesisë së tij Z.Iliaz Vrioni

Kryeministër

Tiranë, Shqipëri[146]

Shkëlqesia Juaj,

Në shtator të vitit 1920, z.Konstandin A. Çekrezi, paraqiti me kabllogram dorëheqjen si komisioner në Uashington DC tek z.Konica për arsye shëndetësore. Dorëheqja e tij u pranua dhe ai duhej ta ndërpriste veprimtarinë më 15 nëntor, dhe unë u caktova ta zëvendësoja atë. Për këtë emërim unë kam kredencialet e duhura të nënshkruara nga z.Konica, ministër i Punëve të Jashtme. Me të ardhur në Uashington, u njoftova prej z.Putney, këshilltar ligjor, që Departamenti i Shtetit kishte një rregull të pashkruar, ku thuhej se një qytetar amerikan nuk mund të jetë përfaqësues i një qeverie të huaj. Për të mos krijuar pështjellim në Departamentin e Shtetit, duke i njoftuar ata për situatën në të cilën z.Çekrezi nuk ishte më përfaqësues, unë prapë u mbajta dhe hapa udhë, duke lejuar z.Çekrezi të vazhdonte punën e tij në zyrë. Gjithashtu unë i shkrova Shkëlqesisë Suaj një letër shpjeguese dhe i bashkëngjita një formë kredencialesh, e cila do të ishte e pranueshme dhe do të më lejonte të bëja punën të cilën unë kuptoja se qeveria shqiptare dëshironte të bëhej në këtë vend, - natyra e së cilës është përshkruar në kredenciale. Kjo letër është dërguar tek ju më 7 dhjetor me postier të posaçëm, dhe një kërkesë e bërë që unë të njoftohesha me kabllogram për veprimet e qeverisë. Kanë kaluar më shumë se dy muaj dhe unë ende nuk kam marrë përgjigje. Ndërkohë, Vatra nuk më njeh më si delegat të saj, bazuar në atë që unë tashmë jam një i punësuar i qeverisë. Kështu, unë e gjej veten të pamundur për

[146] Skeda Erickson DASH 24584-A-157.

të mbajtur familjen time të shpërndarë që nga Elbasani[147] *deri në Kaliforni, dhe asnjë prej tyre pranë meje.*

Unë nuk mund të mbetem edhe më tej në këtë situatë mëdyshëse. Nëse qeverisë së Shkëlqesisë Suaj nuk i nevojitet shërbimi im, ju kërkoj mirësisht të më njoftoni me një telegram dhe menjëherë. Nëse kërkohet shërbimi im, qeveria le të më sigurojë kredencialet e duhura, dhe të më akordojë fondet të cilat do të më bëjnë të sillem si njeri dinjitoz në një zyrë dinjitoze. Unë gjithashtu ju kërkoj që derisa të jem emëruar përfundimisht, Vatra të autorizohet të vazhdojë pagesën e rrogës së tashme nëpërmjet llogarisë në qeverinë shqiptare. Shkëlqesia Juaj do të kuptojë menjëherë drejtësinë e kësaj kërkese. Ashtu siç qëndron puna sot, unë jam Komisioner për Shqipërinë në Uashington, me një letër formale kredencialesh, që është e papranueshme për qeverinë amerikane. Z. Çekrezi shërben pa patur autoritetin e nevojshëm veç nëse e ka tërhequr dorëheqjen. Por kjo ligjërisht nuk mund të bëhet, pa më tërhequr fillimisht mua. Fondet e tij kanë vazhduar ndërsa të miat janë ndërprerë prej "Vatrës" që më 31 janar. Unë jam reklamuar nëpërmjet shtypit, me një telegram që vinte nga Roma, në kohën e mbërritjes sime, për të cilën unë në asnjë mënyrë nuk isha përgjegjës, si "ministër i Shqipërisë në Shtetet e Bashkuara" dhe, kështu siç janë gjërat, unë as mund të pranoj dhe as të mohoj marrëdhëniet me qeverinë shqiptare dhe qeverinë në Uashington, sepse unë nuk e di as vetë të çfarë natyre janë ato tani.

Gjatë këtyre tre muajve në Amerikë, kam qenë shumë aktiv në sjelljen e çështjes shqiptare përpara publikut dhe gjithashtu në bisedimet me burra të pasur dhe ekspertë të aftë në linja të ndryshme, për t'i bërë ata të interesuar për mirëqenien e Shqipërisë. Dje kisha një bisedë të gjatë prej një orë e gjysmë me një prej ekspertëve më të shquar të Amerikës dhe të botës, i cili me miqtë e tij të biznesit përvijoi një skemë të përpunuar mirë për botën financiare. Ai është thellësisht i interesuar për Shqipërinë dhe Ballkanin dhe mund të ndihmojë jashtëzakonisht shumë për ne. Në Çikago pata një numër takimesh me një prej ekspertëve teknikë më të mirë në Amerikë, gjithashtu

[147] Sipas autores së librit "Stone Pillow", në këtë kohë Ericksoni e kishte kthyer përsëri familjen në Elbasan dhe Carrie gjendej atje. Por në asnjë dokument tjetër kjo nuk konfirmohet.

një prej ekspertëve më të mirë të arsimit në Amerikë. Këta burra janë të gatshëm të bëjnë sakrifica të mëdha, të shkojnë në Shqipëri dhe të ndihmojnë të ngrihet në këmbët e saj për shkak të interesit të tyre të madh. Por më duhet të them se asnjë marrëveshje nuk arrihet me ta në rrethanat në të cilat gjendem unë.

Nëse qeveria e Shkëlqesisë Suaj konsideron se mund të jem më i vlefshëm për Shqipërinë po të bëhem shtetasi juaj, unë jam gati ta bëj këtë.

Në secilin rast, unë do të pëlqeja të merrja dy ose tre ekspertë që të studionin situatën në Shqipëri, duke i njoftuar tërësisht për problemet kombëtare me të cilat ata do të duhet të njihen. Unë mendoj se do të jap një ndihmë shumë të madhe ndaj tyre këtu. Gjithashtu unë vetë do të njihesha me ato që ndodhin atje, me progresin e qeverisë, koncesionet që mund të bëhen, vlerat e tyre, organizatorët e kërkuar për qeverinë, planet financiare etj. Dhe nëse qeveria pranon, mund të merrni betimin tim të besnikërisë dhe të bëhem shtetas shqiptar.

Duke investuar kaq shumë vite të jetës sime në Shqipëri, duke hequr dorë prej karrierës sime në Amerikë, duke sakrifikuar djalin tim të madh për çështjen shqiptare dhe duke iu nënshtruar ndarjes së familjes time për tetë vjet, nuk dua të mendoj tani se dobia ime ndaj çështjes shqiptare ka përfunduar dhe më duhet të kërkoj udhë tjera dhe fusha shërbimi.

Unë do ta pres me padurim përgjigjen Tuaj,

Ndërkohë unë jam shërbëtori më i përunjur dhe i bindur i Shkëlqesisë Suaj.

Charles Telford Erickson.[148]

[148] Arkivi i MPJ, Dosja nr. 3,Viti 1920, faqe 7.

Angazhimi dhe përgjegjësia e Erickson-it nuk mbyllet këtu. Edhe pse në një pozitë të paqartë dhe i paemëruar, madje i pasigurt për të ardhmen e vet, ai nuk pushon asnjë çast së punuari për Shqipërinë. Kështu ai i shkruan qeverisë letrën e mëposhtme.

1527 Rhode Island Ave

Uashington, DC, USA

3 dhjetor, 1921

Shkëlqesisë së tij Z, Iliaz Vrioni

Tiranë, Shqipëri.

I dashuri im zotëri,

A do të më ndjeni që po ju shkruaj në anglisht, pasi nuk e shkruaj mirë as frëngjishten, as shqipen. Së pari, a më lejoni t'ju uroj jetë të gjatë e të suksesshme në detyrën e rëndësishme që keni marrë. Jam i sigurt se ju do të ndërmerrni detyrën me motivet më të larta dhe do t'i kushtoni gjithë fuqitë tuaja ndërtimit të një shteti të shëndetshëm dhe të begatë për vendin tuaj të dashur.

Në përmbushjen e kësaj detyre unë dua t'ju ofroj bashkëpunimin tim të plotë pasi nuk kam objekt apo qëllim tjetër në jetën time veç atij që t'u shërbej me çdo forcë timen interesave të Shqipërisë.

Me qëllim që ta bëj këtë, është e domosdoshme që të ketë mirëkuptim të plotë për punën që do të bëj dhe gjithashtu një bashkëpunim të ngushtë në kryerjen e vetë punës. Siç e dini, unë u dërgova këtu prej kabinetit të mëparshëm për të përfaqësuar Shqipërinë në Uashington, fillimisht si komisioner dhe më pas do të njihesha si

Ministër. Më vonë do të ngarkohesha edhe me organizimin e hapjes së konsullatës së Shqipërisë në New York dhe në Boston për të siguruar ekspertë dhe ndërtues që do të punonin me qeverinë shqiptare, duke ngritur departamente të ndryshme bashkë me linjat moderne të nevojshme; për të siguruar interesat e kapitalistëve amerikanë në zhvillimin dhe burimet e Shqipërisë, duke ndërtuar hekurudha, duke vënë linja vaporësh etj. Me të arritur këtu, mësova se Shtetet e Bashkuara e kanë si rregull që asnjë qytetar amerikan nuk ka të drejtë të përfaqësojë interesat e huaja këtu. Prej kësaj u bë e domosdoshme që të ndryshoja formën e kredencialeve dhe të eliminoj pjesën diplomatike. Këtë ia bëra të njohur zotit Konica dy javë më parë në Londër, ende pa e ditur ndryshimin që do të ndodhte në qeveri. Nuk e di nëse kjo është përcjellë tek ju për nënshkrim. Gjithsesi unë po ju dërgoj bashkëngjitur një kopje tjetër, të cilën shpresoj se ju dhe kolegët tuaj do ta miratojnë. Sa më shumë nënshkrime të ketë, aq më mirë do të duket për zyrtarët e këtushëm dhe të tjerët këtu. Ndërkohë që unë nuk do të njihem nga Departamenti i Shtetit zyrtarisht, me atë letër unë mund të veproj me zyrtarët e tjerë të këtij vendi dhe më ndihmon që të kryej punët e duhura. Për shembull, unë kam një letër prezantimi me Drejtorin e Përgjithshëm të Postave, i cili do të më vërë në kontakt me disa zyrtarë të lartë me përvojë të madhe, të cilët pas 4 marsit dhe ndryshimeve në administratë do të jenë të lirë të ndërmarrin ndërtimin e një sistemi modern dhe të plotë postar në Shqipëri. Unë, gjithashtu, jam një mik personal i njërit prej zyrtarëve më të lartë në Drejtorinë e Bankave Federale të Shteteve të Bashkuara. Nëpërmjet tij unë jam i sigurt se do të bie në kontakt me disa ekspertë të financave, të cilët do të ndërmarrin ndërtimin e Bankës Kombëtare Shqiptare dhe krijimin e një monedhe kombëtare shqiptare. Një mik tjetër është në autoritetin e

Gjykatës Kushtetuese dhe ka pranuar të shkojë në Shqipëri, nëse kjo kërkohet, për të ndihmuar në shkrimin e një kushtetute moderne dhe kodifikimin e ligjeve kombëtare në përputhje me të. Unë besoj se mund të gjenden paratë këtu për të ngritur një bankë shqiptaro – amerikane, që do të ishte një faktor i fuqishëm në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Gjithashtu për eksportin e duhanit, vajit të ullirit dhe produkteve të

tjera jam i sigurt se firmat amerikane do të jenë të interesuara të bëjnë mrekulli në zhvillimin e këtyre industrive në Shqipëri. Po kështu edhe mineralet – çfarëdo që të ketë aty, amerikanët do të dinë se si të ngrenë ndërmarrjet e duhura dhe t'i bëjnë ato të suksesshme. Unë do të bëj çdo gjë që është e mundur për të mbrojtur interesat e qeverisë dhe popullit shqiptar, ku përfitimet të ndahen siç duhet dhe të luftohen monopolet. Kështu njëra prej gjërave më të para që po bëj është të gjej një biznesmen, i cili të ketë përvojë në çështje të tilla, që i di këto gjëra dhe të veprojë si këshilltar i qeverisë shqiptare dhe të shohë me kujdes çdo kontratë që i paraqitet për miratim. Një i tillë nevojitet të jetë jashtë Shqipërisë dhe të sigurojë informacion të besueshëm për qeverinë. Unë e kuptoj se qeveria ka një raport të paraqitur nga austriakët dhe neve na duhet ta dimë përmbajtjen e kësaj sa më parë të jetë e mundur. Ne duhet ta dimë kush është në pronësi të këtyre pasurive, qeveria apo privatët, si dhe për shumë gjëra tjera teknike. Sa më shpejt të jetë dikush në terren që të na japë këto informacione, aq më mirë do të jetë.

Do të desha të bëj disa sugjerime në lidhje me anën financiare të kësaj çështjeje. Janë bërë vlerësime në senat prej z. Konica për Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë. Nuk kam dëgjuar nëse ato janë miratuar dhe nuk kam pranuar as fonde dhe as ndonjë autorizim për të tërhequr fonde në këtë vend, të nisura si kredi shqiptare. Nuk është e mundur të bësh kurrfarë pune në këtë vend pa patur para, pasi është vendi më i shtrenjtë në botë për të jetuar.

.....

Sapo Shqipëria të njihet nga Shtetet e Bashkuara, unë do ta kryeja më së miri detyrën e Konsullit të Përgjithshëm nëse qeveria e pranon këtë. Ndërkohë po merrem me takime me miqtë e mi në Amerikë, duke iu shpjeguar gjithnjë e më shumë gjëra rreth Shqipërisë. Amerika thuajse nuk di asgjë për Shqipërinë dhe nevojitet një punë e madhe për të sjellë këtu informacionin e duhur. Një byro publike që sjell informacione të interesit publik do të ishte një pasuri e jashtëzakonshme në këtë proces rindërtimi. Një telegram i shkurtër i drejtuar: "Erickson-it, Portland, Uashington", ku të thuhet:

"Letra dhe dokumentet bashkëngjitur janë pranuar" do të ishte shumë e mirëpritur.

Unë besoj se e ardhmja e Shqipërisë varet më shumë sesa në çdo gjë tjetër në një marrëdhënie të ngushtë me Amerikën dhe Anglinë dhe për sa kohë do të jem këtu unë do të bëj më të mirën e mundshme për t'ia arritur kësaj.

Shumë sinqerisht i Juaji

Charles Telford Erickson[149]

Çështja e emërimit të Erickson-it si përfaqësues i Shqipërisë në Uashington DC, siç del nga korrespondenca, është e diskutueshme. Nga një anë, ka korrespondencë të qeverisë shqiptare, të MPJ-së, për autorizimin e tij si përfaqësues në Uashington. Megjithatë kjo kundërshtohet nga dy dokumente. Njëri është letra që ai i dërgon Kryeministrit Vrioni, në të cilën ngre çështjen e një pengese serioze konsullore, që nuk e lejonte atë të ishte përfaqësues i një vendi tjetër dhe, e dyta, një shkresë e Ministrisë së Financave[150], e cila e kundërshton pagesën që duhej t'i jepej atij, për shkak se Këshilli i Lartë Kombëtar nuk lejonte përfaqësim jashtë Shqipërisë të qytetarëve jo shqiptarë.

Por pas tërë këtyre ecejakeve dhe korrespondencave, më në fund ka një qëndrim të prerë të qeverisë shqiptare të nënshkruar nga Kryeministri Vrioni më 28 dhjetor 1920 në vendimin nr. 1160, në të cilin shprehet tekstualisht kështu:

U vendos qi Z.Erickson, me që nuk asht nënshtetas shqiptar e me qenë se nuk ka dekret prej Këshillës së Naltë të mos njihet si përfaqësues i shtetit t'onë.[151]

Letra i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme për njohje dhe veprim më 30 Dhjetor 1920.[152]

149 Arkivi i MPJ, Dosja Nr. 3,Viti 1920, faqe 10.

150 Arkivi i MPJ, Dosja Nr. 4,Viti 1921, faqe 3.

151 Po aty.

152 Po aty.

Por Erickson-i nuk ishte prej atyre burrave që po nuk ua dhe atë që kërkojnë, të kthejnë shpinën. Ai vazhdonte po me të njëjtën këmbëngulje të mendonte dhe të punonte për të mirën e Shqipërisë. Meqë kishte arritur edhe në një nivel të kënaqshëm me gjuhën shqipe, ai vendosi t'u shkruante letër politikanëve ose udhëheqësve shqiptarë, ku të shpaloste idetë e tij për zhvillimin e Shqipërisë. Letrën po e sjellim në një formë dorëshkrimore kompjuterike në gjuhën shqipe:

Carls Telford Erickson[153]

Letër Miqvet mij, Burravet të Qeverisë Shqiptare

Sh. Tyne, Pandeli (Vangjeli), Kryeministër dhe të ndershmëvet, shokëve të tij:[154]

Urimet e mija më të përsemerta për nderin që ju u-dha, dhe urimet e mija Popullit Shqiptar, se responsibiliteti i Qeveries gjindet në duar kaq të vlefta.

Në qoftë se nuk do të numërohet si një madhështi për mua, më epni ju lutem leje si një që vjen tash nga Amerika, të benj Sh. Tuaj një parashtresë me të cilën dua t'u them se Qeverija Yuaj të mbanj definiterisht politiken sa të mundet ma të afërme me Amerikën.

Shqipnija ka provuar miqësien e me shum të shteteve europian, dhe s'ka gjetun as nji që të mos sakrifikonj interesat vitale të Shqipërisë, ballaz interest e veta.

Pse mos provojnë dhe një herë miqësien e Amerikës, që sot është shteti ma i fortë i Botës, dhe na tjatër anë nuk ka interesa kundër jetës Shqiptarëve?

Me cilën mënyr mundeni të hyjnë në marrveshje me Amerikën?

[153] Kjo letër është shkruar prej vetë Charles Telford Ericksonit në gjuhën shqipe dhe në libër po e sjellim ashtu siç e ka shkruar ai duke mbarur edhe gabimet që ai vetë i ka bërë.

[154] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 3, Folder No 3.

I. Tue i dhan kurajo te hymit të kapitalevet Amerikane në Shqipni. Pse nga situate financiare të socme (change) industriet e Amerikës janë paralizu. Te hollat, fabrikat si dhe vaporet te Amerikës janë pa punë. Për me ndertuar kete situatë Qeverija Amerikane per-krahjen kapitalistet të kërkojnë me punu kapitalet e tyne për jashta si: Tue organizu shoqenin tregtare, tue godit apo mbledh fabrikat, tue bërë bankat, tue marë koncension për c'do minat, tue bërë rrugë-hekuri, d.t.j. në nedra të huaja.

Këta kapitalistë jan gati të japin konditat sikur se japin dhe të tyerat, dhe kejo nedh nga skaken se dollar eshte shum nalt. Çdo herë që jepet na nji shoqëri nji offert shum e pëlqyeshme (extravagant), pershtatet gjithnji na nji qeveri që pshehterisht i shërben çështjes politike që kështu Shqipnija me Shqiptarët e ka për me e pagu këtë diferencë ma pastaj, me të gjithë kamaten.

II. Me zgjedhem organizatorët dhe expertet Amerikan për të asistuar Qeverin Shqiptare në organizimi e saj dhe popullin në zhvellimin e tij ekonomik, industrial dhe social.

Cilat janë fitimet me të dobishme që do t'i vinë Shqipnisë nga nji grup organizatorësh të këtillë?

(1) Shqypnia do të përfitojë përkrahjen morale të guvernës dhe popullit Amerikan, e cila përkrahje për Shqypnin do jetë nga më të fortat që munt të bëhet. Një grup organizatore Amerikan në Shqypni do të signifikojë që zëri i Amerikës do të dëgjohet në favore të Shqypnis, dhe që influence e saj do të përdoret në Balkan për paqe dhe drejtësi.

(2) Amerika do të vijë t'a ndihmojë Shqypnin me atë zel dhe forcate që mundi të transferojë, në 150 vjet, një shkretëtirë me disa kollonia të përdara në mes të indianëve të egar dhe e bëri nji komb nga më të fuqishmit në botë, me më shumë se një qind milionë njeres, siç ndodhet Amerika sot.

Për shembull: Departamenti i Bujqësisë po harxhon milionera dollare çdo vit për përmirësimin dhe çdrivillimin e bujqësisë në tërë degat e saj. Ekspertë po remojnë ter botën per llojesh bimera, drithera dhe produkte hamjeje tjera që t'i shërbenjë nevojave

Amerikan. Basa e prosperitetit shqyptar duhet të jetë bujqësia. Dherrat e saj janë më të mirat në tërë Europen. Por me gjith këtë Shqypnia është aqe shumë pas në methudat bujqësore, sa detyrohet të importojë drithëra për të mbajtur popullatën. Zyrtarët e Departamentit të Bujqësisë të Shteteve të Bashkuara janë zotuar që organizatorët dhe ekspertët amerikan do të kenë bashkpunimin dhe përkrahjen aktife të tyre për në Shqypni.

Në Amerikë ndodhen një shumicë shoqërie që i shërbejnë përmiresimit njerëzor në tërë botën. Për shembull: "The Rockefeller Foundation", e cila ka një fund prej disa qindra milionë dollar, interesohet për konditat e shëndetësisë. Ajo është e lajmëruar për problemin që ka Shqypnia me malarin dhe vdekjen e fëmijëve dhe mund të kandiset lehtë t'ju shërbejë këtyre nevojave.

Veç këtyre, në shkollat dhe universitetet amerikane ndodhen mijëra student prej kombësie të huaj. Një pjesë e madhe prej të cilave vazhdon mësimet me përkrahjen e parese amerikane. Shqypnis i duhen tekniciane të drivillojnë pasurit e saja dhe të organizojnë industritë. Edukata amerikane i bën njerëzit të zotët për çfarëdo pune dhe zotër të siellen peme nga mundimet e tyre. Bashkëpunimi i Amerikës do t'i jap Shqypnis raste të dërgojë një shumicë djemash në shkollat e atjeshme të mësojnë pa të holla.

Një ekspert financiar amerikan do të munde jo vetëm të verë në vepërim një monedhë kombëtare dhe një system bankash, por edhe po të ketë nevojë Shteti për një hua të jashtme, do të jetë në pozitë të munde të interesojë bankat si dhe qarket financiare të Amerikës, të cilat janë më të fuqishmet në botë.

(3) Ndihma dhe bashkëpunimi amerikan do të jetë pa interes politik.

Amerika s'ka ambicie politike në Ballkan. Interesi i saj është të siellë paqe, të çdrivillojë tregëti, të përmirësojë konditat ekonomike dhe të hapë dyer të rea për të punuar kapitalet e saj. Kryetarët e saj dine fort mirë qe Amerika s'munt të ketë prosperite kur industritë e botës janë të pa-lëvizura dhe të prishura. Pra, Guverna

amerikane e sotme iu jep përkrahje të fortë Amerikaneve në shtetet e huaj të cilët mundohen të arrijnë këtë qëllim. Shqypnia mund të përfitojë nga këto rasje në këtë kohë shumë më mirë se në kohërat para luftës.

(4) Fitimi i Shqypnis, dyke patur organizatorët kryesorë të tërë nga Amerika, do të jetë në faktin se do ketë bashkëpunim, një esprit de corps, një program nene një drejtim dhe kryesi, një konsentrasion të energjisë për të formuar një forca të krijonjëse dhe energjitike të shërbenjë si një direk për jetën qeveritare dhe kombëtare.

Ky fitim nuk do të jetë i mundur po të zgjidhen organizator na shumë shtete të ndryshme.

Po them se organizatorët që lypset të zgjedhen sa ma shpejt jan te poshtshenumit: i – Finance, i administratës tregtiies, i bujqjesies, i arsimit, te P.P Botore, dhe shendetesies.

Si munden te hynë sa me shpejt keto kapitale dhe keta organizator dhe ekspert amerikan? Pergjigje: Se vetëm t'u i gjumuar keta nga pas. Amerika asht shum lark dhe e madhe vetëm një nga 48 shtetet e saj esht 15 herë ma i madhe se Shqypnija. Nga këto arsyje s'mjafton te cfaqurit e nevojavet kundrejt një korrespondenti, ose Amerikanvet që shkoja si shetitës në Shqypni. Prandaj proposoj që: Një komision dy vetash i emërruar nga Qeveria dhe pranuar nga Parlamenti, të shkonj sa më shpejt për në Washington; ku mund të bashkohet me atë dhe Z.Chekrezi si anëtar i keti komisionit. Që ky komision për veç kredenzialvet të ket tre letra.

(1) Nga Këshilli i Nalt për Kryetarin i Republikës Amerikan. (2) nga Kryeministri për Zot. Hughes, Kryeministri Amerikes. (3) Nga Kryetari i Këshillit Kombtar për Kryetarin e Senatit Amerikan i cili ësht si nën-Kryetar i Republikës.

Missioni i komisionit të jet indiku si për shëmbull që ju tergojnë me posht:

(1) Na, perfaqësuesit të një kombit të vogël që gjindet në fillim se jetës kombetar, keme ardhun per me kerku simpatin dhe miqësin e kombit të madh amerikan.

(2) Kërkojm kooperazionin e juaj per me ban nje konstitucion model për shtetin t one.

(3) U-heqim vrejtjen kapitalistevet amerikan per me investu kapitalet e tyne në Shqypni.

(4) Kerkojm organizatoret dhe ekspertet amerikan per me bashkpunume me Qeverien dhe popullin shqyptar, per me modellu qeverien t'one dhe çvellu industrin dhe curget t'one dhe per te permirsuar gjindjen e pergjithshme te popullit shqyptar.

S'ka dyshim as pak qe ky komision do të pranohet me shum gezim dhe simpati si nga populli, ashtu dhe nga Qeverija Amerikane. Fletoret nga Boston deri ne Kalifornia do te botojn faktet dhe me interes të madh do të pritet çdokur. Dhe udha esht e përgatitur. Shqypnia nuk asht e pa-njoftun ne Amerikë. Simpathija dhe interesi për Shqypnin jan kriju tashti ne Amerikë. Te dy heret që kam këthye ne Amerikë mas armisticet, nga një anë deri tjaterin kam be propogandë per Shqypnien dyke mbajtur konferenca botore përpara qarkeve tregtare, edukacionale, perpara klubes politike dhe sociale, dhe përpara shoqërive të ndryshme në tërë Amerikën.

Konferencat e mija u-botuan ploterisht ose pjesa prej gazetave kryesore në qytetet ku fola. Shkrova dhe shumë artikulla nëpër gazetat për të inkurajuar Amerikanët t'a ndihmojnë Qeverinë dhe Popullin Shqiptar të ngrejnë një Shtet model këtu në Balkan; Nje Shtet që të jetë model në konstituten, ligjet, sistemin financiar, sistemin aresimtar dhe jetën industriale të sajnë; një Shtet i cili të ketë methudat dhe menyrat më të mira që janë cpikur prej mendjeve me të forta të botës për perparimin, mirësimin, shendetesimin, lirimin dhe drivillimin me te naltë të racës shqyptare. Këta artikulla u-mirëpritnë prej popullit Amerikan dhe mu dërguan shumë letra vetiake prej njerëzve të shënuar Amerikanë, që tregonin interesim dhe simpathi për idenë e cfaqur.

Nga kjo propogandë u-krijua një grup prej tridhjetë – e- pesë gjer dyzet vetash, nga më të shënuarit ekspertë mi tërë parimet dhe problemet fundamentale, që janë cdrivillime për ndertimin të një Shteti model, domethenë: Konstitute dhe Ligje, Sistem Juridik, Financa (monedhe, banka dhe kredite), Administratë tregtare, Engjinieri në tëre degët e saj, Bujqësi, Shëndetësi, Arësim, etj. etj. Këta njerëz janë gati ose të vinë në Shqipny t'i shërbejnë Qeverisë dhe Kombit, ose të bashkëpunojnë me çdo mënyrë

që është e mundur me përfaqësuesit e Shqypnis në Shtetet e Bashkuara.

Në këto kohë fort delikatë të jetës së kombit, kur jan animet në të gjitha anët, me shtetin plotësisht pa-organizu, pa gen konstitucion mbi të cilën mundet të përkrahet për të kërkuar njoftimin e botës, si një shtet, pa një system financiar kombetar, pa një bankë me të cilën të punojë, pa patur një veprim industrial në komb, me një popull të dëshpëruar dhe të shqetësuar, i gati për intrigat dhe propaganda të huajve; këto veprime që propozoj do të bejnë dy gjërat shumë të important:

(1) Do të bënte te kuptojn ata kombe që janë armik të Shqypnis, të cilat na tjetër anë kan edhe nevojë nga Amerika, të pushojnë ataket kundër Shqypnis;

(2) Do të inkurajonte dhe të jepte zemër me një herë popullit shqiptar, që ashtu do të përkrahte me të gjithë shpirtin Qeverinë.

Sikur ky progress të përdoret, jam i sigurt se më pak vjet kombi Shqyptar do të lulëzojë i lirë e plote i lirë nga shtypjet (oppression) e armiqëvet e saj, e mjaft i përparuar në udhën e saj për lumturi të gjithanshme.

ERICKSON-I DIPLOMAT NË AMBASADËN AMERIKANE NË TIRANË, 1922

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e njohën shtetin shqiptar dhe vendosën marrëdhënie diplomatike më 28 korrik të vitit 1922. Ministër Amerikan në Shqipëri u emërua Ulysses Grant-Smith, i cili arriti në Tiranë në dhjetor të atij viti. Ndërkohë që vendi përpëlitej të ndërtonte një qeveri të qëndrueshme dhe të hapte rrugën e ndryshimeve dhe të reformave, Erickson-i vazhdonte të ishte bashkudhëtar i saj në çdo hap. Megjithëse nuk gjenden shumë dokumente, që na japin mënyrën se si ndodhi që ai u bë anëtar i stafit të Ambasadës Amerikane në Tiranë, prapëseprapë një notë e kësaj ambasade dërguar ministrit të Punëve të Jashtme, e gjetur në Arkivin e MPJ-së të RSH-së□ e vërteton këtë. Këtu më poshtë është teksti i notës i përkthyer në gjuhën shqipe:

Legata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Tiranë

Ministrisë së Punëve të Jashtme Prot. C-IV- 770 arritur më 6-III-1923

Shkëlqesisë së tij, Monsinjor Pandeli Vangjeli

Ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë

Tiranë

Ministri amerikan i paraqet komplimentet e tij ministrit shqiptar të Punëve të Jashtme dhe ka nderin të transmetojë bashkëngjitur informacionin e mëposhtëm me listën e personelit dhe punonjësve ndihmës të legatës.

Lista:

Rodgers, J.Donald, C., sekretari i parë i legatës

Erickson, Charles Telford, zyrtar i legatës

Minor George C., zyrtar i Legatës

Kuqali, Kol (Shtetas shqiptar), përkthyes

Shërbëtorë:

Anthony Stevens (shtetas amerikan), postier

Sulejman Përmeti, kavas

Ahmet Osmani, kuzhinier

Beqir Feta, shërbyes

Shaja Meti, shtëpiake

Hane Xhemaili, shtëpiake

Z.Grant Smith përfiton nga rasti për t'i rishprehur Shkëlqesisë së tij z.Pandeli Vangjeli, sigurimet e konsideratës së tij më të lartë.

Tiranë, 2 mars 1923

Kështu, pra, këtë radhë e gjejmë Erickson-in si një diplomat amerikan në legatën e sapohapur të vendit të tij. Nuk ka shumë të dhëna për veprimtarinë e tij si diplomat, por një gjë është e sigurt: Çfarëdo që të ketë bërë dhe çfarëdo të ketë menduar, ai në atë pozitë do të ketë ndihmuar Shqipërinë. Ne e dimë se në atë kohë ai gjendej në Tiranë në shoqërinë e Mehmet Konicës, Ahmet Zogut, Fan Nolit dhe mendonte për projektet që do ta zhvillonin Shqipërinë.

Erickson-i zhvilloi, në mënyrë të veçantë, një shoqëri të madhe me Edit Durhamin. Korrespondenca e tyre na jep një pamje tjetër të shndritshme të dashurisë së tyre për Shqipërinë. Por le të shohim një letër krejt të veçantë nga natyra që Erickson-i i dërgon Miss Durhamit:

Tel: Skanderbeg *phone London*

Phone Mayfair 1819

Albanian Delegation

26 A North Audley Street, W1

August 14

E dashur Miss Durham,

Dy ditë më parë zbulova në Journal des Debats një telegram të gjatë nga Beogradi prej korrespondentit të tyre me disa fjalë të thëna prej një farë Basri Bej nga Konstandinopuli, i cili paskësh hyrë në një marrëveshje me Komitetin Maqedon, me qëllim që të punonin për një shtet shqiptaro-maqedon. Ata do të nxisnin një revolucion në Prizren, Dibër, Strugë, Ohër dhe Podgoricë në interes të popullatës dhe në bazë të saj Italia do t'u kërkojë Fuqive një plebishit në tërë rajonin. Aty thuhet se Italia po e mbështet fort këtë lëvizje, pasi një komitet i tillë është organizuar edhe

në Romë. Ata kishin mbledhur një gjysmë milioni lira për të bërë propagandë dhe e kishin vendosur edhe datën kur do të shpërthente revolta, që është 15 shtatori.

Nëse është kështu, do të ketë disa gjëra me interes për t'i bërë dhe kjo shpjegon edhe pajtimin e menjëhershëm të Italisë ndaj kushteve të vëna nga Shqipëria. Sa më shumë ta kundërshtojmë këtë luftë të vazhdueshme dhe të gjatë, për të kaluar në një periudhë paqeje, e cila na ndihmon të rindërtojmë ndjenjën kombëtare bashkë me shumë gjëra të tjera, më mirë do të jetë për bashkimin e tërë racës shqiptare. Unë nuk guxoj ta mendoj një luftë tjetër, pasi më përvëlohet shpirti prej saj.

Nëse dëgjoni ndonjë gjë të rëndësishme ndërkohë që udhëtoni, ose kur të jeni në Itali, të lutem ma tregoni edhe mua. Kur Konica me shokë janë larg, unë marr shumë pak informacion prej tyre. Madje nganjëherë nuk marr qoftë edhe një rresht prej Konicës në përgjigje të shumë letrave të rëndësishme që ia dërgoj atij.

Por dua të këshilloj diçka - largohu për pak kohë dhe harro se ka Shqipëri për pak çaste dhe gëzo pak kohë të mirë, pusho dhe merre veten dhe rigjenero mendjen, shpirtin dhe trupin. Të lutem, më lër adresën ku do të jesh, në mënyrë që të mund të komunikoj me ju.

Shumë sinqerisht i juaj

Charles Telford Erickson[155]

[155] Welcome to the Royal Anthropological Institute, Edith Durham Collection.

Veç të tjerash, Erickson-i ishte një mik i ngushtë i miqve të vërtetë të Shqipërisë, në veçanti i atyre anglezë, si Nevington, Aubrey Herbert, Arthur Murray, Wolter Guinnes etj. Me ta ai shkëmbente letra dhe artikuj, shkruanin së bashku në gazetat më prestigjioze të kohës. Një e tillë është letra që një grup miqsh të Shqipërisë i kishin dërguar botuesit të gazetës "The Times" me titull:

PAQE NË BALLKAN

Nga, Aubrey Herbert,

Wolter Guinnes,

M.E. Durham,

C. Telford Erickson,

Arthur Murray,

Letër botuesit,

E drejta e autorit, rezervuar gazetës ***THE TIMES, 1920***

Zotërinj,

Heqja dorë nga pretendimet e veta ndaj Vlorës dhe pjesëve tokësore përreth saj, si dhe pushimi i këtyre pretendimeve ndaj një mandati të Italisë mbi Shqipërinë – megjithëse këto i ishin premtuar asaj – prapëseprapë përbën një shembull për t'u lavdëruar. Ky është një prej hapave më të rëndësishëm të ndërmarra në drejtim të vendosjes së një paqeje në Ballkan që është ndërmarrë ndonjëherë.

Italia e njeh të drejtën e Shqipërisë për të qenë e pavarur brenda kufijve të vitit 1913 dhe është përgatitur ta mbrojë atë të drejtë. Z Pashiq e ka deklaruar tashmë zyrtarisht

në Konferencën e Paqes se Jugo-Sllavia është në favor të një Shqipërie të pavarur në vijat kufitare të tërhequra në vitin 1913. Prandaj është për të ardhur keq dhe për t'u habitur që ne marrim vesh se, ndërsa Italia është tërhequr nga Shqipëria, serbët kanë përparuar dhe kanë shkelur kufirin verior.

Ne besojmë se ky do të jetë vetëm një incident i vogël kufitar. Por në interes të paqes – dhe nuk duhet harruar asnjëherë se paqja e Europës varet në masë të madhe nga zgjidhja e çështjeve racore të Ballkanit - ne besojmë se nuk duhet humbur kohë më, dhe se kufijtë e Shqipërisë, siç janë përvijuar në vitin 1913, duhet të njihen me shpejtësi dhe të garantohen prej Fuqive kundër çfarëdo agresioni të mëtejshëm…Ne mbetemi…etj.[156]

Nënshkruar:

Por ajo që vërtet e shqetësonte Erickson-in ishte forma e qeverisjes dhe drejtimi i shtetit demokratik shqiptar nën një formë regjimi që do t'i shkonte për shtat vendit tonë. Një ndër episodet më interesante të kësaj periudhe është tentativa për të vënë në krye të fronit shqiptar mikun e ngushtë të popullit shqiptar, kolonelin anglez, Aubrey Herbert. Erickson-i e tregon vetë historinë se si bashkë me Mehmet Konicën ia ofruan kurorën shqiptare kolonel Herbertit, si në kapitullin që vijon.

[156] Center for Albanian Studies, Archive, London.

ERICKSON-I – EMISAR PËR GJETJEN E NJË MBRETI PËR KURORËN SHQIPTARE – ANGLEZI AUBREY HERBERT[157]

Në një ndër mbrëmjet ku mblidheshin njerëzit e shqetësuar të asaj kohe për të ardhmen e Shqipërisë, gjatë diskutimeve Erickson-i u përfshi në një debat i cili kishte të bënte pikërisht me formën e regjimit në Shqipëri. A do të kthehej ajo në monarki? Kush do të ishte monarku? Erickson-i e përshkruan këtë me ngjyra dramatike dhe një fund tragjik për njeriun i cili i kishte kushtuar një pjesë të mirë të jetës së vet, Shqipërisë, anglezi Aubrey Herbert[158]. Këtu është një përshkrim i atij debati:

> *"Kjo qeveri e përkohshme, me të cilën ju po punoni tani, nuk e përligj qëndrimin tuaj jashtë vendit. Kjo duket më tepër sikur ju kishit shumë pak ide se çfarë kërkonte Shqipëria, ose sikur ta shihnit skemën e vetëqeverisjes së saj si diçka të përkohshme dhe që meriton të rrëzohet. Kështu të gjithë u morën me atë punë dhe diskutuan mbi të mirat dhe të këqijat e një republike sipas modeleve zvicerane dhe amerikane, me përparësitë që do të kishte nisur nga fakti se njerëzit ishin mësuar që prej kohëve të lashta të zgjidhnin prijësit e vet, parinë, bajraktarët, pleqtë e fshatrave dhe të komunave, të cilët vepronin si trupa qeveritare.*

[157] Aubrey Herbert, Somerset County Records, File nr 3.

[158] Po aty.

Pastaj iu shkrepi ideja e mbretërisë dhe i bëri të zbraznin tërë idetë që kishin. A duhej të ishte një monarki kushtetuese? Sigurisht! A duhej të ishte "Ai" një i huaj? Kjo shkaktoi menjëherë reagimin e të gjithëve, duke kujtuar fatin e Princ Vidit. Disa thanë se atij nuk iu dha asnjëherë një mundësi dhe kombi e kishte detyrë nderi që t'i jepte atij një rast tjetër nëse një mbret do ta sundonte këtë vend ndonjëherë. Ahmet Zogu iu bashkua bisedës po aq energjikisht sa edhe të tjerët dhe unë jam i sigurt se ideja e tij për t'u bërë ndonjëherë mbret i Shqipërisë as që i kishte shkuar ndër mend në atë kohë. Dhe më pas, krejt aty për aty, nga ana ime thashë:

"- Pse të mos të zgjidhni një mbret britanik?". Kjo filloi të nxiste fantazinë e bisedës. "Përse propozoni një britanik?" Për të mbrojtur propozimin tim, u përgjigja duke i përmbledhur mendimet dhe duke vijuar bisedën, pasi në të vërtetë nuk kisha menduar për këtë ndonjëherë më parë. Një mbret britanik mund të jetë një bërryl ndaj propagandës italiane, prej të cilës ne të gjithë duhet të frikësohemi. Ai do të ishte në gjendje të siguronte kreditë e domosdoshme me të cilat të fillonte dhe të zhvillohej industria e vendit, e cila ka mbetur krejt në vend. Britania e Madhe nuk do të kishte interesa egoiste, siç është kolonizimi, diçka që e dimë se e ka Italia apo futjen e vendit brenda suazave të perandorisë, gjë e cila e dimë se është në mendjen e Italisë. Ideja u kap menjëherë. "Nuk besoj se mund të marrim Princin e Wellsit ose ndonjë tjetër prej bijve të Xhorxhit, por midis aristokracisë së tyre, dikë që të jetë më i përshtatshëm".

"A keni dikë në mendje?"

Për të mos u treguar tërësisht jashtë loje u përgjigja:

"Po, kam".

"Kush është ai?", më pyetën menjëherë.

Iu thashë: "Kolonel, Aubrey Herbert"

"A mendoni se ai do ta konsiderojë këtë?"

Iu përgjigja se mendoja se ai do ta konsideronte atë shumë seriozisht përpara se

ta hidhte poshtë. Kjo ndodhi pikërisht kur unë sapo e kisha marrë kontratën time për Kolegjin Shqiptaro-Amerikan të Bujqësisë, i dekretuar si ligj prej parlamentit dhe nënshkruar e vulosur prej Kryetarit të Kuvendit dhe Regjentëve. Ato ditë po planifikoja të ikja për në Shtetet e Bashkuara për të filluar fushatën në emër të tyre.

Kështu ata më thanë: "Mirë atëherë, shko nëpërmjet Londrës dhe paraqitja ofertën dhe shihe se çfarë do të thotë. Por ta supozojmë se e pranon, çfarë do të bëjmë pastaj?" Kësaj Ahmet Zogu iu përgjigj: "Unë do të kujdesem për këtë. Si drejtues i ushtrisë unë do t'i dërgoj trupat e mia nga Mati në Durrës për manovra sapo ai të arrijë. Ne do ta marrim nga anija e tij, ta sjellim këtu me nxitim, ku çdo gjë do të jetë gati dhe ai do të kurorëzohet si mbret i Shqipërisë përpara se bota ta marrë vesh se mbreti po e merrte atë detyrë".

"Por a do të rrinin duarkryq përkrahësit e Princ Vidit pa bërë trazira, pasi ata ishin në numër të madh nëpër tërë vendin, përfshirë edhe Aqif Pashën e Elbasanit?"

"Unë do të kujdesem për këtë", ishte përgjigjja e tij e menjëhershme.

Kështu u vendos aty për aty sikundër e tregova.

Për ta plotësuar këtë histori: Unë shkova në Londër, në Westminster, aty ku parlamenti ishte në seancë punimesh dhe ku kandidati ynë ishte anëtar i tij. I dërgova letrën dhe e prita tek lobi. Pas disa minutash ai erdhi, më pa, qeshi me gjithë shpirt, sepse ishte mik i vjetër dhe shumë i dashur i imi dhe bërtiti:

"Tungjatjeta Erik, çfarë të paska sjellë në Londër?"[159]

Me tërë frymën i thashë se kisha ardhur për t'i paraqitur një ofertë për mbretërimin

[159] Kjo ngjarje afërsisht kështu përshkruhet prej vetë Aubrey Herbert-it në librin Albania's Greatest Friend, Aubrey Herbert and the Making of the Modern Albania, faqe 350, në ditarin e datës 13 gusht 1923, në Pixton Park, Dulverton. Ai e përshkruam si më poshtë: "Një fundjavë e këndshme. Erickson-i erdhi nga Shqipëria. Këtë herë e desha më shumë… Ai më tha se ideja e mbretërimit është duke u kthjelluar në Shqipëri…" Në ditarin e datës 6 shtator 1920 Herberti shkruan: "Të shtunën e kaluar erdhën Mehmet Konica dhe Erickson-i dhe mendoj se ishin të kënaqur. Sot në mëngjes dola bashkë me Erickson-in. Ai donte të shkonte në Amerikë të fillonte punën për një kredi për Shqipërinë." (Shënimi im – MB)

e Shqipërisë.

"Çfarë është ajo që më the?" Unë ia përsërita deklaratën time, duke i shtuar se isha autorizuar prej Qeverisë së Përkohshme të Shqipërisë për t'i ofruar kurorën atij.

"O Zot i madh, më duhet të pi diçka! Eja me mua!"

Kështu ai më mori tek bari i katit të nëndheshëm, ku e diskutuam çështjen qetësisht për një orë ose më shumë, me uiskin dhe pijet e buta përpara nesh. I tregova për tërë çfarë kishte ndodhur dhe besimin tim të thellë se ai ishte ndoshta njeriu i vetëm që mund të shpëtonte Shqipërinë nga një fiasko tjetër dhe nga rënia e saj përfundimtare në duart e Italisë. Natyrisht që ai ishte thellësisht i emocionuar. Zakonisht ai i merrte edhe gjërat më serioze në një mënyrë thuajse lozonjare. Përshtypjet e tij nga përvojat e tri luftërave: Francë, Gallillopus dhe "Mespot" mbushnin vëllime nga më magjepsëset të shkruara për Luftën Botërore. Këtë herë nuk kishte fshehje emocionesh. Pasi ia paraqita këtë çështje nga Shqipëria, ai qëndroi për disa minuta në heshtje, u përpi gati si i shushatur dhe i pazoti për t'u përgjigjur. Pastaj ngriti kokën dhe më pa, gati si një gjuetar, drejt e në sy, dhe m'u përgjigj:

"Mirë atëherë, nuk dua të them jo. Le të shkojmë në shtëpi dhe të shohim çfarë do të thotë bashkëshortja ime."

Ditën tjetër ne shkuam në shtëpinë e tij në fshat bashkë me Mehmet Konicën, ministrin shqiptar në Britaninë e Madhe. Atje, për dy ditë të tëra, u diskutua kjo çështje me tërë të mirat e të këqijat e veta, pa ndërprerë, nga fillimi në fund, parë nga çdo aspekt i mundshëm.

Kjo nuk duhej të ishte një çështje që mund të trajtohej pa kujdes, nuk ishte një çështje ambicieje, as një aventurë gazmore për mbretërim. Pastaj mbrëmjen e ditës së tretë ai më thirri veçmas në studion e tij, për të më kumtuar vendimin e tij përfundimtar. Ai më çoi drejt një karrigeje, por unë i kërkova leje që të qëndroja në këmbë. Isha aq i shtrënguar dhe i tensionuar, sa nuk mund qëndroja ulur.

"Mirë atëherë, unë kam vendosur ta pranoj ofertën", tha ai, por kur u turra që t'i merrja dorën, ai më ndaloi me një lëvizje dhe shtoi:

"Ekziston një pengesë e madhe në këtë rrugë, Erik. Unë nuk jam mirë me shëndet. Më duhet të bëj një operacion shumë të rëndë, për të cilin kirurgu më jep një shans pesëdhjetë me pesëdhjetë për qind për shpëtim. Unë e kam shtyrë atë tepër gjatë, por do ta bëj atë pa vonesë. Nuk di askush në botë për këtë gjë, përveç gruas sime dhe familjes, kështu të lutem mbaje për vete, derisa të jetë mbyllur kjo çështje. Unë shpresoj për më të mirën dhe nëse ia hedh dot, do t'i jap Shqipërisë gjithçka në fuqinë time për ta ndërtuar atë si një shtet të fuqishëm që e mban vetveten".

Ai më tha edhe shumë gjëra të tjera, por kjo mjafton për të treguar këtë histori. Unë e mora rrugën për në Shtetet e Bashkuara dhe disa ditë pasi arrita atje, mora një kabllogram, i cili i lëshoi tërë shpresat tona përtokë. "Mbreti" ynë kishte vdekur në operacion përpara se t'i vinte koha që ndonjëherë të bënte betimin. Ky burrë ishte Aubrey Herbert[160], i biri i zonjës Carnarvan, nipi i Sir Ronald Lindsey, i cili sapo kishte dalë në pension si ambasador i Britanisë në Uashington. Lordi Carnarvan, zbuluesi i varrit të Tutankamonit, ishte gjysmë vëlla me të. Aubrey qe një shpirt fisnik, i lindur si i tillë dhe kishte jetuar si i tillë. Ikja e tij nga kjo botë në një kohë të tillë i shtoi një tjetër episod fatkeqësisë së stërzgjatur të historisë së Shqipërisë, edhe ashtu e mbushur plot e përplot me të tilla. Në fakt, pas kësaj u konsideruan edhe një ose dy kandidatë, por as nuk u ndërmor ndonjë gjë dhe aq më pak nuk u përmbush. Historitë që hasen herë pas here nga dikush që thotë se i ishte ofruar froni i Shqipërisë, qoftë si mbret apo si mbretëreshë, përbëjnë lexime me imagjinatë të këndshme.

[160] Aubrey Nigel Henry Molyneux Herbert (1880 – 26 shtator 1923) ishte diplomat britanik, udhëtar dhe oficer i shërbimit të fshehtë, i lidhur me pavarësinë e Shqipërisë. Atij ia ofruan dy herë fronin e Shqipërisë. Nga viti 1911 derisa vdiq, ishte deputet konservator në parlamentin britanik. Ai u bë përkrahës i zjarrtë i pavarësisë së Shqipërisë, vend të cilin e vizitoi në 1907, 1911 dhe 1913. Gjatë qëndrimit në Tiranë më 1913 ai u miqësua me Esat Pashën. Kur arritën në Londër në Konferencën e Paqes për Ballkanin 1912-1913, delegatët shqiptarë arritën të siguronin ndihmën e Herbert-it si këshilltar. Ai u tregua shumë aktiv në mbrojtje të çështjes së tyre dhe vlerësohet se ushtroi një ndikim të konsiderueshëm në procesin e njohjes së pavarësisë së Shqipërisë në Traktatin e Londrës në vitin 1913. Edith Durham-i e mbante atë të informuar përmes korrespondencës së vazhdueshme. Emrin e Herbert-it e mori Biblioteka Kombëtare në Tiranë, në një fond që dhuroi e shoqja, si dhe një fshat në Shqipëri. Më vonë, qeveria komuniste e shpërfilli tërësisht veprën e tij aq të dobishme për shqiptarët. (Shënimi im – MB)

Shqiptarët janë një racë fisnike, veçanërisht në drejtim të grave, dhe një propozim i asaj natyre përbën një gjest shumë mirënjohës dhe fisnik, si vetë raca. Unë vetë njoh shumë prej tyre. Gjithashtu prej amerikanëve të ndryshëm të cilët aspiruan seriozisht ta merrnin atë pozicion, ishte edhe një ndihmësi im. Por asnjë prej tyre, dhe për këtë jam plotësisht i bindur, nuk e kishte atë staturë, të cilën e përshkrova me shkrim për herë të parë këtu.

SHQIPËRIA, VENDI I ZHGËNJIMEVE POLITIKE TË PAFUND

Më 17 dhjetor 1920, Shqipëria u pranua përfundimisht në Lidhjen e Kombeve – një hap i interpretuar prej disave si njohje e nënkuptuar e Shqipërisë si një shtet i vetëqeverisur. Megjithatë, çështja e pazgjidhur e kufirit shqiptar vazhdoi të dëmtonte pozicionin e saj ndërkombëtar. Në skenën e brendshme, ekonomia shqiptare e pasluftës ishte në gjendje ngecjeje dhe kaosi të plotë. Ajo varej nga një sistem jofitimprurës dhe arkaik bujqësor, me kapacitete të cilat ishin minimale, ose që mungonin fare. Do të ishte gabim të pritej që bejlerët më me influencë të braktisnin traditat e tyre joproduktive. Kushtet ekonomike po përkeqësoheshin dhe veprimtaria e forcave politike vetëm sa i dëmtonte ato edhe më shumë.

Erickson-i, me vitet e tij të përvojës në Shqipëri, kuptoi se në një periudhë më afatgjatë, traditat ekzistuese të punës duhej të zëvendësoheshin me forma të reja. Po ashtu klasa udhëheqëse duhej të zëvendësohej me një grup burrash të aftë, të frymëzuar prej parimeve të liberalizmit perëndimor dhe të ndiqnin një politikë sociale të përkushtuar ndaj përmirësimit të jetës fshatare dhe reformës agrare. Duke e përqendruar vëmendjen e tij në kushtet e prapambetura të sektorit bujqësor të ekonomisë shqiptare, Erickson-i parashikoi si hap fillestar dhe të përkohshëm krijimin e disa fermave ose bashkësive komunale rreth qendrave të fshatrave

kryesore të vendit.

Në fakt, bejlerët e keqpërdornin sistemin e tyre arkaik të pronësisë mbi tokën si një përpjekje për të mbajtur kontrollin e plotë mbi fshatin. Megjithatë, në pranverën e vitit 1922 fshatarët që jetonin në Shqipërinë Qendrore dhe Jugore po fillonin të vinin në dyshim pozicionin e privilegjuar dhe kontrollin e pronësisë mbi tokën. Erickson-i, në një përpjekje për të shmangur një trazirë shkatërrimtare dhe të panevojshme, propozoi rishpërndarjen e tokës pronarëve bejlerë midis fshatarëve. Nëse kushtet ekonomike, të cilat Erickson-i i kishte vënë re në sektorin bujqësor të Shqipërisë pasluftës, do të përmirësoheshin nëpërmjet një risie të tillë, më pas ky hap transitor do të kalonte në një fazë tjetër. Ai do të zëvendësohej prej një sistemi më dinamik, bazuar në përfitimet e rritura, që do të motivonin forcat të cilat do të çonin tek nxitja e shpirtit prodhues të fshatarit shqiptar.

Parë thjesht në prizmin ekonomik, propozimi i Erickson-it ishte i papranueshëm po të kihet parasysh gjendja financiare dhe kreditë e pamjaftueshme që siguroheshin qoftë nga brenda, qoftë nga jashtë. Sikur politika e reformës agrare e Erickson-it të ishte zbatuar në kohën e duhur, atëherë ndoshta bujqit do të kishin treguar një shpirt më produktiv dhe kështu do të kishin përmirësuar prodhimin bujqësor. Kjo do sillte edhe ngritjen e dinjitetit të tyre njerëzor dhe ndërgjegjen shoqërore. Kësaj i shtohet edhe rritja e nivelit të jetesës dhe ajo e tregut, që do të sillte edhe zhvillimin industrial të vendit.

Megjithatë, në analizën përfundimtare, qeveria shqiptare, e cila kontrollohej në shumicë prej bejlerëve, nuk zotëronte as kapitalin, as vizionin e nevojshëm për të përshpejtuar reformën e tokës. Fatkeqësisht, reforma e tokës mbeti një ëndërr e parealizuar deri pas Luftës së Dytë Botërore. Por edhe ajo që u bë pas luftës, mbi bazën e parimeve komuniste, solli andralla të tjera, edhe më të mëdha, për bujqit shqiptarë.

Por le të kthehemi tek përpjekjet e Erickson-it për mbarëvajtjen e punëve të shtetit shqiptar. Ai merrej me një qeveri jo të qëndrueshme, të goditur nga trazirat e shkaktuara prej veprimtarive të elementëve vendas dhe agjentëve bolshevikë.

Përveç kësaj, një masë e madhe e popullit shqiptar po fillonte të ndiente neveri për gjendjen e vet të tmerrshme dhe të padurueshme shoqërore. Gjatë udhëtimeve në Jug të Shqipërisë, në tetor të vitit 1921, Erickson-i pa se kishte interesim në rritje për bolshevizmin midis fshatarëve të varfër, të cilët po planifikonin ta merrnin për vete pronësinë mbi tokën që e kishin bejlerët. Megjithëse qeveria shqiptare u tregua e pandjeshme ndaj thirrjeve fillestare të tij për reformën agrare, Erickson-i vazhdoi t'i bënte thirrje qeverisë që të angazhohej në projekte, me qëllim që të krijonte vende pune për të gjithë të papunësuarit. Në vend të kësaj qeveria, reagoi ashpër ndaj grupeve të vogla të revoltuara, i dënoi egërsisht organizatorët dhe pjesëmarrësit, gjë që solli një përkeqësim të jashtëzakonshëm të vetë marrëdhënieve të saj me popullin.

Veprimet shtypëse si këto bënë që Fan Noli, si një reformator liberal, të linte Partinë Popullore dhe të formonte një grup tjetër politik në opozitë ndaj Zogut dhe politikave të tij. Edhe përkundër kësaj kundërvënieje ndaj taktikave të Zogut, mbështetësit konservatorë e rritën fuqinë e tyre në qeveri. Në zgjedhjet e vitit 1924 ata fituan dyzet vende, ndërsa mbështetësit e Nolit vetëm 35. Në më pak se një muaj më vonë, Zogu dha dorëheqjen si kryeministër nën kërcënimet për vrasje. Pasardhësi i tij Shefqet Vërlaci, një pronar tokash, jo vetëm që nuk ia doli të fitonte mbështetjen e duhur nga elementët liberalë në Asamblenë Kushtetuese, por gjithashtu dështoi të vepronte nën kushtet e rënda ekonomike me të cilat ballafaqohej kombi, duke bërë që opozita liberale të çirrej me zë edhe më të lartë për një qeveri të re.

Politikat qeveritare u shfrytëzuan gjithashtu në të gjitha mënyrat prej forcave të bolshevizimit. Qeveria bolshevike kishte kërkuar tashmë marrëdhënie diplomatike si hapi i parë drejt një Republike Shqiptare miqësore ndaj Bashkimit Sovjetik. Detyra e formimit të Partisë Komuniste Shqiptare iu ngarkua Konstandin Boshnjakut, një i ri intelektual shqiptar, i edukuar në Rusi.

Puna e tij propagandistike komuniste pati ndikim midis shqiptarëve të rinj, të cilët ishin anëtarë të organizatës social-politike "Bashkimi" e themeluar në

vitin 1922. Boshnjaku ndihmohej në punën e tij nga komunisti bullgar Dimitri Pençev. Duke udhëtuar nëpër Shqipëri, i veshur si gazetar, Pençevi kishte për synim të realizonte dy misione: së pari, të vendoste marrëdhënie diplomatike midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik; së dyti, të shpërndante idetë komuniste në tërë Shqipërinë. Ndodhi që Boshnjaku të mos kishte sukses në themelimin e Partisë Komuniste, ndërsa Pençevi nuk arriti të siguronte njohje diplomatike nga Rusia. Në atë kohë, kur Noli kishte ardhur në pushtet nëpërmjet një grushti shteti, i vetmi rezultat i arritur ishte lëshimi që bëri qeveria shqiptare e Nolit për të mbajtur një minutë heshtjeje për vdekjen e udhëheqësit komunist sovjetik, Lenin. Por puna e veprimtarëve bolshevikë nuk u ndal gjatë tërë viteve 1920 dhe 1930. Por si erdhi situata deri këtu?

Më 5 maj 1924, Avni Rustemi, një anëtar i shquar i Asamblesë Kombëtare, i cili kishte vrarë Esat Pashë Toptanin në Paris, u vra jashtë godinës së parlamentit. Deputetët e opozitës liberale, të drejtuar nga Fan Noli, e akuzuan Zogun si të përfshirë në këtë krim. Më 17 qershor 1924 Fan Noli e përzuri Zogun dhe formoi një kabinet të vetin qeveritar. Ai menjëherë e filloi punën për reformën agrare. Përveç ndikimit emocional që shkaktoi vrasja e Avni Rustemit, ngritja e menjëhershme politike e Nolit u bë e mundur kryesisht për shkak të udhëheqjes së mëparshme që kishte dështuar edhe në reduktimin e ndikimit të fuqishëm të bejlerëve edhe në shpërfilljen e nevojës për kryerjen e reformës agrare. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se koalicioni liberal që mbështeste Fan Nolin, në dukje, ishte i suksesshëm në punën e vet për bindjen e disa prej fshatarëve, që fuqia e bejlerëve udhëheqës duhej të zvogëlohej përpara se të dekretohej reforma agrare.

Premtimet e Nolit për reformën agrare duhet të kenë ngjallur një farë shprese për Erickson-in, i cili e pat ngritur këtë çështje tek qeveria e mëparshme shqiptare. Por deklaratat e Nolit ndezën zemërimin e bejlerëve. Si pasojë e mungesës së bashkëpunimit dhe armiqësisë së thellë, fshatarët u zhgënjyen nga premtimet e papërmbushura të Nolit. Kështu, ata e lanë qeverinë e tij në kotësinë e vet. Dobësia

dhe dështimi i këtij koalicioni liberal theksoi polarizimin e strukturave shoqërore të Shqipërisë së asaj kohe.

Është fakt se burrë i shtetit më ideal për Fan Nolin mbeti Presidenti Wilson. Këtë lloj adhurimi e shfaqnin shumë shqiptarë, për shkak të rolit që Presidenti pat luajtur në Konferencën e Paqes në Paris. Gjatë qëndrimit të tij të shkurtër në zyrën e kryeministrit, Noli shprehu publikisht mirënjohjen e tij për përpjekjet e Wilsonit për të shpëtuar Shqipërinë. Kështu ai i ndryshoi emrin portit të Shëngjinit ("San Goviani de Medua") dhe ia vuri atij emrin "WILSON".[161] Por as ky gjest i lartë nderimi për Presidentin Wilson nuk mundi ta ndalonte rënien e qeverisë jetëshkurtër të tij. Kështu, më 24 dhjetor 1924, Ahmet Zogu marshoi triumfalisht në Tiranë. Aty nga fundi i janarit të vitit 1925, Asambleja Kushtetuese Shqiptare përqafoi një formë republikane qeverisjeje. Duke marrë ShBA-në si model, ata zgjodhën Ahmet bej Zogun, President të Republikës për një periudhë prej shtatë vjetësh. Me t'u bërë president, Zogu filloi të mendonte dhe të punonte për një monarki kushtetuese. Kjo periudhë trazirash politike përbën edhe pjesën zhgënjyese të jetës së Erickson-it në Shqipëri. Ai kishte shpresuar shumë tek vendosja e një rendi që do të nxiste investimet e huaja. Por kjo që po ndodhte vërtetonte të kundërtën. Përveç problemeve që kishte bujqësia, planeve e ëndrrave të tij të pafund për ngritjen e Kolegjit Kombëtar të Bujqësisë, Erickson-i kuptonte se ekonomia e paqëndrueshme shqiptare nuk do të mbijetonte pa hyrjen e kapitalit dhe investimeve private afatgjata, të mbështetura nga kreditë ndërqeveritare[162].

[161] Emri i portit u hoq menjëherë nga qeveria komuniste në vijim të punës për shpërfilljen dhe errësimin e çdo vepre që anglo-amerikanët kishin bërë në dobi të kombit dhe popullit shqiptar. (Shënimi im, MB)

[162] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

ERICKSON-I - EKSPLORATOR I VAJGURIT SHQIPTAR

Duke qenë se ai kuptonte shumë mirë situatën në Shqipëri dhe e dinte shumë mirë potencialin që mund të kishin investimet private të ShBA-së nëse vinin, Erickson-i filloi të hetonte rezervat e vajgurit, të cilat i kishin zbuluar italianët afër Vlorës në vitin 1919. Zbulimi i tyre i kishte shtyrë edhe më shumë dëshirat italiane për të aneksuar Vlorën dhe pjesën e saj të brendshme tokësore në fund të Luftës I Botërore. Që nga viti 1920, rezervat e vajgurit të Shteteve të Bashkuara kishin rënë në vendin e shtatë të totalit botëror kur ajo vetë konsumonte më shumë vajguri se e tërë pjesa tjetër e botës së bashku. Duke pasur parasysh rrethana të tilla, interesimi i Erickson-it për këtë fushë të ekonomisë shqiptare dhe mundësinë e investimeve amerikane në to, ishte plotësisht i arsyeshëm. Prandaj, ai i kushtoi një vëmendje shumë të madhe kësaj çështjeje. Kështu, ai erdhi në përfundimin se shumë kompani vajgurore amerikane mund të përfitonin nga mundësia për të kërkuar në fushat e ardhshme të naftës së Shqipërisë.

Siç kemi thënë më parë, ai veproi për disa kohë nën petkun e komisionerit të qeverisë shqiptare në Uashington. Në maj të vitit 1921, ai bëri tentativa diskutimesh me qeverinë amerikane në emër të asaj shqiptare rreth mundësisë së investimeve amerikane në Shqipëri. Ai kishte si qëllim të bisedonte me zyrtarë

edhe në Departamentin e Bujqësisë, dhe atë të Tregtisë. Bisedimet e Erickson-it me zyrtarët e duhur në Departamentin e Bujqësisë me sa duket shkuan mirë. Kështu ai mori një letër rekomanduese për tek Herbert Hoover-i,[163] në atë kohë sekretar i Tregtisë. Aty ai u paraqit jo vetëm si një njeri i autorizuar nga qeveria shqiptare, por edhe si një individ i përkushtuar që kërkon kapital për të zhvilluar sektorin bujqësor dhe financiar të shtetit të ri shqiptar. Pasi foli me Kristian Herter-in, në atë kohë asistent i Herbert Hoover-it, në muajin qershor 1921, Erickson-i u kontaktua prej dr. Veatch-it, zëvendëspresident i Sinclair Exploration Company[164], një kompani e madhe me emër botëror edhe sot e kësaj dite në fushën e kërkimeve dhe shfrytëzimit të fushave të naftës.

Bisedimet e tyre, të përqendruara tek rezervat e sapokonstatuara të vajgurit në Shqipëri, bënë që në Shqipëri të dërgohej Ralf Super, zyrtar përfaqësues i Sinclair Exploration Company. Njerëzit e Sinclair-it ndien një farë sigurie se qeveria shqiptare do të preferonte kapitalet amerikane, veçanërisht në rast se do të jepej një koncesion vajguri. Por besimi i tyre se Shqipëria ishte e interesuar, pikësëpari për kapitalin amerikan, ishte edhe i parakohshëm, edhe jo i saktë, pasi qeveria shqiptare kishte përmbyllur pothuajse tërësisht një kontratë monopolistike për një koncesion të tillë me Kompaninë Britanike Anglo-Persiane.

Oferta anglo-persiane, nëse do të miratohej plotësisht, donte të thoshte gati pronësi ekskluzive të të gjitha të drejtave mbi vajgurin, më shumë sesa thjesht një koncesion vajguror. Ajo përmbante tri kushtet e mëposhtme:

(1) Pesëdhjetë e një për qind e stokut të mbahej prej kompanisë, 49 për qind prej qeverisë dhe popullit shqiptar; njëzet për qind të kësaj kompania duhej t'ia jepte qeverisë shqiptare pa pagesë.

(2) Koncesioni do të jepej për 50 vjet.

(3) Kompania do të lejohej tre vjet të bënte kërkimet dhe përgatitjet e nevojshme.

[163] Herbert Hoover

[164] http://www.sinclairoil.com

Më 9 korrik 1921 një raport i pakonfirmuar njoftonte se oferta e Kompanisë Anglo-Persiane për një koncesion vajguri ishte pranuar dhe dukej se ishte miratuar edhe prej Parlamentit Shqiptar.

Disa ditë pasi kjo u mor vesh, Kristian Herteri e këshilloi dr.Veatch të takohej me Erickson-in në lidhje me të ardhmen e zhvillimit të industrisë së vajgurit në Shqipëri. Nëse Kompania Anglo-Persiane nuk kishte marrë një ratifikim përfundimtar të propozimit të saj për vajgurin, a do ta merrej parasysh një ofertë tjetër e mëvonshme për një koncesion të vajgurit prej Sinclair Exploration Company si një gjest i sinqertë apo thjesht si një manovër taktike për të parandaluar miratimin përfundimtar të koncesionit anglo-amerikan? Erickson-i kishte mësuar dhe raportuar tek zyra e "Sinclair"-it se oferta e Kompanisë Anglo-Persiane nuk kishte marrë ende një miratim përfundimtar. Në fillim të tetorit, Ralf Soper-i, inxhinieri që përfaqësonte kompaninë Sinclair Exploration Company arriti në Shqipëri, me qëllim që të hetonte të ardhmen e vajgurit. Soper-i, siç duket, nën udhëzimet e dhëna nga qendra e vet përfitoi shumë nga dijenitë e Erickson-it. Sapo e takoi Erickson-in, Soper-i i kërkoi atij të pranonte një pozicion si këshilltar personal për Sinclair Exploration Company. Erickson-i, i ndërgjegjshëm për atë çfarë sillte kjo kontratë, pranoi. Duke ditur hyrjen me vonesë të "Sinclair"-it, Erickson-i dhe Soper-i nuk humbën kohë, por filluan kërkimet paraprake.

Në mëngjesin e datës 10 tetor 1921 ata u nisën së bashku me kuaj për një vend diku midis Elbasanit dhe Vlorës. Pasi iu ngjitën kodrave, Soper-i vuri re një masë zifti, e cila ishte shumë premtuese. Pasi e ekzaminuan një zonë prej pesëmbëdhjetë këmbësh, të ekspozuar ndaj rërës vajgurore brenda shtratit të serës, të dy burrat shkuan drejt Vjosës dhe e kaluan atë. Në anën tjetër të bregut të lumit Erickson-i i tërhoqi Soper-it vëmendjen tek një shenjë tjetër vajguri në sipërfaqe, e lokalizuar në një shtrat të thatë lumi. Në ditën e tretë të kërkimit, Soper-i i tha Erickson-it se ai besonte se zona e depozitave të naftës shtrihej prej Elbasanit në Vlorë. Erickson-i pa dyshim ndjeu një rreze shprese tek analizat optimiste të Soper-it për depozitat e vajgurit.

Më në fund kompania Sinclair Exploration i hapi negociatat, por ajo kishte një disavantazh të madh. Në plan të parë, Kompania Anglo-Persiane ishte përfshirë në bisedime serioze dhe potencialisht të frytshme qysh më 22 tetor 1921. Së dyti, njerëzit e "Sinclair"-it kishin në dispozicionin e tyre vetëm shërbimin me kohë të pjesshme të Erickson-it, i cili ishte angazhuar aq shumë me hapjen e shkollës bujqësore. Sipas Erickson-it, oferta për një koncesion vajguri e bërë prej Kompanisë Anglo-Persiane jo vetëm përfshinte njëzet për qind aksione të të gjithë vajgurit të nxjerrë, pa asnjë vlerësim, por gjithashtu paraqiste kërkesa për një tjetër njëzet e nëntë për qind, që do të përdorej për qeverinë shqiptare, për tregun e brendshëm ose për eksport. Si vlerësim ligjor për këtë ofertë liberale, Kompania Anglo-Persiane mëtonte pesëdhjetë e një për qind të aksioneve të çdo kompanie vajguri. Në përgjithësi, politikat britanike të vajgurit shpesh ishin fleksibël. Për shembull, në vend që të kërkonte një koncesion të plotë, një kompani britanike vajguri shpesh negocionte për një aksion me përparësi në fitim. Megjithatë, në rastin e Shqipërisë, duket se kishte pasur një synim përfundimtar për të marrë ekskluzivitetin e përfitimit të ardhshëm nga vajguri. Erickson-i, megjithatë, besonte se çështja bazë me të cilën ballafaqoheshin njerëzit që kishin të bënin me të ishte se qeveria shqiptare i shihte koncesionet e mundshme të vajgurit në kontekstin e vlerave të tyre politike ndërkombëtare.

Me fillimin e vitit 1922, kompanitë britanike dhe italiane kishin filluar bisedime me kohë të plotë në Shqipëri. Të dyja firmat kundërshtuan përpjekjet e bëra prej përfaqësuesve të "Sinclair"-it. 42. Duke pasur parasysh këto rrethana, si dhe personelin e paktë, kompania "Sinclair" do të kishte sukses vetëm nëse e bënte ofertën e saj më tërheqëse. Atyre iu ishte dhënë një mundësi tjetër, e papritur, kur qeveria shqiptare shpalli shtyrjen e të gjitha negociatave që kishin të bënin me koncesionet e vajgurit, deri pas zgjidhjes përfundimtare të ngatërresave për kufijtë shqiptarë. Në vend që të shfrytëzonin këtë kohë dhe të përfshiheshin në bisedime me kohë të plotë dhe me ekip të plotë negociues, "Sinclair"-i bëri të kundërtën. E dërgoi Soper-in në Paris që të merrej me një kompani tjetër, duke e lënë Erickson-in në një përfshirje vetjake të plotë.

Erickson-i pësoi një zhgënjim të madh prej mungesës së dukshme të angazhimit nga qendra e "Sinclair"-it. Ishte ky çast kur ai filloi të kuptonte se njerëzit e "Sinclair"-it kishin interesa financiare në pjesë të tjera të botës, të cilave iu kushtonin vëmendje parësore. Sidoqoftë, përderisa kishte mbetur edhe një mundësi për një koncesion amerikan, Erickson-i mbeti si përfaqësues e "Sinclair"-it, duke biseduar herë me anëtarët e komisionit qeveritar për koncesionet e huaja e herë me deputetët. Përveç vështirësive tashmë të njohura me të cilat ballafaqohej tenderi i "Sinclair"-it për një koncesion vajguri, Erickson-i shpejt zbuloi edhe tri pengesa tjera:

Së pari, ekzistonte një ndjesi e përgjithshme midis shumicës së zyrtarëve shqiptarë se, nëse iu jepej koncesioni cilësdo nga kompanitë, qoftë asaj "Sinclair" apo asaj britanike, vënia në shfrytëzim e fushave të vajgurit do të shtyhej për shkak se të dyja kompanitë, meqë zotëronin rezervat e tyre të vajgurit në vende të tjera, do t'i mbanin ato shqiptare si rezervë. Kjo do ta shtynte këtë proces edhe shumë vite të tjera në kohë.

Së dyti, koncesionet e vajgurit duhej të shtyheshin që të mos ndikonin ose të ndikoheshin prej vendimeve të Komisionit të Kufijve të përbërë nga britanikët, francezët dhe italianët, ndërkohë që qeveria shqiptare shpresonte për një vendim të favorshëm në lidhje me kufijtë e saj veriorë dhe jugorë. Nëse njëra prej tyre do të siguronte një koncesion vajguri, qoftë para apo gjatë hetimeve të mosmarrëveshjeve për kufijtë, atëherë kjo mund të sillte pasoja të kundërta në lidhje me dispozitat përfundimtare të përcaktimit të kufijve të Shqipërisë.

Së treti, ShBA-ja ende nuk e kishte njohur Shqipërinë zyrtarisht, çka në fakt dëmtonte pa masë çdo përpjekje për investime të bizneseve amerikanë private në Shqipëri.

Në këto rrethana të caktuara diplomatike, ishte e vështirë për Erickson-in të pranonte politikën e vazhdueshme të mosnjohjes nga ana e ShBA-së. Njohja *de jure* ishte bërë tashmë prej Finlandës, Zvicrës, Belgjikës dhe Jugosllavisë; Franca ishte e përfaqësuar të paktën prej një konsulli në Shkodër. Erickson-i nuk mund

të kuptonte cilat ishin rreziqet që i kanoseshin ShBA-së nga njohja diplomatike e shtetit shqiptar. Gjithsesi, ai vazhdoi ta shkarkonte përgjegjësinë tek punëdhënësi i tij, duke e këshilluar dr. Veatch-in që, nëse oferta e "Sinclair"-it do të modifikohej aq sa të përfshinte edhe investimet e kapitalit shqiptar, atëherë mundësitë për të përfituar një koncesion vajguri mund të rriteshin në mënyrë të konsiderueshme. Kapitali shqiptar duhej përfaqësuar në formën e një banke kreditore amerikane me kompaninë "Sinclair", duke vepruar si kolateral, një sugjerim i cili nuk pati asnjë efekt në qendrën e "Sinclair"-it.

Më 10 maj 1922, Erickson-i dërgoi një letër në qendrën e "Sinclair"-it ku e informonte dr. Veatch-in se Italia tani e konsideronte çështjen e koncesioneve të vajgurit në Shqipëri një çështje jetike, e cila përcaktonte të ardhmen e marrëdhënieve midis qeverisë së Shqipërisë dhe asaj të Italisë.

Pa asnjë shpjegim të qartë, "Sinclair"-i e riemëroi Soper-in dhe një tjetër të quajtur Mak-Donald për të asistuar Erickson-in në tërë përpjekjet e tij negociuese, ndonëse prej këtij çasti nuk ekzistonte asnjë mundësi për një koncesion vajguri. Përfundimisht, doli e qartë për disa zyrtarë amerikanë se prestigji amerikan do të rrezikohej seriozisht nëse ShBA-ja do të vazhdonte të shpërfillte qeverinë shqiptare. Pas tërë këtyre erdhi dita kur Departamenti i Shtetit ofroi njohjen *de jure* për qeverinë shqiptare dhe emëroi W. Grant Smith si ministër të ShBA-së në Shqipëri. Kjo, referuar edhe fakteve të mësipërme, e gëzoi pa masë Erickson-in.

Në fakt mbetet i paqartë udhëzimi që kishte marrë ministri amerikan në Tiranë për rëndësinë që do t'i jepte çështjes së investimeve amerikane në Shqipëri. Vështirësitë për arritjen e marrëveshjes ishin të të gjitha llojeve, deri tek gjuha e komunikimit. Në terminologjinë teknike përziheshin fjalë të gjuhëve të ndryshme, që nga ajo angleze, franceze, gjermane, turke dhe shqipe. Po ashtu kompania kërkonte një koncesion i cili të mos kishte asnjë rrezik financiar.

Më 14 shtator 1922 Roderic Crandall-i, një përfaqësues i "Sinclair"-it paraqiti një kërkesë urgjente pranë Departamentit të Shtetit, ku kërkohej kontrolli i ShBA-së për furnizimet me vajguri nga jashtë. Bashkë me të kërkonte edhe zgjerimin

e ndikimit të zyrës së tij në Shqipëri nëpërmjet ministrit amerikan në Tiranë. Del qartë se ministri nuk bëri përpjekje për të asistuar përfaqësuesit e "Sinclair"-it në negociatat e tyre. Me sa duket ministri nuk i vlerësonte aq jetike interesat amerikane për vajgurin shqiptar.

Në këtë situatë të pafavorshme për të dyja palët, Erickson-i dhe Soper-i vendosën të vepronin drejtpërdrejt me kryeministrin e kohës, Ahmet Zogun, në një përpjekje për të shtyrë përkohësisht vendimin përfundimtar që asnjë koncesion vajguri të mos paraqitej në Asamblenë Kombëtare në seancën e pranverës. Fatkeqësisht, gjatë kësaj periudhe të pezullimit, kushtet ekonomike për investimet në tregun financiar, edhe në ShBA, edhe në Europë u bënë të pafavorshme.

Ndërkohë, shpejt u mësua se përkundër premtimit të Zogut, propozimi anglo-persian, u paraqit në Asamblenë Kombëtare. Francezët dhe italianët e kundërshtuan me forcë këtë monopol vajguri dhënë Britanisë së Madhe. Më 27 shkurt 1923, Sekretari i Shtetit Charles Evans Hughes, autorizoi W.Grant Smith-in ta njoftonte qeverinë shqiptare se Departamenti i Shtetit e konsideronte formatin e propozimit anglo-persian si monopolist dhe një shkelje të parimeve të politikës së "Dyerve të hapura" në respekt të zhvillimit të burimeve natyrore të Shqipërisë. Hughes-i e njoftonte ministrin amerikan në Tiranë se ambasadori italian dëshironte bashkëpunim midis ShBA-së, Italisë dhe Francës në një përpjekje për të bllokuar miratimin përfundimtar të propozimit anglo-persian.

E tëra kjo çoi në dështimin e kompanisë "Sinclair". Në analizën përfundimtare, përpjekjet për bisedime nga ana e Kompanisë Anglo-Amerikane, mbështetur prej qeverisë britanike, pasqyroi një qëndrim sipërmarrës të vërtetë në drejtim të zhvillimit të vajgurit në Shqipëri – një investim gjithnjë në rritje dhe fitimprurës. Në anën tjetër, oferta e cunguar prej "Sinclair"-it, e dyfishuar me mungesën e mbështetjes nga Departamenti i Shtetit, pasqyroi një qëndrim krejt të rezervuar ndaj Shqipërisë së pazhvilluar. [165]

[165] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

Ajo që mbetet në tërë këtë histori të pasuksesshme investimi amerikan është përpjekja e sinqertë, përgjegjësia, pasioni i Erickson-it për të sjellë kompani amerikane në Shqipëri, për më tepër kompani të kërkimeve të vajgurit, të cilat do të mbartnin edhe interesa strategjike të ShBA-së. Por edhe kjo mbeti vetëm një përpjekje, e cila do t'i linte vendin një përpjekjeje tjetër, por shumë të suksesshme: shkollave, ëndrrës së përhershme të Erickson-it për shqiptarët.

THEMELUES I SHKOLLËS SHQIPTARO-AMERIKANE TË BUJQËSISË DHE I SHKOLLËS SË VAJZAVE NË KAVAJË, 1923 – 1939

Gjatë tërë kësaj periudhe në Shqipëri, Erickson-i pat shumë takime me Fan Nolin, atëbotë ministër i Punëve të Jashtme. Edhe ai ishte kthyer në Shqipëri, nga Amerika. Të dy burrat pajtoheshin se arsimimi në Shqipëri mbetej me të vërtetë prapa asaj çfarë kishin bërë vendet e tjera ballkanike. Megjithëse Erickson-i mbështeste përpjekjet për reformën agrare, ai e kuptonte shumë mirë se vetëm një arsim bujqësor modern, ku të përgatiteshin kuadrot e duhura për të ardhmen e vendit, do të sillte zhvillimin e tij. Me këtë ai donte të zhdukte traditën e vjetër primitive të kultivimit të tokës dhe të fuste metodat bashkëkohore. Kështu, ai filloi të mendonte seriozisht për themelimin e një shkolle bujqësore djemsh. Përderisa Shqipëria ishte në përgjithësi një vend me shoqëri bujqësore, një institucion i tillë do të ndihmonte zbatimin e planeve për metoda të përparuara në bujqësi. Ndërkohë ai besonte se, sapo studentët e rinj do t'i përvetësonin këto metoda moderne, traditat e dala mode, të cilat ishin praktikuar për brezni të tëra, do të zhdukeshin ngadalë. Ai po ashtu kuptoi se procesi do të ishte i gjatë dhe i tillë që do të përjetonte edhe kthime mbrapa, edhe zhgënjime. Megjithëse idetë e Erickson-it do të kërkonin vite përpjekjesh pa pushim, ai ishte i bindur se qasja e tij ndaj këtij problemi më në fund do të siguronte një ndikim kuptimplotë mbi tërë shoqërinë

shqiptare.

Më 15 nëntor 1921, Fan Noli i kërkoi Erickson-it të paraqiste me shkrim një propozim, ku të përqendrohej në ato zona ku arsimi shqiptar duhej të luante një rol kryesor në shoqëri. Dita e Falënderimeve e atij viti e gjeti Erickson-in në borxhe, pasi qeveria shqiptare nuk i kishte paguar as rrogën, as shpenzimet e bëra gjatë udhëtimeve në emër të saj matanë detit. Sidoqoftë, përkundër vështirësive të asaj kohe, Erickson-i vazhdoi të mbetej mirënjohës për mundësinë që i ishte dhënë për të jetuar dhe punuar edhe një herë midis popullit shqiptar. Kjo duket në shënimet e tij të asaj dite kur thotë:

> *"Unë i jam gëzuar jetës në shumë kushte dhe rrethana dhe shpresoj se do të vazhdoj të bëj të njëjtën gjë".*

Pas Ditës së Falënderimeve, Erickson-i ia rifilloi punës për vënien në jetë të idesë së tij të vjetër për arsimimin e shqiptarëve. Disa ditë më vonë, ai kontaktoi me mikun e tij të ngushtë shqiptar, Ali Cungun, dhe e pyeti nëse ishte i gatshëm që të përkthente propozimin e tij në shqip, që më pas t'ia parashtronte qeverisë shqiptare. Dhe kështu u bë.

Diku nga dhjetori i vitit 1921, Erickson-i e kishte paraqitur propozimin e tij mbi arsimin. Më 16 tetor 1922 qeveria shqiptare i komunikoi Erickson-it se në përgjithësi ata e miratonin idenë e tij për një Kolegj Bujqësor, megjithëse, siç theksohej, qeveria ende nuk ishte në situatë të përshtatshme për të financuar një shkollë të tillë. Por, meqë financimet për këtë projekt do të vinin nga ShBA-ja, Erickson-i sugjeroi që të emërohej si një komisionier special për bujqësinë, me qëllim që të mblidhte fondet e domosdoshme në Amerikë, një propozim që qeveria shqiptare e pranoi. Më 21 shkurt 1922, Erickson-i i kishte kërkuar qeverisë shqiptare t'i jepte ndonjë zonë që ishte në pronësi të shtetit, ku të ngrihej Kolegji Kombëtar i Bujqësisë, me një fermë model dhe stacion eksperimental pranë tij. Ditën tjetër, Kol Tromara, ish-president i "Vatrës" dhe mik i Erickson-it, e paraqiti kërkesën për tokë tek Kryeministri Zog dhe disa zyrtarë tjerë. Me datë 8 mars

1922, Kryeministri e informoi Erickson-in se jo vetëm që kërkesa e tij për hapjen e shkollës ishte jo-formalisht e miratuar, por edhe se ai do të lejohej të zgjidhte nga një listë prej tetë ose dhjetë fermash më të mira në pronë të qeverisë, që gjendeshin në zona të ndryshme të vendit.

Erickson-i, duke vizituar fermën e parë të asaj liste, e cila gjendej pranë Kavajës, gjeti se përveç lartësisë së përshtatshme mbi nivelin e detit dhe rrjedhës ujore të pandërprerë, kishte po ashtu edhe një varg kodrash ideale për ngritjen e ndërtesave. Pasi vëzhgoi me vëmendje fermat e tjera në atë listë, Erickson-i pa se toka e fermës jashtë Kavajës ishte më e përshtatshmja. Më 4 korrik 1922, Erickson-i u njoftua se qeveria i kishte dhënë lejen për tokën e Kavajës. Më 14 korrik 1922, Erickson-i i kërkoi drejtorit të tokave shtetërore ta shoqëronte në Kavajë, me qëllim që t'i shihnin bashkë kufijtë e asaj pasurie.

Toka që ata panë atë ditë ishte afërsisht treqind hektarë, prej të cilave një pjesë ishte tokë buke, ndërsa pjesa tjetër kodrinore me pyje shumë të bukura. Në dy muaj e gjysmë që pasuan, Erickson-i u mor me aspekte të ndryshme administrative të shkollës, në veçanti me bursat e studentëve. Më 12 nëntor 1922 ai arriti një marrëveshje me ministrin e Financave dhe të Punëve Publike, nga e cila iu premtua mundësimi i tridhjetë e gjashtë të rinjve shqiptarë të jetonin në dhomat pa pagesë të shkollës së re.

Gjatë dy muajve që vijuan, Erickson-i mbeti në kontakt me shumë prej figurave të rëndësishme dhe institucioneve në ShBA. Përveçse i informonte ata për planet e tij për të ndërtuar shkollën, ai pa dyshim iu nënvizonte faktin se projekti i tij varej nga donacionet financiare që priteshin të vinin nga Shtetet e Bashkuara. Më 28 maj 1923, Parlamenti Shqiptar i dha miratimin përfundimtar projektit të Erickson-it. Gjatë periudhës së gjatë të pritjes, Erickson-i qëndroi në Tiranë, duke shfrytëzuar çdo rast që i jepej për të biseduar me anëtarë të ndryshëm me ndikim në Parlamentin Shqiptar. Në veçanti, Erickson-i u ishte mirënjohës përpjekjeve personale të Ahmet Zogut, i cili, që në fillim, kuptoi ndikimin potencial që do të kishte projekti i Erickson-it mbi përpjekjet e tij kombëtare për ta bërë Shqipërinë

një shtet modern europian. Erickson-i e dinte se Zogu ishte një prej shqiptarëve më të zotë në jetën publike, i cili shqetësohej seriozisht për mirëqenien e popullit dhe të vendit. Në këtë rast të veçantë, Erickson-i pa të zbatohej pikërisht ajo që priste prej Zogut.

Në ditarin e tij të datës 28 maj 1923 Erickson-i ulet dhe shkruan këto rreshta:

"Ditët kaluan pa bërë ndonjë punë për të qenë, por prapëseprapë sot u ndez një dritë shprese. Parlamenti e kaloi kontratën time dhe e kaloi njëzëri!

Nuk pat grindje partish, as kundërshtime të ashpra fetare, as opozitë, as ankesa ndaj qeverisë! Ndryshimet e bëra janë të gjitha në favorin tim, me përjashtim të një klauzole mbi shpronësimin e tokës private, të cilën thanë se ishte e paligjshme. Atë do ta rregullojmë disi, megjithëse do të më bezdisë për disa kohë. Tani, jam i lirë të eci përpara me planet e jetës sime për Shqipërinë. Edhe një herë, po!

Deri tani kam shpenzuar shumë energji, shumë punë, shumë djersë e sakrifica – 15 vjet të tërë pa asnjë rezultat! Tani arrita më të madhen gjë që premton shpërblimin për vitet e shkuara!

Kjo nuk do të më kthejë djalin e humbur dhe as vitet e ndarjes dhe të vetmisë, por jam i sigurt se do të ketë dritë përsëri dhe një farë paqeje e kënaqësie për ditët e së ardhmes që më presin."[166]

Më pas ai i shkroi një letër falënderimi tërë anëtarëve të qeverisë dhe të parlamentit. Fill pas kësaj, ai u bë gati për udhëtimin e tij të menjëhershëm për mbledhje fondesh për shkollën në Amerikë. Ministri fuqiplotë amerikan Grant Smith, para se të nisej për pushime, i kishte lënë atij një bankënotë 20-dollarëshe amerikane për pasaportën e tij. Çfarë miku i dashur! Erickson-i tani do t'i hynte një aventure tjetër në dobi të Shqipërisë.

Pak para udhëtimit të Erickson-it për mbledhje fondesh në Shtetet e Bashkuara,

[166] Erickson Collection, Yale Divinity Library, Diary of Erickson, File /box 8.

Zogu i kërkoi atij që të themelonte edhe një shkollë vajzash, sepse, sipas tij, në qoftë se Shqipëria donte të kishte sukses në procesin e ndërtimit të shtetit, edhe gratë duhej të ndihmonin me kontributin dhe përpjekjet e tyre. Megjithëse në fillim ai u habit nga kërkesa e Zogut, ai e vlerësoi shumë atë. Përpara nisjes për në Amerikë, Erickson-i e siguroi Zogun se do t'i modifikonte planet për një Kolegj Bujqësor në atë mënyrë, që të përfshinte edhe shkollën e vajzave. Në Shtetet e Bashkuara Erickson-i bëri takime me figura të shquara, institucione bujqësore dhe filantropike. Në përpjekjet për ta bërë të njohur kërkesën e tij, Erickson-i zakonisht e fillonte me një përshkrim të marrëveshjes së shkëlqyer mbi tokën të arritur me qeverinë shqiptare. Pastaj ai fliste për programin arsimor, i cili do të zhvillohej brenda traditës më të mirë shqiptare.

Ai theksonte se stafi i propozuar arsimor do të përbëhej mundësisht prej sa më shumë shqiptarësh. Pasi shkolla të vihej në punë dhe të funksionontë për njëzet e pesë vjet, do t'i dorëzohej qeverisë shqiptare. Më 4 shkurt 1924, Erickson-i i dërgoi kolonelit Ernest T. Bisknell një letër dhe një kopje të bashkëngjitur të memorandumit mbi shkollën, në të cilën i shpjegonte atij se qeveria shqiptare e kishte caktuar atë të themelonte Shkollën Amerikane – Shqiptare të Bujqësisë, e cila do të mbështetej financiarisht prej një Bordi Amerikan të të besuarish. Fatkeqësisht, mbështetja morale që ai kishte shpresuar të gjente nga ajo shoqëri nuk u materializua kurrë.

Parë nga një anë tjetër më pozitive, një prej figurave më të shkëlqyera, me të cilin Erickson-i u vu në kontakt ishte Herbert Hoover-i[167], Sekretari i Shtetit për Tregtinë. Hoover-i duket se shprehu interes të padiskutueshëm për

[167] Herbert Clark Hoover, (1874-1964) ishte presidenti i 31 – të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga viti 1929-1933. Para se të zgjidhej president ai ishte Sekretar i Shtetit për tregtinë në vitet njëzet, në administratat e presidentëve Warren Harding dhe Calvin Coolidge. Ai e dha atë ndihmë për shkollën e Kavajës nga pozita e sekretarit të shtetit për tregtinë. Lidhjet dhe simpatia për Shqipërinë nuk u shuan asnjëherë pas kësaj. Kur u bë president ai emëroi gjatë periudhës së tij në detyrë ambasadorin Herman Bernstein (1930-1933) një mik i ngushtë i tij dhe po ashtu ndërtoi ambasadën e ShBA – ve në Tiranë, një ndër pasuritë e vyera të Departamentit të Shtetit Amerikan jashtë vendit të vet. Simpatia dhe interesi për Shkollën Bujqësore të Kavajës shfaqen edhe më vonë tek ai. (Shënimi im – MB)

projektin e Erickson-it, pasi më 5 shkurt 1924 ai kontaktoi Allan Dulles-in[168] në Departamentin e Shtetit, për t'i kërkuar informacion për projektin e Erickson-it. Më 9 shkurt të vitit 1924, Erickson-i, në një letër që i dërgonte Hoover-it theksonte se nevoja më e madhe e menjëhershme e Shqipërisë ishte modernizimi i bujqësisë së saj. Shtatëdhjetë e pesë për qind e popullsisë jetonte në fshat në kushte jetese të mjerueshme. Ai gjithashtu e informoi Hoover-in se, duke marrë në konsideratë kushtet ekzistuese bujqësore në Shqipëri, qeveria nuk shpresonte të kishte të ardhurat e duhura prej këtij sektori madhor të ekonomisë. Erickson-i i shkruan me aq dhimbje dhe simpati për shqiptarët, sa askush tjetër nuk kishte bërë:

> *"Shqiptarët janë njerëz të tillë që më mirë vdesin sesa të kërkojnë, më mirë mbarojnë në dëshpërimin e vet, sesa të qahen… ata janë një popull tragjik, por një racë heroike".*

Erickson-i i theksonte Hoover-it se qeveria shqiptare kishte dhënë një donacion prej treqind hektarësh tokë të mirë për kultivim bujqësor si dhe për ndërtimin e shkollës. Ajo ishte një tokë pjellore dhe gjendej pesë milje larg nga qyteti i Durrësit. Qëllimi i shkollës shqiptaro-amerikane, siç ia shpjegonte Erickson-i Hoover-it, mund të përmblidhej në katër pikat e mëposhtme:

(a) Të siguronte një trajnim të plotë për të rinjtë shqiptarë në një bujqësi moderne shkencore në të gjitha degët e saj, duke i kualifikuar ata si ekspertë bujqësie, bujq të suksesshëm dhe drejtues të bashkësive në zonat e pazhvilluara.

(b) Prej punës së përbashkët dhe të zgjeruar, të nxisin dijenitë mbi bujqësinë moderne në mes popullatës që jeton në zonat e pazhvilluara, për ta bërë vetë shkollën qendër kombëtare për zhvillimin e zonave të pazhvilluara të Shqipërisë.

(c) Të ngrihet një stacion eksperimental për kërkime shkencore në fushën e bujqësisë, që i shkon për shtat Shqipërisë.

[168] Alan Welsh Dulles, (1893-1969) ishte një diplomat amerikan, jurist, bankier dhe zyrtar i cili shërbeu shumë gjatë në administratën amerikane, prej vitit 1953 deri në vitin 1961. Ai ishte kreu i CIA. Bashkë me të vëllain mbajtën pozita të rëndësishme në administratat amerikane. I vëllai John Foster Dulles ishte Sekretar Shteti në administratën e presidentit Eisenhower. (Shënimi im – MB)

(d) Të sigurojë trajnim anembanë vendit në tregti, për t'i aftësuar punonjësit që të zhvillojnë jetën industriale dhe ekonomike të vendit.

Në lidhje me marrëveshjet e mëparshme me Kryeministrin Zog, Erickson-i, në letrën që i dërgonte Hoover-it, përmendte edhe kolegjin e vajzave. Aty ai i shpjegonte Hoover-it aspektet financiare të Shkollës Bujqësore Amerikano-Shqiptare, duke theksuar koston e ndërtesës së shkollës – e vlerësuar më pak se dhjetë mijë dollarë për ndërtimin, ngaqë materialin e ndërtesave e jepte qeveria, prandaj kishte kosto të ulët.

Sa për të filluar, plani ishte që ndërtesat të ngriheshin të ndara në seksione, kështu që aty mund të shtoheshin lehtësisht të tjera nëse nevojitej në të ardhmen. Erickson-i vlerësoi se buxheti i propozuar për pesë vjet, për të vënë shkollën në punë, duhej të kapte shifrën 600 000 dollarë. Ai gjithashtu theksoi tek Hoover-i se në qoftë se Shkolla Shqiptaro-Amerikane e Bujqësisë do t'i kontribuonte përmirësimit të bujqësisë dhe industrisë shqiptare atëherë, ato të ardhura të marra prej qeverisë mund të përdoreshin për të përmirësuar standardin kombëtar të jetesës. Në lidhje me çështjen e përgjegjësisë ligjore, Erickson-i nënvizoi faktin se qeveria shqiptare ruante të drejtën edhe të kontrollonte paratë e dhëna për shkollën edhe të zgjidhte tri klasa, secila e përbërë prej dymbëdhjetë studentësh shqiptarë, të cilët do të vijonin shkollën me bursë të plotë, pa pagesë. Në përfundim të kësaj letre, Erickson-i zbuloi se ai kishte marrë më në fund mbështetje nga burra të ndryshëm të shquar, institucione dhe fondacione bamirëse në Shtetet e Bashkuara. Ai, në mënyrë të veçantë, përmendi 500 dollarë donacion që kishte pranuar nga Justice Brandeis[169] dhe mbështetjen e marrë prej Sekretarit Wallace [170] dhe Justice Taft[171]. Megjithëse në dukje i impresionuar me Erickson-in dhe projektin e tij,

[169] Louis Dembitz Brandeis, (1856-1941) ishte jurist i asociuar në Gjykatën e Lartë të ShBA-së nga viti 1916 deri në vitin 1939. Ai ishte bir i një familjeje emigrantësh hebrenj i lindur në Kentucky. Ai kreu Harvardin në moshën njëzetvjeçare me notat më të larta që ndokush ka marrë ndonjëherë në historinë e asaj shkolle. Fakti që Erickson-i mori një donacion prej këtij njeriu të madh tregon se sa lart ai e kishte paraqitur çështjen e kolegjit tek qarqet e ndryshme amerikane.

[170] Henry Agard Wallace, (1888 – 1065) ishte zëvendëspresidenti i 33-të i ShBA-së, (1941-1945) sekretar i Bujqësisë (1933-1940) dhe sekretar i Tregtisë (1945 – 1946)

[171] William Howard Taft (1857 – 1930) ishte presidenti i 27 – të i ShBA – së (1913 – 1913) dhe më pas kreu i

Hoover-i, për shkak të pozicionit të tij të lartë qeveritar, u ndje i detyruar të fshihte mbështetjen e tij, derisa arriti informacioni vërtetues nga Departamenti i Shtetit, i cili kishte kontaktuar tashmë Grant Smith-in, ministrin e vet në Shqipëri. Më 11 shkurt 1924, Kristian Herter-i, një prej asistentëve kryesorë të Herbert Hoover-it, mori një letër nga Allan Dulles-i i Departamentit të Shtetit, me një telegram bashkëngjitur të dërguar më 4 shkurt nga ministri amerikan në Shqipëri, i cili e ngrinte lart punën e Erickson-it:

> *…Projekti i z.Erickson për themelimin e një shkolle për mësimdhënien në fushën e bujqësisë dhe tregtisë në Shqipëri ka miratimin tim që buron nga zemra. Metodat e përdorura këtu sot janë tërësisht arkaike. Realizimi i shpresave të mëdha legjitime për mirëqenien e Shqipërisë në të ardhmen mbështeten kryesisht në përvetësimin praktik nga rinia të shkencave dhe virtyteve të larta.*[172]

Duke qenë plotësisht i kënaqur me raportin e lëshuar nga Departamenti i Shtetit, Hoover-i vendosi t'i jepte mbështetjen e tij këtij projekti, duke bërë një donacion prej 10.000 dollarësh nga llogaria e tij personale, në kushte anonime, me kusht që brenda një viti, Erickson-i të mblidhte edhe një shtesë prej 10.000 dollarësh tjerë. Erickson-i ia doli jo vetëm të grumbullonte një fond të tillë shtesë, por edhe të mbetej i heshtur për kontributin bujar të Herbert Hoover-it, megjithëse publikimi i këtij donacioni nga ana e tij do ta kishte ndihmuar shumë në mbledhjen e fondeve të tjera edhe më të mëdha. Me përjashtim të Vernon Kelleg-ut, sekretarit ekzekutiv të Këshillit Kombëtar të Kërkimeve, që e dinte këtë fakt, askush tjetër nuk e mori vesh për pesëdhjetë vjet, deri kur letrat e Erickson-it u zbuluan dhe u studiuan nga Alan Fusine. Kjo ndodhi pas vdekjes së tij. Zbulimi i këtij fakti flet aq sa për aspektin njerëzor të Herbert Hoover-it, po aq edhe për peshën e punës së Erickson-it në përpjekjet e tij për Shqipërinë dhe besnikërinë e këtij të fundit ndaj miqve dhe qëllimeve të tij të larta e fisnike.

Më 6 qershor 1924 u mblodh në Boston për herë të parë, Bordi i të të Besuarve.

Drejtësisë Amerikane (1921 – 1930) Ai është i vetmi person në ShBA i cili shërbeu në dy pozita të tilla.

[172] Arkivi i DASH, File nr. 367, 112, 4/1/2/3/4/5/6.

Aty Erickson-i u zgjodh drejtor i shkollës, të cilën bordi e quajti zyrtarisht *"Shkolla Shqiptaro-Amerikane e Bujqësisë"*. Bordi vendosi që shkolla të ishte e tillë jo vetëm për mësimin e bujqësisë në Shqipëri, por edhe si bazë prodhuese dhe eksperimentale. Kjo kishte si qëllim përqendrimin e kërkimeve shkencore mbi bujqësinë lokale dhe rajonale. Më në fund, bordi miratoi edhe planin e Erickson-it për një shkollë vajzash, në të cilën do të mësoheshin mjeshtri të ndryshme, si punëdore, ekonomi shtëpiake, higjienë, si dhe lëndë tjera të ngjashme. Dëshira e kahershme e Erickson-it për të përmirësuar bujqësinë shqiptare nëpërmjet një mësimdhënieje me metoda moderne tashmë ishte vënë në rrugë të mbarë. Erickson-i, duke vënë re se detyra që e priste ishte një nga më sfidueset, i hyri asaj me guximin, zotësinë dhe besimin që e karakterizonte për të tejkaluar çdo pengesë.

Si lindi dhe u zbatua ideja e këtyre shkollave?

Në vargun e takimeve të Erickson-it me burrat e atëhershëm të shtetit shqiptar ai vetë kujton dialogë me Ahmet Zogun, Mehmet Konicën, Pandeli Vangjelin, Iliaz Vrionin dhe Fan Nolin. Shumë ide për zhvillimin e Shqipërisë moderne kishin lindur dhe ishin vënë në zbatim nëpër shtetitjet që ata bënin së bashku ose diskutime të gjata. Një prej më interesanteve është ajo për hapjen e Shkollës Bujqësore të Kavajës dhe Kolegjit të Vajzave. Ja si e përshkruan Erickson-i takimin me Ahmet Zogun:

Në një prej takimeve tona jozyrtare, të cilit tashmë i kam referuar, Ahmeti më tha:

"Ne kemi një punë për ty".

"Çfarë është ajo?" i thashë.

"Ndërto një kolegj bujqësor për djemtë", më tha.

"Po ku janë paratë?", ishte përgjigjja ime.

"Ne nuk kemi, ju e dini këtë", më tha Zogu, "Me tërë ata miq tuajt të pasur në Amerikë duhet të jetë e lehtë", vijoi ai.

"A do të vini me mua të bëjmë fushatë për fonde?", iu përgjigja.

"Nuk mund ta bëj këtë. Nëse e lë një herë punën këtu, nuk do ta marr dot më kurrë", më tha ai duke qeshur.

"Në rregull", i thashë, "Do të përpiqem një herë. Por ju duhet të më jepni tokën".

Ministri i Bujqësisë ishte i pranishëm. Ahmeti iu drejtua atij:

"Jepi Erickson-it një listë të fermave shtetërore me detajet e plota dhe një letër ku ta autorizoni atë të bëjë një inspektim zyrtar në ndonjërën ose në të tëra ato."

Dhe ashtu u bë. Pas pak ditëve e mora udhën drejt tokave dhe për gjashtë javë pashë çdo mundësi që mund të kishte. Zgjedhja ime përfundimtare ishte një fushë aluviane me fundin e kodrave prapa tek bregdeti jugor i Gjirit të Durrësit në plan të parë. Në këto 2 000 hektarë përfshiheshin toka private të caktuara brenda planit dhe kjo përbënte projektin më të mirë për këtë qëllim në tërë Ballkanin. Mjerisht, vështirësitë ishin përpara. Toka i ishte premtuar një beu nga Kosova ose nga ajo pjesë e Shqipërisë ku jetonin një gjysmë milion shqiptarë, por që tani, sipas Traktatit të Versajës, ishte marrë prej Jugosllavisë. Ai kishte si qëllim t'i transferonte fshatarët e tij tek ajo tokë. Megjithatë, kjo vështirësi u tejkalua dhe në rrjedhë të gjërave unë arrita të kem një vendim të Parlamentit, i cili e mënjanonte atë dhe më jepte mua autorizimin për hapjen e Kolegjit Bujqësor.

Kaluan një vit e tre muaj. Unë kisha vajtur në Amerikë, mblodha fondin e domosdoshëm për fillimin e shkollës, angazhova një bërthamë mësuesish të rinj, dy prej tyre bashkë me gratë, gjithsej gjashtë. Atje bleva pajisje për shkollën, mjete bujqësore dhe bëra furnizimet e nevojshme për fillimin e punës.

Për habinë time, kur arrita me aq nxitim tek toka me personelin tim të etur për të parë tokën, aty kishin ardhur disa qindra refugjatë shqiptarë nga Kosova, të vendosur mu në mes të tokës. Ata kishin ndërtuar shtëpi, lulet rriteshin në kopshtet e tyre, kishte drithë nëpër fusha, kopshte dhe zarzavate. Disa kishin pemë të reja që po rriteshin. Aty kishte kafshë, qe për plugime, dele për kos ose qumësht të fermentuar. Gratë

kishin vënë vegjët e tyre dhe ishin të zëna me endjen e qilimave, rrobave të leshta, cohave të mëndafshta, tek bënin veshje për burrat dhe familjet e tyre. Ishte diçka si një jetë e re, e lindur prej fatkeqësisë së atyre njerëzve që kishte mbirë aty, por që punën time e bënin të pamundur.

Ku do të shkonin këta të shkretë?! Ata ishin përzënë me dhunë jashtë Jugosllavisë, pasi serbët e kishin bindur Komitetin Ndërkombëtar të Refugjatëve se ata ishin turq dhe se duhej të ktheheshin mbrapsht në "vendin e tyre". Fillimisht, ata u dërguan atje. Turqia i ktheu mbrapsht, pasi ata nuk pranuan se ishin turq, por arnautë. Tetëmbëdhjetë muaj kishin kaluar, ata si pëllumbi i Noeut në kërkim të një vendi ku t'u zinte këmba dhé. Më pas Kryqi i Kuq Ndërkombëtar kishte marrë një kërkesë dhe, ja, ky ishte rezultati.

E tëra kjo ndodhi në kohën kur Fan Noli hipi në pushtet me revolucion, ndërsa Ahmet Zogu iku në Jugosllavi. Unë e kalova këtë periudhë në kërkim të fondit për shkollën në Amerikë. Por, ja që Zogu ishte kthyer përsëri në pushtet dhe unë nuk humba kohë për ta takuar atë menjëherë. Kur i tregova se çfarë kishte ndodhur gjatë mungesës sime në Amerikë, ai menjëherë më pyeti:

"Kush është përgjegjës për këtë?"

Iu përgjigja se kjo kishte ndodhur nën qeverisjen e Fan Nolit.

"Miku yt, Fan Noli, a ishte ai?" më pyeti Zogu.

"Jo, Ahmet, jo! Miku ynë, yti dhe imi, Fan Noli!", iu përgjigja.

Në fakt, në ato ditë, kur ne po hartonim skemën për ndërtimin e Kolegjit Bujqësor, ishim të tre që punuam së bashku duke shkrirë tërë simpatinë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin me njëri-tjetrin në një sipërmarrje që do t'i shërbente kombit.

"Mirë pra," m'u përgjigj Ahmeti. "Çfarë doni që të bëj unë tani? T'i nxjerr kosovarët jashtë nga ajo tokë?!"

Unë nuk kisha zemër për atë dhe kërceva:

"Jo, jo, jo! Kurrë!" i thashë.

Në vend të kësaj u pajtuam që ai të interesohej për një tokë që i takonte Bashkisë së qytetit të Kavajës, të cilën e kam përmendur edhe më parë dhe të na e jepte atë për shkollën tonë. Pastaj erdhi e papritura tjetër.

"Erik, që kur ikët në Amerikë për shkollën bujqësore, unë kam menduar edhe diçka tjetër për ty", më tha, duke më parë drejt e në sy.

"Pata menduar se gjëja më e rëndësishme që ne mund të bënim ishte të fillonim një Kolegj Bujqësor për trajnimin e djemve me bujqësinë moderne. Por sa pare bën kjo nëse ne nuk trajnojmë njësoj si djemtë, edhe vajzat, me të cilat ata do të martohen dhe do të ndërtojnë familje, shtëpi dhe jetë moderne? Nëse djemtë që mbarojnë shkollën, martohen me vajza të pashkolluara, ata do të tërhiqen mbrapsht në të njëjtat kushte nga të cilat ne po përpiqemi t'i nxjerrim ata vetë dhe krejt vendin tonë".

"Në qoftë se i dërgojmë djemtë për trajnim dhe nuk do të kemi vajza të trajnuara këtu, atëherë ata do të martohen me vajza të huaja, italiane, franceze, gjermane dhe do të humbasin. Ne duhet të kemi një shkollë për vajzat që do t'i trajnojmë në praktikë, në punët e shtëpisë, në kujdesin për fëmijët, higjienën, shëndetin, dietologjinë, kopshtarinë, tekstilet dhe artet e ndryshme shtëpiake".

Pastaj ai lëshoi këto fjalë:

"Derisa të ngremë standardin e grave, sa të arrijmë kërkesat e qytetërimit modern, ne mbetemi të paqytetëruar. Nuk ka komb që ngrihet më lart se graria e vet."

Që prej asaj kohe, ai ishte kaq i fiksuar në idenë e vet për hapjen e një shkollë të tillë, saqë, sa herë takoheshim, më thoshte:

"Erik, ju duhet ta filloni atë shkollën e vajzave, ju lutem, fillojeni sa më shpejt,

fillojeni menjëherë. Unë nuk shoh njeri tjetër që mund ta bëjë këtë punë nëse ndonjëherë do të bëhet".

Kur i përmenda një shkollë tjetër vajzash, e cila tashmë ishte hapur, ai ia pati me zë të lartë:

"Vajza bejlerësh, që mësojnë vallëzim dhe sjellje sallonesh?! Kjo nuk është mënyra se si realizohet ky qëllim. Nuk është kjo ajo që kërkoj unë. Duhen zgjedhur prej fshatrave, mundësisht sa më të mira, të cilat, kur të mbarojnë mësimin, të kthehen përsëri atje, ose në bashkësitë e tjera rurale dhe të bëhen drejtuese të guximshme dhe forca vepruese e thyerjes së paragjykimeve të vjetra, injorancës dhe marrëzive ndaj kësaj gjinie. Në fakt, ky është mallkimi më i rëndë që kanë lënë turqit mbi racën tonë. Ose duhet zhdukur kjo, ose ne jemi të humbur".

Këto ishin pak a shumë ato që më tha ai burrë. Unë ndieja se në çdo fjalë ai përcillte zërin e nënës së vet. Dhe ashtu siç e kuptoja unë, ky ishte një shqetësim i jashtëzakonshëm i tij. Kështu, si rezultat i asaj këmbënguljeje, brenda pak muajsh ndërtesat për atë shkollë ose u ngritën, ose u rinovuan aty ku ato ekzistonin.

Kështu u ngritën edhe dy shkolla, me tridhjetë e gjashtë djem dhe tridhjetë e tri vajza. Në kontratën time unë kisha rënë dakord të merrja dymbëdhjetë djem për vitin e parë dhe për dy vitet në vijim të bëheshin tridhjetë e gjashtë, në tërësi. Në vend që të kisha këtë numër djemsh, brenda tre vjetësh arrita të kisha edhe shkollën e vajzave thuajse të barabartë me atë të djemve. Kjo filloi në shtatorin e vitit 1925 dhe që prej asaj kohe, derisa Shqipëria u pushtua nga italianët, kur Mbreti Zog u detyrua të linte vendin, qeveria e tij i dha mbështetje të plotë asaj shkolle.[173]

[173] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

ORGANIZIMI I SHKOLLËS SHQIPTARO – AMERIKANE TË BUJQËSISË NË KAVAJË

Shkolla e Erickson-it, siç mund ta quajmë tashmë, kishte nevojë jo vetëm për tokë dhe fonde, por edhe për mësues dhe këshill pedagogjik. Po ashtu duhej edhe një administratë, e cila të administronte çdo gjë në shkollë. Për këtë Erickson-i u mbështet shumë tek ministri amerikan në Shqipëri, Charles Hart-i, i cili rekomandoi Catherine Ludvig-un, që të emërohej në një pozicion mësueseje në shkollën e vajzave.

Tërësisht i përkushtuar ndaj planit të tij për arsimin në Shqipëri, Erickson-i natyrshëm kuptoi se edhe amerikanë të tjerë që punonin në Shqipëri paraqisnin interes të madh për shkollën e tij. Bazuar në rekomandimet e Hart-it, Erickson-i e mori në punë Ludvigun dhe kunatin e saj, W.D. Svope. Në fakt doli se kjo zgjedhje, nga ana e z. Hart, ishte bazuar krejt mbi motive politike dhe nuk i ndihmoi aspak Erickson-it. Por mësuesit e tjerë të mrekullueshëm bënë që shkolla shumë shpejt të bëhej një vatër dijeje dhe një burim kuadrosh, që do të linin gjurmët e veta në historinë e bujqësisë shqiptare. Të tillë qenë profesor Elmer Jones, dekan i Universitetit Northestern dhe anëtar i Bordit të të Besuarve, i cili mezi priste ditën kur Shkolla Shqiptaro-Amerikane e Bujqësisë do të bëhej një universitet shtetëror i shquar. Gjatë vitit 1925, Erickson-i vazhdoi të shkruante shumë letra

për mbledhje fondesh dërguar personave të ndryshëm në Shtetet e Bashkuara, duke iu kërkuar atyre që të jepnin kontribute, përpjekje të cilat në Shtetet e Bashkuara gjatë vitit 1926 provuan të ishin më pak se të kënaqshme. Mungesa e mbështetjes financiare ishte pengesa më e madhe që i dilte përpara Erickson-it, përkundër zhvillimit të suksesshëm të veprimtarisë së shkollës. Gjatë vjeshtës së vitit 1927, u mor vesh se përpjekjet e Erickson-it për arsimin në Shqipëri ishin paraqitur në mënyrë të gabuar në letrat private dërguar Herbert Hoover-it. Fatmirësisht, George Akerson-i, një ndihmës i Hoover-it ishte udhëzuar të përcillte dosjet edhe të Erickson-it, edhe të Hart-it tek Vernon Kellog-u në Këshillin Kombëtar të Kërkimeve për hetim. Pas një hetimi të plotë,Vernon Kellog-u e informoi Akersonin se Erickson-i po bënte një punë të shkëlqyer në Shqipëri. Ai theksoi se me siguri do të vazhdonte të mbështeste përpjekjet e Erickson-it për arsim në Shqipëri bazuar në arsyet e mëposhtme:

(a) Shumë biseda të gjata me Erickson-in, në të cilat ai shpjegonte projektin e shkollës dhe punën me hollësi.

(b) Miratimin që i kishte bërë vetë Justice Brandeis Erickson-it dhe punës së tij.

(c) Faktin që shkolla kishte një bord të fortë të të besuarish, me William D. Schieffelin si president të saj dhe L.F. Kiesewetter, zëvendëspresident i Bankës së New York-ut dhe Kompanisë së Trustit, si mbajtës i thesarit.

(d) Faktit që Filip Brook House i Harvardit, shkolla "Groton", shkolla "Haverford", Kolegji Smith dhe organizata të tjera përgjegjëse po e ndihmonin shkollën.

Kështu del se prej vjeshtës së vitit 1927, Erickson-i më në fund jo vetëm njihet me veprimtarinë e fshehtë të Charles Hart-it, por gjithashtu, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ai sfidohet prej mosbindjes së zonjës Ludvig dhe kunatit të saj W.D.Svope. Këta dy mësues, jo vetëm shfaqën një qëndrim jo bashkëpunues, por gjithashtu edhe shkruan letra me qëllime të këqija drejtuar William D. Schieffelin dhe Herbert Hoover-it. I ballafaquar me gjëra të tilla, Erickson-i i detyroi dy mësuesit të jepnin dorëheqje, me qëllim që të ruante qëllimet fillestare për të cilat kishin rënë dakord me Bordin e të Besuarve. Që nga 29 korriku 1929, shkolla e

djemve jo vetëm që kishte rritur numrin e të regjistruarve, deri në 92 studentë shqiptarë, por gjithashtu kishte shtuar buxhetin e saj operues deri në 15 000 dollarë me një ndihmë financiare prej 25 000 dollarësh. Shkolla e vajzave, e hapur në vitin 1925, me dyzet e gjashtë syresh, operonte me një buxhet vjetor prej 8 000 dollarësh. Në përgjithësi, studentët në të dyja shkollat zotëronin një potencial të madh për të nxënë. Që nga 18 tetori i vitit 1929, Erickson-i nuk ishte më i shqetësuar prej Charles Hart-it, sepse, në atë kohë, Shtëpia e Bardhë njoftoi transferimin e tij në Persi.

Aty nga viti 1929, edhe qendra bujqësore dhe ferma eksperimentale kishin provuar të ishin efektive në zëvendësimin e shumë traditave jo produktive dhe të dala mode të zbatuara deri atëherë në Shqipëri, si bie fjala, plugu i drurit. Edhe shkolla e vajzave kishte dhënë prova njësoj të vlefshme, sepse ajo ia kishte dalë në heqjen e disa traditave dhe zakoneve arkaike turke.

Problemi i financave vazhdoi të pengonte tej mase planet e largëta të Erickson-it. Në mënyrë të veçantë për pajisjet. Përpjekjet për mbledhje parash dukeshin qartë se hasnin në pengesa edhe për shkak të depresionit të madh ekonomik në Shtetet e Bashkuara. Kësaj i ndihmonte edhe propaganda antishqiptare, e cila e portretizonte kombin e vogël si një kazan të trazirave të brendshme. Pas përpjekjesh të bëra thuajse prej gjashtë vjetësh, Erickson-i arriti në përfundimin se duheshin bërë ndryshime financiare nëse shkolla duhej të vazhdonte të përparonte gjatë dekadës së ardhshme.

Në tetor të vitit 1930, pasi u kthye në Amerikë për një mbledhje të rëndësishme të Bordit të të Besuarve, Erickson-i planifikoi të kontaktonte zyrtarët e Fondacionit të Lindjes së Afërt, të cilët kishin treguar interes të madh rreth projektit të tij. Nëse ky fondacion do të bindej që të pranonte të merrte përgjegjësinë e plotë financiare, shkolla do të plotësohej me më shumë mësues, që do të ishin edhe më të kualifikuar, si dhe me ekspertë të bujqësisë, shëndetit dhe fushave të tjera të lidhura me to. Erickson-i duhet ta ketë paraqitur këtë çështje me shumë forcë bindëse, pasi fondacioni ra dakord të merrte përgjegjësi të plotë financiare. Më 2 mars 1931, në takimin vjetor të Bordit të të Besuarve të shkollës u arrit një marrëveshje, ku dr. Erickson-i dhe Harold Marshalli, i Fondacionit të Lindjes së Afërt, do të vepronin si

drejtorë të përbashkët dhe zëdhënës për Komitetin e Bashkëpunimit të sapofilluar. Për çudi, çdo marrëveshje e arritur më vonë në këtë program të përbashkët mbeti objekt i ratifikimit prej Bordit të të Besuarve të Komitetit Ekzekutiv të Shkollës. Pas kaq e kaq vitesh vështirësish financiare dhe pasigurie, Erickson-i duhet të ketë përjetuar ndjesinë e mirënjohjes dhe lehtësimit nga ajo që sillte kjo marrëveshje. Besimi i tij u rrit kur Fondacioni i Lindjes së Afërt, i cili nuk humbi kohë në marrjen e përgjegjësive të tij, përcaktoi si detyrën e tij kryesore zhvendosjen e shkollës së vajzave nga vendi i saj i përkohshëm në qytetin e Kavajës, në vendin që i ishte dhënë që në fillim Erickson-it nga qeveria shqiptare.

Fondacioni bëri ndërtime që kushtuan 150.000 dollarë. Po ashtu shkolla u pajis me vegla shtesë dhe makineri bujqësore. Gjithashtu aty u mbarështuan shpendë dhe lopë të racës xhersi. Këto të dytat shërbyen si bërthama e një tufe kafshësh që do të furnizonin baxhon e qumështit. Studentët kujdeseshin për dyqind hardhitë e rrushit dhe një kopsht zarzavatesh. Plani ditor kërkonte tri deri në katër orë në ditë përkushtim ndaj punës në klasë, duke rikujtuar zbatimin praktik të asaj që ishte mësuar ditën e mëparshme. Erickson-i lumturohej kur shihte se kishte arritur të ngrinte ndërgjegjen fshatare me përdorimin e metodave moderne në bujqësi. Festa pranverore e plugut dhe ajo e të lashtave në vjeshtë e bënin atë të ndihej edhe më i lumtur. Duke iu kthyer së kaluarës gjashtëvjeçare, edhe pse përmes shumë e shumë vështirësive, ai ndiente një krenari të ligjshme kur shkruante në prill të vitit 1931:

> *…njëqind e gjashtëdhjetë djem dhe vajza kanë kryer mesatarisht tre vjet trajnim intensiv. Ata janë rekrutët e parë të një ushtrie të tërë të së ardhmes."*

Erickson-i besonte se nëse këta të rinj të diplomuar do të kishin një ndikim pozitiv tek popullsia fshatare, atëherë, në një kohë jo të largët, aty do të kishte:

> *"…një Shqipëri të re…, që do të përballej me të ardhmen e saj …"*

Erickson-i ishte i sigurt se shkolla e tij do të luante një rol themelor në luftën për zvogëlimin e

> "*…injorancës, sëmundjeve, varfërisë dhe urisë…"*

ERICKSON-I DHE SHKOLLA E VAJZAVE NË KAVAJË

Koha kishte ardhur që Erickson–i të ndahej me Shqipërinë dhe natyrisht me shkollat e tij. Por ai jo vetëm që ndiente krenari për atë që kishte bërë, por edhe kërkonte që vajzat e Shkollës së Kavajës të trashëgonin virtytet më të mira të kombit shqiptar. Në të njëjtën linjë me të cilën ai kishte biseduar me Mbretin Zog I për grarinë shqiptare, ai iu drejtohet vajzave me një fjalim, të cilin e ka lënë të shkruar si më poshtë. Kjo që do të lexoni është e denjë për penën e çdo rilindësi shqiptar:

SHTËPIA SHQIPTARE[174]

Të dashura vajzat e mia të Shkollës së Kavajës,

Si gjashtë vjet më parë në këtë vjeshtë, kur u ktheva nga Amerika me kontingjentin e parë të punonjësve për shkollën e djemve, e takova Lartmadhërinë e tij Mbretin Zog I, i cili në atë kohë ishte President i Republikës së Shqipërisë. Pasi shkëmbyem komplimentet e zakonshme, ai më habiti me këtë pyetje:

- Cilën shkollë do të fillojmë të parën?

[174] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 2, Box No 2, Folder No 3.

Në letër Erickson-i ndalet tek tërë historia e fillimit të shkollës së vajzave dhe përkujdesjen e Mbretit për to, të cilën e kemi parë edhe më sipër në këtë libër dhe vijon:

"Kështu pasi Mbreti më bërë këtë propozim, pas një tavoline prej druri pishe, rreth së cilës ishim ulur në verandën e shtëpisë së tij modeste në Durrës, tek e vështronim detin, unë ia shtriva dorën dhe i dhashë BESËN se do ta bëja shkollën e vajzave të parën, edhe pse kisha sjellë gjithçka për shkollën e djemve. Kjo është arsyeja përse shkolla ekziston edhe sot. Ju duhet të falënderoni Mbretin tuaj për këtë, sikundër edhe për shumë gjëra të tjera të mira që gëzoni sot në Shqipëri.

Çdo shkollë, me qëllim që të përmbushë qëllimin e vet duhet të ketë një ideal përcaktues që i prin, pa marrë parasysh a është ky mësimi, detyra e shtëpisë, pushimi juaj aktiv, jeta juaj shoqërore… Të tëra këto duhet të mbështeten prej një ideali të njëjtë që fisnikëron dhe i jep dinjitet çdo gjëje që bëni. Për këtë shkollë unë kam patur gjithmonë një ideal të vetëm, dhe ai është që ju të bëheni mbajtëset më të mira të shtëpive të kombit.

Shtëpia në Shqipëri përfaqëson bazën shpirtërore të kombit. Brenda saj kultivohen virtytet më fisnike të kombit. BESA, e cila e ka bërë shqiptarin një burrë që t'i besohet që nga ditët kur ai shërbente në Gardën Pretoriane të Perandorëve të Romës, deri në ditët e sotme, është një virtyt i edukuar brenda shtëpisë shqiptare. Virtytet e grarisë shqiptare, të cilat e kanë mbajtur të pastër dhe të panjollosur shatërvanin e jetës së kombit nëpër shumë shekuj, edhe pse kombi ishte varrosur prej racave dhe perandorive të huaja, është një virtyt i shtëpisë shqiptare. Ai është një prej virtyteve më fisnike që mund të gjenden në ndonjë pjesë të botës. Shpirti i mrekullueshëm i mikpritjes, i afruar me të njëjtën bujari si për të huajin që troket në derë, edhe për njeriun e afërt të gjakut, është një virtyt që haset rrallë në botën moderne që rend me shpejtësi dhe prandaj duhet ruajtur dhe kultivuar brez pas brezi. Nderimi dhe respekti i të rinjve për të moshuarit, fëmijëve për prindërit dhe gjyshërit e gjyshet, vendi i nderit i të vjetrit në familje janë lule të mrekullueshme në kopshtin e bukur të shtëpisë së shqiptarit, e cila nuk duhet të lejohet të vyshket kurrë ose të çrrënjoset prej

zakoneve moderne, të cilat po i ndihmojnë kaq shumë prishjes së shtëpisë.

Kështu, të dashura vajza, po flas me ju sot siç flet babai me fëmijët e vet. Andaj ju kërkoj që të mbani parasysh përherë këto parime, shtëpinë shqiptare, e cila ka ardhur tek ju prej qindra brezash, njëri pas tjetrit. Kaq e rëndësishme është kjo për mua, saqë, nëse më del se me ato që mësoni në shkollë dobësohet kjo shkallë vlerash sadopak, do të më bënte të mendoja nëse kam bërë mirë apo keq që e hapa shkollën. Unë më mirë do ta mbyllja shkollën dhe të mos e hapja kurrë më. Unë dua që ju të mësoni këtu vetëm se si t'i bëni këto virtyte edhe më të mira në jetën e kombit. Unë dua që ju të mësoni se si ta bëni shtëpinë tuaj jo vetëm një vend mikpritjeje, por një shtëpi të rehatshme, të shëndetshme për ju dhe fëmijët tuaj të bukur, të pastër dhe të hijshëm. Unë dua që ju të mësoni se si t'i siguroni fëmijët që do të lindni të jetojnë dhe të shmangni numrin tmerrësisht të lartë të vdekjeve foshnjore, që po e tronditin mëmëdheun nga zhdukja e fryteve të sapolindura, aq të bukura. Dua që ju të mësoni se si ta bëni jetën vetë një gjë të këndshme, të mbushur me gaz e hare, me këngë e gëzime, një bukuri brenda mendimeve dhe ndjenjave tuaja. Dua që mjedisin e jetës suaj ta bëni sa më të këndshëm. Unë shpresoj se shpejt do të vijë dita për Shqipërinë kur frika e hershme tmerruese, mizoritë dhe shtypja e përjetuar në shekuj do të fshihet nga faqja e dheut, nga vetë kujtesa dhe nga zemra e kombit dhe secili do të marrë përsipër deri në fund përgjegjësitë e tij e të saj dhe të punojë për ngritjen e standardit të jetës për këtë komb të nderuar.

Unë jam i lumtur që po bëhen rregullime për të filluar një klasë përgatitore, kështu që vajzat e klasës së pestë mund të vijnë dhe të mësojnë gjuhën angleze, në mënyrë që të mos humbim kohë kur të vijë koha për klasat e tjera.

Mua më është ndaluar prej drejtoreshës së shkollës, zonjushës Camp, të bëj lëvdata për atë dhe stafin e saj. Ajo mendon se e vetmja lëvdatë e vlefshme është ajo që shpreh në vetvete punën e bërë për rregullimin e jetës së vajzave. Kështu, duke iu bërë lëvdata mësuesve dhe drejtoreshës, po ju kërkoj që të shihni në fytyrat e këtyre vajzave të lumtura, të shëndosha, të bukura dhe t'i lëmë ato vetë ta tregojnë këtë histori

të drejtimit të mençur të shkollës. Ju vajza do të vlerësoni pas disa vitesh, shumë më shumë sesa tani, se çfarë nderi dhe privilegji keni patur të ishit nën kujdesin e zonjushës Camp, zonjushës Miss Evans, Miss Smith dhe të tëra ato me të cilat keni mësuar së bashku në tërë këto vite.

Edhe një fjalë dhe do ta mbyll. Ekziston përshtypja nga jashtë se Amerika banohet pothuajse e tëra prej milionerëve. Në të vërtetë ka më shumë njerëz në Kavajë sesa milionerë në Amerikën e 123 milionë njerëzve. Fondet që e kanë mbështetur këtë shkollë nuk kanë ardhur nga njerëzit e pasur, as prej milionerëve, por prej njerëzve të thjeshtë, të cilët, në pjesën më të madhe, si dhe njerëzit tuaj, e fitojnë bukën e gojës me shumë sakrifica. Edhe ajo çfarë japin, e japin me sakrifica të mëdha. Unë mund t'ju tregoj shumë raste heroike të sakrificave të tilla. Për shembull, atë të një gruaje që po vdiste nga tuberkulozi në një spital. Ajo pasi pa se nuk i duheshin paratë për vete, m'i dërgoi mua kursimet e saj të pakta. Po ashtu një zonjë e vjetër, e cila kishte kursyer tre vjet për të blerë një kapele, kur dëgjoi për nevojat tona, m'i dërgoi mua në vend që ta blinte atë. Asaj iu duk më e vlefshme kjo ndihmë sesa kapela; apo të vajzave të një shkolle, të cilat vendosën të mblidhnin para për një konvikt veror këtu tek ju, i cili me shpresë do të ndërtohet vitin që vjen. Ato, në vend që të hanin pulë dhe akullore të dielave si përpara, pranuan të ziejnë lakra dhe paratë e kursyera i dhanë për fondin e konviktit.

Kështu, mbani mend të dashura vajza se ju jeni të lidhura së bashku në këtë jetë jo vetëm nëpërmjet familjes, fqinjëve, mësuesve dhe shoqeve të klasës në shkollë, por edhe me një shoqëri të mrekullueshme e të shkëlqyer njerëzish në Amerikë, të cilët janë disa mijëra, që mendojnë për ju, luten për ju, ju duan ju dhe sakrifikojnë për ju gjërat e domosdoshme të jetës, vetëm e vetëm që ju të keni këtë mundësi për t'u rritur drejt një grarie të bukur dhe të vlefshme, të bëheni drejtuese të gjinisë suaj të kombit dhe, mbi të gjitha, të ndërtoni shtëpi të bukura.

Erickson-i juaj

ERICKSON - MBAJTËS I MEDALJES "URDHRI I SKËNDERBEUT" DHE VITET E FUNDIT NË SHQIPËRI

Të gjitha këto mundime dhe sakrifica të Erickson-it duket se në një farë mënyre u shpërblyen kur më 4 gusht 1931, qeveria mbretërore shqiptare, me një shpirt mirënjohjeje për përkushtimin e tij ndaj Shqipërisë, e nderoi atë me dekoratën e lartë të nderit, medalja "Urdhri i Skënderbeut". Duke vijuar të shprehte mirënjohjen ndaj tij, qeveria gjithashtu i vuri emrin "Erickson" një rruge në Tiranë. Në përurimin e kësaj rruge mori pjesë ambasadori i atëhershëm amerikan në Tiranë Herman Bernstein, edhe ky një mik i madh i Shqipërisë dhe shqiptarëve. Për fat të keq, asaj rruge iu hoq emri nga qeveria komuniste, e cila erdhi në pushtet në vitin 1944, duke ndërmarrë një kurs tërësisht antiamerikan.

Në një nga ditët e tij të bukura në Kavajë, ndërsa po qëndronte tek shtëpia e Koljakëve, aty erdhi një grup prej tridhjetë djemsh të shkollës dhe formuan përpara tij një gjysmë rreth. Një prej djemve i quajtur Kadri Pipa, i zgjedhur si zëdhënësi i djemve, doli nga rreshti dhe i tha këto fjalë:

> *"Kemi ardhur të të falënderojmë për hapjen e shkollës në një tokë e cila për pesëqind vjet është mbajtur thjesht dhe vetëm si livadh, ku ne mund të mësojmë dhe të aftësohemi për të bërë të tëra punët që bëjnë njerëzit nëpër botë. Ne të urojmë udhëtim*

të mbarë, punë të suksesshme në Amerikë dhe kthim të shëndetshëm në Shqipëri.[175]

Erickson-i, me lot në sy iu foli djemve për punën e bërë për tërë ato vite në Shqipëri, derisa hapi këtë shkollë, e cila ishte xhevahiri më i vyer i jetës së tij. Pastaj shtoi:

"Është një gjë e gjallë, që jeton, si një pemë që rritet, që lëshon gjethe dhe lule, që prodhon fruta për jetën tuaj, të fëmijëve tuaj dhe të brezave që vijnë"[176]

Fëmijët u lëshuan në brohoritje. E njëjta gjë ndodhi edhe me vajzat e kolegjit. Ato ishin rreshtuar në oborr dhe prisnin të flisnin me të për disa minuta. Pastaj një nxënëse e quajtur Hyrie, e cila kishte mësuar anglisht, i dëshiroi atij:

"…udhëtim të këndshëm në Amerikë, një vizitë të suksesshme atje dhe të kthehej shëndosh e mirë në Shqipëri."

Kështu ai u nis për në Amerikë edhe një herë bashkë me Carrien, e cila tashti kishte kaluar në një fazë tejet të rëndë fizike dhe mendore. Ai u vendos në Little Hill, afër Plainville në Masachusets. Aty ishte një vend i mrekullueshëm dhe nga maja e kodrës ata vështronin fusha të pyllëzuara dhe të blerta rreth e rrotull. Aty Carrie ndihej më mirë. Në vitin 1931 vajza më e vogël e shtëpisë, Grace, u martua. Kriza financiare kishte goditur ashpër Amerikën, por çifti i ri me një foshnjë mundohej ta kalonte situatën si të mundej. Në atë kohë Universiteti De Pauw i dha Erickson-it gradën "Doktor nderi".

Disa vjet pas largimit nga Shqipëria familjen e Erickson-it e goditën dy fatkeqësi. Carrie, gruaja e tij e dashur, me të cilën kishte vuajtur në një mënyrë të patregueshme, vdiq, duke e lënë në pikëllim të thellë dhe me brengën se ajo asnjëherë nuk qe pajtuar me sakrificat që ai bënte. Dhe, e dyta, shtëpia mori flakë, duke i djegur një sasi të panumërt letrash, fotografish dhe kujtimesh që kishte marrë me vete nga Shqipëria. Por edhe pse në moshë të thyer, ai asnjëherë nuk u dorëzua. Fama e tij kishte marrë dhenë që kur në vitin 1928 u fut në listën e

[175] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 3, Box No 4, Folder No 2.
[176] Po aty.

njerëzve më të shquar të botës, në librin Who is Who.

Ndërkohë që predikonte në Kishën e Hartfordit, ai u njoh me Alice Lee Welcher. Tregimet e tij për Shqipërinë, kulturën, historinë, gjuhën, traditat u bënë pjesë e bisedave të tyre të përditshme. Jeta me aq shumë mundime dhe përpjekje e Erickson-it në vendin tonë u bë pjesë e interesave të Alice-s dhe e solli punën deri aty, sa ata të martoheshin në vitin 1936.

Shpresat e Erickson-it rreth suksesit në të ardhmen të Shkollës Shqiptaro-Amerikane të Bujqësisë u vunë në dyshim përkohësisht për shkak të depresionit dhe rënies së kontributeve. Fondacioni i Lindjes së Afërt po shikonte mundësinë e mbylljes së shkollës së vajzave. Erickson-i, megjithatë, besonte shumë se ekonomia amerikane do të përmirësohej shpejt. Prandaj ai luftoi me çdo mjet që barra kohëshkurtër e mbajtjes hapur të shkollës së vajzave të përballohej.

Duke parë ecurinë e shkollës bujqësore dhe mbështetjen që ajo gëzonte nga Fondacioni i Lindjes së Afërt, Erickson-i filloi të mendonte për projekte edhe më ambicioze, krijimin e Universitetit të Ballkanit. Ai e parashikonte atë si një universitet aq të madh, sa të luante një rol vendimtar në vendosjen e paqes në Ballkan. Universiteti i ri i Ballkanit mund të ofronte bursa kualifikimi për të rinjtë e të rejat nga të gjitha vendet e rajonit. Si i tillë, ky universitet, do të kishte ndikim edhe në rrafshin akademik, edhe në atë politik. Ai e vendoste Shqipërinë si qendër gjeografike të gadishullit, në këtë drejtim.

Por ai e kuptonte se në pozicionin e tij të atëhershëm ai nuk do të kishte mbështetje të mjaftueshme për të realizuar një sipërmarrje kaq ambicioze. Nëse do të emërohej si ministër amerikan në Shqipëri, atëherë ai ndoshta do ta kishte zbatuar këtë projekt kaq të vlefshëm, si dhe do të ndiqte edhe detyrat e tij zyrtare si përfaqësues i shtetit. Erickson-i, me vitet e tij të përvojës në Shqipëri, ishte pa dyshim i kualifikuar aq mirë, sa t'i mbante të dyja këto detyra, edhe interesat e tij të veçanta, edhe protokollin ditor të shoqëruar me marrëdhëniet shqiptaro – amerikane. Prandaj, shumë individë të shquar e mbështetnin atë në një emërim diplomatik të mundshëm për të. Një person i tillë ishte Jane Adams nga Hull

House, i cili i shkroi me gëzim Presidentit Roosevelt, për ta vlerësuar Erickson-in si ministër në Shqipëri. Ai midis të tjerash i shkruante:

> *"E kam njohur z. C. Telford Erickson për shumë vite dhe kam një admirim të madh për karakterin dhe punën që ai ka bërë në Shqipëri."*[177]

Ishte fatkeqësi që, në atë kohë, Erickson-i nuk e njihte personalisht Presidentin Roosevelt, ose ndonjë tjetër të afërt në shoqërinë e tij. Zakonisht emërimet diplomatike bëheshin bazuar në konsiderata politike ose njohje vetjake. Për rrjedhojë, ndonëse Erickson-i ishte i mirëkualifikuar, nuk kishte asnjë mundësi të merrte një post të tillë, po të kihet parasysh veprimtaria ose mbështetja e tij politike ndaj njërës apo tjetrës parti në ShBA.

Gjatë dy viteve në vijim, marrëdhëniet diplomatike midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, megjithëse shumë të pakta, mbetën të përzemërta. Më 1 mars 1933, dy vendet nënshkruan një traktat ekstradimi. Më 11 mars 1933, Mbreti Zog i përcolli urimet e tij më të mira Franklin Roosevelt-it me rastin e zgjedhjes së tij si president.

Në këtë kohë, në Shqipëri filloi një reformë e rëndësishme e sistemit të arsimit, e cila do të kishte ndikim të madh edhe në perspektivë ndaj shumë interesave të huaja në këtë fushë. Më 22 prill 1933, parlamenti shqiptar ndryshoi kushtetutën dhe i hapi udhën shtetëzimit të shkollave shqiptare, duke deklaruar se e drejta e arsimimit për shqiptarët ishte tërësisht një e drejtë shtetërore dhe duhej të drejtohej prej institucioneve shtetërore. Kjo përbënte një largim rrënjësor nga politika e mëparshme shqiptare në fushën e arsimit. Në fakt qeveria kishte arsyet e veta të veçanta për të dekretuar një masë reformuese të tillë. Së pari, asaj i duhej të hiqte qafe ndikimin e Kishës Katolike mbi shumë shkolla private, të cilat nuk e mbështesnin politikën kombëtare të qeverisë. Së dyti, shkollat private të

[177] Hull House Archive, C.T.Erickson, An American Misionary to Albania. "Hull House" është një shtëpi në ShBA e ndërtuar në vitin 1889 prej Jane Adams dhe Ellen Gates Starr dhe gjendet në Çikago, Illinois. Ajo i hapi dyert për emigrantët nga Europa, duke u kthyer më vonë edhe si një arkiv për dokumentacionin e tyre të arritjes në ShBA. (Shënimi im - MB)

financuara nga jashtë dyshoheshin si të rrezikshme për shtetin. Së treti, qeveria e pa se kishte ardhur koha që mësuesit shqiptarë të merrnin një pjesë më të madhe të përgjegjësisë për arsimimin e popullit të vet.

Më 2 prill 1933, Gazeta Zyrtare (nr.21) botoi gjashtë dispozitat që kishin ndikim mbi studentët që ndiqnin shkollat e huaja. Sipas ligjit të ri, jo vetëm që u mbyllën shtatë shkolla, por gjithashtu të shtata u shtetëzuan deri në fund të atij viti shkollor. Megjithatë, ligji i ri nuk pati ndikim mbi veprimtarinë e Shkollës Shqiptaro-Amerikane të Bujqësisë, sepse në vitin 1931 Fondacioni i Lindjes së Afërt kishte negociuar një marrëveshje, duke e vendosur atë nën autoritetin ligjor të qeverisë shqiptare. Një tjetër faktor që ndihmoi ishte praktika e punësimit të personelit shqiptar në këtë shkollë që kishte qenë në fakt qëllimi i Erickson-it që prej fillimit.

Shpejt u bë e qartë se Mbreti Zog dëshironte edhe të forconte nacionalizmin shqiptar, edhe të zvogëlonte ndikimin italian në Shqipëri. Fatkeqësisht, përveç rolit që luante Italia në çështjet ekonomike të Shqipërisë, politika e jashtme e saj përfshinte edhe plane ushtarake për të ardhmen. Sipas një letre të dërguar më 7 korrik 1933, Baroni Aliosi, një nga njerëzit më të besuar të Musolinit në Ministrinë e Jashtme Italiane, i afërt edhe me ambasadorin amerikan Lang në Romë, thoshte se kontrolli i Shqipërisë së pushtuar do të zinte një vend parësor në politikën detare të Italisë. Ai iu përmbajt asaj që Italia kishte të njëjtat të drejta për të kontrolluar Adriatikun siç kishin Shtetet e Bashkuara të drejta kontrolli në Karaibe. Ambasadori Lang, duhet të jetë pajtuar me shpjegimet e Aliosit sepse letra, e cila i kishte arritur Presidentit Roosevelt, i jepte të drejtë kontrolli Italisë mbi vijën bregdetare shqiptare, me qëllim mbajtjen dhe ruajtjen e sigurisë në Europë. Në këtë kohë, kishte pak prova që tregonin se Zogu e kishte marrë vesh qëllimin e plotë të interesave italiane në Shqipëri.[178]

Qeveria shqiptare, duke vazhduar me planet e saj të njohjes dhe kontrollit

[178] Alan Fusine: Albanian – American School of Agriculture, Disertacion. Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 1, Box No 2, Folder No 5.

të sistemit arsimor në Shqipëri, njoftoi një program të ri të edukimit kombëtar, në të cilin sistemi i shkollave të mesme do të përfshinte strukturat e mëposhtme organizative: gjimnaz – tetë vjet mësim; shkollë normale – katër vjet mësim; institut tregtar - katër vjet; dhe shkollë teknike tri vite. Në ndërkohë, dita kur Fondacioni i Lindjes së Afërt do të merrte vendimin e tij përfundimtar në lidhje me statusin e ardhshëm të Shkollës së Vajzave po afrohej me shpejtësi. Në letrën dërguar Herbert Hoover-it më 31 maj 1934, Erickson-i shikon se Hoover-i kishte po ato shqetësime si ai për vazhdimin me sukses të Shkollës së Vajzave:

> *"Më vjen keq të dëgjoj për ndonjë mundësi të braktisjes së përpjekjeve amerikane që bëhen për të rinjtë shqiptarë".*[179]

Të dy ata burra duhet të jenë ndier shumë të lehtësuar me vendimin përfundimtar të Fondacionit për të vazhduar veprimtarinë e shkollës. Me Shkollën Shqiptaro – Amerikane të Bujqësisë nën drejtimin e vendosur të Fondacionit të Lindjes së Afërt, Erickson-i, në vitin 1934, vendosi të jepte dorëheqjen nga detyrat e tij zyrtare, me qëllim që të kthehej në Shtetet e Bashkuara. Prej atje ai do të vijonte të vepronte si këshilltar personal tek Fondacioni i Lindjes së Afërt në administrimin e shkollës. Dhe kështu bëri.

[179] Po aty.

MIK NDERI I MBRETIT ZOG NË FESTIMET E 25-VJETORIT TË PAVARËSISË NË TIRANË

Gjatë dy viteve në vijim, në Shqipëri, qeveria e Zogut bëri përgatitje festive për të kremtuar Pavarësinë e Shqipërisë. Prej kësaj kohe, statusi i vërtetë i Shqipërisë, si një komb i pavarur, ishte zvogëluar tej mase si rezultat i ndikimit italian. Në një letër të Cordel Hull-it, ministri Grant [180], jo vetëm që vuri në pah shumë zona në të cilat italianët tashmë ushtronin kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë, duke cenuar gjithashtu pavarësinë e Shqipërisë,por gjithashtu hamendësoi mbi të ardhmen e Shqipërisë në duart e italianëve:

"Shqiptarët mund të gëlltiten prej Romës së Re Perandorake, por nuk do të treten kollaj."

Pa dyshim, personalitetet italiane dhe disa prej zyrtarëve të Departamentit të Shtetit, të cilët ishin caktuar për të marrë pjesë në festime e dinin se ditët e Zogut si mbret i Shqipërisë ishin të numëruara. Në retrospektivë, Zogu kishte bërë një gabim shumë të rëndë më 27 nëntor 1926, kur nënshkroi Paktin e Miqësisë dhe të Sigurisë me italianët, i njohur me emrin *Traktati i Tiranës*, i cili shënoi rikthimin e ndërhyrjes ekonomike italiane, që do të pasohej nga kontrolli i mundshëm ushtarak i Shqipërisë.

[180] Po aty.

Në dukje i panjohur me planet italiane që prisnin pushtimin e Shqipërisë, Zogu vijoi me planet e tij për përdorimin e festimeve të Pavarësisë së Shqipërisë si mjet për ta përqendruar vëmendjen tek objektivat kombëtare. Gjatë javës së festimeve, Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, u dekorua me të gjitha simbolet e përshtatshme të nacionalizmit shqiptar. Kostume tradicionale fshatare dhe veshje elegante të familjeve të mëdha mund të shiheshin përditë dhe anë e mbanë. Atmosfera e festimeve ishte me të vërtetë shqiptare. Aty ishin ftuar personalitete të ndryshme, përfshirë edhe dr. Erickson-in dhe të shoqen Alice-n. Atyre iu bëri shumë përshtypje përzemërsia ndaj tyre e treguar prej Mbretit Zog.

Kur Erickson-i u martua me Alice Lee Welsh, ai udhëtoi me të nëpër Europë, për ta përfunduar këtë udhëtim në Tiranë, ku do të merrnin pjesë si të ftuar nderi të Mbretit në këto festime. Ata zbritën nëpër bregdetin dalmat drejt Veriut të Shqipërisë, siç Erickson-i kishte bërë edhe herë tjera. Ai tani ishte 68 vjeç, ndërsa Alice 51. Gjatë atij udhëtimi në Shqipëri Alice e nxiti atë të shkruante për Shqipërinë.

> *"Një libër për Shqipërinë dhe vlerat që ju çmoni tek shqiptarët, arrijnë të shkojnë tek më shumë njerëz se çdo bisedë e jotja për ta, Erik",*

i tha ajo, ndërkohë që Erickson-i fliste me aq pasion për shqiptarët. Ai iu vu me mish e me shpirt mbledhjes së dokumenteve, kujtimeve dhe i shkroi ose rishkroi ato.

Ata, sapo arritën në Tiranë, shkuan të shihnin Mbretin Zog. Aty ata panë artikullin: *"Një mbret beqar"*[181] Në atë artikull, mbreti, i pyetur se përse ishte bërë mbret, ishte përgjigjur:

> *"Populli ynë nuk i kupton zgjedhjet presidenciale. Kur erdhën malësorët në pazarin e Tiranës dhe mësuan se ishte zgjedhur një president, ata pyetën: "Po ai i mëparshmi ku është varrosur dhe çfarë po bënte fisi i tij për t'i marrë gjakun?" Kreu i një fisi, sipas mentalitetit të tyre, është i tillë për jetë. Prandaj e kam shpallë vetveten mbretin e kryе-krerëve."*

[181] New York Public Library: New York Times Magazine, September 3, 1937: Intervistë e mbretit beqar, Ahmet Zogu.

Pastaj Mbreti Zog i shpjegoi çiftit Erickson për tri ditët e festimeve të 25-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë. Alice pa me sytë e vet vendin, njerëzit, miqësinë, dhe frytet e punës së Erickson-it në Shqipëri.

Festimet e atij përvjetori mbahen mend si më të bukurat të organizuara ndonjëherë në Shqipëri. Rrugët kryesore që lidhnin qytetet u mbushën me njerëz të veshur në kostume kombëtare. Shumë miq të nderuar nga Europa erdhën për të marrë pjesë në festën e 25- të të Pavarësisë. Erickson-i dhe Alice qëndruan në rezidencën e ambasadorit amerikan në Tiranë, Ulysses S. Grant. Që aty ata dëgjonin në radio thirrjen që Mbreti Zog iu bëri shqiptarëve nëpërmjet radios dhe përkthimin e fjalimit të tij në disa gjuhë të ndryshme, si: frëngjisht, anglisht, gjermanisht dhe italisht. Më pas pasuan të shtënat e 101 topave. Ambasadori në mbrëmje dha një pritje në ambasadë. Ishte një natë e rrallë për Erickson-in tek takonte miqtë e tij të vjetër, diplomatë, zyrtarë apo pjesëmarrës të festës. Ambasadori propozoi një dolli për Naltmadhninë e tij, Mbretin Zog, dhe popullin shqiptar. Pastaj për Presidentin e ShBA-së, një tjetër për Ditën e Falënderimeve dhe për lumturinë dhe shëndetin e Erickson-ëve. Pastaj ai i kërkoi Erickson-it të thoshte disa fjalë për Ditën e Falënderimeve, të cilat ai i tha me shumë emocion dhe elokuencë.

Më pas vijuan veprimtaritë e tjera festive, ndër të cilat, për t'u mbajtur mend, është darka tek Mbreti Zog. Në ftesën që kishte marrë Erickson-i, e shkruar në frëngjisht shkruhej:

> *Me vullnetin e Naltmadhnisë së tij, Mbretit, Gjeneral Serreqit, First Aide de Camp (Mëkëmbësi i parë) i Naltmadhnisë së tij, ka nderin t'i kërkojë Monsinjor dhe Madame Erickson-it pjesëmarrjen në mbrëmjen që do të jepet në Pallatin Mbretëror të enjten me datë 25 nëntor, në orën 22.00.*
>
> *Uniforma: Zyrtare dhe me dekorata*

Erickson-i mbante varur në qafë me krenari Medaljen e Skënderbeut gjatë tri ditëve të festimeve, si në darka, takime, ashtu edhe gjatë paradës ushtarake që do të pasonte. Në mbrëmje, me urdhër të mbretit, gratë pjesëmarrëse ishin veshur

me kostume kombëtare. Edhe të ftuarit, secili sipas traditës së vet, ishte veshur me rroba kombëtare ose me rroba nga më të shtrenjtat dhe më të bukurat e kohës. 600 pjesëmarrës në Pallatin e Mbretit festuan atë natë në një atmosferë gëzimi dhe hareje për Pavarësinë. Në hyrje të pallatit ishte vendosur një portret i Sadije Zogut, nënës së ndjerë të mbretit dhe në faqen tjetër një hartë e madhe e Shqipërisë. Qilimat persianë dhe shandanët e zbukuronin atë mbrëmje pallatin deri në një magji.

Në orën 10.30, rojat hapën derën e madhe dhe në të dha ballë Mbreti, i gjatë dhe i bukur në rrobat e tij mbretërore. Pasi u ul ai, filloi muzika, e cila ishte një kombinacion i instrumenteve moderne të muzikës klasike me ato popullore e folklorike. Gjatë mbrëmjes Erickson-i dhe e shoqja vunë re edhe gajdet, të cilat sollën ndërmend instrumentet skoceze. Alice mësoi shumë fjalë përshëndetëse gjatë asaj mbrëmjeje.

Festa vazhdoi edhe në ditët e tjera. Sheshi i Tiranës u mbush me mijëra njerëz. Pastaj në mbrëmje ata shkuan përsëri në Ambasadën Amerikane. Pasdite ambasadori thirri për çaj disa miq të vet. Gjatë kohës së çajit ai i kërkoi Erikut të mbante një fjalim në gjuhën shqipe, diçka që ai e bëri me shumë kënaqësi, duke tërhequr simpatinë e tërë të pranishmëve, por më shumë se të kujtdo, atë të Alice-s.

Në mbrëmje Kryetari i Bashkisë së Tiranës shtroi një darkë. Edhe aty grupet fshatare vijuan me argëtimet dhe muzikën e tyre. Për gëzimin e jashtëzakonshëm të Erickson-it, gjatë mbrëmjes një vajzë e re i dhuroi atij një libër të quajtur "*Bija e shqipeve*" dhe i kujtoi se ajo kishte studiuar në Shkollën e Vajzave të Kavajës. Erickson-i nuk i mbajti dot lotët nga ky gjest kaq i bukur, fryt i punës së tij shumëvjeçare në Shqipëri. Ditën tjetër Princesha Myzejen drejtoi një program të gjimnastikës dhe të sportit në fushë të hapur. Në mbrëmje ata ndoqën një ndeshje futbolli. Ngado që lëviznin në qytetin e Tiranës, ata vunë re djelmosha, qytetarë, grupe njerëzish të cilët mbanin flamuj kuq e zi në duar, këndonin himnin kombëtar dhe përshëndesnin me dorën e djathtë të ngritur lart deri tek gjoksi, shprehje e përshëndetjes mbretërore. Ajo që e habiste më së shumti Alice-n ishte përdorimi i shumë gjuhëve nga njerëzit, kudo që ata i takonin. Pesë gjuhë ishin thuajse në përdorim të zakonshëm aty. Më pas Kryeministri Koço Kota dha një

darkë në Klubin e Oficerëve me 400 mysafirë. Aty nuk mori pjesë Mbreti, por të gjitha princeshat ishin aty. Erickson-i takoi një mjek me mbiemër Frashëri, i cili kishte kryer shkollën në Wellsley. Ai i tregoi Erickson-it se kishte ngritur një klinikë private në Tiranë dhe një në Kavajë. Erickson-it aty për aty i lindi ideja që ta ndihmonte për pajisjet që i duheshin për klinikën.

Në ditën e Shpalljes së Pavarësisë, u ngrit flamuri kombëtar shqiptar, i shoqëruar prej fishekzjarrësh dhe brohoritjesh pa fund të turmës. Në mbrëmje një darkë tjetër me 200 vetë u mbajt në Pallatin e Mbretit. Natyrisht Erickson-ët ishin midis miqve më të mirë të Shqipërisë. Kur Mbreti hyri në sallën ku shtrohej darka, tërë të pranishmit u ngritën në këmbë dhe i hapën rrugën atij. Tek pa Erickson-in, ai u ndal dhe i tha: "*Erickson, unë kurrë nuk do ta harroj shërbimin e gjatë që ti i ke bërë Shqipërisë*". Pastaj ai takoi Alice-n e cila me mirësjellje ia zgjati dorën Mbretit. Mbreti ia puthi dorën. Më pas pasuan princeshat dhe pjesëtarët e familjes mbretërore. Në atë çasti Erickson-i i tha Alicës:

> *"Shqipëria ka arritur një stad krenarie dhe qytetërimi midis shteteve të Europës. Ajo që i duhet tani menjëherë është një mbretëreshë dhe një trashëgimtar, një familje mbretërore për të forcuar fronin e paqëndrueshëm."*

Ata vërtet e shijuan pjesëmarrjen në atë festë madhështore të një mbretërie të vogël. Por Erickson-i i dinte shumë mirë se si shkonin punët midis mbretërisë dhe Italisë. Në atë ndjenjë gëzimi dhe entuziazmi, ai i tha Alicës:

> *"Do desha të ndieja krenarinë që ndien një prind në ceremoninë e diplomimit, por unë e di se sa larg nga pavarësia është ky fëmijë… Unë besoj se Shqipëria, tek e fundit, do të jetë e paepur, por kam frikë se një eklips tjetër i errët, si ai i kohës së turqve është në horizont. Ju e dini se megjithëse këta njerëz na kanë zbavitur mbretërisht dhe në dukje u japin të huajve si mua dhe ty ngrohtësinë e zemrës, ata asnjëherë nuk e japin shpirtin e tyre tërësisht. Diçka brenda tyre, njësoj si shkrepat e granitit të tokës së tyre, qëndron vetvetiu krenare, qoftë në ditë të mira, qoftë në fatkeqësi. Dhe kjo ashtu ka qenë, ashtu është dhe ashtu do të mbetet".*[182]

[182] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 2, Box No 4, Folder No 6.

NDERIM TEK VARRI I NËNËS MBRETËRESHË

Në kujtimet e tij për këtë festë të shënuar, Erickson-i na përshkruan vajtjen tek varri i Nënës Mbretëreshë, si më poshtë:

"Në programin e përgatitur për festimet e njëzetepesëvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë ishte planifikuar edhe një vizitë tek varri i Nënës Mbretëreshë. Në mëngjes një procesion i zgjedhur, i madh, solemn, marshoi rrugëve të qytetit të Tiranës, kaloi pranë Legatës Amerikane dhe asaj Greke dhe vijoi rrugën drejt një kodre përballë. Që andej vështrohej i tërë qyteti. Aty gjendej varri. Në këtë procesion merrnin pjesë anëtarë të trupit diplomatik, zyrtarë të lartë të qeverisë shqiptare, ushtrisë, shkollave dhe qindra njerëz të të gjitha llojeve dhe shkallëve të shoqërisë, të gjithë të frymëzuar nga e njëjta ndjenjë e respektit për një grua të madhe, një nënë të mrekullueshme dhe një shembull të vlefshëm për gratë e kombit.

Pasi u krye ceremonia dhe turma u shpërnda, gruaja ime dhe unë preferuam të bënim të vetëm pelegrinazhin tonë. Varri ishte mbuluar me kurora të mrekullueshme prej birit të saj, Mbretit Zog I, dhe motrave të tij. Përreth mureve të brendshme ishin grupuar kurorat e shoqërive dhe organizatave, duke e kthyer atë vend nga një varr në një vend qetësie dhe bukurie gati hyjnore. Ndërkohë që ne po qëndronim në heshtjen

nderuese, pranë varrit të saj tri vajza të vogla nga një shtresë më e varfër kaluan ngadalë, si për të mos u vënë re, dhe zunë vendet e tyre në heshtje pranë nesh. Më pas dy hoxhallarë të rangut të lartë, njëri prej tyre myfti, hynë dhe zunë vend, njëri tek koka dhe tjetri tek këmbët, ranë në gjunjë dhe u falën për prehjen në paqe të së ndjerës.

Këtu vërtet ishte një vend i shenjtë për kombin, për katolikët, ortodoksët, myslimanët, protestantët. Kjo vërtet kishte rëndësi. Pranë varrit të së ndjerës, besimet e ndryshme e gjejnë veten të bashkuar në një fe të vetme, në një shpresë, në një Zot.

"Zoti dhe Ati i të gjithë neve, i cili është mbi të gjithë dhe brenda nesh të gjithëve!"

Sa e mrekullueshme dukej që nëna e tërë kombit po nderohej kështu!

Sadije Zogu kishte jetuar sipas traditave më të larta të racës së saj, për të cilën të gjithë ishin krenarë. Ajo kishte sjellë në jetë tetë djem dhe vajza; kishte ndihmuar burrin e saj, i pari i fisit të fuqishëm të Matit, në luftën e egër që të gjithë ata bënin për çlirimin e racës shqiptare nga zgjedha e tmerrshme e Sulltan Abdylit të Kuq. Kur i pari i shtëpisë vdiq ende në moshë të re, Sadija jo vetëm që u bë zonja e shtëpisë, por në një sferë më të gjerë ajo i dha drejtim dhe frymëzim popullit malësor, derisa biri i saj, Ahmeti, u bë trashëgimtari i babait të tij si një prijës, sapo kishte mbushur moshën 18-vjeçare.

Për më shumë se njëzet vjet ajo qëndroi pranë atij djali si në shkallët që pasojnë njëra-tjetrën në udhëtimin e tij, deri në postin e kreut të shtetit. Ajo ishte këshilltarja e tij e zgjuar dhe e dashur në çështjet e shtetit. Aq e zgjuar ishte ajo, sa rrallë ndodhte, nëse ndodhte ndonjëherë, që djali i saj të ndërmerrte ndonjë veprim pa marrë më parë miratimin e plotë të saj. Ajo e frymëzoi atë për jetën në të gjitha drejtimet e mundshme, i forcoi besimin në vetvete dhe në fatin e tij, guximin për të ndërmarrë veprime kur armiqtë e tij ishin një mori e pafund, ndërsa miqtë, të cilëve ai mund t'u besonte plotësisht, për fat të keq, ishin pak.

Ajo i mësoi atij besnikërinë ndaj traditave të forta dhe idealeve të racës së vet. Tek nëna e tij, mbreti i ri gjeti një tërheqje si në një vend të shenjtë, ku ai mund të harronte gjithçka tjetër përveç të qenit biri i saj dhe prehjen në dashurinë dhe bekimin e saj.

Ajo që të habit edhe më shumë është që, edhe një vit pas vdekjes së saj të papritur, Mbreti Zog ishte si një njeri i dalë nga vetvetja, duke mos parë thuajse askënd, duke mos shkuar asgjëkundi, duke jetuar jetën e një eremiti, në ditët kur hija e rëndë e kësaj humbjeje të madhe ende vazhdonte t'i digjte zemrën dhe vetë jetën."

Festa mbaroi. Ata u nisën përsëri për Kavajë, për të mos u kthyer më aty. Kur e lanë Tiranën, Erickson-ët kaluan një javë në Shkollën Shqiptaro-Amerikane të Bujqësisë në Kavajë. Kjo shkollë do të ishte shqetësimi i tyre i përhershëm, në atë prag pushtimi fashist të Shqipërisë. Ata vërtet u gëzuan shumë, por edhe u mbushën me frikën dhe shqetësimin e asaj që dukej pak a shumë hapur se do të ndodhte: Pushtimi fashist italian. Kjo ishte edhe vizita e tij e fundit në Shqipëri.

PUSHTIMI FASHIST ITALIAN DHE FATI I SHKOLLËS SË ERICKSON-IT NË KAVAJË

Siç dihet më 7 prill 1939, Italia fashiste e pushtoi Shqipërinë. Mbreti Zog iku në mërgim. Kjo e shqetësoi pa masë Erickson-in, veç tjerash edhe pse kjo rrezikonte seriozisht statusin e ardhshëm të Shkollës Shqiptaro-Amerikane të Bujqësisë. Vetë fakti që Shtetet e Bashkuara refuzuan të njihnin aneksimin fashist të Shqipërisë, sigurisht do të kishte ndikim shumë të madh mbi të ardhmen e interesave amerikane në vend. Veç kësaj, edhe nëse Departamenti i Shtetit e kishte nxitur privatisht Fondacionin e Lindjes së Afërt që të mbante Shkollën Shqiptaro-Amerikane të Bujqësisë, forcat pushtuese italiane planifikonin të largonin tërë investimet e huaja nga trualli shqiptar.

Më 4 gusht 1939, Ernest Koliqi, ministri shqiptar i Arsimit, i cili dukej se vepronte nën urdhrat e Jakomonit, iu tha zyrtarëve se Fondacioni i Lindjes së Afërt duhej të hiqte dorë nga mbështetja financiare e shkollës. Përderisa tërë sistemi arsimor në Shqipëri, prej kësaj kohe, duhej t'u bindej parimeve të fashizmit edhe shkolla do të vendosej nën mbikëqyrjen italiane. Më 17 nëntor 1939, Fondacioni i Lindjes së Afërme, pasi nuk iu dha asnjë mundësi zgjedhjeje, pranoi shumën prej 10.000 dollarësh për transferimin e pronësisë së tërë pajisjeve të lëvizshme, furnizimeve, gjësë së gjallë të përdorura në shkollë.

Megjithëse tmerrësisht i mërzitur prej këtij ndryshimi të ngjarjeve, Erickson-i ishte mirënjohës, të paktën, për atë që i ishte dhënë mundësia që të jepte kontributin e tij ndaj arsimimit shqiptar. Ai gjithashtu u ndje borxhli ndaj atyre njerëzve të cilët me donacionet e tyre kishin ndihmuar Shkollën Shqiptare-Amerikane të Bujqësisë. Ai shkruante:

> *"Nuk ka nevojë t'ju them se…unë kam pasur një vend shumë të ngrohtë në zemrën time edhe për Vernon Kellogg-un, edhe për mikun e tij anonim Herbert Hoover.*[183]

Sa i takon së ardhmes së Shqipërisë, Erickson-i besonte se, në qoftë se italianët do të vazhdonin të përmirësonin bujqësinë shqiptare, ata duhej të shfrytëzonin aftësitë e më se treqind të diplomuarve të Shkollës Shqiptare-Amerikane të Bujqësisë, të cilët ishin trajnuar me metodat moderne bujqësore. Shumë shpejt doli se planet italiane për Shqipërinë ishin krejtësisht të pasinqerta. E ardhmja e Shqipërisë dukej shumë e errët. Shumë shqiptarë që e njihnin Erickson-in nuk do të harronin kurrë karakterin e tij dhe dashurinë e tij për popullin shqiptar:

> *…Dr. Erickson-i erdhi në Shqipëri më shumë se tridhjetë vjet më parë dhe qëndroi aty për të shpërndarë ungjillin e paqes dhe të vëllazërisë …Ai kishte vizionin dhe shpirtin e shërbimit…për të kryer këtë projekt…*[184]

Në këtë situatë që gjendej shkolla, Ali Cungu, miku i pandarë dhe i përhershëm i Erickson-it, i dërgon atij letrën e mëposhtme, e cila tregon më së miri fatin e asaj shkolle në atë kohë. Shkolla Kombëtare e Bujqësisë në Kavajë, siç quhet sot, përjetoi po atë fat që përjetuan tërë shkollat amerikane, si ajo edhe Shkolla Teknike e Harry Fulltz – it në Tiranë, ose investimet amerikane në Shqipëri. Megjithatë, fakti që ajo mbijetoi dhe që vazhdon edhe sot të përgatisë agronomë për bujqësinë shqiptare tregon se sa të forta ishin themelet e saj që në fillimet e saj kur Erickson-i e themeloi atë.

---

[183] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 2, Box No 2, Folder No 3.

[184] Po aty

I dashur Erickson,

Të kërkoj ndjesë që kam qëndruar në heshtje për një kohë kaq të gjatë, veçanërisht në një kohë kur gjërat po ndodhin me kaq shpejtësi në këtë vend dhe në këtë shkollë që ju e keni themeluar vetë. Sigurisht që ju ndiheshit i qetë kur i dorëzuat shkollën Fondacionit të Lindjes së Afërt. Kështu u ndiem të gjithë ne, derisa diku nga viti i shkuar ata planifikuan ta mbyllnin punën e tyre në Shqipëri dhe të na nxirrnin në rrugë. Atyre iu mbaruan paratë dhe thanë se nuk mund të vazhdonin edhe më tej. Unë vetë, menjëherë, e vura veten në krye të lëvizjes për parandalimin e kësaj dhe iu shkrova atyre që mund të na ndihmonin. Apeli im hasi në një përgjigje të menjëhershme dhe Ministria e Arsimit e rriti mbështetjen financiare dhe atyre të rinjve të cilët kishin dëshirë të mësonin iu dha edhe një mundësi tjetër. Kjo, pa dyshim, që pat efektin e vet edhe në ShBA dhe njerëzit filluan të jepnin përsëri lirshëm për vijimin e mësimit të të rinjve shqiptarë.

Ngjarjet politike të prillit të shkuar duket se kthyen gjithçka mbrapsht në shkollën tonë. Ndërsa më parë ishte Fondacioni i Lindjes së Afërt ai që donte ta kthente shkollën tek qeveria shqiptare, tani u bë një domosdoshmëri për qeverinë shqiptare të kërkojë që shkolla të dorëzohet. Ka pasur një numër arsyesh për këtë hap:

1. *Italianët këmbëngulën që shkollat të drejtoheshin prej personelit shqiptar, në traditën shqiptare dhe që, nëse kishin nevojë për këshillat e të huajve, ata ishin këtu vetë për t'i dhënë ato, në vend që të lejojnë ndonjë të huaj tjetër ta bëjë këtë.*
2. *Qëkurse iu ra ndërmend edhe regjistrimi dhe numërimi i kurseve të studimit, falë asistencës financiare të qeverisë italiane, puna u bë më e lehtë.*

Fondacioni i Lindjes së Afërt ra dakord me kërkesën e qeverisë shqiptare, duke marrë parasysh se 10.000 iu qenë dhënë atyre për t'i hequr në para të huaja si një rikompensim për pajisjet dhe furnizimet e lëna prapa (asnjë pajisje e re nuk i është shtuar inventarit këto dy vjet). Kjo kërkesë dhe mënyra në të cilën ajo është joshur, duke mposhtur tërë interesat tjera të parëndësishme, erdhi si një habi për ne

që vlerësojmë idenë e dhuratës së filantropistëve amerikanë më shumë sesa dhuratën vetë. Dhënësi, gjithashtu, jam i sigurt, kishte rininë shqiptare në mendje dhe jo ndërmjetësimin e dikujt, i cili në rastin tonë është NEF (Fondacioni i Lindjes së Afërt). Unë nuk mund të shoh se si një organizatë humanitare administron dhuratën e një numri filantropësh amerikanë për rininë shqiptare dhe pastaj kthehet dhe kërkon që t'i kthehet përsëri asaj. Unë, për vete, edhe nëse do të isha një dhurues, do të kisha menduar se Fondacioni e ka tradhtuar besimin që i kisha dhënë me tërheqjen mbrapsht nga Shqipëria të dhuratës që ishte caktuar për popullin shqiptar. Po ju si ndiheni vetë për këtë?

Çfarëdo të ndodhë, një gjë është shumë e qartë: Fondacioni i Lindjes së Afërt duket të jetë i vendosur për të mos dhënë kontribute të tjera shkollës sonë, prandaj miqtë tanë amerikanë duhet të japin tek në drejtpërsëdrejti. Në një prej këtyre ditëve unë mund t'u kërkoj juve t'i bëni shkollës një dhuratë, si, bie fjala, një traktor Diesel dhe të bëjë atë që mendon se "dora e majtë nuk di gjë çfarë bën e djathta".

Tungjatjeta juve dhe zonjës,

Sinqerisht, Ali Cungu[185]

[185] Letër e Ali Cungut, drejtuar Charles Telford Erickson-it datë 22 gusht 1939. Letra është e ruajtur në Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 2, Box No 2, Folder No 3.

DELEGATI ZYRTAR I VATRËS NË KONFERENCËN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË SAN FRANCISKO, 1945

Erickson-i i kaloi vitet e Luftës së Dytë Botërore sa në Kinë, sa në Zelandën e Re, sa në Australi, në misione të ndryshme. Në vitin 1945, në San Francisko të Kalifornisë u mbajt Konferenca e Kombeve të Bashkuara. Siç dihet, në atë kohë qeveria e re shqiptare, e dalë nga lufta, nuk njihej nga Shtetet e Bashkuara dhe, si rrjedhojë, ajo nuk u lejua të përfaqësohej në këtë ngjarje të madhe ndërkombëtare.

Konferenca e Kombeve të Bashkuara[186]

Më 25 prill-26 qershor të vitit 1945, zhvilloi punimet konferenca e 50 shteteve anëtarëve themeluese të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Kina thirrën Konferencën e San Franciskos për të hartuar një tekst përfundimtar të Kartës së OKB-së, siç ishte rënë dakord në Konferencën e Jaltës, të mbajtur nga data 4 deri më 11 shkurt 1945. Ftesat iu dërguan fillimisht qeverive të 42 vendeve që kishin nënshkruar Deklaratën e Kombeve të Bashkuara më 1 janar 1942, ose që kishin miratuar deklaratën dhe u kishin shpallur luftë vendeve të bllokut fashist. Vendet e ftuara: Australia, Belgjika, Bolivia, Brazili, Kanadaja, Kili, Kolumbia, Kosta-Rika,

[186] Thanas Mustaqi, marrë nga gazeta "Investigation", datë 17 janar 2012.

Kuba, Çekosllovakia, Republika Dominikane, Ekuadori, Egjipti, Etiopia, Greqia, Guatemala, Haiti, Hondurasi, India, Irani, Iraku, Liberia, Libani, Luksemburgu, Meksika, Holanda, Zelanda e Re, Nikaragua, Norvegjia, Panamaja, Paraguai, Peruja, Filipinet, Franca, El Salvadori, Arabia Saudite, Siria, Turqia, Unioni i Afrikës së Jugut, Uruguai, Venezuela dhe Jugosllavia.

Më 30 prill 1945, konferenca u dërgoi ftesa edhe qeverive të republikave sovjetike të Bjellorusisë dhe Ukrainës dhe – pavarësisht kundërshtimeve të BRSS-së – qeverisë së Argjentinës, e cila kishte ndjekur një politikë armiqësore ndaj Kombeve të Bashkuara, duke i shpallur luftë Gjermanisë vetëm më 27 mars 1945. Më 5 qershor 1945, iu dërgua ftesë edhe qeverisë së Danimarkës. Për shkak të kundërshtimeve të fuqive perëndimore ndaj qeverisë polake, Polonia nuk u ftua në konferencë. Megjithatë, më 23 qershor 1945, me këmbënguljen e Bashkimit Sovjetik, konferenca vendosi të lërë hapësirë në Kartën e OKB-së për nënshkrim nga përfaqësuesit e Polonisë. Kështu Polonia u bë një nga anëtarët themelues të OKB-së.

Konferenca e San Franciskos i kushtoi vëmendje të madhe përcaktimit të qëllimeve dhe parimeve të OKB-së, si dhe strukturës dhe kompetencave të organeve të saj kryesore. Konferenca themeloi Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, statuti i së cilës është pjesë e Kartës së OKB-së. Pas debateve të gjata, më në fund u miratua Karta e OKB-së. Nënshkrimi zyrtar u bë më 26 qershor 1945. Më 24 tetor 1945, pas ratifikimit nga të gjithë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit dhe shumica e shteteve të tjera nënshkruese, Karta e OKB-së hyri në fuqi.

Në këto kushte, kur qeveria shqiptare e Enver Hoxhës nuk u lejua të merrte pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara në San Francisko, Federata Panshqiptare Vatra i doli edhe një herë për zot vendit të vet. Për të arritur atë që donte, ajo delegoi përsëri njeriun që i kishte kushtuar jetën Shqipërisë, pikërisht Charles Telford Erickson-in. Ai u autorizua të shkonte në San Francisko dhe të lobonte për Shqipërinë. Sado që ai nuk mund të ishte një përfaqësues zyrtar me një ndenjëse në konferencë, përsëri ai, si një njeri i njohur jashtëzakonisht mirë me

çështjen shqiptare, duhej të gjendej afër mjediseve të konferencës. Ishte po e njëjta sjellje, po i njëjti qëllim, po e njëjta detyrë që Erickson-i kishte përmbushur 16 vjet më parë në Konferencën e Paqes në Paris, 1919: Mbrojtja e interesave të Shqipërisë dhe lobimi me sa më shumë amerikanë që kishin forcë vendimmarrëse.

Ai niset për në San Francisko dhe vendoset në hotelin "Manx", prej nga do t'i shkruante letra Presidentit Amerikan, Sekretarit të Shtetit dhe kryetarit të delegacionit amerikan në konferencë dhe do të mbante korrespondencë me drejtuesit e "Vatrës" etj. Për të pasur një ide më të qartë të punës që bëri Erickson-i, si përfaqësuesi i vetëm jozyrtar i interesave të Shqipërisë, me mandat të dhënë nga Vatra në këtë konferencë, po sjellim përkthimin e letrave të ruajtura që ai shkroi dhe mori gjatë asaj periudhë të vitit 1945. Kjo korrespondencë vërteton se Erickson-i, edhe pse jo në Shqipëri, ishte përsëri me ndjenjë, mendje dhe zemër atje. Ishte atje për të bërë përsëri atë çfarë mund të bënte për Shqipërinë.

LETËR DREJTUAR SENATORIT VANDENBERG

Nga Charles Telford Erickson

Hotel Manx

Tel. GA. 7070

13 maj 1945

Senator Arthur R. Vandenberg

Delegati i ShBA-së në Konferencën e Kombeve të Bashkuara

I dashur Senator,

A ju kujtohen filmat vizatimor të disa viteve të shkuara? ato "kur një djalë kishte nevojë për një mik?" Unë jam në atë gjendje. Jo vetë. Në atë aspekt unë jam më

i pasur se kurrë. Ndihem i tillë si përfaqësues zyrtar i pesëdhjetë mijë shqiptaro-amerikanëve dhe një ose dy milionë të tjerëve në Ballkan, të cilët janë penalizuar për diçka – që ata vetë nuk e dinë çfarë është – me mohimin e pjesëmarrjes së tyre të merituar në Konferencën e Kombeve të Bashkuara.

I kam falur Shqipërisë afro tridhjetë vjet të jetës sime. E kam përfaqësuar atë në Konferencën e Paqes në Paris (Shih Who is Who) dhe me ndihmën e fatit përftova interesin dhe mbështetjen e Presidentit Wilson, i cili, në fund, e shpëtoi atë nga copëtimi që i kanoste Italia, Jugosllavia dhe Greqia, duke i dhënë formën e saj të pavarur, ndonëse jo me shpirtin dhe trupin e saj të plotë e të merituar. Shqipëria nuk ka nevojë për një Traktat të Dytë të Londrës. Kur kjo të dalë në dritë, do të kundërmojë. A do të ishit aq i mirë Senator, sa të më jepnit një takim të shkurtër në kohën tuaj më të përshtatshme? Ka të ngjarë që unë të organizoj një konferencë shtypi dhe t'i futëm punës. Deri atëherë, mbetem

I juaji sinqerisht

C. Telford Erickson

Nënshkruar [187]

Më datën 11 maj 1945 Erickson-i i dërgon një letër kryetarit të delegacionit britanik, z. Anthony Eden[188], në të cilën i shpreh hapur pakënaqësinë e tij për faktin që Shqipëria nuk ishte ftuar në Konferencën e Kombeve të Bashkuara në San Francisko. Ai i përcjell atij të njëjtin tekst që i dërgoi dy ditë më vonë edhe kryetarit të delegacionit amerikan z. Eduard Stetinius. Meqë dy letrat kanë të njëjtën përmbajtje lexuesi, le të mësojë për përmbajtjen e tyre, të cilat dallojnë vetëm nga adresa marrëse dhe data në të cilën e mori kryetari i delegacionit amerikan Eduard N. Stetinius.

[187] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 3.
[188] British National Library, Anthony Eden Collection, San Francisko Conference.

LETËR DREJTUAR KRYETARIT TË DELEGACIONIT AMERIKAN, EDUARD N. STETINIUS[189]

Nga Charles Telford Erickson

Hotel Manx

Tel. GA.7070

13 maj 1945.

Të nderuarit Eduard N. Stettinius

Kryetar i delegacionit amerikan

Hoteli "Fairmont", San Francisko

I dashur z. Kryetar,

Federata Panshqiptare Vatra e Amerikës më ka dërguar në Konferencën e Kombeve të Bashkuara në San Francisko për të kërkuar një përgjigje të përshtatshme ndaj çështjes që djeg zemrën e kësaj race krenare e të lashtë:

Përse Shqipëria është përjashtuar nga anëtarësia në Kombet e Bashkuara? Kur kombeve të tilla u janë akorduar të gjitha të drejtat, nderet dhe privilegjet në atë organ, si Argjentinës, Bolivisë, Kosta-Rikës, Republikës Dominikane, Libanit dhe Turqisë, kombe të cilat kanë kontribuuar pak ose aspak në fitoren e kësaj lufte – Shqipëria e përgjakur dhe e shkatërruar nga lufta, është lënë jashtë derës. Kjo ngre pyetje dhe dyshime rreth një numri të madh çështjesh. A ka ardhur në jetë përsëri Traktati i Fshehtë i Londrës? A është bërë Shqipëria edhe një herë pengu i radhës,

[189] Eduard Reilly Stettinius (1900-1949), industrialist amerikan, i cili shërbeu si Sekretar Shteti në administratën e Roosevelt-it (1944-1945) dhe kontribuoi shumë në themelimin e Kombeve të Bashkuara.

që duhet sakrifikuar për të rregulluar diçka nga veprimet e rrezikshme, nëse do të thoshim kështu, të bëra prej të kuqve? Ndoshta është përsëri Italia? Apo Greqia? Apo të dyja bashkë duan të përfitojnë prej këtij kurbani?

Këto dhe çështje tjetra ngrihen për arsyen e thjeshtë se është e pamendueshme që një komb i vogël si Shqipëria, vendi i të cilit është bërë fushë beteje dhe ka humbur deri në njëzet mijë vetë, edhe pse ka marrë pak ose aspak ndihmë nga aleatët, që ka luftuar nëpër rrëpirat e veta, edhe pse njerëzit në shtëpitë e tyre vuanin nga uria, të mos merret në konsideratë. A ka arsye për këtë mohim të të drejtave të tyre kombëtare? Çështja bëhet groteske po ta shohim në dritën e arritjeve të tyre.

Ndoshta është qeveria e Enver Hoxhës që është Persona-non-grata në Departamentin e Shtetit? Unë e them këtë duke e marrë me mend se Departamenti ynë i Shtetit dhe 10 Downing Street, janë pajtuar mbi këtë çështje. Ata bashkërisht kanë dërguar "vëzhgues" ushtarakë dhe nuk është dhënë asnjë shenjë se Uashingtoni ka ndonjë plan për Shqipërinë, madje për ndihmat që UNRRA rri e gatshme t'i shpërndajë, derisa qeveria t'u hapë rrugën kërkesave të Britanisë së Madhe, që administrimi të kthehet i tëri tek ajo dhe "një mijë e dyqind oficerët britanikë", të cilët propozohet të dërgohen atje që të arrijnë aty. Më në fund, kërkohet që ndihma të përdoret për "qëllime politike". A është qeveria jonë palë në tërë këtë? A është ajo për t'i nderuar mijërat e ushtarëve shqiptaro-amerikanë në forcat tona të armatosura, që luftojnë në çdo front dhe që kanë dhënë edhe jetët e tyre?

Çfarë ka ndodhur me fjalët e guximshme si këto të ish-shefit: "Ne përsëri propozojmë që jashtë aksit të mos ketë ndryshime territoriale që nuk pajtohen me dëshirat e shprehura nga popujt e interesuar". Dhe "njësoj me këtë, ne i qëndrojmë propozimit për të 'respektuar të drejtat e tërë popujve për të zgjedhur formën e qeverisjes, nën të cilën duan të jetojnë", dhe për më tepër: "Ne ende shpresojmë të shohim «të drejtat sovrane dhe vetëqeverisëse të rivendosura në ato vende që janë privuar prej tyre nëse kjo do të ishte brenda fuqive tona». Këto betime, të shprehura dhe të zbatuara pa asnjë dyshim ndaj Shqipërisë, do t'i inkurajonin ata që kanë vuajtur dhe janë sakrifikuar për çështjen e aleatëve. A jeni ju, zoti Sekretar, i përgatitur që në emër të

humanizmit, të bëni një deklaratë që mund të transmetohet tek ata në mënyrën që ju do të zgjidhnit? A do të ishit aq zemërbardhë sa të më akordoni mua një takim? Unë jam përfaqësuesi i emëruar zyrtarisht i Federatës Panshqiptare të Amerikës, Vatra të Amerikës, e cila gjithashtu përfaqëson qeverinë e vërtetë të Shqipërisë me miratimin dhe mbështetjen që rrjedh prej shumicës dërrmuese të këtij kombi.

Charles Telford Erickson[190]

SENATI I SHTETEVE TË BASHKUARA

Drejtuar: z. Charles Telford Erickson

San Francisko, Kaliforni

Miku im i shtrenjtë,

Dua t'ju njoftoj për marrjen e letrës dhe të memorandumit tuaj.

Jam jashtë mase i interesuar për çështjen për të cilën flisni ju. Ju mund të rrini i qetë për këtë, pasi unë do ta lexoj memorandumin tuaj me kujdes. Nëse është e mundur të gjej kohë për një takim me juve më vonë, do të isha i lumtur ta bëja këtë. Por më duhet të them se në këtë moment, rutina e punëve dhe takimet zyrtare ma bëjnë këtë të pamundur.

Përzemërsisht dhe besnikërisht i juaji

Arthur H. Vandenberg

Nënshkruar[191]

Charles Telford Erickson, Ll.D.

[190] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 4.

[191] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 5.

DELEGAT, FEDERATA PANSHQIPTARE E AMERIKËS, VATRA

Hotel "Manx", San Francisko

Tel GA 7070 , numër shtesë 503

14 maj 1945

Zotëri,

Këtu keni përgjigjen e letrës suaj të datës 11 maj.[192] *Në të njëjtën datë unë i drejtova një memorandum z. Eden në lidhje me situatën në terren, siç vjen ajo nga Shqipëria.*

Ata besojnë (dhe unë mendoj me arsye) që atyre iu është dhënë një rast i mirë. Besoj fort se çelësi i zgjidhjes së situatës gjendet në "10 Downing Street". Ndoshta mund të jemi krejt gabim. Natyrisht ne do të deshëm të dinim të vërtetën. Sado e pakëndshme të jetë, është më mirë të thuhet se ky është një edicion tjetër i Traktatit të Fshehtë të Londrës, i vulosur për kombin shqiptar në rrjedhë të katër viteve të Luftës I, të cilën ata e mbështetën me vuajtje dhe sakrifica të mëdha, me shpresën e kotë se, fill pas Shteteve të Bashkuara, Britania e Madhe do të ishte miku i tyre më i mirë.

Që prej ditës kur u bë e qartë për shkruesin e kësaj letre nga Filip Carrie në Konferencën e Paqes në Paris deri Të Premten e Mirë të vitit 1939, kur Musolini, më në fund, ia nxori fitimet që priste prej traktatit, ka rrjedhur shumë ujë nën urë. Fatkeqësisht ai traktat qëndron i varur në qafën e këtij kombi të vogël edhe sot e kësaj dite.

Z. Eden, siç është raportuar, është kthyer në Londër. A mund të rregullojë një takim të shkurtër me z. Atlee? Mendoj se kjo do të jetë në avantazh të dy palëve nëse kjo do të arrihej.

[192] Teksti i kësaj letre është krejtësisht i njëjtë me atë dërguar Delegacionit Amerikan. Më datën 11 maj 1945, nëpërmjet letrës prot. Alb/45/2, 11 maj 1945, të Delegacionit Britanik, Erickson-i merr përgjigjen e mëposhtme: "Zotëri, jam ngarkuar t'ju njoftoj se e kemi marrë letrën tuaj të datës 7 maj 1945, në të cilën kërkoni një takim me një anëtar të delegacionit të Mbretërisë së Bashkuar, për të diskutuar në lidhje me çështjen e Enver Hoxhës. Ne mendojmë se gjëja më e mirë që ju duhet të bëni është t'i paraqisni pikëpamjet tuaja me shkrim. Ata, pastaj, nëse e shohin të nevojshme, do t'ia përcjellin Foreign Office-it. Sinqerisht i juaji, A.Rumbold. Dërguar Z. Charles Telford Erickson, Ll.D, Hotel Manx, San Francisko.

I juaji me besë

Charles Telford Erickson[193]

Nënshkruar

Charles Telford Erickson Ll.D.

DELEGATI ZYRTAR I FEDERATËS PANSHQIPTARE TË AMERIKËS VATRA

Hotel "Manx"

14 maj 1945

Botuesit të gazetës së San Franciskos "Chronicle"

Kam lexuar me shumë interes intervistën ekskluzive dhënë nga John Sophianopoulos, kryetar i delegacionit grek në Konferencën e Kombeve të Bashkuara, botuar në gazetën tuaj të së dielës 13 maj 1945. Në listën e pretendimeve territoriale të paraqitura është edhe ajo që ka të bëjë me Shqipërinë. Ajo mban nr. 2 dhe thotë:

"Aneksimi i Epirit të Veriut. Përpjekja e bërë prej italianëve dhe shqiptarëve për të ndryshuar karakterin etnologjik të popullatës së dëbuar dhe të përndjekur me forcë, nuk e privon Greqinë prej të drejtave të saj ndaj zonës greke."

[193] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 6.

Ndaj një pretendimi të tillë, me lejen tuaj të mirësjellshme, dua të bëj disa vërejtje. Së pari, një fjalë për veten time. Kam kaluar afërsisht tridhjetë vjet të jetës sime në atë vend, kam folur gjuhën e tyre, e kam ndërtuar jetën time krejt si ai popull në çdo drejtim. Problemet e tyre, interesat e tyre, luftërat e tyre, ambiciet e tyre, kanë qenë një pjesë qenësore e jetës sime.

Unë, gjithashtu, i kam kushtuar më shumë se tri vite një studimi shterues origjinës shqiptare, historisë dhe karakterit të atij populli. Kam hulumtuar në bibliotekën e Muzeut Britanik, në Bibliotekën Bodeleian të Oksfordit, në Bibliotekën Klasike të Romës dhe Athinës. Kam lexuar qindra libra, të lashtë dhe modernë. Unë besoj se mund të flas me një shkallë të lartë sigurie dhe autoriteti mbi këtë çështje.

Vërejtja ime e parë është kjo: Që grekët nuk janë një racë e ndarë qartë, e dallueshme, me një histori racore, karakteri apo ideologjie.

Në vend të kësaj ka një kulturë, një filozofi, një fe, e ndërtuar si rezultat i shkrirjes racore të shumë popujve dhe shumë gjuhëve. Unë e them këtë jo për diskreditimin e tyre. Jo, krejt në të kundërt. Ky është model mbi të cilin është ndërtuar vetë ShBA-ja jonë.

Vërejtja ime e dytë është se ka shumë mundësi që autoktonët, origjina e botës së lashtë egjeane, kanë të bëjnë në masë të madhe me shartesa racore, në të cilën shqiptarët janë pasardhës të drejtpërdrejtë. Ata ende ruajnë në pastërtinë e saj thelbësore edhe karakterin racor, edhe gjuhësor. Ata ishin pionierët e qytetërimit egjean; ata i dhanë botës dramat e pavdekshme të Homerit, vetë «Odisenë», që do të jetonte në folklorin e tyre, zakonet fisnore dhe mitologjinë.

Heronjtë e Homerit, thuajse pa përjashtim, dalin nga ijët e kësaj race. Akili, Agamemnoni, Ajaksi, Menelau dhe Helena, Odiseja dhe Penelopa, zbulojnë, më së pari, prej etimologjisë së emrave të tyre shqiptarë, origjinën e tyre shqiptare. Orakulli më i lashtë i botës egjeane, Dodona, ishte faltorja e tyre racore.

Prej kohës së artë të Greqisë, Aristoteli, mësuesi i Aleksandrit të Madh dhe Euripidi, i cili jetoi në oborrin e Filipit të Maqedonisë, ishin prej të njëjtit trung racor. Aleksandri i Madh, nëna e të cilit ishte epirote dhe babai maqedon, kërkoi leje për të marrë pjesë në Lojërat Olimpike. Atij iu mohua leja pasi kishte lindur barbar. Lista mund të zgjatet pafundësisht. Konstandini i Madh, themeluesi i Perandorisë së Bizantit dhe Kishës Greke u lind në Shkodër, në Ilirinë e lashtë, prej së njëjtës racë shqiptare. Në tërë rrjedhën e historisë së mesjetare deri në atë moderne, një numër i madh i shqiptarëve kanë luajtur role jetike në historinë e Greqisë. Kryetarë, qeveritarë provincash, admiralë të flotave të tyre, gjeneralë të ushtrive, kanë luajtur rol vendimtar në dhënien formë të së ardhmes së vendit tuaj. Një numër i madh i tyre ende gjendet nëpër ishuj, në disa qytete dhe fshatra, madje edhe në vetë Athinën ku të kapur pas gjuhës së tyre, BESËS së tyre, nderit personal, zakoneve dhe traditave të racës së vet, ata qëndrojnë edhe sot e gjithë dita besnikë ndaj vendit të vet dhe ndaj vendit ku janë përshtatur.

Gjatë 450 vjetëve të pushtimit turk të Shqipërisë, grekët, të inkurajuar prej turqve, të cilët u mohuan shqiptarëve të drejtën për të shkruar gjuhën e tyre, vazhduan propagandën e tyre të pandërprerë. Fëmijët pagëzoheshin në Kishën Greke Ortodokse si shpresë e tyre e shpëtimit. Më pas, për të njëjtën arsye, merreshin për grekë, duke e ngulur kështu këtë heshtë gjakatare drejt e në zemër të racës shqiptare.

Sa i takon "Epirit të Veriut": Ai territor nuk ka qenë ndonjëherë pjesë e Greqisë, të paktën jo që prej kohës kur fenikasit e lashtë ndërtuan qytetet e tyre madhështore, në ato kohë tejet të largëta. Pretendime të tilla janë të tëra fantastike. Shtatëdhjetë për qind e Epirit të Veriut janë myslimanë. Të tjerët, tridhjetë për qind, të krishterë, prej të cilëve shtatëdhjetë për qind e përdorin gjuhën shqipe për shërbimet e tyre liturgjike. Nëse iu jepet e drejta e zgjedhjes së lirë, ata japin prova besnikërie edhe më të larta ndaj racës së tyre.

Nëse grekët janë gati të vendosin kërkesat e tyre në një provë të paanshme plebishitare mbi këtë çështje, unë besoj plotësisht se qeveria shqiptare do ta mirëpriste një provë

të tillë. Është e qartë se kjo është tepër e thjeshtë dhe përcaktuese. Ata preferojnë ta sjellin çështjen në Kongresin Amerikan, në Departamentin Amerikan si dhe në 10 Downing Street, në Londër. Kështu ata ua lënë përgjegjësinë e përdorimit edhe një herë Fuqive të Mëdha si mjet grirës ndaj pjesëve edhe ashtu të cunguara tashmë të trupit të Shqipërisë, siç ishte bërë pas Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore. Nëse e them këtë, ky është një kredit i vogël për udhëheqësit politikë grekë, që të përshtatin sofizmin politik të Hitlerit: Nëse e përdorni një gënjeshtër si parullë, aq shpesh dhe aq me kohëzgjatje, do të vijë një ditë kur ajo merr të njëjtin ngjyrë dhe ngjashmëri me të vërtetën, aq sa të shërbejë si e tillë për të njëjtin qëllim.

I juaj besnikërisht

Charles Telford Erickson

Nënshkruar[194]

[194] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 7.

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

ZYRA E INFORMACIONIT TË LUFTËS

224 West 57th street

New York City

14 maj 1945

Charles Telford Erickson

Hotel "Manx"

San Francisko, Kaliforni

I dashur dr. Erickson,

Ju falënderoj shumë për bashkëpunimin tuaj me Z. Stanley Silverman, shef i zyrës së OWI -it tonë në San Francisko. Mezi pres të marr lajmet tuaja mbi zhvillimet në Konferencën e San Franciskos. Mesazhi juaj i parë ishte i vlefshëm.

Qëllimi i seksionit shqiptar të "Zërit të Amerikës" është të nxisë mirëkuptimin midis popullit amerikan dhe atij shqiptar. Bashkëpunimi juaj gjatë qëndrimit në San Francisko do t'i kontribuojë jashtëzakonisht shumë arritjes së këtij qëllimi.

I juaji sinqerisht

Nelo Drizari

Shef i seksionit shqiptar

Byroja e programit të radios

Operacionet matanë detit[195]

[195] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 7.

FEDERATA PANSHQIPTARE E AMERIKËS VATRA

VATRA

30 Huntington Room

520 Av. Boston Mass.

15 maj 1945

I dashur dr. Erickson,

Jam i lumtur që e bëtë atë bisedë me delegatin jugosllav, sepse tani ndihemi më mirë për mikun tonë Hoxha. Ju e kuptoni, pa dyshim, se çështja shqiptare nuk është çështje emrash. Ne na duhet të mbështesim Hoxhën, jo se mendojmë se ai është i mirë, por më tepër sepse ai është në kontroll të plotë të vendit, dhe ne besojmë se, duke e mbështetur atë, po mbështetim popullin shqiptar.

Jam i lumtur që iu drejtuat z. Uhl. Ai është një njeri i mirë. E pashë artikullin e tij që pasoi në gazetën e djeshme dhe do ta botoi përsëri në gazetën "Dielli" të javës së ardhshme. Citimet tuaja përmbledhin situatën.

Merruni me tërë grekët që njihni, por unë besoj se ata vuajnë nga diçka e keqe, nacionalizmi ekstrem, i cili është një formë e caktuar e papërgjegjshmërisë.

Nëse e gjeni të udhës, thirreni z. Louis Dolivet. Ai është një prej botuesve të Free World dhe i është bashkuar, jo zyrtarisht besoj unë, delegacionit francez. Ai është shumë liberal dhe ju do ta pëlqeni. Ai mund të ketë disa sugjerime të vlefshme.

Nuk dua t'ju ngarkoj me më shumë gjëra në këtë kohë, me përjashtim të asaj që dua të them se po bëni punë të mrekullueshme. Telegrami drejtuar Presidentit ishte një ide e shkëlqyer.

Peshkopi ju dërgon të falat më të përzemërta. Ju lutem më kujtoni me zonjën Erickson!

Sinqerisht,

G.M. Panariti[196]

[196] Qerim Panariti (1892-1976), në atë kohë botues i "Diellit" dhe sekretar i "Vatrës". Erickson Collection, Yale

KONFERENCA E KOMBEVE TË BASHKUARA (UNCIO), SAN FRANCISKO

San Francisko, 16 maj 1945

I dashur zoti Erickson,

E mora letrën tuaj të datës 13 maj në lidhje me Shqipërinë.

Kam frikë se për shkak të barrës tejet të rëndë të punëve të konferencës nuk do të mundem t'ju takoj personalisht. Megjithatë, i kam kërkuar një zyrtari të Shteteve të Bashkuara, z. Dewit C. Poole, të gjejë kohë për një takim me ju, në qoftë se do të dëshironit.

Ju mund ta gjeni atë në zyrën nr. 308 të Ndërtesës së Shëndetit Publik, numër telefoni ndërkombëtar 3300, me numër shtesë 127.

Jam i sigurt se në rrethanat që gjendem, do të më mirëkuptoni.

Sinqerisht i Juaji

Firmosur nga:

Kryetari i delegacionit të Shteteve të Bashkuara.[197]

University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 8.

[197] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 9.

Z. CHARLES TELFORD ERICKSON

Hotel "Manx"

San Francisko, Kaliforni.

16 maj 1945

Të dashur miq,

Sikundër ju shkrova, këtë mëngjes vendosa të bëja dorëzimet të premten më 25 dhe bleva biletën e kthimit për në Los Angelos. Kështu nuk do të kemi kur të komunikojmë, veç nëse del diçka tepër urgjente. Unë sapo kam marrë një përgjigje për kërkesën time prej Senatorit Vandenberg për një takim. Po iu dërgoj tekstin e letrës që ai më drejtoi mua.

Drejtuar z. Charles Telford Erickson

Hotel "Manx"

San Francisko

"I dashur miku im,

Konfirmoj marrjen e letrës suaj dhe memorandumin bashkëngjitur asaj, drejtuar Stettinius-it. Unë jam tejet i interesuar për çështjen së cilës i referoheni. Të jeni i sigurt se do ta lexoj memorandumin tuaj me kujdes. Nëse është e mundur të gjej kohën për një takim personal me ju, më vonë, do të isha i lumtur ta bëja këtë. Në këtë moment, më duhet të rrëfehem se rutina ime e takimeve zyrtare e bën këtë të pamundur.

Përzemërsisht dhe besnikërisht i juaji"

Vandenberg

Nënshkruar.

Pastaj Erickson-i vijon me letrën e tij:

Meqë dua me gjithë shpirt ta bëj mik të Shqipërisë, unë do t'i përgjigjem se mezi pres ta takoj pas kthimit nga Uashingtoni. Mua më ngjet se ai do të jetë delegat i riemëruar në takimin e asamblesë dhe është shumë e rëndësishme që të tërheq vëmendjen e tij dhe ta bind se çështja e Shqipërisë është vërtet e rëndësishme për paqen në Ballkan dhe në Europë.

Dhe tani më lër të tregoj se jam ballafaquar me problemet e mia, të cilat ju mund të më ndihmoni t'i zgjidh. Është marrë parasysh që ne të qëndrojmë në Kishën e Avalonit deri në fund të vitit 1945. Sapo të kthehem, do të më pyesin se çfarë duhet të bëj. Gjithashtu duhet të vendoset për programin veror. Por gjithsesi duhet patur parasysh që të përfitojmë mbështetje të fuqishme dhe përcaktuese morale për Shqipërinë në Uashington, midis atyre të cilët do të përfaqësojnë ShBA-në në Asamble. Adresa ime e re do të jetë C/0 Rev. Reynold B. Boden, 2159 Uest 20th St Los Angeles.

I juaji Erickson.

Nënshkruar[198]

Në numrin e së dielës së 19 majit 1945, gazeta "Dielli", organ i Federatës Panshqiptare Vatra boton në faqen e parë artikullin "Delegati i Vatrës në San Francisko"

E quajmë të tepërt t'u themi këndonjësve tanë se cili është dr. Charles Telford Erickson, i cili përfaqëson "Vatrën" në Konferencën e Kombeve të Bashkuara në San Francisko. Mjafton të kujtojmë se dr. Erickson ka më shumë se 35 vjet që

[198] Erickson Collection,Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 10.

punon për popullin shqiptar. Veprimet e tij në San Francisko do t'i botojmë në një raport të plotë kur të vijë koha. Me rastin e emërimit të tij prej "Vatrës", dr. Erickson-i, i dërgoi Presidentit Truman telegramin e mëposhtëm:

Charles Telford Erickson Ll.D.

Delegati zyrtar i Federatës Panshqiptare të Amerikës Vatra

Hotel "Manx"

14 maj 1945

Presidentit të ShBA-së

Z.Harry Truman

Shtëpia e Bardhë

Uashington DC

Njëzet e pesë vjet më parë, Presidenti Wilson i dërgoi këtë kabllogram zotërinjve Lloyd George, Clemenceau dhe Frank Polk në Konferencën e Paqes në Paris, ku iu thoshte:

"As unë, as populli amerikan kurrë nuk do të pranojmë që populli shqiptar, i cili ka luftuar dy mijë vjet për lirinë e tij të sakrifikohet për hir të ambicieve politike të fqinjëve të vet."

Ai e shpëtoi Shqipërinë nga ndarja dhe zhdukja. Sot rreziku është përsëri i madh dhe unë ju kërkoj juve që të ndihmoni në emër të drejtësisë dhe të humanizmit.

Charles Telford Erickson

Delegat i Federatës Panshqiptare Vatra

Hotel "Manx"

San Francisko

Kaliforni.[199]

Z. Charles Telford Erickson

Hotel "Manx"

San Francisko, Kaliforni

24 maj 1945

I dashur zoti Panariti,

E mora letrën tuaj të datës 21, e cila erdhi pasi e kisha dërguar raportin tim. Më vjen keq për 100 000 dollarët. Ishte tërësisht e paraparë. Unë doja të shtoja: "Mbledhur prej Komitetit Shqiptar të Ndihmave", por mendja ime ishte kaq e përqendruar në pikat që dëshiroja të ngrija sa kjo ishte parë ndryshe e tëra. Nëse mendoni se është më mirë t'i shkruaj një letër ndjese Nikut, unë do ta bëj atë menjëherë.

Tani, lidhur me "kriticizmin" tënd, nëse mund ta quaja kështu? Apo është thjesht një "vëzhgim" rreth meje duke qenë "përjashtimisht agresiv" në drejtim të anglezëve dhe ShBA-së (jo delegacioneve, por politikës së departamenteve të shteteve të tyre). Në përgjigje të kësaj, a mund t'ju kërkoj të lexoni artikullin e Dreu Personit, bashkëngjitur?

Gabimi që bëra ishte vënia e emrit Teheran në vend të Kazablankës. Unë nuk e mendova që gjërat të ndodhnin aq shpejt. Pa dyshim Shqipëria nuk është përmendur

[199] Biblioteka e Federatës Panshqiptare Vatra, koleksioni i gazetës "Dielli", viti 1945, New York, 2437 Southern Boulvard, Bronx, NY 10458.

me emër, por edhe një sy i verbër mund ta shohë atë drejt e në qendër gati për t'u përdorur ose nga Italia, ose nga Greqia, ose nga të dyja.

Sa iu takon planeve të mëtejshme, unë kërkoj me ngulm që ju të prisni për kongresin vjetor. Madje, edhe kur ajo kohë të vijë, unë nuk dua të ketë ndonjë kundërshtim për vendin, në emrin tim. Të kuptohemi, unë nuk jam kandidat për një vend në Delegacionin e Paqes ose diçka tjetër. Nëse qeveria e Hoxhës i mbijeton presionit britanik deri në atë kohë dhe vazhdon të ketë besimin e popullit shqiptar, unë mendoj se duhet të ketë një marrëveshje midis tij dhe "Vatrës" dhe atëherë të zgjidhen një numër delegatësh dhe t'u jepet besimi i duhur. Kjo dëshirë tregon një unitet dhe kuptim i cili do të jetë absolutisht i domosdoshëm në qoftë se delegacioni duhet të paraqitet kudo qoftë në Konferencën e Paqes. Dhe, në qoftë se kjo duhet të përmbushet në këto 5-6 javë, nuk ka qoftë edhe një ditë për të humbur për ta arritur atë.

Në Britani do të mbahen zgjedhjet e përgjithshme në korrik. Dhe ju, po ashtu, mund të mblidhni mendjen tani se është një çështje për jetë a vdekje për Shqipërinë, për aq sa kjo ka të bëjë me pavarësinë e saj politike.

Ndërkohë, unë do të kthehem tek "gropa ime e vogël e dhelprës" në Avalon dhe të pres zhvillimet. Sa iu takon grekëve, po ju bashkëngjis kopjen e artikullit tim, siç e shkrova atë në "Chronicle". Është e vërtetë se grekët janë shumë të rëndësishëm në botën politike edhe të ShBA-së, edhe të Europës.

Ju lutem, shprehuni djemve falënderimet dhe vlerësimin tim për mundësinë që më dhanë, që të paktën të hidhja disa heshta në emër të Shqipërisë. Nëse një ose dy prej tyre goditën në shenjë, unë jam edhe më i lumtur. Unë jam i lumtur që ndihmat kanë filluar të lëvizin dhe të tjera janë në rrugë e sipër. Në qoftë se, në ndërkohë mund të bëj ndonjë gjë duke shkruar për këtë ose për atë, më bëj me dije të lutem.

Sinqerisht i juaji

Charles Telford Erickson.[200]

[200] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 11.

Hotel "Manx"

San Francisko

24 maj 1945

FEDERATËS PANSHQIPTARE VATRA

Hotel "Fairmont"

San Francisko

24 maj 1945

Raport mbi mesazhin dërguar Konferencës së Kombeve të Bashkuara.

Ditët e para i kalova duke u orientuar në një situatë të re, duke siguruar kredenciale të tilla të cilat do të më lejonin të gjeja vendndodhjen e delegacioneve me të cilat shpresoja të vendosja kontakte gjatë qëndrimit tim. Po ashtu kërkova të gjeja vendndodhjen e gazetarëve të cilët i kisha njohur në të kaluarën si miq të Shqipërisë.

Delegacioni i parë që arrita të gjej, natyrisht, ishte ai amerikan. Paraqita disa memorandume të shkurtra tek z. Stasen, senatori Vandenberg dhe me në fund tek z. Stetinius. Komandanti Stasen shprehu interesin e tij të sinqertë mbi Shqipërinë dhe dëshirën e tij vetjake, nëse do të ishte e mundur, për të gjetur kohën për një takim. Kjo përpjekje u bë shumë herë derisa doli qartë se ai ishte njeriu më punëtor në delegacion dhe i përfshirë kaq thellësisht në kaq shumë probleme të rëndësisë të dorës së parë, sa nuk ishte gjë e zgjuar ta shtyja kërkesën time edhe më tej. Senatori Vandenberg nuk ishte më pak i përzemërt dhe simpatik, ndoshta edhe më miqësor se komandanti

Stasen. Përsëri, në fund u ra dakord që do të ishte më mirë të takoheshim më vonë në Uashington, ku do të merreshim me çështjen, ashtu siç meritonte, të shkëputur nga furia e çështjeve, të cilat bënin presion nga të gjitha anët. Ndërkohë kisha dërguar memorandumin tim tek Sekretari i Shtetit Stetinius dhe pas disa ditësh përgjigjja e tij erdhi duke shprehur keqardhje që ishte e pamundur për të që të rregullonte një takim dhe sugjeronte se, nëse doja të takohesha, ai do të rregullonte takimin me z. Poole, që të bënte lidhjen me Departamentit e Shtetit dhe të më takonte. Unë ndoqa këtë linjë dhe e bëra takimin. Ai nuk pretendonte të ishte ndonjë ekspert mbi çështjet ballkanike ose shqiptare, por ishte mendjehapur dhe i mirëkuptueshëm. Pas një gjysmë ore përpjekjesh nga ana ime për të paraqitur çështjen, u pajtuam që e kisha prezantuar çështjen shumë mirë. Ai më kërkoi të shkruaja pikat kryesore në një raport dhe t'ia dërgoja shefit të tij në Uashington.

Ndërkohë unë kisha vendosur kontakte me Delegacionin Britanik nëpërmjet Miss Wilkinson, të cilën e kisha njohur pak në Londër. Ajo më ftoi në një pritje kokteji në shtabin e delegacionit në hotel "Mark Hopkins" në të cilin, pa dyshim, mora pjesë.

Në pritje salla ishte e tejmbushur me njerëz. Bisedat serioze natyrisht dominonin tërë situatën. Takova disa anëtarë të delegacionit dhe pata mundësinë t'u bëja të njohur atyre se kush isha dhe çfarë përfaqësoja. Të tërë, përfshirë znj. Wilkinson, më dhanë të kuptoja përfundimisht se kjo ishte një çështje që kishte të bënte me 10 Downing Street dhe se ata nuk kishin kompetenca apo autoritet të merreshin me të. Ajo takoi një korrespondent të një prej gazetave të Londrës dhe bisedoi me të për një farë kohe. Në fund ai më dha emrin e vet dhe adresën, me shpresë se, nëse do të shkoja në Londër, ta kërkoja dhe ai do të më jepte tërë ndihmën që ai kishte në dorë. Aty gjeta edhe një shënim shumë miqësor nga sekretari z. Rumford, që tregonte se memorandumi im drejtuar Edenit do t'i përcillej atij, pasi tani për tani ai kishte ikur. Më vonë pata një orë takim me dy prej korrespondentëve zyrtarë, ku m'u dha rasti të tregoja realitetin shqiptar ashtu siç duket sot.

Ata më premtuan të më takonin me z. Rimford dhe t'i raportoja gjatë bisedës. Nëse

do ta mbanin premtimin, delegacioni do të kishte parasysh Traktatin e fshehtë të Londrës, rrjedhojat shkatërrimtare të së cilës i kallnin datën Shqipërisë edhe sot, se diçka e njëjtë mund t'i imponohej përsëri. Gjithashtu, ajo që do të ndodhte ishte se ata do të prisnin që Shqipëria të luftonte për pavarësi me të njëjtën këmbëngulje siç kishte bërë në Konferencën e Paqes në Paris.

Delegacioni grek

Më së pari unë hëngra një drekë me z. Palizoidoes, profesor i historisë moderne europiane, në Universitetin e Kalifornisë, transmetues radiofonik dhe gazetar, të cilin e kisha njohur prej disa vjetësh. Me të ishte Majori Vounos, i cili drejtonte 250 ose edhe më shumë organizata greke në ShBA. Të dy këta burra ishin aq realistë sa të shihnin diçka, të paktën në anën shqiptare të çështjes. Unë jam i bindur se sikur çështja e Epirit të Veriut të ishte në dorë të tyre, kjo do të ishte rregulluar atëherë dhe aty. Megjithatë, e qëmtova rastin për ta diskutuar çështjen me ndonjë prej anëtarëve të delegacionit të tyre zyrtar. U dha një drekë disa ditë më vonë kur e takova John Politisin. Qëndrimi i tij ishte aq agresiv, aq i verbër prej paragjykimeve nacionaliste, sa ishte e pamundur të bisedoje me të, aq më shumë pastaj të merreshe vesh për ndonjë çështje. Përpara se të mbaronim, unë kam frikë se ne të dy i kishim shkelur tej mase kufijtë e sjelljes diplomatike, përveçse në fund, të paktën ruajtëm mirësjelljen dhe kortezinë e momentit, sa t'i jepnim dorën njëri-tjetrit.

Pak ditë më vonë, kryetari John Sofianopolous kishte një intervistë të gjatë me një gazetë lokale, "San Francisko Chronicle", të cilit iu përgjigja më vonë.

Delegacioni jugosllav

Pa asnjë vështirësi, m'u dha një takim prej Stojan Gavriloviçit, një prej katër delegatëve. Pas një hyrjeje të shkurtër, në të cilën shpreha vlerësim ndaj asaj që kishte bërë Tito për Enver Hoxhën në fushatën e tij për të përzënë gjermanët nga Shqipëria, ai u çlirua dhe e pikturoi regjimin e ri në Jugosllavi me ngjyrat më rozë në kontrast me diktaturën e vjetër ushtarake serbe. Ai më siguroi në mënyrë të përsëritur se regjimi

i sotëm kishte vetëm dëshirën më miqësore dhe të përzemërt për të bashkëpunuar me Shqipërinë në qëllimet e saj kombëtare dhe në themelimin e një Federate Ballkanike, në të cilën Shqipëria pritej të luante një rol të rëndësishëm. Kjo dukej tepër e ëmbël për t'u ngrënë. Megjithatë u ndamë me shtrëngim dy herësh të duarve, sa mua m'u duk sikur ishim miq të vjetër. Ndërkohë që shkruaj, është qenësisht e rëndësishme për Shqipërinë të qëndrojë në këmbët e veta, të ruajë dinjitetin e saj kombëtar. Unë jam i bindur se filantropia e pastër nuk ka vend në një konferencë si kjo, ose në ndonjë tjetër që do të vijë. Por ajo nganjëherë ndihmon për të krijuar një atmosferë në të cilën diskutohet dhe vendoset për probleme më konkrete dhe racionale me interes kombëtar.

Delegacioni francez

Më së pari unë kërkova dhe arrita të kem një takim me Louis Dolivet-in, botuesin ndërkombëtar të "Botës së lirë". Ai ishte shumë miqësor, konfidencial dhe ndihmues në sugjerime dhe këshilla. Dijenia e delegacionit francez këtu ishte shumë i ulët. Ai mendonte se, nëse do ta kisha biseduar çështjen shqiptare me Xhorxhe Bidaultin (George Bedault), unë mund të dilja diku, por përderisa ai kishte ikur për Paris, nuk kishte mbetur asnjë me të cilin të mund të bisedohej. Megjithatë, unë kisha me vete një kopje të një memorandumi që kisha përgatitur, të cilin ia dhashë atij. Ai sugjeroi t'i dërgoja një edhe Josef Paul-Boncour-it, i ngarkuar me punët e kryetarit të delegacionit. Këtë e bëra.

Z. Soli vjen së shpejti për Paris për një muaj dhe më kërkoi që të vihesha në kontakt me të sapo të arrinte, pasi kishte disa informacione të vlefshme dhe sugjerime për mua.

Jo shumë kohë pas arritjes sime këtu, ndjeva një nxitje të fortë për t'i dërguar një letër Presidentit Truman, kopje të cilën ua kam dërguar, duke ditur se ai ishte duke ndjekur në mënyrën e vet problemet e ndryshme të botës së pasluftës. Desha që ai të bëhej i vetëdijshëm për gjendjen e Shqipërisë.

Disa ditë më vonë shtypi raportoi se ai kishte kërkuar informacion nga Departamenti i Shtetit rreth Ballkanit. Tani unë kam një letër prej z. Cannon i Departamentit

të Shtetit, i cili ia kishte referuar telegramin Presidentit për dijeni. Ky është thelbi i përgjigjes: "Shumëllojshmëria e problemeve që dalin nga lufta dhe çlirimi i atij vendi nga pushtimi tërheqin vëmendjen e përhershme të zyrtarëve të Departamentit të Shtetit". Ai pastaj i referohet deklaratës së z. Hull, që "restaurimi i një Shqipërie të lirë është i pandarë nga parimet e Kartës së Atlantikut". "Ju duhet të jeni të sigurt se Departamenti i Shtetit vazhdon t'i qëndrojë kësaj pikëpamjeje dhe se i sheh problemet e Shqipërisë bazuar në parimet e drejtësisë dhe dëshirës së mirë, të cilën zëdhënësi më i lartë i kësaj qeverie e ka afirmuar me respekt". Pa dyshim që kjo duhet të shprehet me terma diplomatikë, por më në fund kjo jep njëfarë terreni për t'u risiguruar. Ndoshta e vërteta mbi këtë çështje është se çfarë mund të bëjë Departamenti i Shtetit nëse Churchill-i dhe Stalini vendosin të zbatojnë një formulë tjetër? Ose në rast se Britania e Madhe i thotë ShBA-së se duhet zgjidhje tjetër për Shqipërinë, e cila të jetë thelbësore për të zhbërë lëmshin që ekziston prej agresionit të mëtejshëm të Stalinit drejt Ballkanit dhe Italisë."

Materialet janë paraqitur shumë mirë në takimin tim. Në fillim arritëm një marrëveshje se kush duhej të siguronte tekstin. Personeli aty ishte shumë miqësor. Unë, nga ana ime, mendoj se nuk ishte aq keq. Kanë kaluar dhjetë vjet ose më shumë qëkurse e kam praktikuar gjuhën – dhe kjo është një kohë e gjatë.

Z. Uhl ishte shumë i mirë me mua dhe unë mbështetem tek ai si tek një mik i mirë dhe i sinqertë. Të tjerët, të cilët nuk i kam takuar këtu dhe që nuk erdhën, Drew Pearson, një mik i vjetër dhe ish-anëtar i bordit të shkollës sime, dhe Edgar Mourer-i, ende një mik i vjetër, të dy të vendosur në Uashington, janë njerëzit e duhur për t'i takuar më vonë. Gjithashtu edhe Louis Ademic dhe Markham.

Kjo është e tërë historia e rishikuar në mendjen time. Mendoj se në tërësi ia ka vlejtur. Është bërë goxha punë dhe ata që pak a shumë e mbajnë të ardhmen e Shqipërisë në dorën e tyre janë ndërgjegjësuar për faktin se ajo është në gjendje alarmi ndaj rrezikut të saj dhe nuk do të dorëzojë "të drejtat e saj të patjetërsueshme për jetën, lirinë dhe të arrijë mirëqenien e saj pa një luftë të gjatë e të fortë."

I juaji sinqerisht

Charles Telford Erickson[201]

Hotel "Manx"

San Francisko

26 maj 1945

I dashur Senator,

Letra juaj e mrekullueshme e datës 14 është thellësisht e mirëpritur. Unë e kuptoj fare mirë situatën dhe kjo ngjet se do të vazhdojë derisa të vijë koha për të ikur më 25, ditën e premte.

Për këtë arsye, unë po ju shkruaj tani që t'ju them se, nëse është e përshtatshme për ju, unë do të vija në Uashington së shpejti. Qëllimi im është t'ju bëj të kuptoni të vërtetën mbi Shqipërinë dhe marrëdhëniet e saj të ndërlikuara në Ballkan. Ajo përbën një problem serioz për paqen në Europë.

Nuk është edhe aq i njohur fakti që Shqipëria erdhi deri pranë të qenët një bête noir[202] *i Konferencës së Paqes në Paris, duke qenë e vënë në kurth mes interesave të Britanisë dhe Francës, pretendimeve të Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë, si dhe turbullirave të pareshtura të Ballkanit. Për shkak të rezistencës së paepur të treguar nga populli shqiptar, të përpjekjeve tona me argumentet që ju vumë përpara dhe mbështetjes së dhënë nga Presidenti Wilson, konferenca u mbyll pa arritur në një zgjidhje përfundimtare të çështjes. Kjo patate e nxehtë i kaloi Lidhjes së Kombeve, por edhe ata refuzuan ta mbanin në dorë atë dhe kështu e kaluan çështjen tek*

[201] Biblioteka e Federatës Panshqiptare Vatra, koleksioni i gazetës "DIELLI", viti 1945, New York, 2437, Southern Boulvard, Bronx, NY 10458.

[202] Nemesis, një frymë e ndëshkimit hyjnor.

Konferenca e Ambasadorëve. Dy vite më vonë ajo ishte e zgjidhur në një mënyrë krejt kuturu.

Jam përpjekur gjatë një viti e gjysmë ta bëja Presidentin Roosvelt ta shihte këtë çështje me kujdes dhe mendova sa ia kisha dalë, derisa erdhi takimi i Teheranit prej nga ne shkuam nga askundi në asgjëkundi. Unë shpresoj se Presidenti Truman do të jetë me mendje më të hapur dhe më pak i kampleksuar nga pagabueshmëria. Kjo po ashtu vlen edhe për njeriun e parë të Departamentit të Shtetit.

Bazuar në rolin shumë të rëndësishëm që po luani në këtë konferencë, duket si e pashmangshme që ju gjithashtu do të shërbeni si një delegat në takimin e asamblesë, rast për të cilin unë do të isha shumë i lumtur.

Me shpresë të shihemi në Uashington, të falënderoj një milion herë.

Sinqerisht

Charles Telford Erickson[203]

[203] Biblioteka e Federatës Panshqiptare Vatra, koleksioni i gazetës "DIELLI", viti 1945, New York, 2437, Southern Boulvard, Bronx, NY 10458.

FEDERATA PANSHQIPTARE E AMERIKËS VATRA

Zyrat 168 Dartmouth, Street Room 265 30, Hungtington Ave

Boston, Massachusets

31 maj 1945

I dashur dr. Erickson,

Sapo kam marrë sot dy letrat tuaja. Memorandumi dërguar z. Eden përmban një gabim fatkeq, fundin e ndihmave për Shqipërinë dhe jo asaj të "Vatrës", e cila ka 100.000 dollarë. Nëse miku ynë dr. Prifti do ta dëgjojë këtë, atij do t'i bjerë tavani mbi kokë. Megjithatë ne të dy e dimë se ky nuk ishte një gabim qëllimkeq.

Tani, sa i takon problemit tuaj: Këtë të diel që vjen do të kemi një mbledhje. Aty unë do të paraqes propozimin tuaj për diskutim dhe do t'ju njoftoj rreth asaj që do të arrihet. Nëse keni kopje të fjalimit të OWI-it, lutemi na e dërgoni që ta publikojmë pjesërisht ose të tërën. Ju duhet të përgëzoheni për atë që keni arritur në përgatitjen e fjalimit tuaj, pasi ne nuk kemi mundur ta bëjmë atë as pjesërisht.

Ndoshta e keni marrë vesh se mbas kaq shumë kohësh ka arritur në Shqipëri një ngarkesë me ushqime. Nëse nuk e keni parë, atëherë do ta shihni në gazetën "Dielli" të kësaj jave. Me aq sa kemi parë ne deri tani, Shqipëria mund ta bëjë vetë shpërndarjen, megjithëse një forcë anglo-amerikane prej 130 burrash po e bëjnë ngarkim - shkarkimin në Durrës dhe në Tiranë. Thuhet se UNRRA do ta marrë këtë detyrë brenda dy muajsh.

Unë shpresoj se ju do t'i përgjigjeni ministrit grek të Punëve të Jashtme me disa tallje të hidhura. Ai i meriton ato. Një popull që nuk qeveris dot vendin e tij ka guximin të kërkojë të qeverisë një popull tjetër, dukshëm shumë më i aftë se ai vetë.

Peshkopi mori sot gradën Ph.D. Përgëzoje për këtë.

Kur ta keni përfunduar punën tuaj aty, na dërgoni faturën që pastaj ta dërgoj çekun.

I juaji me besë

G.M.Panariti[204]

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Zyra e Informacionit të Luftës

111 Sutter street

San Francisko, 4, Kalifornia

1 qershor 1945

Dr. Charles Telford Erickson

Avalon

Catalina Island, Kaliforni,

I dashur dr. Erickson,

Kjo është e para mundësi që m'u dha t'ju shkruaj dhe t'ju shpreh edhe një herë

[204] Po aty.

jo vetëm kënaqësinë time të vërtetë që ju kam takuar ju dhe zonjën Erickson, por, gjithashtu, vlerësimin që pashë nga zyra e informacionit të luftës të Shteteve të Bashkuara për bashkëpunimin tuaj në katër transmetime të konferencës.

Unë e kam biseduar çështjen e bashkëpunimit të vazhdueshëm me ne me z. Nelo Drizari[205] në New Yrok dhe ai bashkohet me mua në shprehjen e kënaqësisë më të thellë në atë që ju mund të flisni herë pas here. Nëse kjo është me të vërtetë e mundur, gjë që unë mendoj se është, atëherë ju mund të punoni në të njëjtën mënyrë, siç bëmë nga shtëpia jote në Kaliforni. Me fjalë të tjera, nëse do t'i dërgonit z.Drizari në New York (drejtuar nën kujdesin e zyrës së informacionit të luftës, 22 West 57th Street, New York, 10019, New York) një tekst anglisht për Shqipërinë, ai (z. Drizari) do ta telegrafojë menjëherë tek ju në shqip për të. (Mesazhi juaj për të duhet të jetë sa ato të shtypit.) Me dërgimin e tekstit në shqip, ne po ashtu ju njoftojmë edhe mbi vendndodhjen e stacionit të radios më të afërt me shtëpinë tuaj. Aty do të bëhet incizimi dhe ata e lëshojnë në ajër për tek ne në New York, që më pas ta ritransmetojmë drejt Shqipërisë.

Unë do të vlerësoja shumë nëse më thoshit mendimin tuaj rreth këtij plani sa më parë të jetë e mundur. Me sa duket, unë do të iki nga San Franciskoja brenda dhjetë ditësh.

Me të falat më të mira për zonjën Erickson dhe juve

Përzemërsisht i juaji,

Stanley H. Silverman

Shef i seksionit të ngjarjeve të veçanta

Për dijeni: z. Nelo Drizari

Shef i deskut shqiptar, New York.[206]

---

[205] Zenel Sulaj është emri i vërtetë i Nelo Drizarit, siç njihet në rrethet intelektuale. Ai ka qenë historian, publicist, gazetar, studiues, gjuhëtar, shkrimtar, piktor dhe, mbi të gjitha, themeluesi i seksionit shqip të radios '"Zëri i Amerikës". Do të ishte viti 1942 kur SHBA-ja, e përfshirë në Luftën e Dytë Botërore, si kontribuueset kryesore të koalicionit antifashist botëror, nisën për qëllimet e tyre propagandistike edhe transmetimet shqip të "Zërit të Amerikës", ku folësi i parë i saj do të ishte pikërisht ai, Nelo Drizari. (Shënimi im – MB)

[206] Skeda Erickson DASH 24584-A-167.

Charles Telford Erickson

Avalon

California

Drejtuar Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Presidentit të ShBA-së, z. Harry Truman[207]

Shtëpia e Bardhë

Uashington DC

25 qershor 1945

I dashur z.President,

Mirësjellja juaj e pasqyruar në kthimin e përgjigjes së telegramit tim që ju dërgova nga San Franciskoja në emër të Shqipërisë më jep zemër që t'ju ofroj për konsideratë planin e mëposhtëm për zgjidhjen e situatës në Ballkan. Së shpejti ju do të takoni zotin Churchill dhe Stalin në një konferencë, e cila ndoshta do t'i japë formë Europës së Pasluftës.

Unë mendoj se e dini tashmë se Ballkani përbën problemin më të ndërlikuar dhe më të rrezikshëm, me të cilin ju do të ballafaqoheni. Nëse tridhjetë vjetët e mia të jetës atje ju vlejnë, atëherë do t'i vija në dispozicionin tuaj me kënaqësi.

Erickson-i besonte në atë kohë se zgjidhja për Ballkanin ishte një konfederatë ballkanike. Ai e mendon këtë konfederatë me vendet e Ballkanit nën këto mbikëqyrje:

[207] Public Papers of the President Hurry Truman, 500 W. US Hwy, 24. Independence MO 64050.

Rusia të kishte Jugosllavinë, Bullgarinë dhe Rumaninë, Britania e Madhe, Greqinë, dhe ShBA-ja, Shqipërinë. Ai vijon:

Në fakt ky plan sapo ka filluar të zbatohet, sidomos po të kemi parasysh Jugosllavinë, Bullgarinë, Rumaninë dhe Shqipërinë. Kjo mbikëqyrje duhet të zgjasë fillimisht për dhjetë vjet dhe pastaj, varësisht nga përparimi i bërë, ose të zgjatet koha edhe dhjetë vjet të tjerë, ose të shndërrohet konfederata. Gjatë kësaj periudhe të ndërtohen tërë institucionet dhe infrastruktura e duhur për këtë. Më pas të ngrihet një organizëm ndërkombëtar i mbikëqyrur drejtpërsëdrejti nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara.

Parashtruar me respekt nga

Charles Telford Erickson

FEDERATA PANSHQIPTARE E AMERIKËS VATRA

Gazeta "Dielli"

168 Dartmouth Street, zyra 205

Boston Massachusets[208]

27 qershor 1945

ot, më 27 patëm mbledhjen e këshillit dhe lexuam para tërë anëtarëve letrat tuaja dhe memorandumet. Ata u gëzuan shumë dhe dhanë për ju vlerësim të lartë dhe falënderime pa fund për punën që keni bërë atje. Unë shpresoj të mos e keni marrë seriozisht "kriticizmin" tim. Në të vërtetë unë u habita ose më mirë të them isha më shumë i kënaqur sesa i habitur. Nuk ka kuptim të jesh i butë me ta, pasi e dimë që e drejta është e tëra në anën tonë. Unë do ta botoj letrën tuaj tek kronika në këtë numër javor të "Diellit". Mendoj se është shumë interesante. A ju tregoi delegacioni jugosllav se Tito e ka njohur Hoxhën? Po, ai e ka njohur! Dy qeveritë janë tani në procesin e shkëmbimit të agjentëve diplomatikë. Ne jemi disi të ngazëllyer prej këtij lajmi, por, pa dyshim, ne do të deshëm të shihnim ShBA-në të bëjë të njëjtën gjë, dhe pastaj do të ndiheshim më mirë.

Delegacioni civil i ShBA-së ka arritur në Tiranë disa javë më parë. Atyre iu është rezervuar një pritje e përzemërt nga populli. Ata kanë hapur legatën dhe janë duke vijuar me hetimet. Personi i ngarkuar është njëfarë Ernest Jacobs. A e njihni ju atë? Z.Fultz nuk është me ta, ndonëse edhe ai ka bërë disa udhëtime në Tiranë.

Ne pajtohemi me ju se nuk i shërbehet çështjes duke u turrur mbi kolaboracionistët, por me aq sa gjykojmë ne qëndrimet e grupeve ndaj njëri-tjetrit janë të tejskajshme.

[208] Biblioteka e Federatës Panshqiptare Vatra, koleksioni i gazetës "DIELLI", viti 1945, New York, 2437 Southern Boulvard, Bronx, NY 10458.

Unë takova një ushtar që sapo vinte nga Bari. Misioni Ushtarak Shqiptar i stacionuar atje i ka kërkuar që të kërkojë nga ne që të bëjmë agjitacion për njohjen. Ushtari ka sjellë me vete një tufë gazetash shqiptare, të cilat përmbajnë edhe fotografi interesante të Tiranës, me vrima fishekësh nëpër to. Njerëzit duken të lumtur edhe kur luftojnë.

Nëse asgjë nuk ndodh prej tani deri më 30 të këtij muaji, kur është edhe data e mbledhjes sonë, ne na duhet të planifikojmë disa lloj direktivash për ta sjellë çështjen shqiptare përpara publikut me tërë forcën e duhur. Unë do të informoj për ato që do të ndodhin. Grupi jugosllav në New York na ka ofruar ndihmë. Mua më duhet të udhëtoj atje diku në ndonjë fundjavë për të diskutuar çështjen shqiptare me ta. Luis Adamic ka shumë miq. Pengesa është se unë jam, gjithashtu, i zënë këtu në zyrë. Ne mund të bëjmë edhe gjëra të tjera nëse njohja nuk arrihet në ndërkohë.

Me të falat më të mira nga secili

Sinqerisht i juaji

G.M Panariti

Avalon, California

Box C

2 korrik 1945

CHARLES TELFORD ERICKSON

Të nderuarit James F. Byrnes[209]

Sekretari i Shtetit

Uashington DC [210]

Zotëri,

Duke shprehur përgëzimet e mia të sinqerta për emërimin tuaj në atë detyrë, shpreh edhe respektin për Presidentin, i cili ka treguar aq zell, sa të emërojë një njeri kaq të kualifikuar për këtë përgjegjësi tejet të jashtëzakonshme.

Jam i sigurt se do të pajtoheni me mua se një prej problemeve më të vështira dhe të ndërlikuara, me të cilin ju do të ballafaqoheni, është problemi i Ballkanit. Meqë kam kaluar thuajse tridhjetë vjet të jetës sime në atë rajon, kryesisht në Shqipëri, duke e përfaqësuar atë si delegat në Konferencën e Paqes në Paris dhe, së fundmi, edhe në San Francisko, besoj se do të zgjoja interesimin tuaj rreth propozimit që kam paraqitur në një memorandum që i kam dërguar Presidentit. Me këtë rast po ju dërgoj edhe juve një kopje të këtij memorandumi, dërguar shumë delegacioneve pjesëmarrëse në Konferencën e San Franciskos.

Unë kam propozuar një udhëtim tonin në Shqipëri. Me këtë rast duhet të marrim përgjegjësinë përfundimtare në Ballkan. Mua më shtyn ta bëj këtë hap ndjesia që kam se derisa të bëhet kjo, nuk ka shpresë për arritjen e një marrëveshjeje që funksionon midis Britanisë së Madhe dhe Rusisë në Ballkan. Dhe derisa të arrihet kjo, unë jam i bindur se e tërë struktura e paqes, për aq sa i takon Europës, do të jetë në mënyrë të rrezikshme e kompromentuar. Në anën tjetër, nëse marrim përgjegjësi për Shqipërinë, ne do të mbajmë kartën e asit në dorën tonë dhe do të qëndrojmë në pozicionin

[209] James Francis Byrnes (1882 – 1972), burrë shteti amerikan nga Karolina e Jugut, kongresmen, Kryetar i Gjykatës së Lartë, senator dhe njeri i besuar i Presidentit Franklin D. Roosevelt. Ai ishte një prej burrave më të fuqishëm në skenën politike amerikane të brendshme dhe të jashtme në vitet '40 të shek.XX. (Shënimi im – MB)

[210] Skeda Erickson DASH 24584-A-258.

drejtues. Popujt e Ballkanit vetë do të jenë të shpejtë në njohjen e kësaj dhe do të pajtohen me propozimet tona.

Një sugjerim i njëjtë i është bërë Presidentit Wilson në Paris dhe ai, vetë, ishte i dhënë pas kësaj ideje, por rrethanat e atëhershme e bënë të pamundur realizimin e saj. Unë qeshë dërguar në komitetin e marrëdhënieve me jashtë të Senatit, me shpresë se do të merrnim disa inkurajime atje, por, në atë kohë, pjesa më e mirë u vu në flakë dhe nuk mbeti asgjë që mund të vlente.

Aty ka edhe probleme të ndryshme, të cilat lidhen ngushtë me atë plan që kam propozuar. Po të isha në Uashington, do të isha i lumtur të uleshim e t'i diskutonim. Megjithatë, pak a shumë gjithçka gjendet në memorandumin të cilin po jua dërgoj bashkëngjitur. Si përfundim, a mund të përsëris atë që kam thënë edhe më parë se asnjë çështje e diskutueshme e Europës, madje as ajo polake, për shembull, nuk përmban as gjysmën e dinamitit politik që rri i groposur, gati për shpërthim, në Ballkan. Nëse do t'ia dilnit ta zgjidhnit këtë çështje, atëherë mund të thoni se keni zgjidhur një prej çështjeve më të vështira të kohës.

Me respekt i juaji

Charles Telford Erickson

FEDERATA PANSHQIPTARE E AMERIKËS VATRA [211]

GAZETA "DIELLI"

30 Huntington Ave, DHOMA 520

BOSTON MASSACHUSETS

28 korrik 1945

I dashur dr. Erickson,

Konventa mbaroi. Ishte mjaft e lodhshme, pasi miku ynë Çekrezi e kishte bërë punën e tij të zakonshme përpara se të mblidheshin delegatët. Qëllimi i tij kryesor duket se është tani ta përplasë "VATRËN", siç bëri me organizatën e tij . Megjithatë, ne e kaluam si e kaluam dhe tani çdo gjë është e qetë.

Unë ua lexova raportin delegatëve një për një dhe zemra jote do të dilte nga kraharori prej gëzimit kur të shihje njerëzit si kërcenin dhe iu shndritnin sytë nga gëzimi, sikur ta kishim shpëtuar Shqipërinë nga shkatërrimi.

E mora vesh se kreu i delegacionit civil të ShBA-së në Tiranë është kthyer në Uashington, por nuk dimë fare se çfarë raporti ka dhënë ai në Departamentin e Shtetit. Po planifikoj të bëj një udhëtim atje, për të gjetur çfarë të mundem. Ju a keni ndonjë sugjerim?

Ju më kujtoni se kam shumë gjëra për të mësuar në diplomaci. A nuk e dinit këtë? A nuk ju kam treguar se jam mjaft i përgatitur për ngatërresat diplomatike?

Tirana ka emëruar një ministër në Beograd, një njeri tërësisht i panjohur për ne. Me sa shoh unë, është një i ri. Ministri jugosllav në Shqipëri është dërguar disa muaj më parë.

[211] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 13.

Peshkopi ju dërgon të fala dhe unë ju dërgoj të falat e mia më të mira për ju dhe zonjën Erickson.

Sinqerisht i juaji

G.M.Panariti

LETRA TË PARRESHTURA PËR SHQIPËRINË

Korrespondenca e Erickson-it për çështjen shqiptare vazhdon me letra pa ndërprerë. Është e qartë se, po të kishin mbijetuar tërë letrat që ai ka shkruar, do të mbusheshin vëllime të tëra me libra. Kështu, duke ndjekur me shqetësim marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më 5 gusht 1945 nga Avaloni i Kalifornisë, Erickson-i i dërgon një letër "Vatrës", në të cilin shprehet si më poshtë:

Charles Telford Erickson

Avalon

Kaliforni

5 gusht 1945

Të dashur vatranë,

…Më pyesni se cilët janë hapat e tjerë që duhet të ndërmarrim në emër të Shqipërisë? Është një pyetje e vështirë për t'i dhënë përgjigje. Mendoj se na duhet të bëjmë një

përpjekje në Uashington, në mënyrë që ta bëjmë Sekretarin e Shtetit Byrnes të gjejë se ku e ka syrin qeveria jonë nëse do të japë ndonjë dritë të gjelbër në situatën e përgjithshme, siç i intereson Britanisë së Madhe dhe Rusisë.

Fakti që pesë ministritë e jashtme, tri të shteteve të mëdha, plus Kinës dhe Francës, mendojnë të ndërtojnë një këshill të lartë për të përvijuar pikat e zgjidhjes për Italinë, Rumaninë dhe Bullgarinë, më duket mua sikur nuk do ta lënë jashtë as Shqipërinë dhe ajo do të jetë brenda kornizës, në mënyrë të pashmangshme. Unë mendoj se do të ishte një gabim serioz që të mos kemi dikë në terren që të merret me çështjen kur të vijë koha. A do të jetë dikush që përfaqëson qeverinë e Shqipërisë, kjo duhet parë me kujdes të madh. Nëse ata e kanë paragjykuar vetveten më tepër se duhet në sytë e Britanisë së Madhe dhe ndoshta ShBA-së, atëherë dikush i pavarur duhet t'i shërbejë kauzës shumë më mirë në hapat e parë për të sjellë qeverinë aty ku duhet kur të vijë koha për marrjen e vendimeve. Kjo del si domosdoshmëri për të vënë në lojë një grup kundër tjetrit dhe përsëri, me laburistët në fuqi në Britani, mendoj se ka pak më shumë mundësi për të ardhur tek një mirëkuptim i përbashkët me Rusinë në një mënyrë të favorshme.

Unë nuk jam kandidat për atë punë. Mendoj se kjo do të jetë një detyrë shumë e vështirë për këdo që e merr përsipër, por nëse Vatra e mendon se nuk ka ndonjë burrë më të zotin për këtë punë, unë jam gati ta ndërmarr dhe të bëj më të mirën. Sido që të jetë, nuk duhet humbur kohë për të bërë planet dhe për të vendosur në emërimin e njeriut të duhur.

Mund të jetë e vështirë për të marrë kredencialet e duhura nga Departamenti i Shtetit për pasaportë dhe për viza, por do të shikoj se çfarë duhet bërë për këtë. Jam i lumtur që e miratuat raportin e S.F.

Të fala për të gjithë

I juaji,

Charles Telford Erickson[212]

[212] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 5, Box No 6, Folder No 14.

Më 27 gusht 1945, Erickson-i merr një letër nga Departamenti i Shtetit në përgjigje të letrës që ai iu kishte dërguar, në të cilën i thuhet:

Departamenti i Shtetit

Uashington DC

27 gusht 1945

Drejtuar Charles Telford Erickson

I dashur dr.Erickson,

Po ju përgjigjemi referuar letrave tuaja dërguar Presidentit, më 25 qershor, 1945, dhe letrës dërguar Sekretarit të Shtetit datë 2 qershor 1945, bashkë me memorandumet, në të cilat ju keni paraqitur pikëpamjet tuaja mbi çështjet shqiptare, në veçanti, dhe ato ballkanike në përgjithësi.

Duke u njohur me atë që thoni, më duhet t'ju njoftoj se Departamenti, i ndërgjegjshëm për shqetësimin tuaj të madh dhe të gjatë mbi çështjet ballkanike, veçanërisht me ato aspekte që kanë të bëjnë me Shqipërinë, e vlerëson angazhimin tuaj për të sjellë këtu shqetësime deri tek ne. Ju duhet të jeni i sigurt se problemet që kanë të bëjnë me vendet ballkanike janë çështje të cilat janë në vëmendje të vazhdueshme në Departamentin e Shtetit dhe që, për këtë arsye, letrat dhe memorandumi juaj janë vënë në dispozicion të zyrtarëve të duhur.

Sinqerisht i juaji,

Për Sekretarin e Shtetit

Samuel Reber

I ngarkuar me punët e shefit të divizionit të çështjeve të Europës Juglindore

Departamenti i Shtetit

Uashington DC

6 shtator 1944

Drejtuar Charles Telford Erickson

Bx.B Avalon, Kaliforni

I dashur dr. Erickson,

Letra që i keni drejtuar Presidentit më 10 qershor 1944, në të cilën rekomandoni marrjen përsipër nga ana e Shteteve të Bashkuara të një mandati amerikan mbi Shqipërinë, i është referuar Departamentit të Shtetit për vlerësim dhe përgjigje.

Ju lutem, rrini i qetë se letra juaj është lexuar me kujdes dhe që zyrtarët e ngarkuar me ekzaminimin e saj në departament e kanë parasysh faktin që ju keni jetuar aq gjatë në Shqipëri dhe që keni një njohje aq të gjerë për atë popull.

I juaji sinqerisht

Për sekretarin e shtetit

Hugh S. Fullerton

Shef i Departamentit të Marrëdhënieve me Europën Jugore

NË AMERIKË PËRSËRI NË SHËRBIM TË SHQIPËRISË DERI NË FUND TË JETËS

Erickson-i ishte larguar nga Shqipëria, por vetëm me trup, jo me shpirt e me zemër. Në këtë pjesë të fundit të këtij libri do të japim përkthimin e atyre letrave që kanë shpëtuar dhe janë ruajtur nëpër biblioteka ose arkiva të ndryshme. Erickson-i i kushtoi shumë kohë shpjegimit të çështjes shqiptare nëpër vende të ndryshme të botës, dhe jo vetëm në ShBA. Ai udhëtoi në Zelandën e Re dhe në Australi, ku predikonte nëpër kisha të ndryshme. Por edhe atje ai fliste për shqiptarët dhe Shqipërinë, për virtytet dhe traditat, për fenë dhe bashkëjetesën e këtij kombi të lashtë. Po këtë bënte ai edhe në ShBA. Po ashtu, do të shohim se si ai iu shkruan letra thuajse tërë presidentëve dhe sekretarëve të shtetit amerikan për Shqipërinë që nga viti 1935 e derisa vdiq. Por më mirë se çfarëdolloj komenti do të flasin vetë këto letra, fjalime, emisione radiofonike, të cilat janë ruajtur mirë. Të mos harrojmë se letrat e Erickson-it në Shqipëri u konfiskuan një herë nga turqit, pastaj nga serbët në vitin 1912. Por një fat jo më i mirë e ndoqi atë edhe në Amerikë, kur iu dogj shtëpia në Masaçusets. Megjithatë, letrat e mbijetuara të ruajtura në arkiva të ndryshme na japin mundësinë që të krijojmë një tablo shumë të qartë të asaj që ai bëri për Shqipërinë, pasi u largua nga ajo. Për këtë do të vendosim këtu korrespondencën e tij në një rend kronologjik.

CHARLES TELFORD ERICKSON

Të nderuarit Cordell Hull[213]

Sekretar i shtetit

Uashington DC

28 maj 1935

Zotëri,

Në vijim të gjashtë muajve të studimeve dhe kontakteve të mia, kam nderin t'ju paraqes disa vëzhgime mbi situatën e tashme në Shqipëri.

Tiranë, kryeqytet

Qiparisat e vjetra të stërgjata, Sheshi i Sahatit, dy xhamitë kryesore ende qëndrojnë rojë si në ato ditë të hershme. Miku im i vjetër Pavli, bakërpunuesi, është më i zënë se kurrë me punë. Hani i vjetër, ku familja ime dhe unë u gremisëm të lodhur njëzet e gjashtë vjet më parë, po rinovohej dhe mobilohej me gjëra të reja, për të marrë formën e një hoteli. Shumica e rrugëve të shtruara me kalldrëm kryqëzohen në të tëra drejtimet. Ato shkojnë paralel me muret e qerpiçit. Aty këtu shoh furra publike, pastaj ndonjë dyqan të vockël që është e vështirë ta përshkruaj, tenda frutash, që prishin monotoninë prej burgu. Por, në anën tjetër, sikur të prera me thikë, shtrihen rrugë të drejta moderne, dyqane të reja të sapondërtuara, të mbushura me mallra europiane. Godina e vjetër e parlamentit, më parë një shtëpi e bejlerëve Toptanas, së bashku me disa ndërtesa të tjera, janë rrethuar me mure të larta tullash, me rojë solemne tek portat. Këtu Mbreti Zog I jeton jetën e tij të izoluar.

Që nga Kulla e Sahatit, në drejtim të perëndimit shihet një bulevard i gjerë, që mban

[213] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 1.

emrin e mbretit. Në qendrën e tij është një rrugë këmbësore e gjerë, e mbushur me lule dhe shkurre. Dielli shndrit, ajri i mëngjesit është i freskët, gjaku rreh në damar, kështu që unë eca në tërë gjatësinë e tij për rreth një gjysmë milje. Kur arrita në një farë vendi, pashë se rruga ime pengohej prej diçkaje si një vinç. Fundi i bulevardit mbaronte menjëherë dhe… nuk ishte i denjë për një rrugë që mbante emrin e mbretit.

Aty kishte pesë a gjashtë ndërtesa, të cilat mund të themi se janë tipike të stilit italian. Ka pak dyqane vendase ose mure të bardha. Kostoja e raportuar për ndërtimin e kësaj gjysmë miljeje rruge moderne ishte dy milion franga ari. Afër sheshit, hyra në një berberhane për një prerje flokësh. Ishte i pajisur me thuajse çdo gjë moderne që njeriu i gjen në një dyqan të tillë amerikan. Pronari i saj kishte kaluar shtatëmbëdhjetë vjet në New York. Këtu kishte vënë tërë kursimet e tij. Ai merrte katërmbëdhjetë cent për një qethje dhe kishte një gjysmë duzine klientësh në një ditë të gjatë punë prej rreth 10-12 orësh. Aty kishte shumë dyqane të tjera të njëjta, por ishin dyqane të vogla vendase, me peshqir të palarë, të përdorur, brisqe dhe krehra me dhëmbë të thyer. Ishte e njëjta histori në dyqane. Taksat e larta doganore i ngrinin çmimet aq lart e deri në atë pikë, sa vetëm një klasë shumë e kufizuar mund t'i blinte ato dhe këta vetë, në të shumtën e rasteve, i blinin ato jashtë shtetit. Në një dyqan unë kërkova çmimin e një kutie pjeshke të Kalifornisë. Me para amerikane do të më kushtonte një dollar e tridhjetë e gjashtë cent.

Dita e pazarit, e cila duhej të sillte mijëra vetë në qytet nga të tëra anët e vendit, madje edhe prej maleve të largëta dhjetë apo edhe dymbëdhjetë orë, ndryshonte pak gjë nga ditët e zakonshme. Disa gomarë të ngarkuar me lesh ose mallra të tjera fshati, presh të bardhë të palidhur, grumbuj gështenjash, disa lëkura dhelprash ose ujku, e plot mallra të tjera shtrohen drejt e në tokë, anës rrugës. Krenaria dhe krekosjet e hershme të maleve janë zhdukur. Takimet burrnore kokë më kokë dhe përshëndetjet me fjalët "A je burrë?" tani mungonin.

Tirana është një qytet pa drita, pa gazmend dhe pa këngë. Ato pak gjëra të gëzueshme që e mbanin atë dikur, tanimë kanë ikur. Fola me shumë njerëz që vijnë nga udhë të

ndryshme të jetës, të vjetër e të rinj, bejlerë, intelektualë, profesionistë, dyqanxhinj… Gjithandej gjeta mosbesim, mungesë shprese, një ndjenjë kotësie. Midis të tjerëve pata një bisedë të gjatë me gjeneralin Sir Jacelyn Percy, oficer shumë i zoti, që të imponohej, inteligjent, i ngarkuar me punët e xhandarmërisë. Ai e përshkroi situatën me një gjest kuptimplotë – i ra murit prej çimentoje të zyrës së tij me kokën e tij të madhe dhe të thinjur.

Qëkurse u tentua t'i merrnin jetën Mbretit në Vjenë dhe pas zbulimit të një komploti pak para se të vihej në jetë në Tiranë, si dhe pas vdekjes së nënës së tij, e cila kishte një ndikim shumë të madh mbi të, ai jetonte një jetë krejt tjetër, duke mos e lënë kurrë pallatin e tij. Një grup prej tre ose katër burrash, midis të cilëve Abdurrahim Klosi, i njohur prej të gjithëve edhe si xhaxhai, edhe si babai i tij, duket hapur se e kanë atë thuajse në kontroll të plotë.

Ata i thanë atij se shefi i rojave të pallatit po komplotonte për t'i marrë jetën dhe menjëherë një çift i oficerëve të xhandarmërisë, detyra kryesore e të cilëve është të kujdesen për raste të tilla, janë dërguar për ta hequr atë. Ai dëgjon fjalë për këta dhe shpëton në Mat në kufi më Serbinë, mbledh njëzet deri në tridhjetë miq malësorë në një bandë dhe merr malet. Tani ai merr me mend përpjesëtimin e revolucionit me dyshime të mëdha të nxitjes serbe dhe mijëra trupa nxitojnë drejt kufirit, me artileri, bateri malore… Gjenerali i shtabit shkon në një sallon konference dhe duket shumë solemn. Gjeneral Percy përfton hyrje tek Mbreti dhe ia vë faktet përpara tij, të cilat kapen menjëherë prej grupit të pallatit. Ndërkohë një javе ose dy kalojnë dhe asgjë nuk ndodh dhe ushtria tërhiqet, mijërat e rekrutëve të thirrur nën armë lejohen të kthehen në shtëpitë e tyre dhe incidentet harrohen.

Tetëdhjetë e pesë për qind e popullsisë së Shqipërisë është fshatare, ndërsa tri të pestat e tokës së punueshme nuk mbillet, as korret. Ajo ose është tokë e pazhvilluar e qeverisë që kërkon kanalizime nga përmbytjet e lumenjve, ose pasuri e madhe që u takonte bejlerëve, të cilët nuk kanë as fonde, as vetë interesa të mjaftueshme për t'i zhvilluar ato. Rezultati është se qeveria duhet të importojë ushqime për popullin,

ndërkohë që një shpërndarje e zgjuar e tokës, një bashkëpunim midis qeverisë dhe bujqve në përdorimin e metodave shkencore do ta kthente dheun aluvional të pasur të vendit në një luginë tjetër Nili të veprimtarisë përfituese për kombin. Sot, bujqve të paaftë për të paguar taksat e qeverisë, ua marrin kafshët e fermave tagrambledhësit, duke e bërë kështu të ardhmen e tyre edhe më të pashpresë sesa është sot. Kur kanë të korra të mbara, siç ndodhi vitin e kaluar, Italia i vë embargo drithit, duke i detyruar të zbresin çmimet gati deri tek asgjëja. Kështu bujku as kështu nuk është më mirë. Është e njëjta histori e rritjes së taksave, konfiskimeve, qirave të larta ndaj pronarëve në mungesë, mungesës së pajisjeve dhe kapaciteteve për punët bujqësore.

Italia dhe Shqipëria

Legata jonë në Tiranë duhej t'ju mbante plotësisht të informuar në lidhje me kontrollin e tepruar të Italisë mbi Shqipërinë për shkak të detyrimeve të saj financiare. Duhej t'ju thoshte se si borxhi ndaj Italisë bëhet mal vit pas viti, se si ai ka arritur tani një pikë ku as interesat nuk mund të paguhen sikur edhe me borxhe të reja, se si kontrolli i Italisë mbi borxhet mundëson atë të drejtojë shpenzimet e veta në projekte të cilat kanë të bëjnë direkt me interesat e saj më shumë sesa me ato të kombit shqiptar, pasi, për shembull, ndërtimi i portit të Durrësit deri në një kapacitet që të akomodojë flotën italiane, kur Shqipëria nuk ka qoftë edhe një anije të vetme të sajën, një aeroport të të njëjtit kapacitet dhe në kontroll të kompanisë së saj, rrugët strategjike drejt kufijve të Jugosllavisë dhe Greqisë, praktikisht pa asnjë trafik ndërshtetëror, për t'i përdor ato projekte ujitjeje për hapjen dhe zgjerimin e tokave bujqësore. E rrethuar prej shtetesh të krishtera, e vënë në aleancë me një qytetërim të krishterë perëndimor, ajo bëhet një Ishmael i dëbuar, të drejtat e së cilës, zotërimet, kufijtë, pakicat në shtetet fqinje asnjë nuk është i detyruar të respektojë, që është rekordi i pathyeshëm i katër shekujve e gjysmë të historisë së Ballkanit. Italia ka kërkuar këmbëngultas ta tëhuajë Shqipërinë myslimane prej turqve, por dredhia dhe grykësia e ujkut ka qëndruar kaq befasueshëm, sa lëkura e saj prej deleje maskuese nuk ka mashtruar askënd. Sot unë dua të them se ka më shumë dinamit politik të paketuar e të vënë për shpërthim në këtë shtet të vogël sesa në të gjitha pjesët tjera të Ballkanit të marra së bashku.

Siç e shoh unë, ka vetëm një zgjidhje e cila mund të provohet si e vlefshme, në qoftë se kjo do të ofrohej në mënyrën e duhur. Kjo do të ishte që Shqipëria të bëhej një shtet nën proktetorat. Përballë kësaj, njeriu mund të supozojë se një sugjerim i tillë do të gjente vetëm përbuzje dhe tallje. Unë mund të konstatoj se kjo nuk është kështu. Sa i takon mbretit, unë e kam diskutuar çështjen me të kur ai nuk ishte mbret, shumë herë, dhe kjo ishte bindja e tij e patundur. Njësoj me këtë e kam diskutuar atë me shumë prej udhëheqësve më me ndikim, veçanërisht myslimanë dhe kanë treguar të njëjtin qëndrim. Ata kanë një vlerësim të lartë për të shkuarën e tyre antike, si të krishterët e parë në Europë. Heroi i tyre kombëtar Skënderbeu, nderohet më shumë prej muhamedanëve se prej të krishterëve.

Unë kam qenë në komunikim me primatin e Britanisë së Madhe me një pikëpamje për të regjistruar ndihmën e tij në organizimin e kishës katolike kombëtare. Përkatësia e afërt e kishës ortodokse greke me kishën e Anglisë do të bënte të lehtë për ta që të bashkoheshin në një trup me një lëvizje të tillë. Sipas shënimeve të mia, mbi njëzetepesëvjeçare, të shoqërisë së ngushtë dhe të besueshme me të tria grupet, veçanërisht me myslimanët, kohë gjatë së cilës unë nuk kam bërë kurrë qoftë edhe një orë aktive propagandistike, e bën atë të mundur për mua, si një mik i tërë palëve, të propozoj dhe të favorizoj një zgjidhje të tillë. Një shtet me kishën e sponsorizuar prej Britanisë së Madhe, një kishë e lirë së bashku me linjat e thjeshta pa ritual, e sponsorizuar prej kishës liberale të Amerikës, do ta transformonte tërë aspektin e jetës në Shqipëri, do të siguronte një rrugë për të shpëtuar nga frymëzënia e sotme që i bën Italia, duke sjellë mbrapa dy milionë të krishterë të tradhtuar dhe të arratisur në vathë pas katër shekuj e gjysmë të jetës tragjike.

Është e qartë se si një individ privat, unë nuk jam në pozitë të bëj një propozim të tillë në një mënyrë që t'i jap atij qoftë edhe shansin më të vogël për të pasur sukses. Një gjë si kjo duhet të studiohet dhe të ushqehet për vite dhe prej dikujt i cili ka mundësi kontakti me mbretin. Gjatë viteve që kam punuar në legatën tonë në Tiranë, kam pasur shumë mundësi që t'u ofroj shërbimin qeverisë shqiptare, të cilat kurrë nuk hynë në raportet për Uashingtonin, por të cilat kishin shumë më shumë rëndësi dhe peshë

sesa gjërat që u patën raportuar. Midis tjerash, si një shembull, unë qeshë deleguar prej Qeverisë së Përkohshme të shkoja në Londër dhe t'i ofroja fronin e Shqipërisë një anglezi, i cili, sikur të mos kishte vdekur ndërkohë që po bëhej operacion, i shkonte plotësisht për shtat asaj detyre dhe do të ishte sot mbret i Shqipërisë. Ka disa shpresa të tilla në zemrën time se, si një mik i pa interes dhe i veçantë i tyre, të mund të jem në gjendje të shtyj më tej propozimin e mësipërm, që unë e kam ofruar veten time të shërbej si ministër amerikan në Shqipëri.

Unë jam zotëri,

Shërbëtori juaj i bindur dhe i përulur

Charles Telford Erickson

RADIOTRANSMETIMET PËR SHQIPËRINË, BOSTON, 1 SHKURT 1942[214]

Ju flet Charles Telford Erickson-i!

Rrofshi ju, rroftë Shqipëria!

Përshëndetjet e mia dërguar tërë miqve të mi, të cilët po më dëgjojnë. Më së pari, mësuesve dhe nxënësve të Shkollës Shqiptaro-Amerikane të Bujqësisë; atyre që e ndoqën atë në vitet që shkuan dhe atyre që i shërbejnë vendit të tyre tani në çfarëdolloj mënyre.

Përshëndetje juve si komb nga bashkatdhetari juaj në Amerikë, Erickson!

Kam takuar shqiptarë në shumë qytete dhe në shumë anë të Amerikës. Përsëri më lipset të gjej një, të paktën një, që nuk është besnik në zemër i "mëmëdheut", ndërkohë që është kaq besnik ndaj vendit të cilin e ka pranuar po ashtu si të tijin, Amerikën. Dhe a mund t'ju them juve, mëma dhe baballarë, juve, familjeve të këtyre shqiptaro-amerikanëve, se ne të Amerikës nuk kemi djem më të mirë se ata që na keni dhënë ju?! Në tërë këto vite, unë kurrë nuk kam dëgjuar që ndonjë shqiptar të ketë bërë krime në Amerikë.

Djemtë e Shqipërisë këtu në Amerikë punojnë shumë, jetojnë duke kursyer shumë dhe shpenzuar pak, me qëllim që të kursejnë për të patur sukses në tregtinë e tyre

[214] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 2.

ose në profesion. Ata i sigurojnë shtëpitë për familjet e tyre dhe i ndihmojnë bujarisht të afërmit në atdhe. Siç e dini tashmë, ne kemi një shoqatë ndihmash shqiptare këtu në Amerikë, president i së cilës unë kam nderin të jem. Ajo është organizuar me qëllim të mbledhë fonde për ata që janë në nevojë në Shqipëri. Tani për tani ne nuk kemi se si t'i dërgojmë ato fonde tek ju, kështu që ju duhet të prisni me durim derisa të hapet rruga. Deri në atë kohë, unë shpresoj se fondi do të rritet me shumë mijëra dollarë, më shumë se ato që kemi në thesar tani për tani. Të jeni të sigurt se, sapo rruga të hapet, dikush do të vijë me shpejtësi bashkë me ndihmat për ata që po vuajnë dhe janë në nevojë të thellë. Gjatë vitit të kaluar, qeshë ministër i një kishe në Fortsmouth, N.N. Në të gjithë atë pjesë të Amerikës kam treguar në mënyrë të përsëritur historinë e figurave tuaja historike, me virtyte fisnike. Gjithmonë sallat e mbushura me amerikane janë habitur dhe janë ngrohur në zemër kur iu kam treguar për luftën e gjatë që ju keni bërë me mijëra vjet për të ruajtur identitetin dhe integritetin tuaj si komb, kur, të shumtën e kohës, kombe të huaja, perandoritë dhe qeveritë e tyre kanë ushtruar dhunë mbi ju. Lufta për pavarësi këtu në Amerikë, për të cilën amerikanët janë kaq krenarë, ishte, në fund të fundit, një luftë shume e shkurtër dhe e thjeshtë në krahasim me atë tuajën. Dhe përsëri lufta jonë e përfunduar pas revolucionit nuk ka përjetuar kurrë një rrezik kaq serioz ndaj pavarësisë dhe lirisë sonë sa kjo e juaja. Ju keni një histori për të cilën duhet të jeni krenarë. Ju keni dhënë shembullin më të lartë të qëndrushmërisë edhe në kushtet e shtypjes së të huajit. Ju keni treguar besnikëri ndaj atdheut tuaj edhe kur kjo ju ka kushtuar bukën e familjes dhe të fëmijëve. Shumë prej jush mund të ishin bërë të pasur me çmimin e tradhtisë. Por jo, ju kurrë nuk e bëtë këtë. Prandaj kjo është një histori që duhet treguar në çdo vend dhe popull, dhe anembanë botës.

Kur shkova në Shqipëri, në vitin 1908, si misionar i Bordit Amerikan, kisha pak ose aspak njohuri për kushtet që do të gjeja atje. Kur e pashë varfërinë e popullit, veçanërisht në fshat, u tmerrova. Mungesa e plotë e rehatisë në shtëpitë e tyre, e ushqimeve të duhura, mungesa e çdo mjeti sanitar, e kujdesit të duhur për fëmijët dhe vdekshmëria e lartë midis tyre më këpuste shpirtin. Unë pashë se sa primitive ishte

bujqësia, e papërshtatshme për të ushqyer popullsinë e vet, ndërkohë që zona të tëra të pllajave më të pasura ishin kthyer në këneta të egërsuar për mungesë të kanalizimeve. E gjeta vendin tuaj pa rrugë, pa industri, pa shkolla kombëtare…, i gjeta të sëmurë të moshuarit, foshnjat tuaja pa spitale, pa kujdes mjekësor. Sëmundjet ngjitëse, si lia, kolera, fruthi, flama, nuk kishin kurrfarë karantine. Këto kushte të tmerrshme jetese luftoheshin vetëm me një fjalë të përgjithshme fataliste të quajtur, KISMET. Kam dëgjuar prej gojëve të shumë baballarëve vajin për fëmijën që iknin nga kjo jetë ende pa e ndier kuptimin e vërtetë të saj. Kam parë dhimbjen e tmerrshme të sëmundjeve, malaries, pikëllimit, të një popullsie e cila ishte tërësisht e pashpresë për ta shmangur atë. Kam parë se si tuberkulozi merrte një numër të madh njerëzish, veçanërisht nënat e reja, si dhe mijërat e të rinjve dhe grave të sapomartuara. Tërë këto, madje edhe më shumë, i shihja me dhimbje dhe keqardhje të thellë në zemrën time. Edhe vetë, edhe familja ime mbajtën mbi supe disa prej këtyre vuajtjeve. Ne paguam pjesën tonë të vuajtjeve, madje edhe të vdekjes. Lavdi Zotit ato ditë kanë shkuar. I lutem Zotit të mos kthehen më!

Ka pasur kohëra kur unë nuk bëja gjë tjetër veçse humbisja shpresën se do të vinin ditë më të mira. Por tani jam i gëzuar për atë progres që është bërë gjatë këtyre viteve të pavarësisë. Isha në Shqipëri dhe e vizitova atë bashkë me zonjën time, në vitin 1937, si mik i qeverisë për t'iu bashkuar gëzimit të popullit në festimin e 25-vjetorit të pavarësisë së saj. Aty pashë një komb të transformuar, qytete moderne, shkolla, spitale, bujqësi, rrugë gjithandej, industri të çdo lloji; madje jeta sociale e popullit ishte bërë perëndimore dhe europiane pas më shumë se katër shekuj izolimi prapa vellos së supersticionit, frikës dhe paragjykimeve. Unë jam shumë krenar që kam një pjesëz të vogël ndihmese në lënien prapa të atyre kushteve.

Megjithatë, puna e ripërtëritjes dhe modernizimit vetëm sa ka filluar. Aty duhet të arrihen shumë gjëra, përpara se Shqipëria të shpresojë të jetë një shtet i shëndetshëm në kuptimin modern të fjalës. Qindra e mijëra njerëz të saj ende jetojnë midis mjerimit në një nivel që është thuajse pragu i fundit i urisë. Minierat nëpër male, pyjet e pafund, fushat e pasura dhe pjellore duhet t'i shërbejnë qëllimit hyjnor që

është dhënë që nga fillimi prej Krijuesit. Burimet natyrore të Shqipërisë, sapo të jenë zhvilluar dhe vënë në shërbim të kombit, janë të mjaftueshme për të nxjerrë çdo familje nga varfëria, uria dhe tërë mjerimi njerëzor që kanë ata tani drejt një niveli të rehatisë, pasurisë dhe lumturisë së tillë sa të krahasohet me Zvicrën, me të cilën Shqipëria ngjet kaq shumë. Ky duhet të jetë qëllimi që çdo shqiptar besnik i vë detyrë vetvetes. Por shqiptari nuk duhet të humbasë asnjëherë drejtimin, pamjen e tij, sepse është ajo që e bën atë të veçantë. Ai duhet të zotërojë atë trashëgimi dhe bekim hyjnor, që kurrë të mos i ndahet kombit.

Rroftë Shqipëria[215]

Charles Telford Erickson

[215] Shqip në origjinal.

ROLLINS COLLEGE LIBRARY[216]

Parku Winter, Florida

Winter Park TOPICS

Një vështrim javor i veprimtarive kulturore dhe shoqërore gjatë stinës dimërore.

Vëllimi i 11-të. Winter Park, nr.3, Florida, e premte, 21 janar 1944

DR. ERICKSON-I FLET PËR SHQIPËRINË

"Shqipëria, çelësi i Ballkanit" është subjekti i ligjëratës që do të mbajë dr. Çarls Telford Erickson-i, të martën më 25 janar, në orën 8 pasdite në Kishën Kongregacionale në Winter Park, në serinë e ligjëratave të netëve të marta.

Dr. Erickson-i ka jetuar shumë vite në Shqipëri. Ai vajti fillimisht në Elbasan, në vitin 1908, me Bordin Amerikan të Misionarëve dhe qëndroi në atë detyrë deri në periudhën para Luftës së Parë Botërore. Ai është themeluesi i Kolegjit Amerikan të Bujqësisë për djem dhe Shkollave të Vajzave në Tiranë dhe Kavajë. Ndërkohë që ishte i angazhuar në këtë punë, ai u bë edhe këshilltari i besueshëm i qeverisë shqiptare në Tiranë. Ai ka qenë delegat nderi i Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Versajë.

Në vitin 1931, dr. Erickson-i u dekorua me titullin "Mbajtës i Urdhrit të Skënderbeut" prej Naltmadhënisë së tij, Zogu I, Mbret i shqiptarëve. Gjatë atyre viteve të vështira ai ka shkruar për revista dhe ente botuese me emër mbi këtë popull, jeta e të cilit fillon me shkrimet e Homerit. Pasi ka dhënë leksione të shpeshta dhe të zgjeruara në publik, ai është bërë një mik i shquar i këtij kombi të vogël me personalitete të mëdha.

Winter Park, nr.3, Florida, e premte, 21 janar 1944

[216] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 3.

Charles Telford Erickson

24 nëntor 1945

Letër dërguar Presidentit Harry Truman[217]

Shtëpia e Bardhë, Uashington DC

I dashur zoti President,

A do të më falnit disa çaste nga koha juaj e vlefshme për të konsideruar sugjerimin e mëposhtëm, qoftë ai me vlerë praktike për ju ose jo? Unë po jua parashtroj këtë jo si një kritikë, por si një nga shqetësimet më të mëdha, që ju fisnikërisht do t'i tejkaloni në një prej orëve më kritike të historisë së njerëzimit.

1. Edhe ju, edhe paraardhësit tuaj, jepni përshtypjen se i bashkoheni politikës së Britanisë së Madhe. Sado e natyrshme të jetë kjo, unë dyshoj thellësisht në drejtësinë e një përputhjeje të tillë politike në këto kohë që po jetojmë. Siç e shoh unë, fati i Perandorisë Britanike tashmë është vulosur. Luftimet e saj në Indokinë, Batavia, Iran, Palestinë, janë provat më të qarta të gjendjes së saj të dëshpëruar. Forcat e pamatshme të krijuara nga Lufta II Botërore sapo kanë filluar të veprojnë. Kolonitë, mandatet, barrët e njerëzve të bardhë janë në udhën e tyre drejt ikjes. Kjo është e shkruar në Librin e Fatit.

2. Potencialisht Rusia dhe Kina duket se shfaqen në horizontin e së ardhmes. Dhe këto të dyja së bashku ndajnë një kufi prej pesë mijë miljesh. Rusia ia ka dalë të kapitalizojë pakënaqësitë e kombeve, duke përfshirë edhe tonat. Ajo i ka vënë bërrylat Britanisë jashtë kontinentit. Greqia mbetet e vetme, ndërsa Rusia do ta anashkalojë atë prej Adriatikut në Dardanele. Dërrmimi e Evropës, tharmi i Palestinës, Iranit dhe Egjiptit janë si erëra stuhie mbi velat e saj. Për Rusinë batica sjell përmbytje dhe i prin asaj drejt fatit.

[217] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 5.

Për mua del e qartë se e vetmja politikë e mbetur për ne është të luajmë futboll me Rusinë. Dërgoni Eric Johnston-in dhe Sumer Vells-in në Moskë, sa më shpejt. Njërin për çështje politike, tjetrin për ato ekonomike. Restauroni miqësinë e lashtë, shtrojini të tëra kartat në tavolinë, përgatitni tërë kornizën e politikës botërore për të ardhmen, me një ndikim të gjerë. Me zgjuarsi, durim dhe dëshirë të mirë mund të provojmë shpëtimin e Britanisë së Madhe për të paktën edhe një gjysmë shekulli. Ajo që është më e rëndësishme është fakti se ajo shtrihet në themelet e gjera qenësore për paqen dhe rendin botëror. Nuk dua të komentoj për atë se si e mendoj unë alternativën ndaj kësaj që ndodh sot.

Në mbyllje, unë shpreh mirënjohjen time të thellë dhe vlerësimin për njohjen bujare të Shqipërisë. Ajo do të përligjë zgjuarsinë e atij kursi dhe për këtë jam i sigurt. Rusia, Kina dhe Shtetet e Bashkuara: Mendo për to, fuqinë njerëzore, mjeshtëritë industriale dhe know how për të bërë të pamundurën. Koha është thelbësore dhe, njësoj si batica, ajo nuk i pret njerëzit.

Zoti ju dhëntë mençurinë dhe këshillën më të mirë!

Sinqerisht i Juaji

Charles Telford Erickson

Aukland, Zelanda e Re, 15 shkurt 1947[218]

Ju flet Charles Telford Erickson-i.

[218] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 6.

SHQIPËRIA DJE DHE SOT

Në këtë artikull Erickson-i krahason të kaluarën e Shqipërisë me atë të vitit 1947. Natyrisht, mungesa prej dhjetë vjetësh në Shqipëri, e kishte lënë atë në gjendje pak a shumë terri informativ. Aq më tepër që tani vendi ishte mbyllur nën darën e egër komuniste.

> *Mirëmëngjesi! Sot do t'ju flas për Shqipërinë si ishte dje dhe si është sot. Shpresoj se do të kënaqeni. Dua t'ju tregoj si ishte Shqipëria kur shkela për herë të parë aty më 8 shtator 1908, bashkë me fëmijët e mi Earl, 10 vjeç, Lois 8, Paul 5. Durrësi, një herë e një kohë qyteti i njëqind mijë vetëve dhe vendpushim i perandorëve romakë, tani ishte tkurrur e mbetur vetëm me rreth pesë mijë vetë.*

Pasi flet për aspekte të jetës në Shqipëri dhe si e kishte njohur ai, gjithmonë në frymën më pozitive, ndalet tek bashkëjetesa fetare. Marrëdhëniet midis feve në Shqipëri ai i quan më të përzemërtat dhe më të mirat që njeriu mund t'i gjejë ndonjëherë në ndonjë vend të botës.

Ai e mbyll bisedën radiofonike përsëri me thirrjen:

Rroftë Shqipëria!

AUKLAND, ZELANDA E RE,

22 SHKURT 1947[219]

Ju flet Charles Telford Erickson.

Tema: TRI FE NJË BESIM[220]

Edhe një herë mirëmëngjes! Në këtë emision do të flas për tri fe – një besim, në Shqipëri. Besoj se juve do t'ju interesojë, në mos për asgjë tjetër, për faktin se do të mësoni diçka rreth një vendi të vogël, Shqipërinë, e cila me aq sa e njoh unë është krejt më unikja. Tri degë të mëdha fesh, dy të krishtera dhe një myslimane, të cilat qëndrojnë së bashku në tërë veprimet që kanë të bëjnë me interesat jetike të kombit shqiptar. Unë vetë kam pasur të bëj me të tria dhe me të tria kam bashkëpunuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Më e vjetra e tyre, ajo katolike romake, ndonëse në numër përbën më të voglën me rreth 12 % të popullatës, ka ruajtur formën e vet në veri të Shqipërisë, që prej kohëve të Apostullit. Deri në vitin 330 pas Krishtit, ajo ishte e tëra nën atë ndikim. Gjatë asaj periudhe, veprimtaritë kishtare ishin të shumta. Apostulli Paul, me shokët e tij, jo vetëm që kaloi shumë kohë dhe përpjekje aty për t'i krishterizuar popullatën, por një numër i madh i Gardës Pretoriane Romake, të cilët edhe vetë ishin ilirë, dërgoheshin në Shqipëri për të qetësuar situatën, duke vepruar si forcë stabilizuese në Ballkan. Shumë prej tyre ishin të krishterë, shumë e morën atë rrugë dhe i hynë shërbimit ndaj asaj feje. Edhe sot ka shumë gërmadha antike të kishave të krishtera dhe altarë, të cilët mund të jenë pikërisht të asaj kohe. Gjatë qëndrimit tim atje, pashë një altar të shenjtë, i cili ishte nxjerrë nga gërmadhat. Kur Konstandini i Madh vendosi të braktiste Romën si kryeqytetin e tij dhe të ndërtonte Kostandinopojën në brigjet e Bosforit, ai e ndau Shqipërinë në dy pjesë. Veriun e la nën ndikimin e Romës, ndërsa jugun nën atë të Perandorisë së Lindjes. Natyrisht që kjo lëshoi hijen e vet mbi

[219] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 7.
[220] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 8.

pjesën veriore, për të cilën dihet pak historikisht për shekujt që vijuan. Dihet që në Shkodër gjendej një prej këshillave më të mëdhenj të kishës dhe në shënimet e lashta gjendet një dëshmi e përsëritur e shpirtit martir, të treguar prej malësorëve shqiptarë, në shekujt e errët e të tmerrshëm të përndjekjes së hordhive barbare, të cilat i pushtuan këto rajone.

Jugu gjysmë i shkatërruar ra në dorën e Perandorisë Bizantine. Kjo ndodhi në vitin 1453, kur Mehmeti II e pushtoi Kostandinopojën dhe e shndërroi kishën e madhe të Shën Sofisë në xhami. Pushtimi i Shqipërisë, më së pari i ndërmarrë prej babait të Mehmetit, i njohur si Murat II, tani u bë objektivi kryesor. Këtë turqit e arritën vetëm pas vdekjes së Skënderbeut, 15 vjet më vonë.

Pastaj Erickson-i vijon me historinë e Skënderbeut, si u mor peng nga sulltani, si u rrit dhe si e çliroi Shqipërinë nga turqit derisa vdiq. Pas vdekjes së tij, pasoi edhe largimi i më se 200 000 shqiptarëve, drejt Italisë, thotë Erickson-i. Ai flet me respekt për arbëreshët, të cilët punojnë për vendin e tyre të dytë, Italinë.

Historia e gjatë e marrëdhënieve ndërfetare në Shqipëri, që nga viti 1468 deri në vitin 1912, është një histori tragjike, e gjatë. Shtatëdhjetë për qind e popullsisë u shndërruan me forcë në muhamedanë. Procesi ishte shumë i thjeshtë: Bëhu mysliman ose nuk ke rrugë tjetër! Nëse jo, ajo që të priste ishte heqja e tërë të drejtave qytetare, ose ikje në arrati jashtë vendit. Paradoksi i tërë këtyre ishte se shqiptarët myslimanë luftuan kundër myslimanëve turq për të ruajtur integritetin e tyre kombëtar, që më në fund të fitonin lirinë.

Me largimin e turqve ndodhi mrekullia. Udhëheqësit shqiptarë, përfshirë edhe Mbretin Zog, thanë hapur se feja myslimane ishte përftuar me detyrim, se ata nuk ishin dorëzuar kurrë në zemrat e tyre, se feja e krishterë e baballarëve të tyre dhe që vetë kombi kishin mbijetuar prej faktit se aty përherë kishte ekzistuar bashkimi i brendshëm shpirtëror i racës, i cili u mbajt gjallë gjatë tërë atyre shekujve. Shtyllat e kësaj feje mund të shpallen si:

1. *Ndjenja e nderit vetjak, i cili ka zënë rrënjë kaq të thella, sa të tradhtosh do të thotë vdekje ose arrati për jetë;*

2. *Ideali familjar i krishterë i tyre, nderimi ndaj gruas dhe virtyteve të saja, që u mbajt kaq vendosmërisht, sa edhe vetë turqit ishin detyruar ta pranonin t'i respektonin ose të përshtateshin me të.*

3. *Ideali i krishterë i shtëpisë. Përkundër shembujve të pushtuesve të tyre turq, monogamia ishte zakoni i tyre universal, si midis myslimanëve, ashtu edhe midis të krishterëve shqiptarë.*

Sapo e hoqën qafe zgjedhën turke, myslimanët e shpallën veten të pavarur nga Shekullislami, që ishte kreu shpirtëror në Stamboll dhe themeluan organizatat e tyre. Ata iu bashkuan në masë një sekti liberal mysliman, të quajtur bektashizëm.

Më pas Erickson-i e vijon bisedën duke treguar se si Mbreti Zog i jepte aq shumë rëndësi shkollimit të vajzave, diçka tashmë e njohur prej lexuesit. Ai e mbyll përsëri bisedën me fjalën shqipe:

Tungjatjeta!

DEPARTAMENTI I SHTETIT[221]

New York, NY 1250 W 57 Street

18 prill, 1951

Z. Charles Telford Erickson

135 Oxford Street

Hartford, Conn.

I dashur z. Erickson,

Në një kohë sa më të afërt, "Zëri i Amerikës" do të fillojë transmetimet në valë të shkurtra në gjuhën shqipe. Ne duam të "rihapim" transmetimin e programeve, të cilat qenë pezulluar në vitin 1945.

Duke pasur këtë parasysh dhe duke ditur shoqërinë tuaj shumë të ngushtë me popullin shqiptar në të kaluarën, do t'ju luteshim nëse do të kishit dëshirë të paraqisnit një deklaratë të shkurtër në anglisht, për t'ua drejtuar shqiptarëve të cilët do ta vlerësonin shumë me rastin e fillimit të transmetimit të programit në valë të shkurtra.

Është e domosdoshme të shmangim referenca të drejtpërdrejta ndaj ngjarjeve specifike politike të raportuara për proceset e sotme në Shqipëri. Ne do të ishim shumë mirënjohës nëse deklarata juaj prej 75 deri në 100 fjalësh të ishte në formën e një përshëndetjeje drejtuar miqve tuaj të vjetër, një deklaratë e cila do të tregonte se ShBA-ja është e interesuar për mirëqenien e popullit dhe të kombit shqiptar. Referenca ndaj së kaluarës historike midis ShBA- së dhe Shqipërisë do të ishin të mirëpritura.

[221] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 9.

Unë besoj se ju do të mund të na ndihmoni në këtë çështje.

Faleminderit

Në mënyrën më të sinqertë:

Edwin H. Griffith

Zëvendësshef, njësia shqiptare në Departamentin e Transmetimeve Ndërkombëtare.

PËRSHËNDETJE SHQIPËRISË NGA DR. ERICKSON[222]

Jam njeriu më i lumtur që po ju drejtoj përshëndetjet e mia me ftesë të "Zërit të Amerikës", popullit dhe kombit shqiptar, të cilin e kam dashur dhe që i kam shërbyer për kaq e kaq vite – Shqipërisë sime të dashur.

Ndërkohë që midis jush ka pasur përherë dallime politike, fisnore, fetare, kulturore apo shoqërore, unë gjithmonë brenda vetes kam menduar se kam të bëj me një familje të një gjaku, ta pandarë, të pashprishur, me një trup, një shpirt, një BESË, një shpresë të madhe për të qenë të lirë nga të gjitha fuqitë e mëdha të huaja – ju vetë zotërit e së ardhmes suaj.

Ju, fëmijët tuaj, fëmijët e fëmijëve tuaj, të bashkuar dhe të lirë! Çfarë vizioni, çfarë ëndrre, çfarë besimi dhe shprese për të shkundur zemrën dhe shpirtin e kombit dhe për ta ngritur atë në shtegun e fitores. Të bashkuar qëndroni – të ndarë humbni!

Zoti e bekoftë, e ruajttë dhe e lulëzoftë Shqipërinë përgjithmonë!

I juaji
Zoti Erickson

[222] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 10.

RADIO EVROPA E LIRË[223]

5 nëntor 1951

Z. Charles Telford Erickson

360 North Quaker Lane

West Hartford 7 Connecticut

I dashur z.Erickson,

Po ju shkruaj për t'ju ftuar të përgatisni një bisedë për transmetim në gjuhën shqipe nga radio "Evropa e lirë". Anëtarët e Deskut Shqiptar të Radios ju kujtojnë me respekt të thellë për shërbimin tuaj të gjatë që i keni bërë popullit shqiptar dhe ndiejnë që bashkatdhetarët në vendin e tyre do ta mirëpresin kur të dëgjojnë diçka prej teje. Edhe organi "Lajmëtari i komitetit kombëtar shqiptar" do të pëlqente të botonte biseđën tuaj në një botim të posaçëm.

Transmetimet tona bëhen në kohë të ndara dhjetëminutëshe. Unë nuk e di cila temë do t'ju pëlqente juve më shumë, por jam i sigurt se do të mendoni për diçka konstruktive për dëgjuesit – diçka si kjo, për shembull: "në venat e një miku amerikan që nuk e ka harruar Shqipërinë" etj. Gjithashtu e di se ju flisni shqip dhe nëse kjo iu përshtatet, do të deshëm të incizonim zërin tuaj në gjuhën shqipe.

Duke ju siguruar për kënaqësinë që do të kemi në rast të një përgjigjeje pozitive, mbetem

Sinqerisht i juaji

Hugo Jaeckel

Shënim: 10 minuta transmetim do të thotë afërsisht 1 200 fjalë. Ne do të deshëm edhe një fotografi tuajën për gazetën.

[223] Erickson Collection,Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 11.

CHARLES TELFORD ERICKSON

360 North Quaker Lane[224]

West Hartford 7, Connecticut

30 nëntor 1951

Të nderuarit James E. Web[225]

I ngarkuar me punët e Sekretarit të Shtetit

Washington DC

I dashur zotëri,

Si një njeri që ka kaluar më shumë se një çerek shekulli të jetës së vet në shërbim të Shqipërisë, jam thellësisht i lumtur që të lexoj deklaratën e mëposhtme të botuar në "New York Times", dy ditë më parë:

" Qeveria dhe populli i Shteteve të Bashkuara, të ndërgjegjshëm për traditën e miqësisë me popullin shqiptar, i sheh me simpati të veçantë përpjekjet e komitetit për të përkrahur parimet e lirisë dhe të pavarësisë së vendit të tyre."

Kjo na sjell në mendje një deklaratë të dhënë nga Presidenti Wilson pak para mbylljes së punimeve të Konferencës së Paqes:

"As unë, as populli amerikan kurrë nuk do të pranojmë që populli shqiptar, i cili ka luftuar dy mijë vjet për lirinë e tij, të sakrifikohet për hir të ambicieve politike të

[224] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 12.

[225] James Edein Webb (1906 – 1992), zyrtar i qeverisë amerikane, i cili shërbeu si administrator i dytë i NASA-s. Ai kishte qenë më parë nënsekretar i shtetit në administratën e Presidentit Hurry Truman. Ai njihet për veprimtarinë e tij për të ndaluar veprimtaritë e dyshuara të anarkistëve, komunistëve dhe homoseksualëve nga punësimi në Departamentin e Shtetit. (Shënimi im – MB)

fqinjëve të vet."

Fatkeqësisht, në vitet e fundit, ngjarje të caktuara zyrtare, siç është rezoluta e paraqitur prej Senatorit Pepper në Komitetin e Marrëdhënieve me Jashtë, që rekomandonte dorëzimin e Shqipërisë së Jugut (Epirin) Greqisë, e cila kaloi më vonë edhe në Senat dhe u miratua, si dhe të tjera të cilët mund t'i përmend, kanë bërë shumë për të krijuar mosbesim në mendjet dhe zemrat e popullit shqiptar, që kishin të bënin me qëndrimin dhe qëllimin e qeverisë sonë mbi këtë çështje. Fakti që ata shohin drejt Moskës për të gjetur mbrojtje është nxitur pak a shumë nga ky motiv.

Për të sqaruar situatën, unë dëshiroj që të lëshohet një deklaratë e qartë dhe pa mëdyshje e qeverisë amerikane, e cila të afirmojë pozicionin dhe qëllimin e saj në mbështetje të plotë të integritetit të Shqipërisë brenda kufijve të caktuar nga Komisioni i Kufijve që pasoi Konferencën e Paqes në Paris. A është kjo kërkesë e tepërt? Unë mund t'ju siguroj se një deklaratë kaq e drejtpërdrejtë do të përshpejtonte rrahjen e zemrave të një milioni e më shumë njerëzish të këtij populli kaq të dashur, kaq të vuajtur dhe kaq gjatë në kohë të përndjekur.

Unë jam zotëri, me respekt të thellë i Juaji,

Charles Telford Erickson

Letër nga G.S Freeman[226]

7023 Empire State Building

New York, 1 New York,

4 mars 1952

Drejtuar z. C. Telford Erickson*,*

Frary Von Blomberg, C.S.Freeman, Hugh G. Grant [227]*, Nuçi Kota*[228]

Zotërinj,

Kjo është kopje e letrës, dërguar saktësisht më 29 prill 1952, drejtuar secilit prej katërmbëdhjetë emrave në adresat shoqëruese. Letra origjinale e nënshkruar prej katër të sipërpërmendurve gjendet në dosjen e kësaj zyre. Të gjitha letrat janë dërguar nga kjo adresë:

Komiteti Shqiptar për një Shqipëri të Lirë dhe të Pavarur.

233 Marlbourough Street

Boston, Massachusetts

[226] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 13.

[227] Hugh Grant, diplomat amerikan, ministër fuqiplotë në Tiranë që prej vitit 1935 deri në vitin 1939. Ai ishte një simpatizant i popullit shqiptar dhe ka botuar një libër me kujtime me titull "Mbreti Zog, ashtu siç e kam njohur". (Shënimi im – MB)

[228] "The ACEN" drejtohej prej Nuçi Kotës, komandanti ushtarak i Zogut, i cili e udhëhiqte komitetin "Free Albania" dhe themeloi Komitetin Kombëtar Shqiptar (Albanian National Committee). (Shënimi im – MB)

Letra: (29 prill 1952) [229]

Duke ditur se Shqipëria është tani për tani e burgosur dhe e vënë pas perdes së hekurt komuniste, personat e nënshkruar u takuan në New York me datat 28-29 prill 1952, me qëllim që të bëjnë plane për një aktivizim të mëvonshëm të Miqve Amerikanë të Popullit Shqiptar.

Qëllimi i përpjekjeve tona është të japim ndihmesë në drejtim të restaurimit të plotë të integritetit politik dhe territorial të Shqipërisë dhe popullit të saj. Gjithashtu ne e kuptojmë se pozicioni strategjik i Shqipërisë në Ballkan dhe në tërë zonën mesdhetare e bëjnë atë një vend të veçantë për botën perëndimore.

Ne jemi mirënjohës që keni pranuar të na bashkoheni në këtë objektiv të vlefshëm dhe do të deshëm të dinim nëse ju e ndieni se mund ta gjeni të mundshme të ndiqni një mbledhje të një komiteti të plotë në Washington DC në fund të prillit ose në fillim të majit? Nëse arrihet kjo, ne do të mirëprisnim sugjerimet se kur do të ishte koha më e përshtatshme për ju.

Në qoftë se për ndonjë arsye, ju nuk do të mund të ndiqni një mbledhje të tillë, ne shpresojmë të paktën të marrim ndonjë këshillë apo ndihmesë prej jush. Një përgjigje e kthyer në adresën e mësipërme në kohën më të përshtatshme do të ishte shumë e mirëpritur.

Robert D. Abrahams[230]

Harry W. Ayers

Louis Bromfield[231]

---

229 Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 13.

230 Roger D. Abrahams ishte një antropolog, folklorist, ish-president i Shoqërisë Amerikane të Folklorit.

231 Louis Bromfield ka studiuar bujqësi në Cornell University nga viti 1914 deri në vitin 1916. Më pas studioi në Columbia University për gazetari. Fitues i çmimit "Pulitzer" në vitin 1927. Ai ka botuar 30 libra të cilat janë renditur si librat best seller në kohën e botimit të tyre.

Robert E. Burns [232]

James Cagny[233]

Cyril Coleman

John D. Dingell[234]

John B. Hynes[235]

William Lester

Richman S. Margeson

Philip J. Philbin[236]

Samuel W. Yorty[237]

Luther W. Youngdahl [238]

[232] Robert E. Burns, i lindur në New Jersey ishte botues i Greater Chicago Magazine.

[233] James Francis Cagney Jr. 1899 – 1986, aktor filmash amerikan. Në vitin 1999, Instituti i Filmit Amerikan e ka renditur me artistët meshkuj më të mëdhenj të të gjitha kohërave.

[234] John David Dingell, Jr. 1926 kongresmen i Miçiganit në vitin 1955.

[235] John B. Hynes (1897–1970), politikan nga Massachusetts dhe kryetar i bashkisë në vitet 1950-1960.

[236] Philip Joseph Philbin, (1898-1972) kongresmen demokrat nga Massachusetts. Ai studio në Universitetin Harvard dhe më pas në Universitetin Kolumbia.

[237] Samuel William Yorty (1909 – 1998), politikan nga Los Anxhelos, Kaliforni. Ai ishte kongresmen i ShBA-së dhe i asamblesë së shtetit të Kalifornisë.

[238] Luther W Youngdahl: Guvernator i Minnesotas, 1947-51. (Shënimet e mia – MB)

CHARLES TELFORD ERICKSON

Claremont, Kaliforni,

10 qershor 1954[239]

Dërguar John Foster Dulles[240]

Sekretar i Shtetit,

Uashington DC

I dashur z. Dulles,

I nderuar z. Sekretar Dulles,

Duke ju shkruar këtë letër, nuk dëshiroj t'ju shtoj shqetësime të tjera për situatën që mbretëron në botën e sotme dhe t'ju bëj barrë edhe problemet e një kombi tjetër. Por, përsëri, duke kaluar shumicën e jetës sime në një prej qendrave më të trazuara të globit, mund të mos jetë krejt pa vend t'ju drejtohem për këtë çështje.

Më duket se koha ka ardhur që të rikonsiderojmë me shumë kujdes tërë situatën botërore në të cilën e gjejmë vetveten si "Gardianë të botës së lirë" kundër botës komuniste. Franca duket se është gati të hidhet në rehatinë e saj pa ia bërë as çak, as bam. Britania, duke pas humbur perandorinë e saj, po tregon se i është kthyer edhe një herë rolit të tregtarit në "Tokën e gjelbër dhe të këndshme të Anglisë". Evropa është në tranzicion dhe ëndrra e profetit për një Evropë të Bashkuar është zbehur deri tek një shpresë e venitur.

---

[239] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 14.

[240] John Foster Dulles (1888 – 1959) ishte Sekretar i Shtetit në administratën e Presidentit Dwight D.Eisenhower nga viti 1953 deri në vitin 1959. Ai ishte një figurë qendrore në periudhën e Luftës së Ftohtë dhe mbronte një qëndrim të ashpër ndaj komunizmit në tërë botën. (Shënimi im – MB)

Komunizmi nuk është një institucion dimensional konkret, por një forcë shpirtërore. Ai përbën një forcë që ka shpërthyer për të mbushur boshllëkun që ka krijuar një protestantizëm ngecës, sipërfaqësor, i botës perëndimore. Demokracia është trashur dhe dembelosur dhe si një Moab ka "rënë në fundërrinë". Komunizmi, ndërkohë, e ka rritur forcën e tij të uraganit dhe Shtetet e Bashkuara, së bashku me Evropën, qëndrojnë sot para rrezikut të afërt: ose të një izolimi të plotë, ose të një kompromisi tragjik, që në fund të fundit të bën të dorëzohesh. Me një fjalë anija e shtetit tonë ka hyrë në zonë me "mot të keq". Prandaj është zgjuarsi që, sa më parë të dalim nga kjo zonë, aq më mirë do të jetë.

Do të ishte madje pjesë e zgjuarsisë të dëgjohen këshillat e burrave tanë të hershëm të shtetit, edhe pse këtë nuk e kemi bërë në të kaluarën, si Herbert Huveri dhe të shpëtojmë prej skrapit dhe pergamenës së vjetër e të zverdhur, të njohur si "Doktrina Monroe"[241].

Me respekt i Juaji

Charles Telford Erickson

[241] Doktrina Monroe është një politikë e SHBA-së e paraqitur me datën 2 dhjetor 1823. Doktrina ndalonte kolonizimin e mëtejshëm të territoreve të tjera nga fuqitë evropiane në Amerikën Veriore dhe Jugore. Ajo ndalonte gjithashtu ndërhyrjen amerikane në çështjet e brendshme të vendeve të Evropës. (Shënimi im – MB)

DEPARTAMENTI I SHTETIT

Uashington

12 gusht 1954

Në përgjigje të referencës SEV 611.00/7 – 154

I dashur zoti Erickson,

Besoj se do të na ndjesh për vonesën në dhënien e përgjigjes ndaj letrës suaj dërguar Sekretarit Dulle më 1 Korrik. Ne i vlerësojmë mendimet tuaja të hedhura në këtë letër.

Ndoshta ju intereson letra dërguar nga nënsekretari Marchant, në të cilën kemi diskutuar politikën ndaj vendeve që janë nën dominimin sovjetik.

Sinqerisht i Juaj

Howard A. Cook

Shef i divizionit të shërbimit publik

Bashkëngjitur letra.[242]

[242] DASH, Koleksioni i dokumenteve SEV 611.00/7 – 154 - Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 15.

DEPARTAMENTI I SHTETIT[243]

Uashington DC

20 gusht 1954

I dashur z. Erickson

Sekretari Dulles më ka ngarkuar t'ju falënderoj për letrën tuaj të datës 29 qershor në lidhje me mundësitë e programeve të shkëmbimit me Shqipërinë. Interesi juaj për t'i bërë pikëpamjet tuaja të disponueshme është shumë i mirëpritur.

Ka pasur një politikë tradicionale të qeverisë tonë për të favorizuar shkëmbimet më të gjera të mundshme të personave me kombësi të tjera në interes të miqësisë dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Shtetet e Bashkuara po vazhdojnë të këmbëngulin për zgjerimin e kontakteve me vendet e bllokut sovjetik, bashkë me linjën e 17 pikave të propozuara, të përcjella vitin e kaluar në takimin e ministrave të jashtëm të Gjenevës, prej shteteve perëndimore.

Gjithsesi, më duhet të theksoj se Shtetet e Bashkuara nuk e njohin regjimin e sotëm në Shqipëri dhe nuk mbajnë marrëdhënie diplomatike me atë vend. Si rrjedhojë, kjo situatë përjashton mundësinë e marrjes në konsideratë të çfarëdo programi shkëmbimi me Shqipërinë.

Sinqerisht i juaji

John P. Meagher

Shef i Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun

[243] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 16.

MIQTË AMERIKANË TË LINDJES SË AFËRT[244]

New York, 17 prill 1956

Dr. Charles Telford Erickson

680 West Eighth Street

Claremont, Californi

I dashur dr. Erickson

Faleminderit për letrën që më dërgove më 8 prill 1956, në të cilën ju, në mënyrë kaq të sjellshme, na ofruat të çojmë më tej çështjen e Miqve Amerikanë të Lindjes së Mesme. Është jashtëzakonisht e këndshme për ne të kemi mbështetjen e një personi kaq të shquar si ju. Duke njohur disa shqiptarë të fesë myslimane, unë vetë jam i interesuar për mbarëvajtjen e tyre dhe do të mirëprisja të dëgjoja prej jush gjëra edhe më të detajuara rreth punës që keni bërë atje.

Siç jeni i njohur ndoshta, në një përpjekje për të pasur një kuptim më të qartë të amerikanëve për Lindjen e Mesme, AFME sjell afërsisht çdo vit dhjetë vetë të shquar nga Lindja e Mesme në Shtetet e Bashkuara, me qëllim që të bëjnë një turne kombëtar dhe të japin leksione. Programet e leksioneve dhe angazhimet në fjalime janë rregulluar në mënyre rajonale prej anëtarëve të AFME-së, organizata mike dhe njerëz si puna Juaj. A do të dëshironit të ndihmonit AFME-në për të rregulluar programe të tilla kur miq të Lindjes së Mesme të planifikohen për të vizituar zonën tuaj?

[244] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 17.

Duke e mbyllur, më lejoni t'ju falënderoj edhe një herë për interesin dhe ofertën e këndshme për të ndihmuar. Mezi pres të dëgjoj sërish prej jush.

Sinqerisht i Juaji

Virgil C. Crippin

Drejtor

BORDI AMERIKAN

PËR KOMISIONERËT E MISIONEVE TË HUAJA

14 Beacon Street, Boston 8 Massachusets

4 dhjetor 1959[245]

Rev. Charles Telford Erickson

680 W. Eight Street

Claremont, Kaliforni[246]

I dashur dr. Erickson,

Jam duke shkruar një material të shkurtër mbi Shqipërinë dhe do të desha ta punoja me ju, Kenedët dhe të tjerë që punuan atje nga viti 1908 deri në vitin 1922. Unë kam një letër nga znj. Kenedi, shkruar më 31 tetor 1922, e cila jep një histori të shkurtër të misioneve në Shqipëri. Por do të desha të kisha më shumë informacion dhe referenca që mund të më jepnit ju. Unë po ju dërgoj bashkëngjitur një kopje të letrës së saj dhe do të desha që ju të komentoni mbi të dhe të na jepni sa më shumë informacion. Nuk po ju kërkoj një dokument të gjatë, por shënime të tilla të cilat ju i mendoni se do të na hynin në punë. Këto janë pyetjet:

1. *A mund të na tregoni për rezultatet e punës së misionit atje dhe t'i ilustroni ato?*
2. *A keni ndonjë dijeni për bashkësitë protestante midis shqiptarëve në Shqipëri sot?*

[245] Erickson Collection,Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 18.

[246] Kjo është adresa e fundit në të cilën jetoi Ericksoni, derisa vdiq në vitin 1966.

3. A jeni në kontakt me ndonjë grup shqiptarësh protestantë në Amerikë?

E kam rilexuar serinë e dr. Bartonit "Free Albania", të botuar në tetor 1913. A do të komentonit diçka edhe mbi aspekte të tjera të atyre çfarë paraqiten aty?

Me dëshirat më të mira

I juaji sinqerisht

Fred Field Goodsell

BARON FRARY FON BLOMBERG

111 Exeter Road

Hampton, N.H.

17 shkurt 1961

Drejtuar: z. Telford Erickson

Connecticut

North Quaker Lane[247]

West Hartford

I dashuri im Erickson,

Szpo kam ardhur nga një udhëtim tjetër tek Naltmadhnia e tij Mbreti Zog dhe Mbretëresha Geraldinë. Ata më folëm edhe për kujtimet e tyre për Ju. Do të desha të di nëse ju jeni ende në Hartford, pasi do të mbaj një fjalë në Torrington më 6 Mars. Ndoshta mund të takohemi përsëri.

Me dëshirat e mia më të mira,

I Juaji

Baron Frary Fon Blomberg[248]

---

[247] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 19.

[248] Kjo letër dëshmon se Ericksoni njihej me aq shumë njerëz që kishin lidhje me Shqipërinë. Baroni Fon Bloomberg ishte një figurë tejet interesante, i cili kishte lidhje me oborret mbretërore të shumë e shumë vendeve. Ai është fitues i çmimit Who is Who, siç është edhe vetë Ericksoni. Ai drejtonte dhjetëra organizma ndërkombëtarë, që kishin të bënin me qeveri në arrati. Ai merrej me palestinezët, sudetët, polakët, armenët, gjeorgjianët, grekët. Ai kishte lidhje me Mbretin e Egjiptit, Farukun, dhe në një periudhë të caktuar ishte Sekretar i Komitetit Amerikan për një Shqipëri të Lirë. (Shënimi im – MB)

BARON FRARY VON BLOMBERG

111 Exeter Road

Hampton, N.H.

March, 17, 1961

Zonjës Telford Erickson

680 West 8th Street

Claremont, California[249]

E dashur zonja Erickson,

Jam shumë i interesuar për letrën tuaj, të cilën e përcolla tek Naltmadhnia i tij. Familja mbretërore jeton tani në rrethinat e Parisit dhe mbreti gjithmonë e kujton bashkëshortin tuaj me vlerësimin më të lartë.

Me aq sa mund të kujtoj, unë kisha kënaqësinë ta takoja burrin tuaj tek Mbreti Zog. Jam kaq i lumtur kur dëgjoj se në një moshë kaq të thyer, z. Erickson është ende mirë dhe, me shpresë të Zotit, besoj se do t'ju takoj ndonjë ditë kur të jem në Kaliforni.

Duke ju uruar çdo gjë të mirë dhe me falënderime për mirësinë që keni pasur duke më shkruar,

I Juaji,

Baron Frary Von Blomberg

[249] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 13.

PAUL MOJZES

Pine Street

Dover, Massachusets, 02030

19 nëntor 1963

Rev. Charles Telford Erickson

680 W.Eighth Street Clearmont

Kaliforni[250]

I dashur Rev. Erickson,

Jam një ish-metodist jugosllav, që studioj në Universitetin e Bostonit, dhe po bej doktoratën me temën: "Historia e kishave kongregacionale në Bullgari, Hungari dhe Jugosllavi". Edhe pse ky disertacion nuk e përmend Shqipërinë, unë po e trajtoj atë nën emrin e Turqisë Evropiane.

Po ju drejtohem sepse kam gjetur material rreth veprimtarisë së Kenedëve dhe tuajën në Shqipëri.

Çdo gjë që mund të më dërgoni është shumë e mirëpritur. Unë lexoj serbo-kroatisht, bullgarisht dhe gjermanisht, por jo shqip.

Sinqerisht i juaji

Peter Mojzes

[250] Erickson Collection,Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 21.

UNIVERSITETI MINNESOTA

Kolegji i Artit Liberal

Departamenti i Historisë Minneapolus – Minossota

28 shtator 1965

Drejtuar Dr. Charles Telford Erickson

680 8th Street Claremont[251]

Kaliforni, 91711

I dashur z. Erickson,

Në Boston, zoti Josif Panariti më tregoi tani vonë rreth punës suaj të gjatë në Shqipëri si dhe për punën e bërë në programin arsimor që ju keni drejtuar atje. Isha në Boston për të marrë në ruajtje letrat e Peshkopit Noli dhe nëse është e mundur të sistemoj dokumentacionin e emigrantëve të Evropës Lindore dhe Juglindore në Shtetet e Bashkuara.

Ne jemi shumë të interesuar për punën e misionarëve amerikanë, siç jeni juve, për përgatitjen e njerëzve nga bota e vjetër apo fëmijët e tyre që erdhën në botën e re, apo thjesht edhe për ata që shpërndanë kulturën amerikane. A mund t'ju pyes nëse i keni vendosur ende dokumentet tuaja në ndonjë arkiv universitar, në mënyrë që edhe të tjerët t'i shfrytëzojnë ato për studime në të ardhmen?

Më duhet t'ju kujtoj se asnjë dokument i juaji, i sjellë nga Shqipëria, nuk më duket i parëndësishëm. Ne jemi jashtë mase të interesuar të njihemi me dokumentet për

[251] Erickson Collection,Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 22.

njerëz, të cilët ju i keni përshkruar në letrat tuaja. Ne duam të dimë sa më shumë për shqiptarët që keni njohur atje, si dhe për ata që kanë ardhur e jetojnë këtu.

A thua do të marr ndonjë lajm prej teje mbi këtë çështje? Një ose më shumë njerëz nga ekipi ynë do të udhëtojnë për Kaliforni dhe do të kishin kënaqësinë të bisedonin me juve rreth kësaj çështjeje.

Juaji shumë sinqerisht

Timothy L. Smith

Profesor i historisë

Drejtor i komitetit të bibliotekës së emigrantëve

UNIVERSITETI MINNESOTA

Kolegji i Artit Liberal

Departamenti i Historisë Minneapolus – Minossota

15 nëntor 1965[252]

Zonjës Telford Erickson

680 West 8th Street

Claremont, California 91711

E dashur zonja Erickson

Shumë falënderime për përgjigjen që më dhatë më 6 nëntor. Sigurisht që më vjen keq që mësova që as pamflete, as letra, as materiale të tjera që kanë të bëjnë me punën e Erickson-it në Shqipëri nuk janë ruajtur. Unë mora iniciativën dhe i shkrova Bordit Amerikan për të parë nëse dosjet e korrespondencës apo raporte të tij të ruajtura përmbanin punën e tij, në mënyrë që emri i tij të mos humbasë kur të vija dita që historianët e Shqipërisë të merren me figurën e tij.

Në ndërkohë, a mund t'ju siguroj se doreshkrimi mbi Historinë e Shqipërisë, të cilin e ka përgatitur z.Erickson, edhe nëse nuk ka aq shumë interes për t'u botuar, në të ardhmen do të jetë i një interesi të konsiderueshëm për studiuesit, të cilët do të kërkojnë të kuptojnë më së miri historinë e atij vendi.[253] *Nisur nga kjo, nëse ai ose ju do të dëshironit ndonjëherë të bëheshit pjesë e tij, ne do të ishim të lumtur të kujdeseshim për ruajtjen e përhershme si një pjesë e arkivit tonë të emigrantëve këtu.*

I juaji shumë sinqerisht

[252] Erickson Collection,Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 23.

[253] Vini re rëndësinë dhe vëmendjen e treguar ndaj veprës së Ericksonit mbi Historinë e Shqipërisë.

Timothy L. Smith

Profesor i historisë

Drejtor i komitetit të bibliotekës së emigrantëve

FEDERATA PANSHQIPTARE E AMERIKËS VATRA

115 Petersboroug Street

Boston, Mass. 02215

19 janar 1967[254]

E dashur zonja Erickson,

Lajmi për humbjen e burrit tuaj të dashur, në ditët e Krishtlindjeve, na pikëlloi pa masë. I vetmi ngushëllim që kemi është se burri juaj jetoi një jetë jashtëzakonisht të bukur dhe të vlefshme, pothuajse e tëra në shërbim të popullit shqiptar. Mund të thuhet pa frikë se ai do të kujtohet si një prej themeluesve të Shqipërisë moderne.

E kam takuar doktor Erickson-in në Durrës, në verën e vitit 1914. Në atë kohë vendi ishte plot e përplot me trazira. Që prej asaj kohe i kam mbajtur lidhjet me të. Në kohën kur ai mblidhte fonde për Shkollën e Kavajës, takoheshim shpesh në Boston. Në shumë raste e kam intervistuar për gazetën "Christian Science Monitor" për punën e shkëlqyer që bënte. Më kujtohet se sa e lumtur dhe e kënaqur ishte bashkësia shqiptare në këtë vend kur merrte vesh për këto kontribute për mëmëdheun e tyre.

Në vitin 1945 unë bëra çmos që ai të "emërohej" në Konferencën e San Franciskos, aty ku po shqyrtohej Karta e Kombeve të Bashkuara. Ai ishte i vetmi vëzhgues i Shqipërisë në konferencë dhe shumë gazeta e lëvduan për veprimtarinë e tij në dobi të atdheut të tij të dytë, Shqipërisë.

Kur shoh prapa në këto 52 vjet trazirash, e gjej të pamundur t'i gjej fundit punëve të panumërta që ai ka bërë për popullin shqiptar, në daç si udhëheqës shpirtëror, edhe si diplomat dhe edukator. E kam të pamundur të them dot se çfarë vendi të madh ka pasur ai në jetën time personale.

[254] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 24.

Sarah, ime shoqe, u bashkohet ngushëllimeve dhe simpatisë më të thellë, pasi ne të dy ndiejmë se kemi humbur një mik shumë të vlefshëm.

Ne shpresojmë se ju do të gjeni mundësitë t'i mbani lidhjet me ne.

Sinqerisht

G.M.Panariti

Shënim: Shpresoj se ju do të gjeni biografinë e tij, pasi më mundon shumë ideja se ajo është harruar diku ose edhe ka humbur fare. Unë e di që Vatra do ta vlerësonte pa masë dërgimin e çdo kopjeje shtesë të librit "Little Man and the Cosmos"[255]. Adresa është: 25 Huntington Avenue, Rm. 412A, Boston Mass. 02116

[255] Titulli i këtij libri përmendet shumë herë, por deri tani nuk kemi rënë në gjurmë të tij.

G.M.PANARITI

115 Petersboroug Street

Boston, Mass. 02215

2 mars 1967[256]

E dashur zonja Erickson,

Ju treguat vërtet bujari kur dërguat ato njëqind dollarë për fondacionin edukativ të "VATRËS", në kujtim të burrit tuaj të shquar, i cili ka dhënë aq shumë dhe për aq shumë kohë për edukimin e shqiptarëve. Shkolla që themeloi ai në Kavajë ishte si një fener që ndizet në një horizont të errët. Ajo ende ndriçon dhe qëndron si një monument për një numër të madh burrash e grash, të cilët kanë pasur fatin e mirë ta ndiqnin atë në vitet '20.

Më takon që rastësisht të takoj ish-studentë të Shkollës së Kavajës në bashkësi të ndryshme shqiptare, këtu, dhe kur iu tregoj se e kam njohur personalisht z. Erickson, ata menjëherë shprehin dashuri dhe admirim të jashtëzakonshëm për të.

Jam i sigurt se ata do të marrin pjesë në Mardi Gras Ball[257] *më 10 të këtij muaji dhe personalisht do të shpreh mirënjohjen e tyre për kontributin tuaj bujar.*

Janë disa njerëz që kanë ndikuar në jetën time. Dr. Erickson është njëri prej tyre. Çdo herë që vinte në Boston për t'u takuar me miqtë e tij amerikanë, për punën që bënte në Shqipëri, ai kurrë nuk harronte të më ftonte e të takoheshim.

---

256 Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 24.

257 Mardi Gras Ball është një mbrëmje formale që organizohet për anëtarët dhe miqtë të saj. Ajo përbëhet nga një oborr mbretëror me mbret dhe mbretëreshë, me duka dhe dukesha, të veshur me rroba tradicionale. Sipas Arthur Burton-it ajo është mbajtur për herë të parë në vitin 1857 prej Comus, në Gaiety Theatre, i thirrur më vonë si Teatri Variete. (Shënimi im – MB)

Në një rast, për ta nderuar Erickson-in, miqtë e tij amerikanë të Bostonit, të shoqatës së quajtur "20th Century Clup of Beacon Hill", shtruan një banket. Ai ishte i vetmi folës i mbrëmjes. Unë isha i vetmi shqiptar i pranishëm. Më kujtohet edhe sot e kësaj dite biseda e tij elokuente mbi karakterin e popullit shqiptar. Ndërkohë që ai po tregonte me pasion se sa perandorë romakë kishin prejardhje shqiptare, një amerikan, i cili ishte ulur pranë meje, pëshpëriti:

"Nëse vazhdon të flasë edhe më tej për këtë çështje, jam i sigurt se më në fund do na bindë se edhe Xhorxh Uashingtoni ka qenë pjesërisht shqiptar!"

Unë e mbaj gjallë kujtimin e tij dhe ikja e tij nga kjo jetë për mua ishte një humbje personale. Por unë ngushëllohem prej faktit se ai jetoi një jetë tejet të dobishme.

Edhe Sarah edhe unë shpresojmë se ju do t'i mbani lidhjet me ne.

I juaji sinqerisht,

G.M.Panariti

UNIVERSITETI I SIRAKUZËS

Zëvendësdrejtori i Bibliotekës për Koleksionet e Veçanta

29 prill 1968[258]

Zonjës Telford Erickson

680 West 8th Street

Claremont, California 91711

E dashur zonja Erickson,

Faleminderit për letrën tuaj të prillit, në përgjigje të kërkesës sonë në lidhje me letrat e bashkëshortit tuaj. Na vjen kaq keq që korrespondenca dhe letrat që dokumentojnë karrierën e shquar misionare të burrit tuaj nuk janë në dispozicionin tonë për një studim të koleksionit. Do të deshëm shumë t'ju kishim shërbyer me këtë.

Me dëshirat më të mira,

Përzemërsisht i Juaji,

Howard L. Applegate[259]

[258] Erickson Collection, Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 13.

[259] Howard L. Applegate, arkivist i njohur amerikan i dorëshkrimeve dhe letrave të rralla.

UNIVERSITETI MINNESOTA

Kolegji i Artit Liberal

Departamenti i historisë Minneapolus – Minossota

1 maj 1968[260]

Mrs. Telford Erickson

680 West 8th Street

Claremont, California 91711

E dashur zonja Erickson,

Ju falënderoj nga zemra që më dërguat një kopje të materialit, "Tëhuajtja ime nga qytetërimi"[261] *për Arkivin e Emigrantëve. Kur arriti kjo disa muaj më parë, i lexova shënimet e burrit tuaj, rreth përvojës së tij në Shqipëri, dhe e gjeta atë si një prej tregimeve më mbresëlënëse. Ju jemi shumë mirënjohës për dërgimin e këtyre materialeve.*

Dje mora letrën ku më premtonit se do të më dërgoni një kopje të korrigjuar. Kur të arrijë, siç më keni kërkuar, unë do t'ju kthej juve kopjen tjetër përveç faqes së parathënies.

I juaji me besë

Austin McLean

Shef i koleksioneve të veçanta

[260] Erickson Collection,Yale University Divinity School Library, Group 26, Seria no 6, Box No 3, Folder No 26.

[261] My retreat from Civilization, material i shkruar nga Alice Lee Welsh – Erickson, gruaja e dytë e C.T Erickson, pas vdekjes së të shoqit, me një përmbledhje të tregimeve, shkrimeve dhe kujtimeve të tij dhënë për ruajtje Universitetit Minnesota me kërkesën e kësaj të fundit, siç shihet në materialin e mësipërm. Ky libërth është përkthyer nga Abdullah Karaabdiu dhe është botuar në shqip në Tiranë.

NDERIM NGA FEDERATA PANSHQIPTARE E AMERIKËS VATRA FILL PAS VDEKJES[262]

Në të gjitha shkrimet dhe korrespondencën e Charles Telford Erickson-it del se ai gëzonte një respekt dhe mirënjohje të veçantë nga Vatra dhe vatranët. Këtë sidomos e shpreh korrespondenca e tij me Qerim Panaritin, një nder drejtuesit dhe kryetarët e "Vatrës", i cituar deri tani disa herë. Më datën 1 shkurt 1967 Qerim Panariti shkruan një artikull të gjatë për Erickson-in në të cilin nënvizon veprimtaritë e tij në mënyrë kronologjike në dobi të Shqipërisë. Në fillim të shkrimit ai thotë:

> *Dr. Charles Telford Erickson-i, i cili ndërroi jetë në moshën 99-vjeçare në Claremont, Kaliforni, më datën 26 dhjetor të vitit që sapo lamë pas, ishte një burrë gjenial i shumanshëm, predikues, misionar, diplomat, edukator dhe poet, i cili ia kushtoi thuajse tërë jetën çështjes së nxjerrjes së Shqipërisë dhe popullit të saj nga errësira mesjetare.*

Pasi përshkruan biografinë e tij që nga lindja, ai ndalet tek momentet më të rëndësishme të jetës së Erickson-it, të cilat tashmë janë përmendur në rrjedhë të faqeve të këtij libri dhe shton:

---

[262] Dr. Charles Telford Erickson: Friend of Albania, gazeta "DIELLI", Boston, datë 1 shkurt 1967.

Kur përfundoi lufta, dr. Erickson-i u angazhua nga Federata Panshqiptare Vatra e Amerikës, me qendër në Boston, që të mbronte interesat e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Versajë. Pozita e Shqipërisë në konferencë ishte e dëshpëruar. Në të vërtetë, fuqitë aleate – Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Rusia, tashmë kishin vendosur nëpërmjet Traktatit të fshehtë të Londrës, të nënshkruar në vitin 1915, ta fshinin Shqipërinë nga harta. Ishte Presidenti Wilson i cili qëndroi i vetëm midis jetës dhe vdekjes së Shqipërisë.

Ishte detyra e dr. Erickson-it që ta çonte çështjen shqiptare deri tek veshi i Presidentit Wilson. Në këtë sipërmarrje të vështirë ai kishte pengesa pa fund. Presidenti ishte i angazhuar në misionin e tij mesianik, që "ta bënte botën të sigurt e demokratike". Por koha e tij ishte tejet e racionuar dhe ai e kishte tejet të vështirë të priste një misionar të thjeshtë dhe të bisedonte me të. Në këto kushte të rënda dr. Erickson-i i kërkoi takim zonjës Wilson dhe ia arriti kësaj. Ai i parashtroi asaj fakte dhe shifra rreth Shqipërisë dhe iu përgjërua që t'ia transmetonte të tëra ato bashkëshortit të saj. Dhe ajo kështu bëri.

Presidenti Wilson nuk humbi kohë për t'i informuar kolegët e tij të Konferencës së Paqes se nuk mund të bëhej asnjë lloj ndryshimi kufijsh në hartën e Ballkanit në kurriz të Shqipërisë.

Kur deklarata e Presidentit Wilson doli në shesh, shtypi grek filloi të çirrej se "Misionarët amerikanë" po minonin kërkesat greke në Jug të Shqipërisë. Z. Wilson dhe i tërë delegacioni amerikan qëndruan të vendosur dhe Shqipëria shpëtoi. Kështu që nga gushti i vitit 1922 Shqipëria ishte e lirë nga pushtuesit e huaj dhe në dhjetor të atij viti iu bashkua familjes së madhe, si anëtare e Lidhjes së Kombeve.

Më pas kryetari i "Vatrës", Qerim Panariti vijon me shpjegimet rreth aktivitetit të dr. Erickson-it në Shkollën e Kavajës. Pasi jep një pasqyrë të kohës dhe mënyrës se si u ndërtua ajo, ai shton se studentët e tij, një pjesë e të cilëve kishin vajtur në ShBA, e kujtojnë atë me nderim e dashuri si një figurë karizmatike. Më pas ai shton:

Dr. Erickson-i u mor me poezi dhe në vitin 1957 botoi librin me vjersha: "Njeriu i vogël dhe kozmosi". Panariti shton se filozofia e Erickson-it mund të kuptohet në këtë strofë:

Rruga ime, e vështirë si një shteg alpin,
Rreziqet e rëndojnë të rëndin mundim,
Armiqtë e mi janë mbushur me tërbim,
Duan të ndalin mbërritjen time, me mëri,
Por unë shoh larg, larg, përsëri,
I sigurt si përherë se një ditë do të arrij,
Po, do të arrij!

Kjo mbyllje që i bën shkrimit patrioti i madh Qerim Panariti, nëpërmjet vjershës së Erickson-it na jep edhe kuptimin e tërë asaj që ky njeri bëri për Shqipërinë.Viteve të fundit jo rrallë janë botuar artikuj për jetën e Charles Telford Erickson-it. Ndër ta do të veçoja, për vërtetësinë e tyre, ato të botuar nga prof.dr. Uran Asllani. Artikujt e tij, në një farë mënyre, e kanë mbajtur opinionin shqiptar të informuar për veprimtarinë e Erickson-it në Shqipëri. Por për të patur një ide edhe më të qartë për figurën e tij, puna vijoji jo vetëm me kërkimet nëpër arkiva, por edhe me të gjallët, miqtë dhe pasardhësit e tij...

TAKIMI IM ME ERICKSON-ËT "PAS 100 VJETËSH"

Këtu mbyllet cikli i letrave dhe korrespondencës së Erickson-it, të paktën ato që arrita të mblidhja deri tani. Shpresoj që në një të ardhme do të gjenden edhe të tjera. Por paralel me mbledhjen, përkthimin dhe sistemimin e veprës së Charles Telford Erickson-it, u desh të kërkoja edhe për ndonjë pasardhës të mbetur nga familja e tij.

Në njoftimin për vdekjen e tij të botuar nga kisha e Claremont Pelgrim Place[263] në Kaliforni, thuhej se ai ka lënë pas gruan e tij Alice Welsh Erickson, të birin Paul Erickson, dhe tri vajzat e tij, në tri shtete të ndryshme të Amerikës. Pas një odiseje shumë të gjatë dhe përpjekjesh të panumërta për të rënë në kontakt me ta, falë ndihmës së dhënë nga patrioti i madh, shqiptaro-amerikani At Arthur Liolin, arrita të lidhem fillimisht me Donald Johnson-in, i biri i Grace Elizabeth Johnson – Erickson. At Liolini kishte patur njohje dhe lidhje të hershme me këtë familje dhe më datë 31 gusht 2012 më njoftoi me një e-mail, të cilën po e rendis këtu ashtu siç e dërgoi ai:

[263] Obituary of Charles Telford Erickson, Kingman Chapel, Claremont United Church of Christ Congregational Archive. 26.12.1966.

I dashur Mal,

Ka Perëndi! E gjeta nipin e Telford-it. Don J. Johnson. Është 60 vjeç. Jo vetëm kaq, por Doni më tha se nëna e tij, Grace Erickson – Johnson, rron! Ajo është 101 vjeç dhe e ka mendjen. Ndodhet në një shtëpi për pleqtë jashtë Bostonit. E kam lajmëruar për punën tënde të mrekullueshme për gjyshin e tij. Doni më tha se ka dy vëllezër dhe dy motra, si dhe disa kushërinj (nipër dhe mbesa të Telford-it) me banim në Montana, Idaho dhe Alaska. Ai do të më dërgojë kontaktet e të gjithëve, e-mailet, adresat e banimit sa më shpejt, dhe unë do t'i dërgoj ty. Më vjen gëzim për t'ju informuar për këto të dhëna….

I juaji,

Artur

Kështu, falë ndihmës së dhënë nga At Arthur Liolini u lidha me tërë nipat e mbesat e Charles Telford Erickson-it. Ata kanë qenë plot dymbëdhjetë, nga të cilët jetojnë:

Christel Stoll, Patricia Prestegaard, Faye Alverson, Robert Johnson, Paul Erickson Jr., Mary Alice Morris, Peter Johnson, Don Johnson, Charles Hurrey.

Unë i ftova ata që të vijnë e të marrin pjesë në përurimin e librit në Tiranë. Tre prej tyre, Paul Erickson Jr., Donald Johnson dhe Mary Alice Morris do të marrin pjesë. Ata do të jenë aty kur t'i vihet emri i gjyshit të tyre Shkollës Kombëtare të Bujqësisë në Kavajë, që ai vetë e themeloi: *"Shkolla bujqësore Charles Telford Erickson"*. Po ashtu do të marrin edhe titullin *"Qytetar nderi i qytetit të Elbasanit"* për gjyshin e tyre.

Unë u kërkova atyre që të shkruajnë përmbylljen e këtij libri dhe ata me dashamirësi pranuan. Ja çfarë shkruanin ata për kujtimet që kishin për gjyshin e tyre, ose siç e quajnë të gjithë gjysh Erikun.

EPILOG ME KUJTIME NGA NIPËRIT DHE MBESAT E DR. CHARLES TELFORD ERICKSON, SHBA

20 SHTATOR 2012

Patricia Prestegaard

Unë jam Patricia, vajza e Christel Erickson-it. Nëna ime ka lindur në Tiranë – Shqipëri, më 12 korrik 1909 dhe është e bija e Carrie dhe Charles Telford Erickson-it. Gjyshi im, C.T. Erickson, njihej në brezin tim midis nesh dymbëdhjetë nipërve e mbesave si "Gjysh Eriku" Në pjesën e fundit të jetës së tij ai ishte një "dhuratë" e veçantë për mua, për shumë arsye.

Në rininë time ishte aventurë të udhëtoje me të me tren apo me taksi, për shkak se ai njihte disa gjuhë dhe i befasonte njerëzit duke iu folur, madje me dialekt, në gjuhët e tyre amtare, duke treguar interes ndaj tyre dhe duke marrë përgjigje, të cilat na çonin në biseda të ngrohta e gjithmonë me humor të këndshëm.

Ai më tregonte se si e kishte mësuar gjuhën shqipe. "Ishte populli shqiptar që ia mësoi atij gjuhën dhe jo përmes leximit të librave, për shkak se autoritetet turke kishin djegur madje edhe tekstet e gramatikës, për të detyruar njerëzit që të pranonin regjimin turk dhe gjuhën turke". Mungesa e librave i dha gjysh Erikut një mundësi për të ndërvepruar me shqiptarët drejtpërsëdrejti, personalisht, duke krijuar një respekt të dyanshëm shumë miqësor. Në fund, ai e fliste shqipen shumë më mirë se turqit.

Për këtë ata e morën atë për shqiptar, që kishte ardhur për të punuar kundër turqve i fshehur si amerikan. Prandaj e burgosën dhe ia dogjën librat e tij personalë dhe ata fetarë. Kjo ishte një përvojë tepër e hidhur dhe shkatërruese për të dhe familjen. Të njëjtën gjë bënë edhe serbët. Ata e burgosën dhe arriti të dilte i lirë vetëm falë një miku të tij austriak, që ishte konsull në Shqipëri. Ai u kthye në shtëpi, por u dëbua prej tyre me gjithë familjen dhe iku nga Shqipëria. Kur po largoheshin, shqiptarët krijuan rreshta të tërë në rrugë në shenjë nderimi e keqardhjeje që ata po largoheshin. Ishte diçka shumë ngazëlluese kur mora vesh për arritjet e mëdha të gjysh Erikut në Konferencën e Paqes në Paris, për mbrojtjen e tërësisë së shtetit shqiptar.

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, gjyshi ynë të gjithë vëmendjen e përqendroi në atë se si të përmirësonte sistemin arsimor të vendit. Ai mundi të fitonte mbështetjen e miqve të tij amerikanë për të ndërtuar një shkollë për të rinjtë shqiptarë në fushën e bujqësisë dhe ekonomisë shtëpiake. Unë gjithashtu mësova se gjysh Eriku ishte themeluesi dhe drejtori i parë i asaj shkolle.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj ndodhën shumë zhgënjime për popullin shqiptar. Vendi përsëri e humbi pavarësinë e më pas ra pas "Perdes së hekurt". Gjyshi ynë ndjeu një dhimbje të madhe për popullin shqiptar, i cili edhe një herë e gjeti veten në vështirësi të jashtëzakonshme. Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Dwight Eisenhower-i i kishte thënë gjysh Erikut se do ta emëronte ambasador të ShBA - së në Shqipëri nëse gjendja politike do të ishte ndryshe. Ekzistojnë disa burra dhe gra, përfshirë edhe gjyshin tonë, të cilët kurrë nuk heqin dorë nga shpresa dhe gjejnë një mënyrë për të vazhduar e punuar për ditë më të mira. Gjatë gjithë jetës, Shqipëria zuri një vend shumë të madh në zemrën dhe shpirtin e tij.

Një herë unë po luaja një rol kryesor në teatrin e shkollës në një pjesë që quhej "Zemrat tona ishin të reja dhe të gëzueshme". Gjysh Eriku erdhi për të parë aktrimin tim. Unë e dëgjova të qeshurën e tij të madhe. Më pas ai më tha: "Pat, nuk të kam njohur mirë deri në momentin kur të pashë të aktroje". Më pas ai më tha se ai vetë kishte luajtur rolin e Shylock-ut në veprën e Shekspirit "Tregtari i Venedikut"

në Shkollën Ungjillore në Yale. Drejtori i shkollës i kishte thënë atij: "Kam frikë se do të na ikësh nga kjo shkollë ungjillore". Por jo, gjysh Eriku e dinte që atij i kishte ardhur një thirrje nga Zoti dhe duket se ai e gjeti dramën dhe shprehjen e shpirtit të tij të gjallë mes njerëzve të vendit të tij të adoptuar, Shqipërisë.

Kur isha në vitin e dytë të universitetit, takova një studente tjetër që quhej Marna Cacossa, me origjinë shqiptare. Natyrisht unë i tregova Marnas për jetën e gjysh Erikut dhe punën e tij në Shqipëri. Ajo ishte anëtare e një grupi të krishterë dhe biseda jonë rreth Jezusit na ndihmoi që t'i forconim lidhjet tona. Më pas fillova një korrespondencë me gjysh Erikun në lidhje me besimin tim, gjë e cila vazhdoi për vite. Kështu që lidhja ime mes gjysh Erikut dhe besimit të krishterë filloi dhe u forcua përmes shoqes stime shqiptare, Marna.

Kur gjysh Eriku ishte 89 vjeç, erdhi që nga Kalifornia, Bregu Perëndimor i Amerikës, në New Jersey, në Bregun Lindor, për të marrë pjesë në martesën time. Aty ishin katër fëmijët e tij, Lois-i, Paul-i, Christel-i dhe Grace. Po ashtu ishin edhe disa nipër e mbesa. Ah po, të mos harroj, ishte edhe Marna Cacossa! Ne ishim të gjithë shumë krenarë për gjysh Erikun, i cili drejtoi edhe martesën e dy mbesave të tjera, më vonë.

Gjysh Eriku ka lindur në vitin 1867 dhe vdiq në vitin 1966, pak muaj para ditëlindjes së tij të 100 - të. Fjala e tij e fundit para se të shkonte të flinte, natën që ai vdiq, ishte "Aleluja!". Falënderoj Zotin për bekimet e tij, të cilat kalojnë nga një brezni në tjetrën. Dua të falënderoj Mal Berishën i cili kurrë nuk e ka njohur personalisht Charles Telford Erickson, por është frymëzuar nga përpjekjet e tij heroike, që ai ka bërë një shekull më parë, mësoi për të dhe tani po ndan me ne dhe popullin shqiptar historinë e tij. E tërë familja dhe farefisi Erickson, u entuziazmuan kur mësuan se këtë vit, në 2012, festohet 100-vjetori i Pavarësisë, dhe lutemi për bekimet e Zotit për këtë ngjarje historike.

Mary Alice Morris

Jam e bija Paulit. Babai im ishte fëmijë katër vjeç kur shkoi bashkë me gjysh Erikun, gjyshe Carrie-n, teze Lois-in dhe Earl-in e shkretë që nuk u kthye më, në Shqipëri. Duke qenë se jam mbesa e katërt, më e vogla nga nipërit dhe mbesat, kujtimet e mia për gjysh Erikun janë të kufizuara. Më kujtohet që ai ishte një burrë i afrueshëm dhe me dinjitet. Momentet e tij të humorit, nganjëherë edhe me spec e të papritura, ishin prapëseprapë të mirëpritura. Kjo tregonte se njeriu mund të kënaqet, por në të njëjtën kohë mund t'i përmbahet etikës.

Një nga kujtimet e mia, që më ka mbetur në mendje, është koha kur e vizitova gjysh Erikun në shtëpinë e tij të bukur në Kaliforni, për ta ndihmuar në festimin e datëlindjes së tij të 69 - të. Atë të diel ai do të predikonte si i ftuar në kishën e lagjes. Unë vajta me të dhe u mrekullova nga predikimi i tij. Ai pasqyroi të gjithë Biblën në jetë, duke treguar se si ajo ka pasur dhe ka ende lidhje me jetët tona. Ai tregoi se si dashuria për Zotin dhe ndjekja e mësimeve të tij ishin një ndërmarrje e lumtur dhe jo një detyrë që duhej duruar. Gjysh Eriku më ndihmoi që të ndryshoja jetën time, krejtësisht, pasi deri në atë moment unë isha shumë e çrregullt. Ajo nuk ndryshoi menjëherë, por gjysh Eriku mbolli farat për të mirën time, duke më ndihmuar për t'u bërë ajo që unë kisha menduar. Ai e kishte atë dhunti.

Donald Johnson

Unë quhem Donald. Jam djali i Grace-t dhe nipi më i vogël i Erickson-it. Nëna ime Grace Elizabeth Johnson u lind në gjendje internimi nga turqit në Manastir, me datën 19 gusht 1911. Gjysh Erikun, me sa mbaj mend unë e kam takuar vetëm një herë kur kam qenë pesë vjeç, por ky kujtim është i gjallë edhe sot.

Familja jonë e madhe ishte me pushime në një shtëpi vere pranë një lumi në shtetin e New Hampshire. Si një fëmijë shumë i lëvizshëm, unë doja që t'i bashkohesha familjes në të gjitha veprimtaritë. Megjithatë, për shkak të frikës sime, familja refuzoi që të shkoja me ta në një shëtitje me varkë në liqen, duke më thënë që ishte shumë e rrezikshme dhe se unë isha shumë i vogël. Kështu që unë u ula në fund të dokut

dhe prita i inatosur kthimin e familjes sime, duke llokoçitur ujin me këmbë, kur papritmas vura re që gjysh Eriku, i cili nuk kishte shkuar në shëtitjen me varkë, po më afrohej nga pas. Ai ishte rreth nëntëdhjetë vjeç në atë kohë. Pa thënë asnjë fjalë, ai i hoqi këpucët dhe çorapet, ngriti pantallonat dhe u ul pranë meje. Gjysh Eriku filloi të godiste ujin së bashku me mua. Unë u ndjeva i pushtuar nga dashuria e tij dhe e humba inatin tim fëmijëror.

Dashuria e përhershme për gjysh Erikun vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Paul Erickson Jr.

Unë quhem Paul, jam djali i Paulit, vëllai i Mary Alice, dhe nipi i pestë më i vogël i Charles Telford Erickson-it. Me aq sa më kujtohet, burri që anëtarët e familjes e quanin "gjysh Erik" ishte dhe vazhdon të jetë frymëzuesi kryesor për mua. Ai ishte modeli i një jete të jetuar më së miri. Rrjedha e jetës sime, deri diku, ka ndjekur shumë shembullin e gjysh Erikut. Unë u rrita në qytete të vogla, por ai më hapi sytë ndaj një bote më të gjerë – udhëtimet e mia më kanë çuar në një duzinë vendesh. Përkushtimi vetëmohues i gjysh Erikut ndaj Shqipërisë u bë një shembull për mua që të shërbej në Afrikë, si në Kenia dhe në Liberi, si një mësues. Gjuhët e huaja kanë një interes të madh për mua, falë frymëzimit dhe shembullit të gjysh Erikut. Vullnetarizmi dhe shërbimi publik kanë qenë të ndërthurura gjatë gjithë jetës sime.

Me tërë ato arritje të mrekullueshme, Charles Telford Erickson-i, ka qenë një gjigant, në supet e të cilit unë kam qëndruar. Prandaj ndihem me fat që jam nipi i tij.

Faye Marie Johnson Alverson

Unë jam mbesa e gjashtë në radhë e gjysh Erikut. E mbaj mend që kur ishte në pension, aty nga fillimi i viteve 1940. Por nuk e kisha njohur ende deri vonë.

Mësova prej tij se puna që kishte bërë në Shqipëri pengohej aq shumë prej të huajve. Sa herë u detyrua të arratisej, sa pengesa i dolën në përpjekjet e tij për të bërë gjëra të mira për Shqipërinë!? Në të vërtetë çdo njeri i zakonshëm do të ishte lodhur dhe do të kishte hequr dorë. Por gjysh Erikut këto pengesa vetëm ia dyfishonin përkushtimin. Deviza e tij ishte: "Kurrë mos u dorëzo!" Përkushtimi i tij dhe jeta rrëzohu e çohu shumë e shumë herë e çoi atë drejt suksesit të jashtëzakonshëm. Shembulli i tij ka qenë një mësim i madh, frymëzues dhe i vlefshëm gjatë tërë jetës sime. Ai ishte një njeri që mërzinë e shprehte me vjersha si kjo, botuar në librin "Njeriu i vogël dhe kozmosi". Për shembull:

Ah, ti Tokë e përhime, e sosur, vjetërsirë,
Ku është ajo nënë që të lindi n'errësirë,
Ty, fëmijë bastard, bijë e një Dielli bredharak,
Që Ferrin e përvëluar ke, dhe djep, dhe shtrat?

Nuk ka kënaqësi që fillon pa dhimbjen e vet,
Djemtë tuaj mallkuar me shenjën e Kainit, ditë e net!
Zvogëluar, e prerë me zjarr e hekur ndarë,
Fëmijët tuaj të verbër – hordhi, lypsarë.

Lëri ata që do mbajnë zgjedhën tënde mundimplotë,
Të mallkuar – stërkalur, në kobin tënd nëpër botë,
Edhe unë ju mallkoj, pse jeni një dështake,
Një yll bastarde e rënë, bredharake.[264]
(fragment)

Më vonë e takoja në Claremont, Kaliforni. Aty ndieja qetësinë dhe mirënjohjen e thellë të tij. Ai i tejkalonte të tëra vështirësitë me dashuri për botën e bukur dhe tërë natyrën e gjallë. Veçanërisht ai i donte zogjtë. Kështu e shprehte ai gëzimin duke shkruar poezi. Si për shembull:

[264] Little man and the Cosmos, Poetry by Charles Telford Erickson, 1957.

E gjej:
Kamjen në flori të perëndimit,
Bukurinë tek hëna dhe tek yjet,
Hijeshinë në lulëzimin e trëndafilit,
Forcën tek malet dhe tek pyjet.

Gëzimin në këngën e këndezit,
Qeshjen në lindjen e hënës,
Shpresën në freskinë e mëngjezit,
Dritën në largimin e errësirës.

Kjo është madhështia e të qenit,
Mrekullia e jetës fshehur pa u parë,
Që rrethon tokën tonë me qiellin,
Dhe brishtësinë tonë me Zotin e pandarë.[265]

[265] Po aty.

MBYLLJE

Erickson-i, përveç tërë këtyre që u thanë në këtë libër, e përjetësoi emrin e vet si një mik i pashoq i kombit shqiptar kur shkroi një seri librash. Për këtë ai studioi në bibliotekat më serioze të botës, prej Muzeut Britanik, Bibliotekës së Stambollit, Universitet Yale, Bibliotekës së Uashingtonit etj. Në librat e tij, të cilët deri tani njihen pesë, të pabotuara deri sot, lexuesi do të gjejë referenca nga autorë të famshëm, albanologë, udhëtarë, studiues të kombit shqiptar, që nga antikiteti deri në shekullin e njëzetë. Ai iu referohet autorëve më në zë të gjithë kohërave, të cilët kanë studiuar dhe shkruar për popullin shqiptar, gjenezën e tij dhe figurat e tij të shquara historike.

Librat e tij: "Mbretëria e vogël, po më pas?", në dy vëllime, "Saga e shqiptarëve", "Njeriu i vogël dhe kozmosi"[266], "Ky fryt i pazakonshëm" dhe "Enigma e Ballkanit", të gjithë përbëjnë një enciklopedi të vërtetë për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ndoshta Erickson-i është një prej studiuesve të rrallë, që e ka përshkruar historinë e kombit tonë në një kohë shtrirjeje kaq të gjatë, që prej pellazgëve, ilirëve, epirotëve, e deri në kohën moderne. Ai është po ashtu studiuesi më i guximshëm, që e thotë hapur se shqiptarët janë populli që i ka dhënë njerëzimit Aleksandrin e Madh, Pirron e Epirit, Konstandinin e Madh, Diklecianin, Justinianin, të tërë së bashku

[266] Ky është një libër me poezi, i vetmi i botuar dhe nuk është përfshirë në këtë botim.

13 perandorë romake dhe bizantinë. Këto fakte, vetë ne shqiptarët ngurrojmë t'i pohojmë, megjithëse kemi shumë më shumë arsye për t'u mburrur me ta, sesa ata që ngrenë monumentet e tyre edhe pse nuk kanë asgjë të përbashkët. Ndërsa ne… heshtim. Erickson-i me argumente pohon origjinën e tyre, madje duke përmendur qartë edhe vendlindjen e tyre në trojet ilire. Në këtë aspekt, puna e Erickson-it merr vlera edhe më të mëdha në pikëpamje akademike. Ai nuk mbetet thjesht një njeri i dashuruar me kombin shqiptar, por edhe një njeri që i kontribuon me çdo mjet, përfshirë studimet historike. Vëllimet që do të pasojnë këtë monografi të jetës së tij, do të na japin një pasqyrë të plotë të veprës së tij akademike.

Lexuesi shqiptar do të ketë rastin të mësojë më shumë jo vetëm për përkushtimin e Erickson-it, por edhe për vetë historinë tonë të madhe dhe kontributin e dhënë ndaj njerëzimit. Ajo çfarë bëri Erickson-i me veprat e tij kishte qëllim të na bënte ne shqiptarëve krenarë për atë çfarë jemi. Unë jam krenar që më është dhënë mundësia dhe rasti i lumtur që ta zbuloj, sistemoj, përkthej dhe sjell përpara lexuesit shqiptar këtë korpus të madh veprash të tij. Me këtë rast dua të theksoj dy gjëra:

Erickson-i më ka bërë të kuptoj më mirë shumë veprime të bashkëkombësve të mi dhe të miat vetë. Më ka bërë të jem shumë më krenar për atë çfarë jam. Kjo më bën t'i them edhe një herë faleminderit.

Gjëja e dytë është që ai ishte një misionar. Si i tillë ai iu kushtua një çështjeje të madhe, asaj të kombit shqiptar. Ndërsa unë i vura vetvetes një mision: Të mos e lë të mbetet në harresë veprën e këtij njeriu për ne shqiptarët. Prandaj, mendoj se puna e këtyre viteve ia kanë vlejtur, për t'u kujtuar edhe një herë shqiptarëve virtytin e tyre më të lartë, që çdo i huaj e ka vlerësuar aq lart tek ne: Mirënjohjen.

Në këtë aspekt puna që kam bërë është fryt i këtij virtyti shqiptar:

Mirënjohje ndaj këtij njeriu që shkriu jetën për ne.

Erickson-i i jetoi vitet e tij të mbetura në Pilgrim Place, Kaliforni, një vend i qetë, i caktuar për misionarët e huaj të pensionuar. Dua ta mbyll këtë libër për t'i lënë vendin historisë së shqiptarëve me titull "Shqiptarët – Enigma e Ballkanit" duke pohuar:

Ai erdhi në Shqipëri si misionar, u kthye në edukator, u transformua në politikan, punoi dhe veproi si diplomat, kërkoi fushave të naftës si inxhinier, shkroi si historian, meditoi si filozof, frymëzoi si patriot dhe…iku si njeriu më i dashur i Shqipërisë.

Faleminderit, i dashur Erickson!

Londër, shtator, 2012

FOTO ALBUM

Mathias Erickson, babai i
C.T. Ericksonit në uniformën e tij
gjatë Luftës Civile,
ku shërbente si borizan i një
rregjimenti, në vitin 1864.

▲

Nëna e Ericksonit,
Mary Holmberg,
1861.

▲

Carry Earl Erickson, gruaja e parë e Ericksonit, nëna e pesë fëmijëve të tij, e cila kaloi vite të tëra në Shqipëri.

Mary Holberg, nëna e Ericksonit në moshën 106 vjeçare.



Ericksoni në rrobat
e klerikut të
Kishës Kongregacionale.

Ericksoni dhe
bashkëshortja (e dyta)
Alice Welsher Erickson.

Në moshën 98-vjeçare
me bashkëshorten Alice
dhe nipin Bob Johnson

Alice Erickson,
bashkëshortja e
Telford Ericksonit,
Doris Erickson,
bashkëshortja e Paulit,
Pauli dhe e bija Grace,
viti 1945.

Ericksoni me nipin,
Paul Telford Erickson, Jr,
te shtëpia e tij në Kaliforni
në vitin 1958.

▲

Ericksoni me mbesën
Patricia, vetë në mes
dhe dy vajzat e tij.

▲

Vajza e Ericksonit, Grace Elizabeth Johnson – Erickson, lindur në datën 19 gusht 1911, ndërsa familja ishte në internim nga Elbasani në Manastir. Fotografia është e datës 19 gusht 2012, në 101 vjetorin e lindjes së saj. Ajo ende jeton në një shtëpi pleqsh në Boston.

Ericksoni në studion e tij në moshë shumë të thyer.



Ericksoni në shtëpinë e tij
në Kaliforni. Pas tij duket
Medalja e Skënderbeut.
Viti 1960.

▲

Ericksoni me dy vajzat
dhe dhëndrrin e tij

▲

Alice Erickson, Doris Erickson,
bashkëshortja e Paulit,
Telfordi i biri i Paulit dhe
e bija e Grace,
viti 1945.

▲

Djali i Ericksonit, Pauli,
i lindur më 4 korrik 1904.
Ai erdhi në Shqipëri
4 vjeç dhe jetoi 4 vjet të tjera
në Tiranë dhe në Elbasan.

▲

Ericksoni me bashkëshorten Alice, mars 1961.

Nipi i Ericksonit, Pauli, në moshën 17-vjeçare me motrën e tij Mary Alice, 13 vjeç, viti 1957.

Ericksoni me bashkëshorten
Alice, viti 1943.

▲



Foto shkollore e
Paul Telford Erickson, Jr,
kur ishte 6 vjeç.

▲

Paul Telford Erickson, i biri i Charles Telford Ericksonit me të birin, Paul Erickson Jr, kur ky i dyti ishte 1 vjeç.

Pauli, i biri i Telfordit, viti 1941.



▼

Paul Telford Erickson, Jr, lindur
më datën 1 prill 1938.

▼

Charles Telford Erickson me bashkëshorten
Alice, në moshë të thyer.

▼

Ericksoni me Medaljen e Skënderbeut
në festimet e 25 vjetorit të Pavarësisë së
Shqipërisë, Tiranë, 28 nëntor 1937.



BARON FRARY VON BLOMBERG
PROMINENT FIGURE IN
INTERNATIONAL RELATIONS

Probably knows more Royalty than any other person in the United States

SUBJECTS FOR HIS LECTURES
ARE:

1. "Unusual People in Unusual Places"
2. "Little Known Religions of the World"
3. "Living on Five Iron Curtains
4. "Spiritual Needs of the World"
5. "Continents in Conflict"
6. "Royalty I Have Known"
7. "Refugee Problems of the World"

American Scan. Adopted by the late Baroness Adelheid Maria von Blomberg, whose title is one of the oldest in Europe.

In in America after many years in Europe, the Middle East and Africa. The Baron brings his experiences in palaces of Kings, caves of refugees, and rondavels of the jungles. The Baron has a long career in International Relations and has not only served as advisor to Royalty in Exile but to world refugee organizations. He has served as advisor to the Royal Government of Greece, the Polish Government in Exile, King Zog of Albania, King Farouk of Egypt, and to many international personalities and groups. He lived many months in Israel on the border of no-man's land, meeting Jewish leaders and the people of kibbutzims. He is also intimately acquainted with the leaders of the Arab world and the Palestinian refugees. Baron von Blomberg served some months in Austria with Hungarian refugees and made intensive speaking tours in Switzerland, Spain, and the Union of South Africa. In the course of his tour he has spoken to groups of 30,000 and 30 and has interviewed and met most of the world leaders in the areas through which he has worked and traveled.

The Baron will be in this country for a speaking tour from September 1st, 1959 until February, 1960. He will then return abroad.

MARSH PROGRAM SERVICE
28 WALNUT PLACE, NEWTONVILLE 60, MASS.
Tel. Bigelow 4-6544 Tel. EVergreen 5-6855

▼

Blomberg, një mik i Familjes Mbretërore
Shqiptare dhe i C.T. Ericksonit

THE HARTFORD DAILY COURANT: SUNDAY, JANUARY 29, 1928.

HARTFORD MISSIONARY TURNS PATRIC

C. T. Erickson, Former Local Minister, Once Persecuted by the Turks, Founds School of Agriculture in Albania, Which He Helped Make Free

Gazeta Harford Daily shkruan për Ericksonin si patriot shqiptar.



Bibliotika ku ruhet fondi i dokumentacionit të C.T. Ericksonit



Letra në shqip e shkruar nga Ericksoni, drejtuar miqve të tij shqiptarë.

Nxënëse e Shkollës së Vajzave të Kavajës.

Foto e një grupi nxënësesh të Shkollës së Vajzave të Kavajës.

Salla kryesore e Shkollës Bujqësore të Kavajës në kohën kur atë e drejtonte Ericksoni, foto e bërë prej vetë atij.

Fillimet e punës së shkollës bujqësore të Kavajës, 1926.



Shkolla Kavajë në kohën e Erickson-it

Një prej mësuesve amerikanë të shkollës, Burch Shnaider.

Foto e Shkollës Bujqësore të Kavajës e përdorur si kartolinë nga mësuesit e saj, suvenir i mësuesit Ali Cungu